



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Mbi

**“Auditimin financiar dhe të
Përputhshmërisë në Bashkinë Shkodër.**

SHTATOR 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

📖 PËRMBAJTJA:

NR EMËRTIMI I KAPITULJVE

I

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Faqe 4-22

HYRJA

23-28

- a. *Objektivat dhe qëllimi*..... 23
- b. *Identifikimi i çështjes*..... 23-24
- c. *Përgjegjësitë e strukturave drejtuese*..... 24-25
- d. *Përgjegjësitë e audituesve*..... 26
- e. *Kriteret e vlerësimit*..... 26-27
- f. *Standardet e auditimit*..... 27-28

III PËRSHKRIMI AUDITIMIT

28-29

IV GJETJET DHE REKOMANDIMET

30-208

- A. *Auditim mbi planifikimin dhe identifikimin e riskut, strategjia dhe vlersimi i riskut dhe kontrolli i brendshëm*..... 30-42
- B. *Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik dhe ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017, me ndryshime e tij; ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”* 42-73
- C. *Vlerësimi i Raportimit Financiar, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në, udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisive që varen prej tyre si dhe të njësisive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”; për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2017-2018, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë*..... 73-95
- D. *Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797 datë 29.12.2017, zbatimi kontratave* 95-187
- E. *Mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm*..... 187-196
- F. *Rekomandime*..... 196-210

V ANEKSE

210-243



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standartet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektraportit të Auditimit:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Shkodër në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 405/1prot, datë 28.05.2019, me afat auditimi nga data 05.06.2019 deri në datën 09.08.2019, për periudhën nga 01.01.2017 deri më 30.06.2019.

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, monitorimi i tyre nga auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Shkodër, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura, për realizimin e nevojave për mallra, shërbime dhe investime. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar 2100 transaksione financiare nga SIFQ¹, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur tre zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230- 231 “investime”, si dhe u auditua zhvillimi i 20 procedurave të prokurimit, ose 64 % e fondit të prokuruar, nga të cilat 9 procedura "Tender i hapur" në masën 67 % të fondit limit të prokuruar dhe 11 procedura të llojit "Kërkesë për propozime" në masën 68 % të fondit limit për periudhën objekt auditimi, mbi anagazhimin e fondeve për kryerjen e tyre; përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit; përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës; vlerësimin e ofertave etj., në përputhje me kriteret e paracaktuara.

I.b. Përmbledhje e gjetjeve kryesore:

Gjetja nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në RPA	Rëndësia	Rekomandimi
1	<i>-Për vitin 2017 buxheti është realizuar në masën 76% ose nga 3,165,026 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 2,395,740 mijë lekë, ndërsa për vitin 2018 është realizuar në masën 77% ose nga 3,342,581 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 2,569,341 mijë lekë. Në zërin investime, buxheti për vitin 2017 është realizuar në masën 42,4% ose nga 720,908 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 306,161 mijë lekë, nga të cilat financim me të</i>		I lartë	<i>-Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Shkodër të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.</i>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	<p><i>ardhurat e veta në vlerën 215,100 mijë lekë ose 39,8%. Ndërsa për vitin 2018 është realizuar në masën 44% ose nga 726,040 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 316,978 mijë lekë, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 261,513 mijë lekë ose 40,1%. Për periudhën janar-qershor 2019 është realizuar në masën 42% ose nga 3,394 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 1,411 mijë lekë.</i></p> <p><i>Të ardhurat e veta, për vitin 2017 është realizuar në masën 99% ose nga 621,886 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 612,686 mijë lekë, dhe për vitin 2018 është realizuar në masën 104% ose nga 678,761 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 703,176 mijë lekë.</i></p> <p><i>Veprime dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.</i></p>			
2	<p>-Sipas të dhënave të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2018, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në</p>		I lartë	<p>-Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës, bazuar në Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

<p>llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 142,899,482 lekë, ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën 59,234,048 lekë, për 47 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 37,206,747 lekë, për 118 raste; detyrime për vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 30,098,764 lekë, në 23 raste dhe detyrime të tjera në vlerën 16,359,923 lekë, për 22 raste.</p> <p>Ndërsa vlera faturave të palikujduara gjendje në 30.06.2019, të pasqyruara në llog 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 51,972,676 lekë, ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën 20,681,950 lekë, në 15 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 837,772 lekë, në 8 raste; detyrime për vendimet e gjykatave të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 28,737,232 lekë, për 20 raste dhe detyrime të tjera në vlerën 1,665,722 lekë, për 2 raste.</p> <p>Veprimet apo mos veprimet janë në kundërshtim me:</p> <ul style="list-style-type: none">-Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), Neni 40⁽²⁾- E drejta për të kryer shpenzime,-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014.-Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”,		<p>Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pikat 116-117- Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën 51,972,676 lekë, sipas Aneksit bashkangjitur mbi gjendjen e faturave të palikujduara me datën 30.06.2019, e rakorduar kjo me pasqyrën e dërguar në Ministrinë e financave.</p>
---	--	---

²⁾ Ndryshuar me ligjin nr. 57/2016.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.			
3	<p>-Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2017 janë mbyllur me vonesë, nga Bashkia Shkodër, pasi me shkresën nr.8014, datë 23.05.2018, janë dërguar në Degen e Thesarit Shkodër, pra me mbi dy muaj vonesë. Ndërsa për vitin ushtrimor 2018 janë dërguar me shkresën nr.7026, datë 26.04.2019, konfirmuar nga dega e thesarit me nr.783, datë 30.04.2019, pra me një muaj vonesë.</p> <p>Veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtime me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, Neni 9, pika 4, germa (d) dhe Neni 12, pika 2, germa (b), si dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 118</p>		I lartë	-Nëpunësit autorizues dhe Nëpunësit zbatues të marrin masa për hartimin në afat të pasqyrave financiare, në vitet në vijim.
4	<p>-Në pasqyrat e konsoliduara, gjendja e llogarisë 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 69,305,204 lekë, kurse në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën 123,462,513 lekë, e cila përfaqëson vlerat e studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investime, të kryera gjatë periudhës së auditivit dhe investimeve të kryera ndër vite.</p> <p>Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:</p> <p>-Vlera 15,007,412 lekë, janë vlera e projekteve për investime të pa financuara.</p> <p>-Vlera 77,241,703 lekë, janë vlera e projekteve të financuara për investimet në proces.</p> <p>-Vlera 5,494,886 lekë janë vlera e projekteve të financuara për investimet në proces, nga njësitë vartëse.</p> <p>-Vlera 25,718,512 lekë i përkasin</p>		I lartë	-Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për vlerën 25,718,512 lekë , llogaria 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” duhet të pakësohet dhe kjo vlerë të shtohet në investimet e përfunduara sipas objekteve që u përkasin projektet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	<p>studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investimet e kryera në periudhën para vitit 2017, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara.</p> <p>Nga vlera e totale prej 123,462,513 lekë, duhet sistemuar vlera 25,718,512 lekë e studimeve dhe projekteve për investimet e kryera ndër vite, në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit. Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.</p>			
<p>5</p>	<p><i>-Në pasqyrat e konsoliduara gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në fund të vitit 2018, paraqitet me një vlerë 6,284,216 lekë e pa ndryshuar, nga viti mëparshëm.</i></p> <p>Konstatohet se:</p> <p>-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.</p> <p><i>-Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016</i> “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 48, shtojca me nr.46, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Shkodër, me numur rendor nga 1(një) deri 2160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Në këtë</p>		<p style="text-align: center;">I lartë</p>	<p>- Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit dhe Pyjeve, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për inventarizimin, evidentimin dhe regjistrimin në Pasqyrat Financiare, të pronave , <i>Pyje, kullota, plantacione.</i></p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	<p>rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96.</p>			
6	<p>-Në pasqyrat e konsoliduara gjendja e llogarisë 44 “Institucione të tjera publike” paraqitet në fund të vitit 2017 dhe në fund të vitit 2018 me të njëjtën vlerë prej 3,000 lekë, e cila përfaqson detyrime të Bashkisë, ndaj shtetit të trashëguar nga Nj A Shalë, nga viti 2015. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se, vlera prej 3,000 lekë duhet të derdhet në buxhet të shtetit.</p>		I lartë	<p>-Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës, të marrë masa për të derdhursistemuar llogarinë 44 “Institucione të tjera publike” duke derdhur në buxhet të shtetit, vlerën prej 3,000 lekë.</p>
7	<p>-Në pasqyrat e konsoliduara gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në pasiv të bilancit në vlerën 67,910,088 lekë, e cila përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh, gjendje më 31.12.2018. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:</p> <p>-Vlera 8,059,901 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2016, kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin bashkangjitur për këtë qëllim në vlerën e sipër cituar prej 8,059,901 lekë, sipas aneksit bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit.</p>		I lartë	<p>-Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit dhe Pyjeve, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për inventarizimin, evidentimin dhe regjistrimin në Pasqyrat Financiare, të pronave , Pyje, kullota, plantacione.</p>
8	<p>-Nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Sektori i Sinjalistikës, Transportit dhe Mobilitetit, Bashkia Shkodër, nuk është vepruar për të pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për</p>		I lartë	<p>-Nga Bashkia Shkodër, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës 8,000,000 lekë, sipas aneksit nr.1, bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit, detyrime të pa arkëtuara nga</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	<p>përdorim nga konsumatorët fundorë dhe nuk janë arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, të trajtuara në aneksin nr.B/4. jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kapitulli II, pika 1; germa “b”; pika 9 dhe të VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar me VKB nr.84, datë 26.12.2017 dhe VKB nr.79, datë 04.12.2018, kapitulli II.4.5.1, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Shkodër, sipas aneksit nr.1, në 8 raste në vlerën 8,000,000 lekë.</p>			kontratat e qirave.
9	<p>-Nga auditimi i kryer për planifikimin, realizimin e të ardhurave nga dhënia me qira e asteve, konstatohet se nga Bashkia Shkodër, Zyra e Aseteve, nuk kanë kryer plotësisht monitorimin për të arkëtuar detyrimin sipas kontratave të qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Shkodër dhe shoqërive private, për dhënien me qira të asetëve, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kapitulli VI, pikat 1,2,9 e 10, sipas aneksit nr.1 me pasojë, dëm ekonomik</p>		I lartë	<p>-Nga Bashkia Shkodër, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës 2,524,805 lekë, sipas aneksit nr.2, bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit, detyrime të pa arkëtuara nga kontratat e qirave.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	<i>në Buxhetin e Bashkisë në vlerën 2,524,805 lekë.</i>			
10	<p>Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Shkodër për periudhën objekt auditimi, nuk ka vlerësuar si duhet riskun, dhe për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10 2016, “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”</p>	E lartë	<p>Njësia e Auditimit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për cdo auditim.</p>
11	<p>Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 966 persona me vlerë 235,048,927 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Shkodër, sipas listës së administruar me CD</p>	E lartë	<p>Bashkia Shkodër, nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 235,048,927 lekë .</p>
	Në auditimin e dokumentacionit			Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

<p>12</p>	<p>ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 4195 subjekte për vlerën 543,695,300 lekë (sipas listave të administruara me CD).</p> <p>-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet.</p>	<p>.....</p>	<p>E lartë</p> <p>Shkodër, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të paarkëtuara të subjekteve fizik/ juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura ndaj 4195 subjekte për vlerën 543,695,300 lekë (sipas pasqyrave që disponon, marrë në CD), bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:</p> <p><i>a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.</i></p> <p><i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.</i></p> <p><i>c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i></p> <p><i>d- Dhe në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë së Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave dhe Drejtorisë Juridike, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre</i></p>
-----------	--	--------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

				masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.
13	Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2018, janë gjithsej debitorë 37302 familje për vlerën gjithsej 351,468,284 lekë (për taksë toke në vlerën 12,917,007 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 129,754,321 lekë, për taksë trualli në vlerën 3,516,124 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 205,280,832 lekë	E lartë	Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër të marrë masa dhe të kërkojë arkëtimin debitorëve për 37302 familje për vlerën gjithsej 351,468,284 lekë , sipas të dhënave të disponon, duke dërguar njoftim vlerësimet abonentëve familjarë me postë, për: -Taksë toke në vlerën 12,917,007 lekë; -Taksë ndërtese në vlerën 129,754,321 lekë; -Taksë trualli në vlerën 3,516,124 lekë; -Tarifa shërbimi në vlerën 205,280,832 lekë.
14	Mbi vlerësimin ofertave: Në 8 nga 20 procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2018, nga auditimi janë konstatuar shkelje të LPP, VKM dhe DT. <u>Tender i hapur</u> "Rruga Lugoçesme", "Rruga Rragam-Sheldi" "Vllaznimi " "Rikualifikim Zogu I" <u>Kërkesë për propozim:</u> "Rruga e Mushanit" "Rruga Bashej" "Ndriçim i rrugës Ura e Bardhajve" "Rruga Oblikë-Velinaj" 1. Në 6 (gjashtë) raste në procedurat e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion Rruga Lugoçesme", "Rikonstruksion Rruga Rragam-Sheldi" "Rikonstruksion Rruga Vllaznimi" "Rikonstruksion Rruga e Mushanit", "Rikonstruksion Rruga Bashej" dhe "Rikonstruksion Rruga Oblikë-Velinaj", nga ana e KVO-ve për të njëjtat kriteret të papërbushura, mosparaqitje e		I lartë	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

<p>dokumentacionit të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none">-<i>Certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm;</i>-<i>Certifikatë për transport mallrash brenda vendit për të tretë, për të cilat disa OE pjesëmarrës në garë, janë skualifikuar, ka rezultuar se ju mungojnë edhe OE të shpallur fitues në këto procedura. KVO ka vepruar me dy standarde dhe në kundërshtim me:</i> <p>LPP, me ndryshime, neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 3, duke shkaktuar dhe përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 43,100,735 lekë, respektivisht:</p> <p>Rikonstruksion Rruga "Rragam-Sheldi", në shumën 16,638,245 lekë; Rikonstruksion Rruga "Vllaznimi" në shumën 17,234,990 lekë; Rikonstruksion Rruga "Mushanit" në shumën 9,227,500 lekë.</p> <p>2. Në 2 (dy) raste në procedurat e prokurimit me objekt: Rikonstruksion Rruga "Oblikë-Velinaj" me fond limit 7,610,563 lekë pa TVSH dhe Rikonstruksion Rruga "Bashej" me fond limit 6,879,166 lekë pa tvsh, KVO duhet të anulonte procedurën, pasi nga auditimi rezultoi se asnjë prej OE në garë nuk plotësonte kriteret e kualifikimit. KVO ka vepruar në kundërshtim me LPP neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 3, duke shkaktuar dhe përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 14,489,729 lekë.</p> <p>3. Në 7 (shtatë) raste, KVO-të në mënyrë të padrejtë kanë përdoruar</p>			
--	--	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	<p>si kriter skualifikimi, një kriter i cili nuk është i specifikuar në DT. Konkretisht, në 6 raste në DT është kërkuar që OE duhet të paraqesin "Certifikata për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme)", dhe janë skualifikuar se kanë paraqitur "Certifikatë për transport mallrash brenda vendit për përdorim të vet (të vlefshme)" dhe në një rast kanë kërkuar pagesën e taksës së qarkullimit e pakërkuar në DT. KVO-të kanë vepruar në kundërshtim me LPP me ndryshime, neni 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", pika 2 dhe Dokumentet e tenderit, pika 2.3.10/11.</p> <p>4. Në një rast, "Rikualifikim i bllokut të banimit Bulevardi Zogu I" është bërë kualifikimi pa plotësuar dokumentet e kërkuara në KVK, duke shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 15,766,715 lekë pa tvsh.</p>			
15	<p>Përsa i përket përcaktimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, konkretisht "Kapacitetit teknik", u evidentua fakti se NJP, nuk ka përdorur të njëjtin standard mbi dokumentacionin që duhet të paraqitet për mjetet me rrezikshmëri të lartë. Në DT pika 2.3. "Kapaciteti teknik" në disa raste (procedura) është kërkuar që OE të paraqesë "Certifikatë transporti për mallrat të rrezikshëm" dhe në disa procedura nuk është vendosur ky kriter. Veprim në kundërshtim me LPP, neni 1 "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa d.</p>		I mesëm	Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke vendosur në Dokumentet e Tenderit, kërkesa të njëjta për përmbushjen e kriterëve të njëjta për kualifikim, nga ana e Operatorëve Ekonomikë.
16	<p>Përsa i përket përcaktimit të kriterëve të veçanta për kualifikim konkretisht "Kapacitetit teknik", u evidentua fakti se NJP, në DT për të përmbushur kriteret mbi automjetet, ka kërkuar një sërë dokumentacioni ku bën pjesë edhe pagesave e taksave. Kjo kërkesë është e panevojshme, pasi paraqitja ose jo e mandatit mbi pagesën e taksave nuk sjell asnjë dobi, veçse bëhet shkak për</p>		I mesëm	Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kërkesave të panevojshme, duke përcaktuar dokumentacionin e duhur, për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, nga ana e Operatorëve Ekonomikë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	<p>skualifikim të padrejtë të OE. Fakti që duhet të paraqitet certifikata mbi kontrollin teknik të mjetit, është shterues edhe për pagesën e taksave.</p> <p>Ky veprim është në kundërshtim me LPP nenin Neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.</p>			
17	<p>Në 5 raste (procedura prokurimi) nga ana e anëtarëve të KVO-ve nuk është nënshkruar dokumentacioni i mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procesverbalin e hapjes së ofertave - Procesverbalin e shqyrtimit të ofertave - Raporti Përmbledhës - Formularin mbi konfliktin e interesit. <p>Veprime në kundërshtim me: VKM, neni 64 "Hapja e ofertave", pika 2 dhe 5, si dhe nenin 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.</p>		I mesëm	<p>AK dhe NJP të marrë masa për eliminimin e rasteve të tilla, duke kërkuar jo vetëm plotësimin e dokumentacionit mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit nga ana e KVO-ve, por edhe nënshkrimin e tyre, me qëllim lënien e gjurmës së auditimit, mbi veprimet e kryera.</p>
18	<p>U auditua zbatimi punimeve në katër objekte dhe konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - "Zbatim Rikualifikim Urban blloqe banimi "Tepe-tek Fusha e Druve" - "Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Qendër Dragoç" - "Rikonstruksion rruga e "Mandave" - "Rikonstruksion rruga e Shirqit". <p>U konstatua likuidimi i punimeve të pakryera në fakt, i cili konsiderohet si dëm ekonomik, shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Shkodër, si më poshtë (vlera pa TVSH):</p> <ul style="list-style-type: none"> - "Zbatim Rikualifikim Urban blloqe banimi "Tepe-tek Fusha e Druve" 243,320 lekë - "Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Qendër Dragoç" 262,860 lekë - "Rikonstruksion rruga e "Mandave" 107,690 lekë - "Rikonstruksion rruga e Shirqit" 731,549 lekë. 		I mesëm	<p>Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës së konstatuar si dëm ekonomik nga ana sipërmarrësve.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

19	<p>Në tenderin me objekt “Rikonstrukcion Rruga Udhakryq”, me fond limit 24,482,500 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE fitues “S. M. O. U.” shpk &”S. M. O. V.” shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 20,811,378 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, veprime në kundërshtim me: nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, neni 24 “Anullimi i një procedure prokurimi” pikën 5 e neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe neni 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Shpallja fitues e BOE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, janë veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve në vlerën 24,482,500 lekë.</p> <p>- Në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim rruga nacionale pika Ada – By Pass”, me fond limit 16,197,981 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE fitues “S. M. O. U.” shpk &”S. M. O. V.” shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 13,257,923 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, veprime në kundërshtim me: nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, neni 24 “Anullimi i një procedure prokurimi” pikën 5 e neni 53 “Shqyrtimi I ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe neni 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Shpallja fitues e BOE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, janë veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve në vlerën 16,197,981 lekë.</p> <p>Në procedurën e tenderit me objekt</p>	E lartë	Bashkia Shkodër të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomik, të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST dhe kualifikohen, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, pasi këta OE nuk japin garanci për kryerjen me cilësi të kontratës.
----	---	-------	----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	<p>“Skema ujitëse Bërdicë – Shkodër” me fond limit 26,466,971 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE fitues “Rr. G.” shpk &”Sh. A.” shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 16,323,443 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, veprime në kundërshtim me: nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” , neni 24 “Anullimi i një procedure prokurimi” pikën 5 e nenit 53 “Shqyrtimi I ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Shpallja fitues e BOE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, janë veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve në vlerën 26,466,971 lekë.</p> <p>- Në tënderin me object “Rikonstruksion rruga Dhimitër Frangu”, me fond limit 7,886,280 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE fitues “K. G. K.” shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 5,594,336 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, veprime në kundërshtim me: nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” , neni 24 “Anullimi i një procedure prokurimi” pikën 5 e nenit 53 “Shqyrtimi I ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Shpallja fitues e OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, janë veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve në vlerën 7,886,280 lekë.</p>			
20	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të rikërkua nga</p>		I lartë	<p>Bashkia Shkodër të hartojë një program pune për realizimin e rekomandimeve të pa zbatuara dhe</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

<p>KLSH me shkresën nr. 1005/57, datë 20.12.2018, rezultoi si më poshtë:</p> <p>A. MASA ORGANIZATIVE: Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Shkodër 34 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 12 masa, janë në proces zbatimi 21 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative për të cilën rikërkojmë zbatimin e masës.</p> <p>B. Masa Shpërblim Dëmi Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Shkodër 10 masa shpërblim dëmi në vlerë 8,907,702 lekë, të cilat nuk janë zbatuar.</p> <p>C. Masa për përdorimin me 3E të fondeve publike Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Shkodër 2 masa për përdorim me 3E të fondeve në vlerë 9,819,489 lekë, të cilat nuk janë zbatuar.</p>		të rikërkuara, dërguar me shkresën e KLSH nr. prot nr. 1005/57, datë 20.12.2018.
--	--	--

I.c. Opinioni i auditimit.

Opinion mbi Pasqyrat financiare të vitit 2018.

Opinion i kualifikuar

Përgjegjësia e Auditit të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar. Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, mbështetur në standardet (ISSAI 1700)³, ISSAI 1705 dhe (ISSAI 1200)⁴, shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Bashkisë Shkodër, duke aritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura. I njëjti opinion vlen edhe për pasqyrën e realizimit të buxhetit.

a-Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër, e cila përbëhet nga pasqyrat financiare (bilanci) të institucionit më 31 Dhjetor 2018, pasqyra e performancës

³ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

⁴ Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

financiare, pasqyra e flukseve monetare (cash'flow), pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, pasqyra e investimeve dhe burimet e financimit, pasqyra e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (kosto historike), pasqyra e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto), pasqyra e numurit të punonjësve dhe e fondit të pagave dhe pyetësor dhe shënime shpjeguese për pregatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

Në rrethanat e mësipërme, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për opinionin e kualifikuar (ISSAI 1705)⁵ të faktit se, jemi të pasigurt për disa çështje të konstatuara, të cilat janë *materiale*, me ndikim në vendimmarrjen e përdoruesit të pasqyrave financiare si:

Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë prapë e materialitetit prej 2% për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për opinionin e kualifikuar të faktit se jemi të pasigurt për disa çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave si:

-Në llogarinë 20 “**Aktive Afatgjata jo materiale**” është pasqyruar gabim **vlera 25,718,512 lekë, vlerë e cila i përket studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investimet e kryera në periudhën para vitit 2017, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara, e cila duhet sistemuar në llogaritë** përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit.

-Në llogarinë 211 “**Pyje, kullota, plantacione**” **nuk është pasqyruar vlera e 2160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) pronave të pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.**

-Në llogarinë 44 “**Institucione të tjera publike**”, pasqyrohet për disa vite detyrimi ndaj shtetit në vlerën prej 3,000 lekë e cila përfaqson detyrime të Bashkisë, ndaj shtetit të trashëguar nga Nj A Shalë, nga viti 2015 dhe nuk derdhet për llogari të buxhetit të shtetit.

-Në llogarinë 466 “**Kreditorë për mjete në ruajtje**” pasqyrohet për disa vite rresht, vlera 8,059,901 lekë, të cilat janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2016 dhe kësaj vlere nuk i është dhënë një zgjidhje për të njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumenteve dhe sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin bashkangjitur për këtë qëllim.

b-Nga auditimi mbi përputhshmërinë

Për drejtimin e Bashkisë Shkodër:

Ne kemi audituar përputhshmërinë^{6/7} e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të ligjeve rregullave dhe rregulloreve, termave apo kushteve të vendosura, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në fushën e prokurimeve publike.

⁵ Kur gabimet janë materiale por jo të përhapura, audituesi paraqet një opinion të kualifikuar.

⁶ Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

⁷ ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Auditimi ka përfshirë auditimin e 8 procedurave të prokurimit në vitin 2017, të 20 procedurave të prokurimit të zhvilluar në vitin 2018 dhe 4 procedurave të prokurimit të zhvilluara në 6 mujorin e I-rë 2019, bazuar në analizë risku⁸.

Opinion i pamodifikuar me "Theksim çështje":

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të procedurave të prokurimit, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e pamodifikuar me theksim çështje”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale dhe të përhapura, si dhe nuk kanë patur ndikim në realizimin e kontratave.

Baza për opinion e pamodifikuar me "Theksim çështje":

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme⁹, për të bazuar opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me përjashtim të disa çështjeve (jo materiale dhe të përhapura), për të cilat duam të tërheqim vëmendjen e subjektit, konkretisht:

Mbi përcaktimin e kriteve për kualifikim:

1. Përsa i përket “Kapacitetit teknik”, u evidentua fakti se NJP, nuk ka përdorur të njëjtin standard mbi dokumentacionin që duhet të paraqitet nga OE, për automjetin “Autobitumatriçe”. Në DT pika 2.3. “Kapaciteti teknik” në disa raste (procedura) është kërkuar që OE të paraqesë “Certifikatë transporti për mallrat të rrezikshëm” dhe në disa procedura nuk është vendosur ky kriter. Konkretisht, në procedurën me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Hidrovor Dobraq”, “Asfaltim i Rrugës Oblikë-Obot”, “Rikonstruksion Rruga Tepe-Vasijet”, “Rikonstruksion Rruga Tepe-Vasijet” etj, nuk është kërkuar dhe në “Rikonstruksion i Rrugës Lugoçesme” “Rruga Rragam-Sheldi”, “Rruga Vllaznimi” etj., është kërkuar. Veprim në kundërshtim me LPP, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa d dhe LPP, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1.

2. Përsa i përket “Kapacitetit teknik”, nga NJP, në DT për të përmbushur kriteret mbi automjetet, është kërkuar një sërë dokumentacioni ku bën pjesë edhe pagesave e taksave.

Kjo kërkesë e NJP, është e panevojshme, pasi paraqitja ose jo e mandatit mbi pagesën e taksave nuk sjell asnjë dobi, veçse bëhet shkak për skualifikim të padrejtë të OE. Fakti që duhet të paraqitet certifikata mbi kontrollin teknik të mjetit, është shterues edhe për dokumentet: (Leje qarkullimi të vlefshme dhe plotësuar saktë në të gjitha rubrikat e saj, dokument i lëshuar nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor që vërteton shlyerjen e detyrimeve pranë këtij institucioni, etj.). Sa më sipër, NJP, ka vendosur kërkesa të panevojshme mbi përmbushjen e kriteve për kapacitetin teknik, veprim në kundërshtim me LPP nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.

3. Përsa i përket përmbushjes së kriterit “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, NJP ka kërkuar që OE të paraqesin xhiro mesatare të tre viteve (2014, 2015 dhe 2016), ndërkohë që procedura do të zhvillohet më vitin 2018. Përsa i përket xhiros vjetore, NJP duhet të kërkonte të dhëna mbi xhiron vjetore të viteve 2015, 2016 dhe 2017 dhe pasqyrat financiare të viteve 2014, 2015 dhe

⁸ Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), Objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.

⁹ Objektivi i audituesve është të hartojnë dhe kryejnë ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojnë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

2016, në rast se procedurat zhvillohen përpara mbylljes dhe dorëzimit të pasqyrave financiare në administratën tatimore deri në 31.03.2018. NJP, duhet të përcaktojë kriteret të cilat vërtetojnë kapacitetin ekonomik sa më koherent të OE, referuar LPP, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, germa c.

Mbi miratimin e DT dhe administrimin e dosjeve nga NJP:

1. Në 5 raste nga ana e anëtarëve të KVO-së nuk është nënshkruar: Procesverbali i hapjes së ofertave; Procesverbali i shqyrtimit të ofertave; Raporti Përmbledhës; Formulari mbi konfliktin e interesit. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 64 "Hapja e ofertave" dhe neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.

Mbi zhvillimin e procedurave, vlerësimin e ofertave dhe shpalljen e fituesit.

Në dy raste në vitin 2017, në gjashtë raste në vitin 2018 dhe në dy raste në vitin 2019, është bërë kualifikimi i OE fitues pa plotësuar dokumentet e kërkuara në DST, duke shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Shkodër:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, janë përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi, të cilat duhet të mbështeten nga një sistem i kontrollit të brendshëm funksional. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të prokurimeve publike dhe përdorimin e burimeve financiare të vëna në dispozicion në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme¹⁰, nëse procedurat e prokurimit publik, nuk paraqesin anomali materiale, si nga ana sasiore dhe cilësore, nëse veprimtaria e subjektit të audituar në fushën e prokurimeve publike, është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatimin e procedurave të prokurimit publik, në përputhje me ligjet dhe rregullat, me përjashtim të rasteve kur kadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

¹⁰ **ISSAI 300** Parimet Bazë të Auditimit në lidhje me përputhshmërinë pohojnë se auditimi duhet të japë siguri të arsyeshme për zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimeve të paligjshme që mund të cenojnë ndjeshëm objektivat e auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 405/1 datë 31.05.2019 “Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Shkodër”, ndryshuar me shkresën nr. 405/2, datë 14.06.2019 "Njoftim për shtesë në grupin e auditimit", të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 05.06.2019-07.08.2019, në subjektin Bashkia Shkodër për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2017-30.06.2019, u krye auditimi “Auditim financiar dhe përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **A. Z., Përgjegjës Grupi**
2. **B. Z., kryeaudituese**
3. **P. Gj., Auditues**
4. **H. A., Auditues**
5. **R. G., Auditues**
6. **F. Ç., Ekspert i jashtëm**

Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Shkodër.

Marrësi: Projekt raporti i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Shkodër.

Procedura e ndjekur: Projekt Raport auditimi i dërgohet subjektit Bashkia Shkodër, pasi nga grupi i auditimit janë dorëzuar në protokoll aktet e mbajtura në lidhje me problematikat e konstatuara dhe nga subjekti me shkresat përcjellëse janë paraqitur kundërshtitë, të cilat pasi janë analizuar me kujdes, profesionalizim dhe paanshmëri, janë marrë në konsideratë ato raste të cilat kishin mbështetje ligjore, ndërsa për rastet e tjera të cilat kundërshtitë nuk mbështeteshin me argumente ligjore, nuk janë marrë në konsideratë dhe janë trajtuar në këtë projekt raport auditimi, i cili i përcillet subjekti për vërejtje.

Objektivat dhe qëllimi: Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2018 dhe dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me kuadrin rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve publike.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Gjithashtu, pjesë e Projektraportit të Auditimit do të jetë, opinionit mbi përputhshmërinë, nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (kriteret e paracaktuara).

Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Ai promovon përgjegjshmëri ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre, duke identifikuar dobësitë dhe devijimet nga ligjet dhe rregulloret, si dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm.

Mashtrimi dhe korrupsioni, për shkak të natyrës së tyre, përmbajnë elementë që janë në kundërshtim me transparencën, përgjegjshmërinë dhe administrimin e mirë.

Auditimi ka përfshirë veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, menaxhimin financiar dhe kontrollin, hartimi e zbatimi i buxhetit, auditimin e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu auditimi ka përfshirë edhe zbatimin e procedurave të prokurimit, zbatimin e kontratave të punimeve, si dhe zbatimin e detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Shkodër.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare dhe përputhshmërinë:

Administratori i Përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) znj. V. A. Kryetar i Bashkisë Shkodër dhe Drejtore e Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ) znj. B. M., janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Titullari i Institucionit, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Shkodër.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht:

-Neni 34, pika 6, ku cilësohet: “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”;

-Neni 91, pika 1.3., ku cilësohet: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit".

Neni 65, pika 1, ku cilësohet: "Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori".

Përgjegjësitë e audituesve të KLSH për auditimin e pasqyrave financiare:

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Shkodër dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

- Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
- Plotësia: Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
- Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
- Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
- Ligjshmëria dhe rregullësia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

- Ekzistenca: asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë
- Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
- Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivitet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

- Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
- Plotësia: Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
- Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

- Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

Kriteret e vlerësimit:

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

- ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 200 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar”;
- Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS);
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.04 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.11 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”;
- UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.
- Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Standardet e auditimit:

Auditimi është kryer, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, në zbatim të Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin¹¹.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet,

¹¹ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminonj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Informacioni i Përgjithshëm:

Fillimet e institucionit të Bashkisë në Shkodër datojnë në vitin 1865.



Bashkia Shkodër shtrihet në Veriperëndim të Shqipërisë, në një territor prej 873 km², i cili kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë.

Bashkia e Shkodrës është pjesë e Qarkut Shkodër dhe përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (Shkodër, Rrethina Shalë, Shosh Pult, Postribë, Guri i Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, dhe Velipojë). Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej një qytet dhe 93 fshatra.

Me reformën e re territoriale, popullsia e Bashkisë së Shkodrës është dyfishuar. Aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej 204,954 banorë. Përqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (114,085 banorë), ndërsa për sa i përket njërive administrative, njësitë me popullsi më të madhe është ajo e Rrethinave me 23,923 banorë. Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë: Guri i Zi me 11,838 banorë, Postriba me 11,730 banorë, Bërdica me 9,655 banorë, Velipoja me 9,574 banorë dhe Dajçi me 8,998 banorë. Tre njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 5,968 banorë, Pulti me 3,249 banorë, si dhe Shalë e Shosh me 5,934 banorë.

Në çdo bashki krijohet organi përfaqësues dhe organi ekzekutiv. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë. Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak. Ky organ përbëhet nga 51 këshilltarë, përfaqësues të subjekteve të ndryshme politike të zgjedhur në zgjedhjet vendore.

Funksionet e qeverisjes vendore:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksione, kompetenca, si dhe funksione të deleguara. Rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet duke respektuar politikën kombëtare dhe rajonale. Ndër funksionet bazë të njërive të vetëqeverisjes vendore janë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

- Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike.
- Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale.
- Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.
- Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit.
- Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit.
- Funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.
- Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike.
- Funksionet dhe kompetencat e deleguara.

Misioni i njësisë që auditohet:

Misioni i Bashkisë Shkodër është sanksionuar në Statut neni 2.

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit. Bashkia nxit zhvillimin dhe përparimin civil, social dhe ekonomik të komunitetit, nëpërmjet bashkëpunimit me gjithë personat publikë dhe privatë, duke ndikuar në pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të faktorëve sociale, ekonomike dhe sindakale në administrimin e qytetit duke vepruar sipas parimevet të ratifikuara ka Kushtetuta.

Objektivat e subjektit të audituar:

Objektivat e Bashkisë Shkodër burojnë nga Kushtetuta dhe ligji “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht:

- Kapërcimi i problemeve ekonomike, sociale, territoriale që i përkasin Bashkisë;
- Nxitja e rolit social të iniciativës ekonomike, publike dhe private, edhe përsa i përket zhvillimit të shoqatave ekonomike dhe të bashkëpunimeve;
- Mbështetja në realizimin e një sistemi global dhe i plotësuar për sigurinë sociale dhe mbrojtjen e drejtave të njeriut, edhe nëpërmjet përfshirjes së organizatave dhe shoqërisë civile në përgjithësi, me qëllim të krijimit të një gjendje social-ekonomike të stabilizuar.
- Mbrojtja dhe zhvillimi i pasurive të natyrës, të ambientit, historike dhe kulturore, që gjenden në territorin e Bashkisë, që ti garantohet shoqërisë një cilësi e jetës sa më e mirë;
- Ofrimi sa më i mirë i shërbimevet institucionale për t’u bërë përfitueshme për gjithë njerëzit që kanë nevojë dhe mbështetja në forma të ndryshme ndihmese për kategoritë më në nevojë.
- Mbrojtja dhe nxitja e traditave dhe të vlerave më të mira që i përkasin artit dhe kulturës , nëpërmjet krijimit të strukturave të cilat mbrojnë trashigiminë kulturore dhe nxisin zhvillimin e mëtejshëm të saj.
- Marrja e masave për të pasur mundësi të barabarta për burrat dhe gratë.
- Nxitja e aktivitetet sportive dhe të motit të lirë, tue ndihur shoqërizimin rinor dhe ndër pjeqtë.

Fushëveprimi:

Përfshin vlerësimin e përputhshmërisë së Bashkisë Shkodër, në fushën e prokurimeve publike, për periudhën objekt auditimi, vlerësimin mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe vlerësimin nëse pasqyrat financiare të njësisë për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, janë hartuar sipas standardeve të raportimit financiar.



IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.

A. MBI PLANIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN E RISKUT.

A.1. Planifikimi dhe identifikimi i riskut.

IV/A. 3 1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Viti ushtrimor 2017

Nga auditimi i dokumentacionit mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për periudhën 01.01.2017 deri më 30.06.2019 rezulton se Titullari i Bashkisë Shkodër me shkresën nr.3083 prot,datë 26.02.2018 ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithsme të Harmonizimit të Kontrollit të Brëndshëm Financiar Publik, pyetSORIN e vetëvlersimit dhe deklaratat përkatëse për cilësinë e sistemit të kontrollit të brëndshëm të kësaj Bashkie, për vitin 2017.

Ku i është kushtuar vëmendje e vecantë menaxhimit me efencë dhe efektivitet të burimeve financiare dhe jo-financiare të njësisë territoriale të Bashkisë Shkodër, veprime në përputhshmëri me parimet themelore të Ligjit Nr.10296,datë 08.07.2010 " *Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin* ", të ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 " *Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.10296 ,datë 08.07.2010 " Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin "Kreu I, neni 5: Kreu II, neni 5, neni 8, pika 8, Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 " Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"* të ndryshuar me Udhëzimin nr.20,datë 17.11.2014 " *Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.30,datë 27.12.2011 " Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"*, pika 5-pika 13.

Sa më sipër Nga Bashkia Shkodër është plotësuar pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2017, Deklerata dhe Raporti Vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2017 , raporti për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2017.

Nga auditimi u konstatua se në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Titullarja e Bashkisë Shkodër znj.V. A. në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe koordinatorit të riskut ka monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm, si dhe ka kryer menaxhimin e burimeve financiare me efencë, ekonomikitet dhe efektivitet, në përputhje me kriteret e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 " *Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin* , i ndryshuar, neni 9.

Deklarata e Misionit të Bashkisë Shkodër për vitin 2017 është hartuar në përputhje me dokumentin e PBA 2017-2019, miratuar me VKB nr.08,datë 30.01.2017 " *Për miratimin e buxhetit të vitit 2017, dhe programit buxhetor afatmesëm 2018-2019"* ndërsa me urdhër nr.14,datë 09.01.2017 titullari i Bashkisë Shkodër ka ngritur **Grupin e Menaxhimit Strategjik(GMS)**.

Është hartuar plan veprimi për arritjet strategjike me afate dhe me presona përgjegjës për çdo veprim sipas urdhrorit për zbatimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2017-2018, si dhe janë informuar menaxherët dhe punonjësit e njësisve publike në lidhje me përmbajtjen e *Misionit, Objektivave dhe të Strategjive* me dokumentet përkatës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Në bazë të Rregullores “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër, miratuar me vendimin nr.96, datë 20.03.2017, për çdo departament, drejtori dhe sektor janë përcaktuar detyrat përkatëse.

Për sa i përket zbatimit të Kodit të Etikës nga nëpunësit e administratës publike, institucionet dhe ndërmarrjet e vartësisë, neni 15 i kësaj rregulloreje përcakton qartë detyrimet dhe rregullat përkatëse të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë punojësit.

Në lidhje me çështjet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit Bashkia Shkodër, krahas trajnimeve periodike me punojësit e administratës, janë kryer edhe konkurse me qëllim motivimin e punojësve për rritjen e mëtejshme profesionale, në funksion të kësaj Bashkie. Nga auditimi i ushtruar në pyetsorin e vetëvlersimit për vitin 2017, i plotësuar më datë 26.02.2018, rezultoi se ky pyetsor është plotësuar sipas pikëve përkatëse (1-4) për sejcilin objektivi

Në kolonën “**Komente**” përgjigjet e pyetësorit janë dhënë në formë të plotë, duke dhënë një panoramë të qartë të mbarvatjes dhe ecurisë së punës në Bashkinë Shkodër. Lidhur me vlerësimin e rubrikave përkatëse me bazë pikësh rezultoi se :

Në kolonën e vlerësimit me pikë për 5 seksionet është vendosur në mënyrë jo të saktë vlerësimi i pikëve, për të gjithë pyetësorin.

Mjedisi i Kontrollit, (48 pikë:16 pyetje =3), që do të thotë se ky aspekt i menaxhimit financiar, kuptohet dhe funksionon në pjesën më të madhe.

Menaxhimi i Riskut, (19 pikë:6 pyetje = 3.1), që do të thotë se ky aspekt i menaxhimit financiar kuptohet dhe funksionon në pjesën më të madhe.

Aktivitetet e kontrollit, (24 pikë:7 pyetje = 3.4), ky aspekt i menaxhimit financiar kuptohet funksionon në pjesën më të madhe .

Informimi dhe komunikimi, (23 pikë: 6 pyetje=3.8), që do të thotë se ky aspekt i menaxhimit kuptohet mirë funksionon në të gjitha hallkat e Bashkisë.

Monitorimi, (15 pikë:4 pyetje=3.75), ky aspekt i menaxhimit financiar kuptohet dhe funksionon në pjesën më të madhe.

Me gjendjen e paraqitur më sipër jepet një vlerësim mesatar për 5 komponentët me koeficient mesatar **3.41**, çka do të thotë se kriteret e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm funksionojnë në pjesën më të madhe,

Viti ushtrimor 2018

Titullari i Bashkisë Shkodër me shkresën nr.3238 prot, datë 27.02.2019 ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithsme të Harmonizimit të Kontrollit të Brëndshëm Financiar Publik, pyetsorin e vetëvlersimit si dhe deklaratat përkatëse për cilësinë e sistemit të kontrollit të brëndshëm të kësaj Bashkie. Ku u është kushtuar vëmendje e vecantë menaxhimit me eficientë dhe efektivitet të burimeve financiare dhe jo-financiare të njësisë territoriale të Bashkisë Shkodër, veprime në përputhshmëri me parimet themelore të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 " Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin " , të ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 " Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.10296 , datë 08.07.2010 " Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin " Kreu I, neni 5: Kreu II, neni 5, neni 8, pika 8, Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 " Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" të ndryshuar me Udhëzimin nr.20, datë 17.11.2014 " Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 " Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", pika 5-pika 13.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Nga auditimi u konstatua se në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Titullarja e Bashkisë Shkodër znj.V. A. në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe koordinatorit të riskut ka monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm, si dhe ka kryer menaxhimin e burimeve financiare me efikasitet, ekonomicitet dhe efektivitet, në përputhje me kriteret e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 " *Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin* ", i ndryshuar, neni 9.

Deklarata e Misionit të Bashkisë Shkodër për vitin 2018 është hartuar në përputhje me dokumentin e PBA 2017-2019, miratuar me VKB nr.08, datë 30.01.2017 " *Për miratimin e buxhetit të vitit 2017, dhe programit buxhetor afatmesëm 2018-2019*" ndërsa me urdhër nr.6, datë 10.01.2017 titullari i Bashkisë Shkodër ka ngritur **Grupin e Menaxhimit Strategjik(GMS)**.

Sa më sipër, me shkresën nr.3298, datë 28.02.2019, Bashkia Shkodër ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brëndshëm Financiar Publik, deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brëndshëm të Bashkisë Shkodër për vitin 2018, nga ku titullari i kësaj Bashkie parashtron një prëmbledhje të aktivitetit të Bashkisë, lidhur me menaxhimin me sa më efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike, në përputhje me parimet themelore të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 " *Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin* ", të ndryshuar

Referuar shkresës të sipërcituar është dërguar raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të Njësisë, Bashkia Shkodër, për vitin 2018, sëbashku me pyetsorin përkatës, nga ku jepet një panoramë më e qartë e objektivave, pritshmërive si dhe evidentimit të sektorve më me risk në këtë Bashki.

Në lidhje me çështjet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit Bashkia Shkodër, krahas trajnimeve periodike me punojësit e administratës, janë kryer edhe konkurse me qëllim motivimin e punojësve për rritjen e mëtejshme profesionale, në funksion të kësaj Bashkie. Nga auditimi i ushtruar në pyetsorin e vetëvlerësimit për vitin 2018, i plotësuar më datë 28.02.2017, rezultoi se ky pyetsor është plotësuar sipas pikëve përkatëse (1-4) për sejcilin objektiv.

Nga auditimi i ushtruar në dokumentacionin e vënë në dispozicion rezultoi se për vitin ushtrimor 2018, Bashkia Shkodër i është referuar udhëzimeve dhe formatit përkatës të Ministrisë së Financave lidhur me plotësimin e pyetësorit e vitit 2018¹², pyetësori i cili përbëhet nga pesë seksione të cilat i përgjigjen pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare INTOSAI dhe COSO, ku në vetë –vete komponentët përfshijnë gjithsecili, parime specifike.

Për sejcilin parim janë ndërtuar një grup pyetjesh, bashkëlidhur të cilave janë vendosur dokumentet justifikuese , konkretisht në rubrikën “*Evidenca Mbështetëse*”, dokumenta të cilat janë një domozdoshmëri për institucionin, pasi bazuar në këto evidenca, nxirren informacionet e detajuara lidhur me pyetjet e kërkuara.

¹² <https://financa.gov.al/pyetesori-i-vetevleresimit-per-vitin-2018-per-komponentet-e-menaxhimit-financiar-dhe-kontrollit/>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Nga auditimi I ushtruar lidhur me plotësimin e Pyetësorëve të Vetëvlerësimit për vitin 2018 vihet re se procedurat dhe veprimtaritë e kontroleve të ndërmarra nga subjektet e pyetsorit në të gjitha nivelet e Njesisë Publike garantojnë se menaxhimi financiar dhe kontrolli është në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi.

Gjatë vitit 2018 është përmirësuar ndjeshëm informimi dhe komunikimi si brenda drejtorive të Bashkisë, ashtu dhe me institucionet e vartësisë, gjithashtu është punuar për përmirësimin e menaxhimit të riskut, por ka ende punë për të bërë.

Titullari I institucionit ka ndërmarrë hapat e nevojshme ligjore lidhur me delegimin e kompetencave bazuar në Kodin e Procedurave Administrative. Gjithashtu, janë të miratuara përkrahjet e punës për çdo pozicion dhe kryhen vlerësime vjetore të punës mbi arritjet individuale në punë. Për sa i përket rritjes së kapaciteteve profesionale të punonjësve rezultoi se Bashkia Shkodër ka kryer trajnime të vazhdueshme në bashkpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike si dhe trajnime të tjera.

Lidhur me sa mësipër në përputhje me kriteret e kërkuara në pyetsorët përkatës të vitit 2018 rezultoi se:

Mjedisi i Kontrollit përbëhet nga 5 parime të cilat janë :

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Parimi 2 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Parimi 3 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Për sa i përket plotësimin të pyetësorit **lidhur me parimin 1**, rezultoi se ky komponent është ndarë në 6 pyetje, nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse, çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me zbatimin kuadrit ligjor në fuqi, lidhur me kodin e etikës, rregulloren e institucionit dhe mënyrën se si funksionon i gjith sistemi menaxhues i institucionit. Drejtoritë përkatëse të Bashkisë për çdo ndryshim ligjor, njoftojnë zyrtarisht punonjësit dhe nëpunësit e saj, krahas shkresave një rëndësi e vecantë i adresohet edhe paraqitjes online nëpërmjet Eëb.

Për sa i përket programeve të trajnimit dhe përmirësimit të anës profesionale, rezultoi se çdo punonjës i ri i është nënshtruar provimeve pranë ASPA, ku një ndër temat e trajtuara ka qënë edhe "Integriteti dhe sjellja etike", gjithashtu, janë bërë edhe trajnime nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Në rastet kur pranë Bashkisë paraqiten ankesa apo kërkesa të ndryshme, ato regjistrohen pranë zyrave me një ndalesë, nga ku më pas bëhen raportimet e nevojshme në drejtoritë përkatëse dhe dhënia e përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara, në përputhje me ligjin me nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe në Urdhërin e komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore". Referuar ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar si dhe VKM me nr.109, datë 26.2.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë", çdo drejtori kryen vlerësimin e punonjësit të saj, vlerësim i cili firmoset nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari autorizues.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Lidhur me parimin nr.2 rezultoi se ky komponent është ndarë në 10 pyetje, nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mënyrën se si Nënpunësi Autorizues mbikëqyr aktivitetin e Bashkisë nëpërmjet mekanizmave specifike si planet vjetore të auditit të brendshëm, parashkimit të planeve mujore mbi nivelin e realizimit të të ardhurave për çdo zë, për çdo njësi, planet vjetore të drejtorisë/ sektorëve, raportime të cilat realizohen në formë shkresore dhe me email. Në përbërjen e Bashkisë Shkodër janë 9 institucione, të cilat kryejnë secila 12 raportime vjetore, pra në total 108 raportime, krahas raportimeve mujore, prej nënpunësve përkatës kryhen edhe 4 raportime për secilin dhe konkretisht : 2 raportime cdo 4 muaj, 1 raportim cdo 6 muaj, si dhe 1 raportim vjetor pra gjithsej 36 raportime, numri i të cilave gjatë vitit ushtrimor shkon në 144 raportime në total.

Mbikqyrja e aktivitetit të Bashkisë bazohet në planin vjetor të punës, me qëllim arritjen e objektivave si dhe , raportimin e dobësive dhe korigjimin e tyre në të ardhmen. Për rastet të cilat paraqesin rrisht, hartohet një plan i vecantë veprimi, prej drejtorive përkatëse, në përputhje me regjistrin e riskut.

Titullari i institucionit mbikëqyr ecurinë e punës nëpërmjet raporteve të auditit të brendshëm, apo organizatave atij të jashtëm etj, gjithsesi Po punohet për krijimin e procedurave standarde të veprimit (PSV) nga secila drejtori/ sektor, kjo nëpërmjet një projekti ndërmjet STAR2 dhe UNDP. Disa PSV janë finalizuar, miratuar edhe nga Titullari i institucionit. Në lidhje me opinionet/sugjerimet apo raportet e auditit të brendshëm si dhe nga KLSH merren në konsideratë dhe ndiqet plani i veprimit sipas rekomandimeve të lëna. Raportet janë të publikuara në faqen web të Bashkisë.

Lidhur me parimin nr.3 rezultoi se ky komponent është ndarë në 15 pyetje, nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me hartimin e deklaratës së misionit, objektivat afat mesëm dhe afat gjatë të Bashkisë. Nëpërmjet kësaj rubrike i vihet më shumë rëndësi faktit nëse punonjësit e njësisë publike, janë të informuar mbi përmbajtjen e Deklaratës së Misionit, objektivat, strategjitë si dhe plan-veprimet vjetore të miratuara, me qëllim arritjen e objektivave vjetore si dhe personat konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar. Gjithashtu në këtë rubrik jepet një panoramë më e detajuar edhe për detyrat funksionale të cdo sektori në përputhje me rregulloren e brendshme nr 96, date 20.03.2017 , e cila përshkruan përgjegjësitë dhe detyrat e gjithsecilit.

Për sa i përket performancës dhe vlerësimit të strukturës organizative, titullari i Bashkisë monitoron vazhdimisht realizimin e detyrave sipas kompetencave përkatëse të cdo punojësi, duke ju drejtuar me shkresë zyrtare drejtorive përkatëse dhe duke lënë afatet e nevojshme ligjore me qëllim përmirësimin e detyrave funksionale, në bazë të punës së kryer bëhen edhe vlerësimet përkatëse të cilat realizohen përmes Pyetësorit të vetëvlerësimit; Raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Lidhur me evidentimin e risqeve që mund të hasen gjatë ushtrimit të detyrës funksionale dhe punës së përditshme rezulton se risqet janë të analizuara dhe të përditësuara për ato drejtori të cilat mund shfaqin risk të lartë për njësinë. Bashkia dhe drejtoritë vartëse marrin masat e nevojshme nëpërmjet plane veprimi në fushat ku adresohet ky risk.

Lidhur me parimin nr.4 rezultoi se ky komponent është ndarë në 11 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mënyrën se si rekrutohen dhe merren në punë punonjësit e Bashkisë, vlerësimet periodike,organizimin e trajnimeve. Sa më sipër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

vleresimet realizohen në mbështetje të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar si dhe VKM nr.109, datë 26.2.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë". Ekziston përshkrimi i punës dhe ai rishikohet në raste ristrukturimi nga drejtuesit në lidhje me detyrat që duhet të kryhen, kërkesat për kualifikimet e nevojshme dhe linjat e raportimit.

Janë miratuar përshkrime pune për çdo punonjës e pozicion pune në institucion, në të cilat të përfshihen detyrat individuale që duhen kryer, kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme dhe linjat e raportimit, sipas shkalëve të hierarkisë.

Bëhet hartimi i planeve/matricave për objektivat dhe aktivitetet që duhet të realizohen, evidentimi i aktiviteteve të realizuara, shkalla e realizimit si dhe evidentimi i problematikave.

Për sa i përket procedurave të rekrutimit, Bashkia Shkodër mbështet në kriteret e përcaktuara me ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe VKM nr. 142, datë 12.3.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar

Lidhur me trajnimet Drejtoria e Burimeve Njerezore ben planifikimin e nevojave per trajnime, konkretisht gjatë vitit 2018 janë realizuar trajnime në fushën e planifikimit strategjik, përgatitjen e planeve financiare, menaxhimin e riskut, prokurimin dhe kontraktimin, sistemet e kontabilitetit etj.

Lidhur me parimin nr.5 rezultoi se ky komponent është ndarë në 2 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me përgjegjshmërinë menaxheriale dhe çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, diskutimet dhe dokumentimin mbledhjeve të kryera në lidhje me GMS.

Sa më sipër kompetencat dhe detyrat funksionale të menaxherëve të institucionit përshkruhen qartë në rregulloren e miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 96 datë 20.3.2017 "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër", ndërsa për sa i përket përgjegjësive të koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", të gjitha takimet mbahen e kryera faktohen nëpërmjet procesverbaleve përkatëse, të cilat firmosen nga të gjithë të pranishmit.

Menaxhimi i Riskut përbëhet nga 4 komponentë të cilat janë:

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme.

Lidhur me parimin nr.6 rezultoi se ky komponent është ndarë në 4 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mënyrën se si vendosen objektivat afatmesme për përgatitjen e PBA-së, komunikimin e tyre stafit të Bashkisë, si dhe a përputhen objektivat afatmesme (PBA) me ato të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë. Sa më sipër prej Bashkisë dhe njësive vartëse janë miratuar objektivat afatmesme me VKB nr. 60 datë 30.9.2017 "Miratim i tavaneve përfundimtare të vitit të parë të programit buxhetor afatmesem vendor për vitet 2018-2020 të Bashkisë Shkodër", raportimet bëhen duke respektuar afatet dhe i komunikohen zyrtarisht stafit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Objektivat e paraqitura në PBA përputhen me ato të buxhetit vjetor të miratuar me VKB Nr 82 datë 20.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër”

Lidhur me parimin nr.7 rezultoi se ky komponent është ndarë në 8 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mënyrën dhe mekanizmat e ndjekur si identifikohet dhe si vlerësohet risku, ngritja e GMS, delegimi i detyrave të koordinatorit të riskut, regjistri i riskut.

Sa më sipër secila drejtori plotëson regjistrin e riskut për aktivitetet që ka, i gjithë stafi bën evidente risqet në nivel sektori/njësie/drejtorie plotësohet çdo vit nga secila drejtori dhe bëhet azhurnimi i tij në bazë të ligjit 1 here ne vit ose cdo 6 mujor, gjithmonë nëse ka azhurnime apo ndryshime. Njësia e Auditit të Brendshëm në Raportin Vjetor për vitin 2018 ka analizuar procesin e menaxhimit të riskut dhe ka paraqitur rekomandime në lidhje me përmirësimin e tij. Janë identifikuar risqet e analizuar në regjistrin e riskut dhe janë mbajtur në procesverbalet e datave 10.4.2018, 12.04.2018, 08.05.2018, 30.07.2018, 04.09.2018. Kryesisht në vlerësimin e riskut merren parasysh treguesit e performancës mbi shkallën e arritjes së objektivave, tregues të cilët janë të publikuara në rubrikën mbi realizimin e buxhetit. Për sa i përket ngritjes së GMS-së rezulton se kjo njësi është ngritur me urdhrin Nr. 6, date 20.01.2018 të Titullarit "Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik për vitin 2018", në zbatim të ligjit nr.10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.16, date 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësite publike", të gjitha takimet mbahen me protokoll dhe firmosen nga të gjithë të pranishmit.

Lidhur me parimin nr.8 rezultoi se ky komponent është ndarë në 4 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me marrjen e masave lidhur me vlerësimin e riskut të mashtrimit, mënyrat dhe metodat e ndjekura ndaj ekspozimit të veprimtarive mashtruese, raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi. Referuar evidentimit të mashtrimeve të mundshme, sektori kryesor i cili merret dhe monitoron aktivitetin e institucionit, është Audit i Brendshëm cili nuk ka identifikuar ndonjë rast të tillë gjatë 2018.

Lidhur me parimin nr.9 rezultoi se ky komponent është ndarë në 2 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me ndikimet e mundshme të cilat mund të hasen gjatë shtimit ose ndryshimit të strukturave ekzistuese, nga ku rezulton se Bashkia Shkodër merr parasysh ndikimet e mundshme të riorganizimit.

Aktivet e Kontrollit përbëhet nga 3 komponentë të cilët janë :

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Lidhur me parimin nr.10 rezultoi se ky komponent është ndarë në 9 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me Dokumentimin ose jo të aktiveve të kontrollit, proceseve të punës, pranimi i tij përpara njohjes së shpenzimit në kontabilitet, në mënyrë të tillë që, ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare mos të bëhen nga i njëjti person. Disponimi ose jo i regjistrave të prokurimeve dhe përditësimi i tij në përputhje me ndryshimet e fondeve në dispozicion të njësisë publike. Krijimi i komisioneve nga titullari për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit, etj
Procedurat e ndjekura për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit.

Sa më sipër Bashkia Shkodër është duke punuar për krijimin e procedurave standarde të veprimit në të cilat do bazohet stafi për kryerjen e detyrave në mbështetje të legjislacionit në fuqi. Nga secila drejtori/sector, nëpërmjet projekteve STAR2 dhe UNDP. Disa PSV janë finalizuar, miratuar edhe nga Titullari i institucionit.

Për sa i përket kontrollit të dokumentacionit para kryerjes së shpenzimeve rezulton se Drejtoria e Financës, funksionon me dy sektor, konkretisht:

Spektori i Financës e Marrëdhënieve me Thesarin, i përbërë nga një përgjegjës dhe tre specialiste

Spektori i Kontabilitetit, i përbërë nga një përgjegjës dhe tre specialist.

Kontrolli i dokumentacionit kryhet nga specialistët e financës, nënshkruhen nga nepunesi autorizues dhe nepunesi zbatues i institucionit, ndërsa kontabilizimi kryhet nga Përgjegjësi dhe specialistet e kontabilitetit dhe autorizimi i pagesës kryhet nga nepunesi zbatues, i cili paraqet urdher shpenzimit për firmosje/kalim, likuidim nga nepunesi autorizues në Degen e Thesarit

Lidhur me procedurat e prokurimeve egzistojnë regjistrat përkatës për cdo procedurë të kryer, në përputhje me fondet buxhetore të miratuara cdo fillim viti dhe që përditësohet gjatë vitit me ndryshimet që mund të bëhen (shtesa pakesime me VKB apo me Vendime të Titullarit)

Pranë njësisë publike çdo viti nxirret urdheri i firmosur nga titullari për ngritjen e grupeve të punës sipas drejtorive përkatëse (sipas aktiviteteve që secila drejtori ka) prokurimi dhe kontraktimi ngrihet grup pune për hartimin e specifikimeve, marrjes në dorezim të mallit/shërbimit/ punës ngrihet komisioni për vlerësimin e ofertave. Këto grupe pune dhe komisione miratohen nga NA i njësisë publike. Anëtarët e komisioneve propozohen nga drejtoria sipas profilit që kanë dhe fushes që mbulojnë.

Për sa i përket procedurave për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit financiar, dokumenti specifik është Bilanci kontabël i cili për vitin 2018 i cili është mbyllur më dt. 31.3.2019 ndërsa në ZVRPP nuk ka përfunduar regjistrimi i të gjitha pasurive të paluajtshme edhe pse janë aplikuar për regjistrim. Ndërsa regjistri i aktiveve përditësohet periodikisht në bazë të Udhëzimit të Ministrisë së Financave me nr. 30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik", i ndryshuar. Me urdher të Titullarit ngrihen komisione të posacme për inventarizimin, vlerësimin dhe asgjësimin apo shitjen me ankand të aktiveve.

Lidhur me parimin nr.11 rezultoi se ky komponent është ndarë në 6 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me metodat e ndjekura nga Bashkia Shkodër lidhur me ruajtjen e të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe dëmtimet fizike,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

vënia në zbatim e planeve të emergjencave, ndarja e detyrave në kontrollin e sistemit të IT, garantimi i sigurisë së sistemit, masat e marra për rikuperimin e materiale në rast avarie.

Sa më sipër Bashkia Shkodër nëpërmjet Vendimit të Kryetarit me nr. 449, dt. 15.7.2016 "*Për miratimin e rregullores për menaxhimin e aktivëve të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë së saj*", dhe rregullores së brendshme të miratuar, me Urdher të Kryetares së Bashkisë Shkodër me nr 96 date 20.03.2017 "*Per miratimin e rregullores per organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës te Bashkisë Shkodër*" janë të përcaktuara detyrat e funksionet per secilin punonjës, në funksion të ruajtës së të dhënave, të cilat mbrohen permes nje serveri back up i cili gjithashtu është i mbrojtur permes inverterit dhe monitorohet me kamera. Për sa i përket ndryshimit të fjalëkalimeve hyrjen në të dhënat etj zbatohen rekomandimet e Politikave për sigurinë Kibernetike.

Lidhur me parimin nr.12 rezultoi se ky komponent jep përgjigje për 1 pyetje e cila ka të bëjë kryesisht me përgjegjësitë për aktivet e kontrollit, si për personelin por edhe për rangun drejtues. Sa më sipër me vendim të Kryetares së Bashkisë Shkodër me nr. 96 datë 20.03.2017 "*Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës të Bashkisë Shkodër*" janë të përcaktuara përgjegjësitë dhe rolet e drejtueseve dhe personelit perkates te drejtorive/njesive/sektoreve;

Informimi dhe komunikimi përbëhet nga 3 komponentë të cilët janë:

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.

Lidhur me parimin nr.13 rezultoi se ky komponent është ndarë në 5 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me monitorimin, llojet e raportimit periodik, vendimmarrja, disponimi ose jo i një sistemi kontabiliteti (përveç SIFQ). Sa më sipër raportimet në KB bëhen çdo muaj, çdo 4 muaj, 6 muaj, 8 muaj dhe vjetore. Në përgjithësi raportimet bëhen si elektronikisht por edhe manualisht, raportimi është i ndërtuar mbi bazën e matjes së performacës përmes indikatorëve sasior dhe cilësor për arritjen e objektivave. Për sa i përket sistemit të përdorur në lidhje me kontabilitetin, njësia operon nëpërmjet SIQF, kjo nepernjmet Deges se Thesarit, mbahet me programin Alpha vetem magazina, ndërsa është në proces implementimi programi web-alpha per Bashkine qender dhe institucionet e varesise.

Lidhur me parimin nr.14 rezultoi se ky komponent është ndarë në 2 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mënyrën sesi informohen menaxherët dhe personeli i njësisë publike lidhur me vendimet/projektet/nismat e njësive të tjera, si dhe nëse janë konstatuar mangësi të cilat ndikojnë në performancën e institucionit.

Në shumicën e rasteve informacioni ligjor apo shoqëruet i një praktike për vendimarrje është i mjaftueshem. Struktura që siguron këtë informacion, tek menaxheret është Drejtoria e Financës, per realizimin , dhe Drejtoria e Analizes dhe Programimit Buxhetor per planet sipas programeve. Çdo drejtori ne baze te urdherit te Titullarit zbaton me perpikmeri afatet dhe kryerjen e raportimit ne kohe dhe me cilesi, ku i gjithhe informacioni permblihdhet ne Drejtorine e Analizes dhe Programimit Financiar. Informacioni jepet në mënyre periodike. Libri i buxhetit, matrica,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

dhe raportet e realizimit dhe vleresimit të performances janë të publikuara dhe në faqen ëeb të bashkisë.

Për sa i përket kontrolleve dhe auditimeve të realizuar nga AB, rezultojnë se për vitin 2018 prej kësaj njësie janë konstatuar 138 gjetje dhe janë dhënë 113 rekomandime. Rekomandimet e lëna janë pranuar nga të gjitha subjektet e audituara. Për të gjitha auditimet e kryera janë përpiluar memorandumet për Titullarin.

Lidhur me parimin nr.15 rezultoi se ky komponent është ndarë në 2 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me metodat dhe rregullat e komunikimit të brendshëm si dhe atij të jashtëm, informimin dhe konsultimet me grupet e interesit.

Sa më sipër rezultojnë se komunikimi ndërmjet drejtorive dhe sektorëve përkatës realizohet nëpërmjet e-mailit zyrtar i cili menaxhohet nga punojësit e autorizuar. Lidhur me informimin dhe konsultimet me grupet e interesit, rezultojnë se njoftimet e ndryshme bëhen publike në faqen ëeb të Bashkisë, me qëllim qenien sa më transparent me komunitetin, konsultimet dokumentohen me procesverbale, me foto dhe liste pjesmarrje.

Monitorimi përbëhet nga 2 komponentë të cilët janë :

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.

Lidhur me parimin nr.16 rezultoi se ky komponent është ndarë në 9 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me monitorimin e objektivave të vendosur prej Bashkisë Shkodër, vetëvlerësimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, plan veprimet përkatëse për ecurinë e MFK-së, rekomandimet specifike për sistemin e kontrollit të brendshëm të përfshirë në raportet e AB, KLSH, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të KBFP, mbikëqyrja e realizimit të tyre, informacioni i vënë në dispozicion nëpërmjet auditimeve të brendshme.

Sa më sipër monitorimi i objektivave ndiqet rregullisht nga Titullari për cdo program/projekt dhe analizohen shkaqet që mund të çojnë në dështim. Merren masat e duhura duke nxjerrë urdhëra për monitorimin, vlerësimin e situatës, analizën deri në hartimin e Projekt -vendimeve për zgjidhje të risqeve që mund të çojnë në dështim.

Drejtuesit e EMP hartojnë plane/matrica 6-mujore, 8-mujore si dhe vjetore për objektivat dhe aktivitete që duhet të realizojnë, të realizuara , shkalla e realizimit si dhe evidentojnë progresin apo problematikën.

Lidhur me plotësimin e pyetësorit të vetvlerësimit Titullari u dërgon drejtorive përkatëse me shkrese dhe me e-mail pyetësorin , duke i kushtuar rëndësi maksimale plotësimit të tij brenda afateve ligjore.

Për sa i përket rekomandimeve të lëna prej KLSH dhe AB në raportet e auditimit, rezultojnë se Bashkia Shkodër ka ngritur grupet e punës me qëllim evidentimin e shkaqeve, si dhe ka marrë në konsideratë dhe ka realizuar rekomandimet e lëna brenda afateve ligjore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Lidhur me parimin nr.17 rezultoi se ky komponent është ndarë në 3 pyetje nga ku janë dhënë përgjigjet përkatëse çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me funksionimin ose jo të linjave të raportimit në shkallë hierarkike si dhe marrja e masave për të korrigjuar mangësitë e raportuara nga personeli, Auditimi i Brendshëm por edhe prej Institucioneve të tjera audituese si KLSH.

Lidhur me sa më sipër kur egzistojnë raportime për mos ecurinë pozitive të punës, prej Drejtorisë së Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese dërgohen Titullarit MEMO-t përkatëse me problematikën e konstatuar. Titullari pasi njihet me problematikën merr masat e duhura duke respektuar afatet ligjore, me qëllim rritjen e performancës së Institucionit.

Për sa i përket monitorimit nga niveli drejtues lidhur me statusin e veprimeve korrigjuese, rezulton se për gjithë rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm dhe KLSH, merren masat e duhura duke evidentuar progresin apo problematikën në çdo rekomandim. Raporti i rekomandimeve nga AB realizohet cdo 6 muaj.

Viti 2019

Shënim: dërgimi i pyetësorit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2019 dërgohet pranë Ministrisë Përgjegjëse në muajin shkurt në përputhje me kriteret e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 " Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 18, UMF nr.28, datë 15.12.2011" Mbi Paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësinë Publike "

A. 3.2 Kontrolli i brendshëm

KLSH konstatoj se Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Shkodër, për vitin 2017 planin e auditimeve e ka realizuar në masën 83%, për vitin 2018 e ka realizuar në masën 79% dhe 6/mujorin e vitit 2019, e ka realizuar në masën 80%, nuk ka vlerësuar si duhet riskun, dhe për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit.

Situata: Njësia e Auditit të Brendshëm, Bashkia Shkodër është pjesë përbërëse e Strukturës Organizative të Bashkisë. Për vitin 2017, me strukturën organike të Bashkisë është miratuar dhe struktura e njësisë së auditimit të brendshëm me VKB 34, datë 30.05.2017, për vitin 2018, me strukturën organike të Bashkisë është miratuar dhe struktura e njësisë së auditimit të brendshëm me VKB 85, datë 26.12.2017 dhe për vitin 2019, me strukturën organike të Bashkisë është miratuar dhe struktura e njësisë së auditimit të brendshëm me VKB 6, datë 30.01.2018, në përbërë të cilit janë 3 punonjës, me çertifikatë të AB ku njëri është përgjegjës. Për vitin 2017, janë planifikuar 12 auditime, nga këto 9 auditime kombinuara, 3 auditime financiare 10 auditime, ose në masën 83 % dhe jashtë planit vjetor 5 auditime nga këto 2. auditime përputhshmërie 1 auditim i kombinuar dhe 2 auditime konsulencë, për vitin 2018, janë planifikuar 14 auditime, nga këto 6 auditime përputhshmërie, 5 auditime financiare dhe 3 auditime të kombinuara, janë realizuar 11 auditime, ose në masën 79 %, dhe jashtë planit vjetor 4 auditime nga këto 2 auditime përputhshmërie 1 auditim i kombinuar dhe 1 auditim konsulencë dhe për 6/mujorin 2019, janë planifikuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

5 auditime, nga këto 3 auditime përputhshmërie, 2 auditime te kombinuara. Për periudhën objekt auditimi, për auditimet e kryera rezulton se janë rekomanduar masa si më poshtë:

Masa organizative

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2018
1	<i>Sistemi I prokurimeve</i>	6	49
2	<i>Sistemi I pagave e shperblimeve</i>	12	6
3	<i>Sistemi I tatimeve taksave</i>	5	0
4	<i>Sistemi I administrimit prone</i>	1	0
5	<i>Të tjera Gjetje</i>	65	83
	Totali I gjetjeve	89	138

Me dëm ekonomik

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2018
1	<i>Paga e Shperblime</i>	3,889	953
2	<i>Administrim prone</i>	200	625
	Totali I gjetjeve	4,089	1,578

000/lekë

Rekomandime sipas katgorive

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2018
1	<i>Rekomandime të përmirësimit e sistemeve</i>	59	15
2	<i>Rekomandime të karakterit organizativ</i>	32	8
3	<i>Rekomandime të tjera</i>	40	88
	Totali	131	111

NjAB Bashkia Shkodër për gjetjet si më sipër dhe rekomandimet e lëna për masa organizative dhe masa shpërblim dëmi, nuk ka bërë me program të veçantë auditim lidhur me zbatimin dhe realizimin e këtyre masave për auditimet e kryera.

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm rezulton se në fillim të vitit janë hartuar deklaratat e pavarësisë, për çdo rast të angazhimit të auditimit janë bërë njoftimet për fillimin e angazhimit të auditimit si dhe autorizimet përkatëse me protokoll të veçantë, për çdo auditim janë hartuar edhe deklaratat e paanësisë. Është zhvilluar takimi i hapur prezantues dhe ai përmbyllës, janë hartuar pyetësorët e vlerësimit të përgjithshëm të riskut dhe të fushës që është audituar, si dhe janë mbajtur letrat e punës si dhe është bërë inventari i dosjeve me dokumentet përkatës, për çdo rast është hartuar programi i angazhimit duke qene në strukturë 1 auditues ka zbatuar të gjitha pikat përkatëse te programit. Hartimi i projekt- raporteve dhe raporteve finale është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit, observacionet e subjekteve janë administruar në dosje dhe janë trajtuar në një rubrike të veçantë në raportin final të auditimit, janë hartuar dhe dërguar në subjekt edhe memorandumet e auditimit të cilat janë dërguar në subjekt me shkresa të veçanta dhe të protokolluara. Për çdo rast si projekt-raportet edhe raportet finale të auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual.

Janë respektuar kërkesat e manualit në hartimin e materialeve të auditimit në auditimet e kryera në subjektet në lidhje me hartimin e:

a-Letrave të punës së auditimit në fazën përgatitore të programit

b-Letrave të punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

hartimit të projekt-raportit dhe raportit final nga audituesit.
c-Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standardet e auditimit. *Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi: z.P. Z. me detyrë Përgjegjës i Njesisë së Auditit të Brendshëm për periudhën e auditimit.*

- Kriteri:** Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”. VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.
- Impakti:** Nuk jep siguri të mjaftueshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni.
- Shkaku:** Nga neglizhenca dhe nga mos këmbëngulja në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e ushtruara nga Auditi i Brendshëm.
- Rëndësia:** **E lartë**
- Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për cdo auditim.

Për sa sipër, është paraqitur observacioni i ardhur nga subjekti, me nr. 9599/5 prot, datë 26.08.2019, protokolluar në KLSH me nr. 405/5 prot, datë 29.08.2019, në të cilin citohet:

Lidhur me Njësinë e auditimit trajtohet “impakti” ku citohet se nuk jep siguri të mjaftueshme për objektivat e përcaktuara nga institucioni, “shkaku”, neglizhenca dhe moskëmbëngulja në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Në reference të pikës d, nëni 12 I ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” thuhet se titullarët e njësive publike, janë përgjegjës për hartimin, miratimin dhe ndjekjen e planit të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga njësia e auditimit të brendshëm dhe/ose në përfundim të procedurave të vlerësimit të cilësisë së auditimit nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar. Njësia e auditimit Brendshëm, duhet të kishte monitoruar më mirë zbatimin e rekomandimeve, por ky fakt nuk përben shkak thelbësor në dhenien e sigurisë për objektivat e përcaktuara nga Bashkia Shkodër. Për sa sipër kërkojme që të rishikoni dhe një here impaktin përsa i përket Njesisë Auditimit.

Opinion i grupit të auditimit:

Përsa observohet për këtë pikë, nuk merren në konsideratë sepse NjAB Bashkia Shkodër për gjetjet dhe rekomandimet e lëna për masa organizative dhe masa shpërblim dëmi, me program të veçantë duhet të bënte verifikimin lidhur me zbatimin dhe realizimin e këtyre masave për auditimet e kryera, sipas kriterëve dhe përcaktimeve në ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar nga Ministri i financave me Urdhër nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të brendshëm”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), ligjin nr.130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, dhe ligjin nr.109/2017, datë 30.11.2017“Për buxhetin e shtetit të vitit 2018”, me ndryshimet.

1. Programimi i PBA 2017-2019 dhe programimi i buxhetit vjetor 2017 dhe 2018;
2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;
3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;
4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;
5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave; (*Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF*)
6. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

1. Programimi i PBA 2017-2019 dhe programimi i buxhetit vjetor 2017, 2018 dhe 2019:

Në Bashkinë Shkodër buxheti i vitit 2017, 2018 dhe 2019 është hartuar kryesisht mbi bazën e 27 N/funksioneve të cilat janë:

N/funksioni – Planifikimi menaxhim dhe administrim	N/funksioni - Planifikimi urban vendor
N/funksioni – Gjendja Civile	N/funksioni – Shërbimet publike vendore
N/funksioni – Shërbimet e policisë vendore	N/funksioni - Furnizimi me uje
N/funksioni – Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	N/funksioni - Ndriçim rruges
N/funksioni – Mbështetje për zhvillimin ekonomik	N/funksioni – Shërbimet e kujdesit paresor
N/funksioni – Shërbime tregjve, akreditimi dhe inspektimi	N/funksioni - Sport dhe argetim
N/funksioni - Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	N/funksioni - Trashëgimia kulturore, eventet artistike e kulture
N/funksioni – Menaxhim infrastrukt se ujitjes, kullimit	N/funksioni - Arsimit baze dhe arsimin parashkollor
N/funksioni - Administrimi i pyjeve dhe kullotave	N/funksioni – Arsimit mesem i pergjithshem
N/funksioni - Rrjeti rrugor rural	N/funksioni – Arsimit profesional
N/funksioni - Transporti publik	N/funksioni - Kujdesi Socila, personat e semure dhe me aftesi te kufizuara
N/funksioni - Zhvillimi i turizmit	N/funksioni – Kujdesi social per familjet dhe femijet
N/funksioni - Menaxhimi i mbetjeve	N/funksioni – Strehimi social
N/funksioni – Menaxhimi i ujrave zeza dhe kanalizimeve	

Në lidhje me programimin e buxhetit për periudhën e viteve 2017, 2018 dhe për periudhën janar-qershor 2019, sipas dokumenteve të vëna në dispozicion konstatohet se:

Për vitin 2017 buxheti Bashkisë Shkodër është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 08, datë 30.01.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2017 dhe programit buxhetor afatmesëm 2018-2019 të Bashkisë Shkodër”, është miratuar buxheti nga të ardhurat vendore dhe transferta qeveritare në vlerën 2,512,289 mijë lekë. Gjatë vitit 2017 ka pasur ndryshime pakësime dhe shtesa të buxhetit miratuar me vendime të Këshillit bashkiak dhe vendime të kryetarit. **Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2017 është bërë jashtë afateve ligjore, në**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

kundërshtim me kërkesat e nenit 32 të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet:

Neni 32. Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore.

Si rregull, brenda **muajit nëntor të vitit buxhetor**, Kryetarët e njësisve të qeverisjes vendore paraqesin për miratim buxhetet në këshillat e tyre.

Këshilli i qeverisjes vendore, **brenda datës 25 dhjetor**, miraton buxhetin vendor, në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor.

Për vitin 2018 buxheti vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.85, datë 26.12.2017, në vlerën 2,700,732 mijë lekë nga të ardhurat vendore, transferta e pakushtëzuar, transferte specifike dhe transferte të kushtëzuar. Gjatë vitit 2018 ka pasur ndryshime pakësime dhe shtesa të buxhetit miratuar me vendime të Këshillit bashkiak dhe vendime të kryetarit.

Pasqyra e planit të buxhetit të vitit 2017 krahasuar me planin e PBA në 000 lekë

Nr.	Emërtimi	Plani I buxhetit 2017	Plani I buxhetit 2017 ne PBA	Diferenca
1	Shpenzime personeli (600,601)	604,247	641,816	-37,569
2	Shpenzime korente (602,604,609)	1,609,745	1,761,536	-151,791
3	Shërbimi i borxhit (166,651)			-
4	Shpenzime investimi (230/231)	298,297	385,056	-86,759
	Totali gjithsej	2,512,289	2,788,408	-276,119

Nga krahasimi i planit të buxhetit 2017 me planin e vitit 2017 në PBA rezulton një diferencë prej 276,119 mijë lekë. Nga auditimi konstatohet se:

-Në buxhetin e vitit 2017 bëjnë pjesë të ardhurat dhe shpenzimet e trashëguara nga viti i kaluar të cilat në hartimin e PBA-së nuk planifikohen dhe konkretisht në shumën 5,587 mijë.

-Shtesë e grantit të pakushtëzuar për vitin 2017 është jashtë parashikimit në planin e vitit 2017 në PBA me 54,631 mijë lekë .

-Pakësimi transfertës specifike për vitin 2017 është jashtë parashikimit në planin e vitit 2017 në PBA me 75,912 mijë lekë.

-Pakësimi transfertës së kushtëzuar për vitin 2017 është jashtë parashikimit në planin e vitit 2017 në PBA me 263,732 mijë lekë

-Në buxhetin e vitit 2017, ka një rritje tek plani i të ardhurave me 3,307 mijë lekë, krahasuar me planin e vitit 2017 në PBA.

Nëpërmjet grupit të punës për menaxhimin strategjik (GMS), ngritur nga Kryetari i Bashkisë, është hartuar PBA për periudhën 2017-2019 dhe është raportuar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 6569, datë 31.05.2016. Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projekt buxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë dhe institucionet vartëse, drejtoritë e shkollave, drejtoritë e bashkisë, njësitë administrative, etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare. Për hartimin e buxhetit të vitit 2017 nga titullari është nxjerrë Urdhri nr.216, datë 20.5.2016 dhe Urdhri nr.620, datë 10.10.2016 për ndërtimin e ekipeve të menaxhimit të programeve për fazën e parë dhe fazën përfundimtare. Gjithashtu me urdhrin nr.217, datë 20.05.2016 është miratuar kalendari për përgatitjen e projekt buxhetit vjetor 2017 dhe PBA 2017-2019- faza I-rë me urdhrin nr. 619, datë 10.10.2016 është miratuar kalendari për përgatitjen e projekt buxhetit vjetor 2017 dhe PBA 2017-2019- faza përfundimtare. Me shkresën nr. 2376/b,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

datë 12.10.2016 është nxjerrë udhëzimi për hartimin e PBA 2017-2019 dhe buxheti vjetor 2017. Ky dokument është hartuar nga Ekipe të Menaxhimit të Programeve.

Pasqyra e planit të buxhetit të vitit 2018 krahasuar me planin e PBA. në 000 lekë

Nr.	Emertimi	Plani i buxhetit 2018	Plani i buxhetit 2018 ne PBA	Diferenca
1	Shpenzime personeli (600,601)	634,410	666,393	-31,983
2	Shpenzime korente (602,604,609)	1,724,072	1,611,798	112,274
3	Sherbimi I borxhit (166,651)			-
4	Shpenzime investimi (230/231)	342,250	336,213	6,037
	Totali gjithsej	2,700,732	2,614,404	86,328

Për hartimin e buxhetit të vitit 2018 nga titullari është nxjerrë Urdhri nr. 201, datë 3.04.2017 për ndërtimin e ekipeve të menaxhimit të programeve. Me shkresën nr. 1030/b, datë 31.03.2017, është nxjerrë udhëzimi për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm periudha 2018-2020. Gjithashtu me urdhrin nr.198, datë 31.3.2017, është miratuar kalendari për përgatitjen e përgatitjes së PBA 2018-2019 faza I-rë, me urdhrin nr.620, datë 04.09.2017, është miratuar kalendari për përgatitjen e PBA periudha 2018-2019 dhe projekt buxhetit vjetor 2018, ndryshuar me urdhrin nr.658, datë 19.9.2017. Ky dokument është hartuar nga Ekipe të Menaxhimit të Programeve. Dokumenti i PBA 2018-2020 është raportuar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.8109, datë 31.5.2017, për fazën e I-rë të PBA-së dhe me shkresën nr.13773, datë 14.9.2017, për fazën e II-të të PBA 2018-2020.

Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për buxhetin e vitin 2017 dhe vitin 2018 është planifikuar duke përcaktuar fushat prioritare përkatëse. Në varësi të vlerave të fondeve të çelura në thesar në fillim të vitit ushtrimor janë bërë edhe miratimet e buxhetit fillestar të bashkisë. Për vitin 2017 nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se programimi i plan buxhetit i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2017 është në vlerën 248,902 mijë lekë dhe për vitin 2018 në vlerën 382,531 mijë lekë, sipas pasqyrës së mëposhtme:

Programimi i buxhetit për vitet 2017 dhe 2018.

Në 000/lekë

Nr	Emertimi	Plani i vitit 2017		Plani i vitit 2018	
		Ardhurat	Shpenzimet	Ardhurat	Shpenzimet
1	Te ardhura te trashëguara viti 2016/2017	5,587		27,516	
2	Transfereta e pakushtëzuar viti 2017/2018	555,124		606,231	
3	Transfereta specifike viti 2017/2018	318,428		351,477	
4	Plani I te ardhurave viti 2017/2018	616,046		678,761	
5	Plani I transferetes se kushtezuar 2017/2018	1,017,104		1,027,436	
6	Trashëguara nga Transfereta viti 2016/2017			9,311	
7	Shtese ne transfereten e vitit 2017/2018				
8	Trashëguar nga FZHR viti 2016				
9	Paga (600)		522,277		543,029
10	Sigurime shoqerore (601)		81,970		91,381
11	Shpenzime operative (602)		559,272		605,747
12	Transfereta (603+604+605+606+609)		1,050,473		1,118,325
13	Investimet (230+231) nga Buxheti I Bashkise		298,297		342,250
	Totali I buxhetit	2,512,289	2,512,289	2,700,732	2,700,732

Sipas pasqyrës më sipër rezultoi se për vitet 2017 dhe 2018 buxhetet janë miratuar të balancuara dhe pa defiçite. Buxhetet e dy viteve janë miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe janë konfirmuar nga prefektura e Qarkut Shkodër. Për vitin 2017 Buxheti është miratuar me VKB nr. 8, datë 30.1.2017 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 150/1, datë 08.02.2017. Për vitin 2018 me VKB nr.85, datë 26.12.2017 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 16/1, datë 15/01/2018.

Për periudhën janar - qershor 2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

-Për periudhën janar qershor 2019, buxheti i Bashkisë Shkodër është miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.82, datë 26.12.2018, konfirmuar me shkresën e Prefektit të Qarkut Shkodër me nr.1462/1, datë 07.01.2019. Gjatë kësaj periudhe, buxhetit i janë bërë ndryshime sipas miratimit me Vendime të Këshillit të Bashkisë dhe vendime të kryetarit .

-Buxheti për Bashkinë Shkodër është programuar në total në vlerën 2,994,147 mijë lekë, nga të cilat 630,668 mijë lekë janë me burim financimi nga të ardhurat e veta, vlera 984,436 mijë lekë me burim financimi të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe ajo specifike, vlera 1,069,689 mijë lekë me burim financimi transfertat e kushtëzuar dhe vlera 7,443 mijë lekë, me burim financimi projekte të huaja si dhe të trashëguara në shumën 242,042 mijë.

Programimi i buxhetit për periudhën janar-qershor 2019.

Në 000/lekë

Nr	Emertimi	Plani i viti 2019	
		Ardhurat	Shpenzimet
1	Te ardhura te trasheguara viti 2018	242,042	
2	Transferta e pakushtezuar viti 2019	630,668	
3	Transfereta specifike viti 2019	353,768	
4	Plani I te ardhurave viti 2019	690,537	
5	Plani I transferes se kushtezuar 2019	1,069,689	
8	Projekte te huaja	7,443	
9	Paga (600)		584,446
10	Sigurime shoqerore (601)		96,918
11	Shpenzime operative (602)		629,167
12	Transfereta (603+604+605+606+609)		1,121,854
13	Investimet (230+231) nga Buxheti I Bashkise		561,762
	Totali I buxhetit	2,994,147	2,994,147

Më hollësisht, burimet e financimit janë si vijon:

A-Të ardhurat nga tatim taksat lokale për vitin 2019 janë 690,537 mijë lekë,

B-Të ardhura te trashëguara: 242,042 mijë lekë,

C-Transferta e pa kushtëzuar (Granti) 630,668 mijë lekë,

D-Transferta për funksionet e reja, specifike (Arsimi, shërbimi i kullimit dhe ujitjes, shërbimi pyjor, rrugë rurale, SHMZSH), vlera 353,768 mijë lekë,

F-Transfertat e kushtëzuara në total 1,069,689 mijë lekë, me destinacione si vijon:

-Transferta të kushtëzuara për (Gjendje civile + QKB) 16,140 mijë lekë, (Ndihma ekonomike + paaftësi) 1,010,000 mijë lekë, Shpenzime ushqime shkolla 3 Dhjetori Speciale 3 200 mije , bursa nxënësit e shkollave të mesme 6,944 mijë lekë, Investim Ndërtim fusha sportive shuma 18,943 mijë lekë, Investim për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara në shumën 14,462 mijë lekë.

Gjatë 6 mujorit të parë 2019 ka patur shtesë fondi nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale me objekt "Fondi i rritjes së pagave për funksionin e arsimit parashkollor (transfertat e pakushtëzuar sektoriale që do shpërndahet sipas VKB nr.43, datë 24.6.2019). Gjatë 6 mujorit të parë 2019 janë bërë shtesa dhe pakësime sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe vendimeve të kryetarit.

Realizimi i treguesve të buxhetit, sipas akt rakordimit me degën e thesarit, paraqiten në vijim:

Realizimi i buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve paraqitet në 000 lekë

Nr	Emertimi	Viti 2019 – 6 M I-re		
		Plan	Fakt	Realizimi ne %
1	Paga 600	670,423	268,908	40%
2	Sigurime Shoqerore 601	111,669	44,838	40%
3	Shpenzime operative 602	859,328	336,104	39%
4	Subvencion 603	8,000		
5	Transferime te brendshme 604	113,074	61,954	55%
6	Transferime te individe 606	640,024	384,644	60%
7	Sherbimi borxhit , interesa 651			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

8	Fond rezerve dhe kontigjence 609	15,623	-	0%
9	Investime 230/231	976,321	315,418	32%
Total buxheti me ndryshime		3,394,462	1,411,866	42%

2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Për periudhën e audituar, viti 2017, 2018 dhe janar-qershor 2019, ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit. Si rezultat i këtyre ndryshimeve buxheti përfundimtar i planifikuar vlera me të cilat është rakorduar me thesarin në fund të vitit, për vitin 2017 është 3,165,026 mijë lekë dhe për vitin 2018 në vlerën 3,342,581 mijë lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Pasqyra e planit përfundimtar të buxhetit për periudhën e viteve 2017 dhe 2018. në 000/lekë

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2018
		Plan	Plan
1	Te ardhura te trashguara viti 2016/2017	201,403	383,587
2	Transferta e pakushtëzuar viti 2017/2018	555,124	606,231
3	Transfereta specifike viti 2017/2018	318,428	351,477
4	Plani I te ardhurave viti 2017/2018	616,046	678,761
5	Plani I transfertes se kushtezeuar 2017/2018	1,016,439	974,167
6	Trasheguara nga Transfereta Pakushtez viti 2016/2017	241,125	264,244
7	Trasheguara nga Transfereta specifike viti 2016/2018	48,032	52,873
8	Trasheguara nga Transfereta e kushtez dhe FZHR viti 2016/2017	168,429	31,241
Totali Burimeve		3,165,026	3,342,581
1	Paga 600	589,552	609,676
2	Sigurime Shoqerore 601	94,481	101,833
3	Shpenzime operative 602	701,142	825,674
4	Subvencion 603		3,000
5	Transferime te brendshme 604	100,863	141,466
6	Transferime te individe 606	953,406	924,218
7	Sherbimi borxhit , interesa 651		
8	Fond rezerve dhe kontigjence 609	4,674	10,674
9	Investime 230/231	720,908	726,040
Total buxheti me ndryshime		3,165,026	3,342,581

Si rezultat i ndryshimeve gjatë vitit brenda zërave të shpenzimeve janë bërë ndryshimet e nevojshme të cilat janë miratuar në mbledhjet e Këshillit Bashkiak me VKB të konfirmuar me shprehje ligjshmërie nga Prefekti si dhe me vendim Kryetari.

Ndryshimet pasqyrohen në tabelën e mëposhtme në vlerën totale për secilën llogari.

Pasqyra e ndryshimeve të buxhetit si shtesa dhe pakësime për vitet 2017 dhe 2018. në 000/lekë

Nr	Emertimi	Përfundimtar		Fillestar		Ndryshimet ne plan			
		Viti 2017	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2017		Viti 2018	
		Plan	Plan	Plan	Plan	Shtesa	Pakesime	Shtesa	Pakesime
1	Paga (600)	589,552	609,676	522,277	543,029	67,275		66,647	
2	Sigurime shoqerore (601)	94,481	101,833	81,970	91,381	12511		10452	
3	Shpenzime operative (602)	701,142	825,674	559,272	605,747	141870		219927	
4	Transfereta 603+604+605+606+609)	1,058,943	1,079,358	1,050,473	1,118,325	8470			-38,967
5	Investime (230+231) Buxheti Bashkise	720,908	726,040	298,297	342,250	422611		383790	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Total buxheti	3,165,026	3,342,581	2,512,289	2,700,732	652,737	-	680,816	-38,967
---------------	-----------	-----------	-----------	-----------	---------	---	---------	---------

Në tabelën bashkangjitur nr.1 paraqitet buxheti fillestar i vitit 2017 i miratuar me VKB nr.8, datë 30.1.2017 dhe konfirmuar për shprehje ligjshmërie nr.150/1, datë 8.2.2017, buxheti fillestar i vitit 2018 i miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017 dhe konfirmuar për shprehje ligjshmërie nr.16/1, datë 15.1.2018 dhe buxheti fillestar i vitit 2019 i miratuar me VKB nr. 82, datë 26.12.2018 dhe konfirmuar për shprehje ligjshmërie nr.1462/1 datë 17.1.2019 i ndarë sipas programeve dhe institucioneve.

Në tabelën bashkangjitur nr.2 paraqitet buxheti përfundimtar i vitit 2017, buxheti përfundimtar i vitit 2018 dhe buxheti i 6 mujorit të I-rë të vitit 2019, i ndarë sipas programeve dhe institucioneve.

3.Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;

Në auditimin e kryer për saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit, bazuar në situacionet e shpenzimeve të rakorduara me degën e thesarit, shpenzimet buxhetore rezultojnë sipas periudhave përkatësisht:

për vitin 2017, janë planifikuar në vlerën 3,165,026 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 2,395,740 mijë lekë ose në masën 76%.

për vitin 2018 janë planifikuar në vlerën 3,342,581 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 2,569,341 mijë lekë, ose në masën 77%.

Është rakorduar çdo muaj me degën e thesarit Shkodër, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Shkodër duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga grantet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore sipas pasqyrës në vijim:

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha vitet 2017 dhe 2018. Në 000/lekë

Nr	Emertimi	Viti 2017			Viti 2018		
		Plan	Fakt	Realizimi ne %	Plan	Fakt	%
1	Te ardhura te trashguara viti 2016/2017	201,403			383,587		
2	Transfereta e pakushtëzuar viti 2017/2018	555,124			606,231		
3	Transfereta specifike viti 2017/2018	318,428			351,477		
4	Plani I te ardhurave viti 2017/2018	616,046			678,761		
5	Plani I transferes se kushtezuar 2017/2018	1,016,439			974,167		
6	Trashguara Transfereta Pakushtez viti 2016/2017	241,125			264,244		
7	Trashguara Transfereta specifike viti 2016/2018	48,032			52,873		
8	Trasheg Transfereta kushtez e FZHR 2016/2017	168,429			31,241		
Totali Burimeve		3,165,026	-	-	3,342,581	-	-
1	Paga 600	589,552	511,748	87%	609,676	524,015	86
2	Sigurime Shoqerore 601	94,481	83,850	89%	101,833	87,351	86
3	Shpenzime operative 602	701,142	454,973	65%	825,674	597,649	72
4	Subvencion 603				3,000		0
5	Transferime te brendshme 604	100,863	95,863	95%	141,466	125,618	89
6	Transferime te individe 606	953,406	943,145	99%	924,218	917,730	99



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

7	Sherbimi borxhit , interesa 651						
8	Fond rezerve dhe kontigjence 609	4,674		0%	10,674		0
9	Investime 230/231	720,908	306,161	42%	726,040	316,978	44
Total buxheti me ndryshime		3,165,026	2,395,740	76%	3,342,581	2,569,341	77

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se peshën specifike më të madhe në buxhet e kanë shpenzimet për transfertat tek individët të cilat për vitin 2017 zënë 39.3% të shpenzimeve totale. Në vitin 2018 konstatohet se peshën specifike më të madhe në buxhet e kanë shpenzimet për transfertat tek individët të cilat për vitin 2017 zënë 35.7% të shpenzimeve totale. Për periudhën janar-qershor 2019 realizimi i shpenzimeve është sipas tabelës së mëposhtme:

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha 6 M i I-re 2019 Në 000/lekë

Nr	Emertimi	Viti 2019 per 6 M I-re		
		Plan	Fakt	Realizimi ne %
1	Te ardhura te trashguara viti 2018	731,994		
2	Transferta e pakushtëzuar viti 2019	630,668		
3	Transfereta specifike viti 2019	353,768		
4	Plani I te ardhurave viti 2019	690,537		
5	Plani I transfertes se kushtezuar dhe FZHR 2019	695,949		
6	Projekte te huaja	12,203		
7	Trashguara nga Transfereta Pakushtez viti 2016/2017	221,861		
8	Trashguara nga Transfereta specifike viti 2016/2018	36,860		
9	Trashguara nga Transfereta e kushtez dhe FZHR viti 2016/2017	15,442		
	Te trashguara projekte te huaja	5,180		
9	Paga (600)	670,423	268,908	40
10	Sigurime shoqerore (601)	111,669	44,838	40
11	Shpenzime operative (602)	859,328	336,104	39
12	Transfereta (603+604+605+606+609)	776,721	446,598	57
13	Investimet (230+231) nga Buxheti I Bashkise	976,321	315,418	32
	Totali I buxhetit	3,394,462	1,411,866	42

Në vitin 2017 është dërguar raporti i monitorimit të 6 mujorit të parë të vitit 2017 në Këshillin Bashkiak me shkresën 2973/b, datë 24.07.2017. Gjithashtu është dërguar raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën 8 mujorit të vitit 2017 në Këshillin Bashkiak me shkresën 3874/b, datë 22.9.2017 dhe në Ministri të Financave me shkresën nr.14162, datë 22.9.2017. Bashkia Shkodër me shkresën nr. 934/b, datë 27.3.2018 ka paraqitur për miratim buxhetin faktik të vitit 2017 në KB i cili është miratuar me VKB nr. 35, datë 22.05.2018 dhe është dërguar në MF me shkresën nr. 9593, datë 18.06.2018.

Në vitin 2018 është dërguar raporti i monitorimit të 4 mujorin e vitit 2018 në Këshillin Bashkiak me shkresën nr.8451, datë 29.05.2018 dhe në Ministri të Financave me shkresën nr.8392, datë 29.5.2018. Gjithashtu është dërguar raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën 8 mujore të vitit 2018 në Këshillin Bashkiak me shkresën nr.15647, datë 25.9.2018 dhe në Ministri të Financave me shkresën nr.15648, datë 25.9.2018. Bashkia Shkodër me shkresën nr. 767/b, datë 27.2.2019 ka paraqitur për miratim buxhetin faktik të vitit 2018 në Këshillin Bashkiak i cili është miratuar me VKB nr. 26, datë 18.04.2019 dhe është dërguar në MF me shkresën nr.3336, datë 28.02.2019.

Në 6 mujorin e parë të vitit 2019 është dërguar raporti i monitorimit te 4 mujorit të I-rë të vitit 2019 në KB me shkresën nr.9456, datë 31.5.2019 dhe në M F me shkresën nr.9455, datë 31.05.2019. Bashkia Shkodër çdo muaj deri më datë 10 të muajit pasardhës dërgon në Këshill Bashkiak treguesit kryesor të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor dhe planit të periudhës për periudhën respektive në bazë të nenit 44 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Analizë për investimet

Nga auditimi në lidhje me planifikimin dhe realizimin e investimeve në Bashkinë Shkodër u konstatua se:

*Për vitin 2017, me financim nga buxheti i Bashkisë dhe nga FZHR, janë planifikuar investime në vlerën 720,908 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 306,161 mijë lekë. Për vitin 2017 investimet me burim financimi transfertë e pakushtëzuar, transfertë specifike, të ardhura dhe donator janë 540,285,522 lekë dhe janë realizuar 215,100,284 lekë me rreth 39,8 % sipas aneksit bashkangjitur. Për vitin 2017 investimet me burim financimi transfertën e kushtëzuar janë 180,622,604 lekë dhe janë realizuar 91,060,604 lekë me rreth 50.4 % sipas aneksit bashkangjitur.

*Për vitin 2018, me financim nga buxheti i Bashkisë dhe nga FZHR, janë planifikuar investime në vlerën 726 040 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 316 978 mijë lekë. Për vitin 2018 investimet me burim financimi transferte e pakushtëzuar, transferte specifike, të ardhura dhe donator janë 652,606,113 lekë dhe janë realizuar 261,513,237 lekë ose 40,1 %, sipas sipas aneksit bashkangjitur.

Për vitin 2018 investimet me burim financimi transfertën e kushtëzuar janë 73,433,710 lekë dhe janë realizuar 55,464,935 lekë ose 75.5 % sipas aneksit bashkangjitur.

*Për periudhën janar-qershor 2019, me financim nga buxheti i Bashkisë dhe nga FZHR, janë planifikuar investime në vlerën 976,320 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 315,417 mijë lekë. Investimet me burim financimi transferua të pakushtëzuar, transferte specifike, të ardhura dhe donator janë 920,932,298 lekë dhe janë realizuar 296,930,050 lekë ose 32.2 % , sipas aneksit bashkangjitur.

Për periudhën janar-qershor 2019, investimet me burim financimi transfertën e kushtëzuar janë 55,388,701 lekë dhe janë realizuar 18,487,468 lekë ose 33.4 %.

Pasqyra e realizimit të Investimeve për 6 M e I-re vitit 2019 me burim financimi transfertën e kushtëzuar në lekë

Plani Total	Likuidime thesar	Gjendje Plan-likuidime	Pershkrimi
7,289,393	6,590,556	90.4%	Projekte per permiresimin e kushteve te banimit per komunitete
6,238,274		0%	Projekti "Jeto me sportin" "Rik terreneve sportive ne shkollat
11,907,996	11,896,912	99.9%	Rikonstruksion I bllokut te pallateve Xhabije
14,510,321		0%	Kanali Ujites KU-21
102,872		0%	Skema Ujitese Guri-Zi Juban(rehabilitim i pjeshem)
13,107,081		0%	Skema Ujitese Berdice-Shkoder
2,232,764		0%	Skema Ujitese Guri-Zi Juban Rehabilitim i Pjesshem
55,388,701	18,487,468	33.4%	Totali

Për shpenzimet e reja kapitale janë zbatuar hallkat e miratimit për përfshirjen në buxhet, pasi janë bazuar në prioritetet e caktuara, në kërkesat e paraqitura dhe verifikimit në vend të problemit, duke zhvilluar takime me komunitetin me qëllim nxjerrjen e nevojave reale dhe evidentimin e atyre me imediate. Të gjitha investimet janë të planifikuara dhe të mbuluara me cash.

Nga Bashkia Shkodër janë marrë masat për miratimin në kohë të buxheteve të viteve 2018 dhe 2019 pavarësisht faktit që shkresa e detajimit të transfertes së pakushtëzuar dhe asaj specifike ka ardhur në fund të muajit dhjetor duke krijuar mjaft vështirësi, megjithatë buxhetet janë miratuar respektivisht, Për vitin 2017 buxheti është miratuar me VKB nr. 8, datë 30.1.2017 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 150/1, datë 08.02.2017. Për vitin 2018 me VKB nr.85, datë 26.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 16/1, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

15/01/2018 . Për vitin 2019 me VKB nr.82, datë 26.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 1462/1, datë 07.01.2019. Në vitin 2017 është dërguar raporti i monitorimit të 6 M të I-rë të vitit 2017 në Këshillin Bashkiak me shkresën 2973/b, datë 24.07.2017. Gjithashtu është dërguar raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën 8 mujorit të vitit 2017 në Këshillin Bashkiak me shkresën 3874/b, datë 22.9.2017 dhe në Ministri të Financave me shkresën nr.14162, datë 22.9.2017. Bashkia Shkodër me shkresën nr. 934/b, datë 27.3.2018 ka paraqitur për miratim buxhetin faktik të vitit 2017 në KB i cili është miratuar me VKB nr. 35, datë 22.05.2018 dhe është dërguar në MF me shkresën nr. 9593, datë 18.06.2018. Në vitin 2018 është dërguar raporti i monitorimit të 4 mujorin e vitit 2018 në Këshillin Bashkiak me shkresën nr.8451, datë 29.05.2018 dhe në Ministri të Financave me shkresën nr.8392, datë 29.5.2018. Gjithashtu është dërguar raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën 8 mujore të vitit 2018 në Këshillin Bashkiak me shkresën nr.15647, datë 25.9.2018 dhe në Ministri të Financave me shkresën nr.15648, datë 25.9.2018. Bashkia Shkodër me shkresën nr. 767/b, datë 27.2.2019 ka paraqitur për miratim buxhetin faktik të vitit 2018 në Këshillin Bashkiak i cili është miratuar me VKB nr. 26, datë 18.04.2019 dhe është dërguar në MF me shkresën nr.3336, datë 28.02.2019. Në 6 mujorin e parë të vitit 2019 është dërguar raporti i monitorimit të 4 mujorit të I-rë të vitit 2019 në KB me shkresën nr.9456, datë 31.5.2019 dhe në M F me shkresën nr.9455, datë 31.05.2019. Bashkia Shkodër çdo muaj deri më datë 10 të muajit pasardhës dërgon në Këshill Bashkiak treguesit kryesor të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor dhe planit të periudhës për periudhën respektive në bazë të nenit 44 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Gjetje nga auditimi:

Titulli Gjetjes	-Zbatimi i Buxhetit
Situata:	<i>-Për vitin 2017 buxheti është realizuar në masën 76% ose nga 3,165,026 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 2,395,740 mijë lekë, ndërsa për vitin 2018 është realizuar në masën 77% ose nga 3,342,581 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 2,569,341 mijë lekë. Në zërin investime, buxheti për vitin 2017 është realizuar në masën 42,4% ose nga 720,908 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 306,161 mijë lekë, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 215,100 mijë lekë ose 39,8%. Ndërsa për vitin 2018 është realizuar në masën 44% ose nga 726,040 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 316,978 mijë lekë, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 261,513 mijë lekë ose 40,1%. Për periudhën janar-qershor 2019 është realizuar në masën 42% ose nga 3,394 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 1,411 mijë lekë. Të ardhurat e veta, për vitin 2017 është realizuar në masën 99% ose nga 621,886 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 612,686 mijë lekë, dhe për vitin 2018 është realizuar në masën 104% ose nga 678,761 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 703,176 mijë lekë.</i>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,-Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar,-Ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”,-Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,-UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe-UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Ndikimi/Efekti	-Mos realizim i treguesve të zbatimit të buxhetit, në total treguesit e shpenzimeve të buxhetit buxhetit për vitin 2017 dhe 2018 janë realizuar respektivisht në masën 76% dhe 77%.
Shkaku	- Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	-I Lartë
Rekomandimi	Të merren masa nga Bashkia Shkodër, që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të hartojë një buxhet sa më real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;

B/. pika 4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

KLSH konstatoj se Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër nuk ka bërë të mundur arkëtimin detyrimeve të paarkëtuara të subjekteve fizik/ juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të për 4195 subjekte për vlerën 543,695,300 lekë dhe debitorëve për 37302 familje për vlerën gjithsej 351,468,284 lekë.

Situata:

Për periudhën objekt auditimi, sipas strukturës organizative, për mbledhjen e të ardhurave ka funksionuar Drejtoria e të Ardhurave, me 4 Sektorë Paketat fiskale për periudhën objekt auditimi janë miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 1, datë 22.01.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave në Bashkinë Shkodër” të ndryshuar, rezulton se për vitin 2017, kanë ushtruar aktivitet 6116 subjekte (5072 subjekte të biznesit të vogël, 1044 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera institucione) dhe për vitin 2018, kanë ushtruar aktivitet 6151 subjekte (5084 subjekte të biznesit të vogël, 1067 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera institucione).

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se, për vitin 2017, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore gjithsej, nga 621,886 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 612,686 mijë lekë ose 99 %, me një mosrealizim në vlerën 9,200 mijë lekë më shumë .

Për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore gjithsej, nga 678,761 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 703,176 mijë lekë ose 104 %, me një tejkallim në vlerën 24,415 mijë lekë.

Për 5/ mujori e vitit 2019, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore gjithsej, nga 248,601 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 189,848 mijë lekë ose 76 %, me një mos realizim në vlerën 58,753 mijë lekë, sipas pasqyrës Aneks nr. 1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2018 për mos pagesën e detyrimeve tatimore në vlerën gjithsej 895,163,594 lekë, janë debitorë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh gjithsej 4195 subjekte në vlerën 543,695,300 lekë lista të administruara me CD dhe 37302 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 351,468,284 lekë, sipas pasqyrës Aneks nr. 2 dhe 3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

U konstatua se edhe pse vazhdojnë procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 4195 subjekte debitorë në vlerën 543,695,300 lekë, janë aktiv 1414 subjekte ose 34 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, në vlerën 136,813,591 lekë ose 25 % e vlerës së debitorëve. Debitorë, më datën 30.06.2019 për mos pagesën e detyrimeve tatimore në vlerën gjithsej 898,720,017 lekë, janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh gjithsej 3772 subjekte në vlerën 503,506,017 lekë dhe 36679 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 395,214,000 lekë, sipas pasqyrës Aneks nr. 4 dhe 5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi: z. B. Gj. me detyrë Drejtor i Drejtorisë e të Ardhurave për periudhën e auditimit.

Kriteri:

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 68-2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104,.

Impakti:

Mos pasqyrim i drejtë i situatës financiare të Bashkisë Shkodër, mangësi në realizimin e të ardhurave të programuara sipas paketës fiskale dhe rrjedhimisht mos përmbushje e programeve buxhetore në lidhje me realizimin e tyre, duke mos ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për popullatën. Akumulim i borxheve dhe rrjedhimisht pamundësi për të programuar në mënyrë të qartë dhe të realizueshme shpenzimet e buxhetit.

Shkaku

Mos ndjekja dhe mos arkëtimi i detyrimeve të debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave.

Rëndësia

E lartë

Rekomandimi:

Drejtorja e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të paarkëtuara të subjekteve fizik/ juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura ndaj 4195 subjekte për vlerën 543,695,300 lekë (sipas pasqyrave që disponon, marrë në CD), bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-T’u ridërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-Të ridërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

vendosjen e barrës siguroese për mjetet, sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Dhe në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Drejtorja e të Ardhurave, Bashkia Shkodër të marrë masa dhe të kërkojë arkëtimin debitorëve për 37302 familje për vlerën gjithsej 351,468,284 lekë, sipas të dhënave të disponon, duke dërguar njoftim vlerësimit abonentëve familjarë me postë, për: taksë toke në vlerën 12,917,007 lekë;

-Taksë ndërtese në vlerën 129,754,321 lekë, taksë trualli në vlerën 3,516,124 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 205,280,832 lekë.

B/. pika 4, -Mbi lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

KLSH konstaton se Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve në vlerën 235,048,927 lekë, shumë e cila përben të ardhur të munguar për bashkinë.

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e Aluiznit Shkodër janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP Shkodër.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.05.2019, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **966 persona** me vlerë **235,048,927 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Shkodër**, sipas listës së administruar me CD. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr.860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1. *Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi: z. B. Gj. me detyrë Drejtor i Drejtorisë e të Ardhurave për periudhën e auditimit.*

- Kriteri:** Me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1.
- Impakti:** Mos arkëtimi i detyrimeve taksës së ndikimit në infrastrukturës nga ndërtimet pa leje, ka çuar në mungesë të ardhurash në vlerën **235,048,927 lekë**, për buxhetin e Bashkisë.
- Shkaku** Nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër nuk janë bërë akt rakordimet me Drejtorin Rajonale e ALUIZNIT Shkodër, për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve.
- Rëndësia** **E lartë**
- Rekomandimi:** Bashkia Shkodër, nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **235,048,927 lekë**.

Për sa sipër, është paraqitur observacioni i ardhur nga subjekti, me nr. 9599/5 prot, datë 26.08.2019, protokolluar në KLSH me nr. 405/5 prot, datë 29.08.2019, në të cilin citohet: *Drejtoria e të Ardhurave, ka zbatuar dispozitat ligjore të VKM-se nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” Pika 5, si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, pasi në momentin e marrjes së informacionit nga ALUIZNI është bërë faturimi dhe është dërguar njoftimi sipas dispozitave ligjore të lartpërmendura. Ne shkresën Nr. 13824, dt. 24.10.2016 i është kërkuar ALUIZNI-t mospajisja me leje legalizimi, pa likuduar nga ana e subjektit taksa e ndikimit në infrastrukturë. Po kështu me shkresën Nr. 13827, dt. 24.10.2016 i është kërkuar ZVRPP-së Shkodër moskryerja e regjistrimit të pronës për subjektet debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Në vijim, për ecurinë e procedurave, Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 2.11.2016, me propozim të Kryetares së Bashkisë, me vendimin nr. 54, ka vendosur: “Miratimin e fondit në vlerën lekë 5,057,790 si shpenzime gjyqësore për ngritjen e kërkesë padive në lidhje me vlerën e debitorëve në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në zonat /ndërtimet informale. Burimi i financimit ishte parashikuar fondi i kontigjencës i Bashkisë Shkodër, miratuar me VKB nr. 17, datë 28.4.2016. Me shkresën nr. 954/1 prot, datë 10.11.2016 në verifikim të këtij vendimi, Prefekti i Qarkut Shkodër, nuk autorizon procedimin, me arsyetimin: Referuar ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 6 “Fondi i kontigjencës mund të krijohet për të përballuar efektet e mosrealizimit të të*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

ardhurave”, dhe duke qenë se në buxhetin vjetor 2016 nuk keni parashikuar përballimin e këtyre shpenzimeve nga të ardhurat, Prefekti nuk autorizon procedimin”. Në lidhje me këtë propozim të Bashkisë Shkodër, bashkia ka vazhduar punën për kërkimin dhe mbledhjen e debive në rrugë gjyqësore, për ato raste kur subjektet debitore nuk i përgjigjen kërkesës së bashkisë për pagesën e detyrimeve.

Në vijim janë dërguar shkresat Nr. 7092, dt. 10.05.2018 dhe Nr. 13985, dt. 29.08.2018 drejtuar ALUIZNI-t për dhënie informacioni për subjektet në proces legalizimi.

Opinion i grupit ta auditimit:

Përsa observohet për këtë pikë, nuk merren në konsideratë për faktin se procedurat e ndjekura për arkëtimin e detyrimeve nga Drejtoria e të Ardhurave nuk janë të mjaftueshme, nuk janë në zbatim të përcaktimeve të VKM nr.860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5.thuhet se: “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar,

si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1 , ku thuhet: “.....Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit”.

*Në lidhje me auditimin e kryer për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave nga dhënia me qira të pasurisë së Bashkisë apo Njësisë Administrative si, Ambiente, Toka, Pyje, Kullota, etj, u audituan dokumentacioni për vitet 2017, 2018 deri më 30.06.2019.

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e zyrës së Sektorit të Menaxhimit të Aseteve dhe aksioneve të Ndërmarrjeve të bashkisë, për dhënien me qira të pasurive të institucionit të qeverisjes vendore dhe konkretisht kontratat e trashëguara dhe të përthithura nga ish Komunitet aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë.

Nga auditimi i kryer për monitorimin e arkëtimit të detyrimeve nga dhënia e objekteve të ndryshme me qira, kontratat e qirave të përpiluara midis Bashkisë Shkodër dhe personave fizik dhe juridik, datat e lidhjes së kontratave, vendndodhjen e objektit të dhënë me qira, afatin e kontratës, detyrimet, arkëtimet dhe diferencat e pa arkëtuara për periudhën objekt auditimi, paraqiten në vijim:

Viti 2017.

Pasqyra e detyrimeve, arkëtimeve, diferencave për periudhën 01.01.2017-31.12.2017.

Nr	Emri Shoqërisë	Vendndodhja	Kontrata		Afat Në vite	Sipërfaqja	Detyrimi për vitin 2017	Arkëtuar në lekë	Dif për arkëtim në lekë
			Nr	Datë					
1	B. B.	Shkodër	2,946	23.05.2014	5	1,132	1,550,000	1,350,000	200,000
2	"I."shpk	Shkodër	650	24.03.2000	20	1,133	311,767	311,767	0
TOTALI							1,861,767	1,661,767	200,000

Viti 2018.

Pasqyra e detyrimeve, arkëtimeve, diferencave për periudhën 01.01.2018-31.12.2018.

Nr	Emri Shoqërisë	Vend	Afati	Sipërfaqja	Detyrimi	Arkëtuar	Dif për
----	----------------	------	-------	------------	----------	----------	---------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

		ndodhja	Kontrata		Në vite		për vitin 2018	në lekë	arkëtim në lekë
			Nr	Datë					
1	B. B.	Shkodër	2,946	23.05.2014	5	1,132	1,800,000	0	1,800,000
2	"I."shpk	Shkodër	650	24.03.2000	20	1,133	311,767	311,767	0
3	"B. T."sha	Shkodër	18,374	11.12.2017	1	7,5	13,500	13,500	0
TOTALI							2,125,267	325,267	1,800,000

Viti 2019

Pasqyra e detyrimeve, arkëtimeve, diferencave për periudhën janar-qershor 2019.

Nr	Emri Shoqërisë	Vend ndodhja	Kontrata		Afati Në vite	Sipër faqja	Detyrimi janar-qershor	Arkëtuar në lekë	Dif për arkëtim në lekë
			Nr	Datë					
1	B. B.	Shkodër	2,946	23.05.2014	5	1,132	750,000	419,000	331,000
2	"I."shpk	Shkodër	650	24.03.2000	20	1,133	305,792	111,987	193,805
3	"B. T."sha	Shkodër	18,374	11.12.2017	1	7,5	13,500	13,500	0
4	"B. V."sha	Shkodër	2,085	08.02.2019	1	12	21,600	21,600	0
TOTALI							1,090,892	566,087	524,805

Si përfundim konstatohet se: -Nga Bashkia Shkodër, Zyra e Aseteve, në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave nga dhënia me qira e asetëve që kanë në administrim, nuk kanë kryer sa dhe si duhet monitorimin për të arkëtuar detyrimin, sipas kontratave të qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Shkodër dhe shoqërive private, ku rezultojnë diferenca të pa arkëtuara në total **në vlerën 2,524,805 lekë, sipas periudhës rezulton** për vitin 2017 në vlerën 200,000 lekë, për vitin 2018 në vlerën 1,800,000 lekë dhe për periudhën janar-qershor viti 2019 vlera 524,805 lekë, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", sipas aneksit nr.2.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Nga auditimi i kryer për planifikimin, realizimin e të ardhurave nga dhënia me qira e asetëve, konstatohet se nga Bashkia Shkodër, Zyra e Aseteve, nuk kanë kryer plotësisht monitorimin për të arkëtuar detyrimin sipas kontratave të qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Shkodër dhe shoqërive private, për dhënien me qira të asetëve, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, kapitulli VI, pikat 1,2,9 e 10, sipas aneksit nr.1 **me pasojë, dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë në vlerën 2,524,805 lekë.**

Titulli Gjetjes	-Mos monitorim të kontratave të qirasë të asetëve të Bashkisë, mos arkëtim detyrimi.
Situata:	-Nuk janë zbatuar detyrimet kontratuale, nuk është zbatuar plotësisht monitorimi për të arkëtuar detyrimin në vlerën 2,524,805 lekë , sipas kontratave të qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Shkodër dhe shoqërive private, për dhënien me qira të asetëve të Bashkisë,
Kriteri	-VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, kapitulli VI, pikat 1,2,9 e 10.
Ndikimi/Efekti	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Shkaku	-Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	-I lartë.
Rekomandimi	-Të merren masa nga Bashkia Shkodër, që të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimit në vlerën 2,524,805 lekë .

Komente nga subjekti i audituar: Në kundërshtimet me nr.9599/37/1 datë 26.08.2019, protokolluar në KLSH me nr.405/5, datë 29.08.2019 të znj.M. Ll. dhe znj.S. M. për Projektraportin e Auditimit ku citohet se:

Bashkia Shkodër ka filluar procedurën administrative duke njoftuar zyrtarisht subjektin B. B. pf, për kryerjen e pagesave dhe respektim të kushteve të kontratës, Me shkresën nr.3820.prot, datë 23.03.2017 me objekt: për shlyerjen e pagesës së qirasë për muajt janar- shkurt 2017, me shkresën nr. 5575.prot, datë 25.04.2017 me objekt : për shlyerjen e pagesës së qirasë për muajt janar- mars 2017, me shkresën me nr. 6862.prot, datë 10.05.2017, me objekt : për shlyerjen e pagesës së qirasë për muajt janar- prill 201, me shkresën nr. 10066.prot, datë 28.06.2017 me objekt : për shlyerjen e pagesës së qirasë për muajt janar- maj 2017.

Subjekti "B. B." pf ka paraqitur kërkesë padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dt.29.06.2017, me palë ndërgjyqese dhe objekt;

Paditës: "B. B." person fizik, përfaqësuar me administrator z.B. B. ,me nr.NIPT K36317001M.

I paditur: Bashkia Shkodër

Objekti: Përmbushjen e detyrimeve kontraktore të shprehura në kontratën e qerasë me nr.2946 prot. dt.23.5.2014, konkretisht neni 9, efekt të forcës madhore. për muajt korrik gusht 2016 duke i kompensuar muajt pasardhës për vitin 2017, (referuar Urdhrit të Ministrit të Bujqësisë nr.371, datë 08.07.2016, urdhërit nr.448 , datë 29.08.2016, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e semundjes Dermatozës Nodulare të gjedhit".

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr.1330 (51-2017-4427) datë 26.10.2017, vendosi pranimin e kërkesë padisë. Detyrimin e të paditurit bashkia shkoder për të përmbushur detyrimin kontraktor në favor të paditësit B. B., detyrim kontraktor ky që rrjedh nga kontrata dt.23.5.2014 »Kontrate qeraje » neni 9 (efekt të forcës madhore).

Detyrimin e palës së paditur për të bërë kompensimin e pagesave për periudhën nga 08.07.2017 deri 19.08.2017, konkretisht vlerën prej 250,000 lekë në muajt pasardhës. Vendimi gjyqësor është zbatuar nga Drejtoria e të ardhurave (1 muaj e 20 ditë).

Gjatë monitorimit ka rezultuar se subjekti B. B. pf, ka vazhduar të mos shlyej detyrimet nga Janar-shkurt-mars-prill-maj-qershor -1-7korrik-20.08.-shtator-tetor- nëntor 2017.

Si rezultat bashkia Shkodër ka vazhduar me procedurën administrative dhe me shkresën nr.17536 prot. dt.21.11.2017, ka njoftuar subjektin B. B. pf, për mos respektimin e kushteve të kontratës dhe detyrimin e shlyerjes se pagesës së qirasë për vlerën 1,400,000 lekë, në të kundërt do të zgjidhet kontrata bazuar në nenin 10, pika 2 e kontratës, e cila në rregullimin e kësaj marrëdhënie ka forcën e ligjit.

Nga ana e qiramarrësit subjektit B. B. pf, nuk është kryer asnjë veprim për shlyerjen e detyrimit kontraktor (qira mujore/vjetore).

Detyrimi kontraktor i pashlyer nga subjektit « B. B. » pf është në vlerën 1,400,000 lekë për periudhën respektive Janar-shkurt-mars-prill-maj-qershor -1-7korrik-20.08.-shtator-tetor-nëntor 2017.

Sa sipër, bashkia Shkodër është drejtuar Gjykatës së Rrethit Shkodër me kërkesë padinë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

nr.18511 prot. dt.13.12.2017, me palë ndërgjyqëse;

Paditës: Bashkia Shkodër

I paditur: "B. B." person fizik, përfaqësuar me administrator z.B. B. ,me nr.NIPT K.....M.

Objekti:

1-Zgjidhjen e kontratës së qirasë nr.2946.prot, dt 23.05.2014, lirimin dhe dorëzimin e objektit, për shkak të mos përmbushjes së kushteve kontraktore.

2-Detyrimin e subjektit "B. B." pf, t'i paguaj paditësit Bashkisë Shkodër masën e detyrimit kontraktor (qira mujore) të pashlyer në vlerën 1,400,000 lek, për muajt Janar-shkurt-mars-prill-maj-qershor -1-7korrik-20.08.-shtator-tetor- nëntor 2017.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr.235(845) dt.26.02.2018, vendosi ; pushimin e gjykimit, pasi ndërmjet bashkisë Shkodër dhe subjektit B. B. pf është nënshkruar marrëveshja nr.2996 dt.26.02.2018 për likuidimin me këste të detyrimeve tatimore deri tetor viti 2018.

Vlefta që ka shlyer subjekti në fjalë sipas konfirmimit të drejtorisë së të ardhurave pranë bashkisë Shkodër është 1,350,000 lekë pjesë e detyrimit të prapambetur për vitin 2017, duke mbetur debitor përsëri në vleftën 200,000 lekë për vitin 2017.

VITI 2018

Referuar pasqyrës se aseteve të dhëna me qira per subjektin B. B. pf ju sqarojmë ;

Pasqyra e aseteve të dhëna me qira për periudhën 01.01.2018- 31.12.2018

Nr	Emri i Shoqërisë	Vend ndodhja	Kontrata		Afati në vite	Sipërfaqja në m ²	Detyrimi për vitin 2017	Arkëtuar në lekë	Dif për arkëtim në lekë
			Nr.	Data					
1	B. B.	Shkodër	2946	23.05.2014	5	1132	1,800,000	0	1,800,000
2	"I.D.A." Sh.a	Shkodër	650	24.03.2000	20	1133	899,339	899,339	0
3	B. T. Sh.a	Shkodër	18374	11.12.2017	1	7.5	13500	13500	0
TOTALI							2,712,839	912,839	1,800,000

Në vijim të monitorit për shlyerjen e qirasë sipas marrëveshjes, rezulton se subjekti B. B. pf nuk ka zbatuar marrëveshjen e nënshkruar duke vazhduar mos respektimin e kushteve të kontratës.

Bashkia Shkodër ka vijuar me procedurën administrative duke njoftuar subjektin për shlyerjen e detyrimeve me anë të shkresave të mëposhtme ,me shkresa nr.5504 prot. dt.13.04.2018 « Për shlyerje të pageses së qirase », shkresa nr.7491 prot. dt.17.05.2018 « Për shlyerje të pagesës së qirase », shkresa nr.17103 prot.dt.16.10.1018 « Njoftim për masën e detyrimit e keni ndaj bashkisë Shkodër dhe kërkesën për shlyerjen e detyrimit », shkresa nr.19534 prot. dt.21.11.2018 « Njoftim për zgjidhje marrdhënie kontraktuale ».

VITI 2019

Referuar pasqyrës se aseteve të dhëna me qira për subjektin B. B. pf ju sqarojmë,

Pasqyra e aseteve të dhëna me qira për periudhën 01.01.2019- 30.06.2019

Nr	Emri i Shoqërisë	Vend ndodhja	Kontrata		Afati në vite	Sipërfaqja në m ²	Detyrimi për vitin 2017	Arkëtuar në lekë	Dif për arkëtim në lek
			Nr.	Data					
1	B. B.	Shkodër	2946	23.05.2014	5	1132	750,000	419,000	331,000
2	"I." Sh.a	Shkodër	650	24.03.2000	20	1133	305,792	111,987	193,805



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

3	B. T. Sh.a	Shkodër	18374	11.12.2017	1	7.5	13500	13500	0
4	"B. V." Sh.a	Shkodër	2085	08.02.2019	1	12	21600	21600	0
TOTALI							1,090,892	566,087	524,805

Bashkia Shkodër duke u ndodhur në kushtet e mos respektimit dhe përmbushjes së detyrimit ligjor të kontratës së qirasë ka depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kërkesë padinë nr.745 prot. datë 17.01.2019, me palë ndërgjyqës ;

Paditës: Bashkia Shkodër

I paditur: "B. B." person fizik, përfaqësuar me administrator z.B. B., me nr.NIPT K.....M.

Objekti:

1-Zgjidhjen e kontratës së qirasë nr.2946.prot, datë 23.05.2014, lirimin dhe dorëzimin e objektit, për shkak të mos përmbushjes së kushteve kontraktore.

2-Detyrimin e subjektit "B. B." pf, t'i paguaj paditësit Bashkisë Shkodër masën e detyrimit kontraktor (qira mujore) të pashlyer, si më poshtë; -në vlerën 200,000 leke, për vitin 2017.-në vlerën 1,800,000 lekë, për vitin 2018.-në vlerën 150,000 lekë, për vitin 2019. Vlera totale 2,150,000 lekë 3-Sigurimin e padisë.Ky detyrim kontraktor i pashlyer është deri me datën 16.01.2019 , sipas konfirmimit të drejtorisë të ardhurave.

Bashkia Shkodër me shkresën nr.9823 prot. dt.07.06.2019 ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ndryshimin e objektit të padisë duke saktësuar detyrimin kontraktor të mbetur pa likuiduar nga subjekti "B. B." pf, konkretisht;-në vlerën 200,000 leke, për vitin 2017.-në vlerën 1 800 000 leke, për vitin 2018.-në vlerën 331 000 leke, për vitin 2019.(janar -23 Maj 2019)

Statusi i çështjes :Vazhdon gjykimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Referuar dokumentacionit që disponojmë në lidhje me monitorimin e kontratës së qirasë nr.650.prot, datë 23.03.2000, realizuar me shoqërinë I., për vitin 2019, ju sqarojmë ;

-Shoqëria I. për Janar- qershor 2019 ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Shkodër duke përfshirë edhe detyrimin në vlerën 193 805 leke të cituar në aneksin Nr. 1, të cilat janë

1035\$ me datë 08.05.2019 tek B. C., 2967\$ me datë 19.06.2019 tek B. C. dhe vleften 28,848 leke, me datë 14.08.2019 B.C. e cila përfshin detyrimet nga 01 Janar deri 30 qershor 2019.Bashkangjitur janë -Kopje të marrëveshjes me subjektin B. B. pf; -kopje të kërkesë padisë; -kopje të shtesës së kërkesë padisë; -kopje të konfirmimit të pagesës së subjektit I. sha.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit nuk merren në konsideratë pasi :

Për subjektin B. B. detyrimi për vitin 2017, sipas observacionit Tuaj ngelet 200,000 lekë, vlerë e cila është konstatuar edhe nga grupi i auditimit, por Ju jepni sqarime të cilat gjatë procesit të auditimit janë diskutuar edhe në ballafaqimet e bëra në subjektin Bashkia Shkodër. Gjithashtu për vitin 2018 dhe për periudhën Janar – Qershor 2019 ngelet po i njëjti detyrim. **Merren në konsideratë për sa i përket përgjegjësisë** pasi Ju i keni ndjekur të gjitha procedurat e monitorimit për arkëtimin e detyrimeve nga Qiratë e aseteve, pavarësisht rezultatit përfundimtar pasi jeni në vazhdim procedure dhe u bënë rregullimet përkatse në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjithashtu edhe për subjektin "I." sha pavarësisht shpjegimeve dhe komenteve Tuaja detyrimi është i pa arkëtuar, por procedurat Tuaja janë ndjekur për monitorimin e kontratave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

*Në lidhje me auditimin e kryer për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave nga zbatimi i tarifës së pagesës për dhënie dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Shkodër, konstatohet se:

Sipas evidencës së paraqitur nga specialistët e Sektorit të Sinjalistikës, Transportit dhe Mobilitetit, lidhur me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitete me seli në territorin e bashkisë Shkodër dhe në Njësitë Administrative në vartësi, u audituan për arkëtimin e tarifës për lëshimin e Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Shkodër.

Në vijim paraqiten subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë në Bashkisë Shkodër, nipti, administratori, adresa ku ushtron aktivitetin, numri data dhe afati i fillimit dhe përfundimit të autorizimit/Licencës.

Pasqyra e subjekteve që tregtojnë karburante bashkia Shkodër periudha janar 2017-qershor 2019.

Nr	Subjekti	Nipti	Administratori	Adresa	Nr. Dt. Afati
1	"E.-K" shpk	K.....C	V. G.	Rr Lev Postribes	nr.6, 05.01.2012-2017
2	"A." shpk	K.....V	R. S.	Bul Zogu I	nr.7, 04.05.2012-2017
3	"L. - A" shpk	K.....C	S. L.	Pazari Vjetër	nr.4,17.11.2011-2016
4	"J. P." shpk	L.....I	D. Gj. C.	Bahçallëk	nr.9,28.10.2013-2018
5	"J. P." shpk	L.....I	D. Gj. C.	Skënderbeg	nr.8,28.10.2014-2019
6	"L. - A" shpk	K.....C	S. L.	Bahçallëk	nr.2/1,04.11.2013-2018
7	"L. - S" shpk	K.....I	S. L.	L.N.Gjylbegu	nr.5, 30.11.2011-2016
8	"D." shpk	K.....T	I. D.	L.S. Halili	nr.3,14.11.2011-2016
9	"A." shpk	J.....O	Xh. A.	L.Liria	nr.1/1,25.11.2011-2016
10	"A." shpk	J.....T	A. M.	Edit Turhan	nr.10,08.08.2014-2019
11	"L. - A" shpk	K.....C	S. L.	Mark Lula	nr.11,22.09.2014-2019
12	"G. C." shpk	K.....T	D. G.	Liria	nr.11,10.12.2014-2019
13	"G. C." shpk	K.....T	D. G.	Guerile	nr.12,10.12.2014-2019
14	"O." shpk	J.....I	B. Ç.	3 Heronjtë	nr.13,07.01.2015-2020
15	"J. P." shpk	L.....I	B. A.	Dobraç	nr.14,04.12.2015-20120
16	"J. P." shpk	L.....I	B. A.	Shtoji Vjeter	nr.15,04.12.2015-2020

Në lidhje me auditimin e kryer, për zbatimin e legjislacionit të taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të këshillit bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë karburanti, (autorizime), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", si dhe të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pikës 1, germës "b"; pika 6/1; dhe pika 9; të VKB nr.1, datë 22.01.2016 "Për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër", ndryshuar me VKB nr.84, datë 26.12.2017 dhe VKB nr.79, datë 04.12.2018, kapitulli II.4.5.1, u konstatua se:

-Nga 16 subjekte që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Shkodër, në 8(tetë) prej tyre u ka përfunduar afati i përdorimit dhe për rrjedhojë duhet të përsëriteshin dhe të paguanin tarifën përkatëse.

Në 8 raste nga sektori i transportit, nuk janë pajisur subjektet, me autorizim/licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe nga Drejtoria e të Ardhurave nuk është arkëtuar tarifa për dhënie dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

shkelje të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9; si dhe VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Shkodër”, ndryshuar me VKB nr.84, datë 26.12.2017 dhe VKB nr.79, datë 04.12.2018, kapitulli II.4.5.1.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Sektori i Sinjalistikës, Transportit dhe Mobilitetit, Bashkia Shkodër, nuk është vepruar për të pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe nuk janë arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, të trajtuara në aneksin nr.B/4. jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kapitulli II, pika 1; germa “b”; pika 9 dhe të VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar me VKB nr.84, datë 26.12.2017 dhe VKB nr.79, datë 04.12.2018, kapitulli II.4.5.1, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Shkodër, sipas aneksit nr.1, në 8 raste në vlerën **8,000,000 lekë**.

Gjetje nga auditimi

Titulli Gjetjes	-Mos arkëtim tarife nga mos dhënia e Licencave për tregti karburanti.
Situata:	-Nuk është vepruar për të pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, nuk është arkëtuar tarifa në vlerën 8,000,000 lekë , për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë.
Kriteri	-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017
Ndikimi/Efekti	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.
Shkaku	-Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	-I lartë.
Rekomandimi	-Të merren masa nga Bashkia Shkodër, që të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimit në vlerën 8,000,000 lekë .

Komente nga subjekti i audituar: Në kundërshtimet me nr.9599/37/1 datë 26.08.2019, protokolluar në KLSH me nr.405/5, datë 29.08.2019 të z.B. Gj. dhe z.V. M. për Projektraportin e Auditimit ku citohet se:

Në lidhje me 8 raste që nuk janë pajisur subjektet me licencë nga sektori i transporteve për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajra lubrifikante dhe lëndëve djegëse, të paraqitura në pasqyrën e detyrimeve të subjekteve që tregtojnë karburante të pa pajisur me licencë, sqarojmë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

1. Subjekti "A." shpk është refuzuar disa herë, së fundmi me 06.06.2019, pasi aplikimi ka rezultuar me mangësi në dokumentacion. Pas plotësimit të dokumentacionit, është realizuar pagesa prej 1,000,000 Lekë dhe subjekti është pajisur me licencë me datë 11.07.2019.
2. Subjekti "L." shpk është refuzuar pasi aplikimi ka rezultuar me mangësi në dokumentacion.
3. Subjekti "L. A." shpk me adresë në Pazar të vjetër, është refuzuar disa herë, së fundmi me 26.03.2019, pasi aplikimi ka rezultuar me mangësi në dokumentacion.
4. Subjekti "L. A." shpk me adresë në Bahcallëk, është refuzuar pasi aplikimi ka rezultuar me mangësi në dokumentacion.
5. Subjekti "D." shpk është refuzuar disa herë, pasi aplikimi ka rezultuar me mangësi në dokumentacion.
6. Subjekti "J. P." shpk nuk ka aplikuar për licencim pranë Bashkisë Shkodër.
7. Subjekti "A." shpk ka bërë kërkesë dhe është refuzuar për mosplotësim dokumentacioni.
8. Subjekti "E. K." shpk nuk ka aplikuar për licencim pranë Bashkisë Shkodër.

Sqarojmë se Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës (Sektori i Transporteve), ka për detyrë të pranojë aplikimet për licencim dhe përgatit licencat pas plotësimit të kriterëve. Në rast mosplotësimi të një apo më shumë kriterëve, e refuzon deri në plotësimin e dokumentacionit sipas kërkesave të përcaktuara me VKM nr 970 datë 02.12.2015 i ndryshuar kreu II pika 2. Pas plotësimit të dokumentacionit, aplikimi i përcillet drejtorisë së të Ardhurave Bashkia Shkodër për shlyerjen e tarifave për licencim. Pas shlyerjes së tarifës, aplikanti pajiset me licencë. Aplikimi i tarifës behet pasi subjekti ka plotësuar kriteret për licence dhe përpara pajisjes me licencë duhet të lëshohet fatura për arkëtim, të paguhet nga kjo e fundit dhe me pas të pajiset me license. Vlera prej 8,000,000 lekë nuk mund të konsiderohet si e ardhur e munguar deri në momentin që lind detyrimi, detyrim i cili fillon me lëshimin e licenses. Sektori i transportit nuk ka kompetencë kontrolli në terren për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që tregtojnë karburant. Ne referencë të nenit 23 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar. Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë, të ushtruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, që funksionon dhe varet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Në këto kushte kërkojme nga ana juaj te rishikoni kete gjetje , pasi subjektet detyrohen të kryejne pagesat pas përfundimit të shqyrtimit dhe miratimit te dokumentacionit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit nuk merren në konsideratë pasi Ju nuk keni sjellë dokumente dhe prova shkresore që të vërtetoni se subjektet nuk plotësojnë kriteret për tu pajisur me Licencë, pasi subjektet janë të regjistruara ndër vite dhe ushtrojnë aktivitetet pra janë aktiv në QKB. Pretendimi Juaj se nuk keni kompetencë kontrolli në terren për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që tregtojnë karburant, nuk qëndron, pasi Bashkia funksionon në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve. Në ligje dhe Rregulloren e brëndshme përcaktohet se zyrat e Bashkisë funksionojnë në bashkëpunim me njëra tjetrën. Kështu që Ju si zyrë Shërbimesh duhej të bashkëpunoni me Zyrën e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policinë Bashkiake për të ushtruar kontrole në terren në subjektet e tregëtimit të Karburanteve të cilat nuk janë pajisur me Licencë përklatse. Ju nuk keni zbatuar kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, "për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kapitulli II, pika 1; germa "b"; pika 9 dhe të VKB nr.1, datë 22.01.2016 "Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër", i ndryshuar me VKB nr.84, datë 26.12.2017 dhe VKB nr.79, datë 04.12.2018, kapitulli II.4.5.1.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z.V. M. me detyrë, përgjegjës i Sektorit të Sinjalistikës, Transportit dhe Mobilitetit.

Z.B. Gj. me detyrë Drejtor i të Ardhurave.

5.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF) Trajtuar me Akt Konstatim të veçantë.

Në auditimin e kryer për vlerësimin e risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve sipas dokumenteve të paraqitura nga Drejtoria e Financës dhe Sektori i Kontabilitetit konstatohet se:

-Në fund të vitit 2017, në bilancin e konsoliduar kemi një gjendje detyrimesh në shumën prej 294,437,717 lekë shumë e cila përbëhet nga:

Pasqyra e detyrimeve të prapambetura 31.12.2017

40	Furnitore e llogari te lidhura me to	28,637,490
42	Personeli e llogari te lidhura me to	40,171,513
431	Shteti tatim-taksa	2,774,302
435	Sigurime shoqerore	11,964,744
436	Sigurime shendetsose	1,469,365
437.438	Organizma te tjere shoqerore	9,600
44	Institucione te tjera publike	3,000
467	Kreditore te ndryshem	209,407,703
	TOTALI	294,437,717

Këto detyrime janë krijuar nga pezullimi i pagesave për projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me shkresën nr.13433 prot, datë 02.10.2017 dhe si rezultat i vendosjes së limitit në pagesa, me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.15973 prot, datë 09.11.2017, shkresë nr 18123. prot me datë 05.12.2017 me objekt "Mbi limitin e përdorimit të cash-it për njësitë e qeverisjes vendore" për muajin Nëntor dhe Dhjetor.

Pasqyra e detyrimeve të prapambetura të regjistruara në SIFQ për llogari të viti 2017.

	602	606	230+231	Totali
Bashkia Shkoder	42,015,667	1,624,100	34,335,432	77,975,199
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	24,441,146		2,729,198	27,170,344
Drejtoria Ekonomike e Kultures	2,991,570		110,400	3,101,970
Teatri " Migjeni"	896,732			896,732
Sportklub " Vllaznia"	6,565,570	200,000	297,045	7,062,615
Drejtoria Kopshte Çerdhe	5,392,170	16,500		5,408,670
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	2,212,710	9,000	1,190,400	3,412,110
Drejtoria e Sherbimit bujqesor	6,959,407			6,959,407
Totali	91,474,972	1,849,600	38,662,475	131,987,047

Këto detyrime në vlerën prej 131,987,047 lekë janë shlyer me çeljen e fondeve në periudhën Janar-Mars 2018. Detyrimet e prapambetura të ish njësiteve të vetëqeverisjes vendore të trashëguara nga Zbatimi i Reformës Territoriale. Sipas përcaktimit në udhëzimin e Ministrisë së Financave, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të përcaktuara nga një ligj/kontratë /marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 60 ditë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e vetëqeverisjes vendore (kontratat e financuara nga qeveria qendrore).

Në detyrimet e prapambetura të lindura në njësitë e vetëqeverisjes vendore përfshihen vetëm detyrimet për punimet e kryera por të papaguara në kuadër të financimeve nga fondi për zhvillimin e rajoneve si edhe transfertat për përfitimet e paaftësisë. Të gjitha detyrimet e tjera financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore, që nuk përfshihen në sa më sipër, duhet të parashikohen në vetë buxhetet e njërive të vetëqeverisjes vendore.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 15, datë 28.04.2016 “Për miratimin e buxhetit faktitk të vitit 2015 të Bashkisë Shkodër”, janë miratuar detyrimet e trashëguara nga ish- komunat detyrime për vendime gjykate të formës së prerë ose në proces, detyrime me fatura, detyrime pa fatura dhe vetëm me kontrata, me fondet përkatëse të tyre. Kjo procedure është ndjekur, në zbatim të reformës territoriale të VKM nr 510, datë 10.06.2015 “ Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territorial”.

Gjatë vitit 2017, Bashkia Shkodër, ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresat nr.4540, datë 05.04.2017, nr.10442, datë 04.07.2017, nr.14767, datë 04.10.2017, me nr.132, datë 04.01.2018 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga zbatimi i reformës territoriale.

Gjatë 12-mujorit të vitit 2017, Bashkia Shkodër ka shlyer investime, detyrime të prapambetura në total 135 milion lekë, të përbëra si më poshtë:

Investime në vlerën 81,914 mijë lekë. Investimet nga FZHR në shumën 27,047 mijë lekë. Mallra dhe Shërbime në vlerën 23,999 mijë lekë. Vendime gjyqësore në vlerën 1,994 mijë lekë. Të tjera në vlerën 4 mijë lekë.

Tabela nr. 2: Zhvillimi i shumës së detyrimeve të prapambetura deri në tremujorin e katërt 2017

Detyrimet e nj.v.q.v (lekë)	(1) Në fillim të Vitit (Detyrimi i mbartur deri në 31.12.2015)	(2) Detyrimi i krijuar (01.01.2016 deri në 31.12.2016)	(6) Detyrimet e krijuara rishtas 1 Tetor- 31 Dhjetor 2017	(7=6) Totali i detyrimeve	(8) Detyrimet e prapambetura të shlyera (nga viti 2015 deri në 31.12.2017)	(9) Detyrimi i shlyer në %	(10=7-8) Detyrimi i mbetur
Vlera Totale	213,523,931	2,910,886	131,987,048	348,421,865	134,958,509		213,463,356
Investimet	111,695,447	2,910,886	38,662,476	153,268,809	81,914,497	53%	71,354,312
Investimet FZHR	41,718,659			41,718,659	27,046,710	65%	14,671,949
TVSH Kosto lokale				0			0
Mallra dhe Shërbime	24,837,680		91,474,972	116,312,652	23,999,327	21%	92,313,325
Vendime Gjyqësore	33,594,903			33,594,903	1,994,219	6%	31,600,684
Të tjera	1,677,242		1,849,600	3,526,842	3,756	0%	3,523,086

Në fund të vitit 2018 në bilancin e konsoliduar kemi një gjendje detyrimesh në shumën prej 287,656,576 lekë shumë e cila përbëhet nga:

Paasqyra e detyrimeve të prapambetura deri 31.12.2018 .në lekë

40	Furnitore e llogari te lidhura me to	17,654,513
42	Personeli e llogari te lidhura me to	41,357,554
431	Shteti tatim-taksa	3,297,885
435	Sigurime shoqerore	11,800,771
436	Sigurime shendetsore	1,608,064
467	Kreditore te ndryshem	211,937,789



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Totali	287,656,576
---------------	--------------------

Në fund të vitit 2018, janë krijuar rishtazi detyrime të palikuiduara për Bashkinë Shkodër në zërin shpenzime operative në shumën 36,369 mijë lekë, në zërin transferime 14,694 mijë lekë dhe në zërin Investime dhe projekte në shumën 29,453 mijë lekë . Këto detyrime janë krijuar nga limiti i vendosur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresë nr.19932, datë 07.11.2018 me objekt “ mbi limitin e planit të shpenzimeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Më poshtë detajimi i detyrimeve të palikuiduara për vitin 2018, për shkak të vendosjes së limitit mbi planin e shpenzimeve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, sipas Institucioneve paraqitet në vijim:

Pasqyra e detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2018.

Në lekë.

Sipas Njësive Vartëse	602	606	230+231	Totali në lekë
Bashkia Shkoder	17,345,038	13,911,360	18,191,186	49,447,584
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	6,188,048	257,657	7,344,958	13,790,663
Drejtoria Ekonomike e Kultures	1,115,210	41,775	1,111,174	2,268,159
Teatri " Migjeni"	4,505,230	61,500	1,494,840	6,061,570
Sportklub " Vllaznia"	1,119,520	25,459	150,000	1,294,979
Drejtoria Kopshte Çerdhe	5,190,481	351,375	1,160,940	6,702,796
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	342,948	1,500		344,448
Drejtoria e Sherbimit bujqesor	562,500	43,575		606,075
Totali	36,368,975	14,694,201	29,453,098	80,516,274

Të gjitha këto detyrime në vlerën prej 80,516,274 lekë janë shlyer me çeljen e fondeve në periudhën Janar-Mars 2019. Në detyrimet e prapambetura, të mbartura nga ish-komunat ka edhe procedura me parregullsi ligjore dhe financiare, të pamundura të likuidohen, të cilat janë objekt verifikimi nga grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushave të ndryshme, ngritur me urdhrin nr.225, datë 08.03.2018, kjo edhe në zbatim të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të KLSH-së nr. 491/15, datë 30.11.2017.

Gjatë vitit 2018, Bashkia Shkodër, ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresat nr.4954, datë 04.04.2018, për tremujorin e parë të vitit 2018, dhe nr.10743, për tremujorin e dytë të vitit 2018, dhe me nr.16372, datë 04.10.2018 për tremujorin e tretë, me shkresën nr.1510 , datë 30.01.2019, për katër mujorin e vitit 2018, kjo në zbatim të udhëzimit nr.2, datë 19.01.2018 “ Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, pika 86.

Në detyrimet e prapambetura të NJ.A-ve, peshën më të madhe e zënë Investimet prej rreth 30 milion lekë, si dhe shpenzimet gjyqësore prej rreth 30 milion lekë, në proces gjykimi. Gjatë 12-mujorit të vitit 2018, Bashkia Shkodër ka shlyer investime, detyrime të prapambetura në total 112 milion lekë, të përbëra si më poshtë:

Investime në vlerën 84,825 mijë lekë.

Mallra dhe Shërbime në vlerën 24,000 mijë lekë.

Vendime gjyqësore në vlerën 3.496 mijë lekë.

Të tjera në vlerën 12 mijë lekë

Pasqyra e detyrimeve të prapambetura gjendje më 31.12.2018.

Në lekë

Detyrimet e nj.v.q.v (lekë)	(1) (Detyrimi i mbartur deri në 31.12.2015)	(2) Detyrimi i krijuar Viti 2016	(7) Detyrimet e krijuara nga 1 Tetor- 31 Dhjetor 2018 *	(8=7) Totali i detyrimeve te krijuara	(12) Detyrimet e shlyera nga 1 Korrik -	(13) Detyrimet e shlyera nga 1 Tetor- 31 Dhjetor	(14=9+10+11+12 +13) Totali i detyrimeve te shlyera	(15) Detyrimi i shlyer në %	(16=8-14) Detyrimi i mbetur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

					30 Shtator 2018	2018			
Vlera Totale	171,805,272	2,910,886	80,516,274	255,232,432	650,501	828,000	112,332,950		142,899,482
Investimet	111,695,447	2,910,886	29,453,098	144,059,431			84,825,383	59%	59,234,048
TVSH Kosto lokale				0			0		0
Mallra Shërbime	24,837,680		36,368,975	61,206,655	581		23,999,908	39%	37,206,747
Vendime Gjyqësore	33,594,903			33,594,903	649,920	828,000	3,496,139	10%	30,098,764
Të tjera	1,677,242		14,694,201	16,371,443			11,520	0%	16,359,923

Gjatë vitit 2019, Bashkia Shkodër, ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.5645 prot, datë 08.04.2019, për tremujorin e parë të vitit 2019, me shkresën nr.11359 prot, datë 01.07.2019, për tremujorin e dytë të vitit 2019. Me shkresën nr. nr.4337 prot datë 19.03.2019, është dërguar shkresë MFE me objekt “ Informacion mbi kalendarin e planit të veprimit për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për bashkinë Shkodër për vitet 2019-2022”. Pasqyra e detyrimeve të prapambetura gjendeje më 30.06.2019. Në lekë

Detyrimet e nj.v.q.v (lekë)	(1) (Detyrimi i mbartur deri në 31.12.2015)	(2) Detyrimi i krijuar Viti 2016	(3=1+2) Totali i detyrimeve te krijuara	(4) Detyrimet e prapambetura të shlyera (viti 2015, 2016, 2017)	(5) Detyrimet e prapambetura të shlyera (viti 2018)	Viti 2019		(8=4+5+6) Totali i detyrimeve te shlyera	(9) Detyrimi i shlyer në %	(10=3-8) Detyrimi i mbetur
						(6) Detyrimet e shlyera nga 1 Janar - 31 Mars 2019	(7) Detyrimet e shlyera nga 1 Prill- 30 Qershor 2019			
Vlera Totale	171,805,272	2,910,886	174,716,158	110,854,449	1,478,501	9,099,000	1,361,532	122,793,482		51,922,676
Investimet	111,695,447	2,910,886	114,606,333	84,825,383		9,099,000		93,924,383	82	20,681,950
TVSH Kosto lokale			0					0		0
Mallra Shërbime	24,837,680		24,837,680	23,999,327	581			23,999,908	97	837,772
Vendime Gjyqësore	33,594,903		33,594,903	2,018,219	1,477,920		1,361,532	4,857,671	14	28,737,232
Të tjera	1,677,242		1,677,242	11,520				11,520	1	1,665,722

Gjatë 6-mujorit të vitit 2019, Bashkia Shkoder ka shlyer investime, detyrime të prapambetura në total 123 milion lekë, të përbëra si më poshtë:
 Investime në vlerën 93,924 mijë lekë.
 Mallra dhe Shërbime në vlerën 24,000 mijë lekë.
 Vendime gjyqësore në vlerën 4,858 mijë lekë.
 Të tjera në vlerën 12 mijë lekë
 Në detyrimet e prapambetura nga Nj.A-të, peshën më të madhe e zënë Investimet prej rreth 21 milion lekë, si dhe shpenzimet gjyqësore prej rreth 29 milion lekë, në proces gjykimi.

Si përfundim konstatohet se:

Bazuar në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2017, 2018 dhe të dhënave të periudhës janar-qershor 2019, konstatohet se:

-totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten në vlerën 142,899,482 lekë, për 210 raste, ndaj subjekteve private, nga të cilat:

.....detyrime për Investime në 47 raste, në vlerën 59,234,048 lekë,

.....detyrime për mallra e shërbime në 118 raste, në vlerën 37,206,747 lekë,

.....detyrime 23 persona të cilët kanë fituar vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë në vlerën 30,098,764 lekë dhe

.....detyrime të tjera në 22 raste në vlerën 16,359,923 lekë, ku përfshihen pagesa e kuotës së Këshillit të Qarkut, shperblim për dalje në pension, transferta të organizatat jo fitimprurese, ndihmë për rate fatkeqësie si shtepi të djegura dhe transferta për jetimët..



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Ndërsa vlera faturave të palikujduara gjëndje në 30.06.2019, të pasqyruara në llog 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 51,972,676 lekë, ndaj subjekteve private, nga të cilat:

.....detyrime për Investime në 15 raste, në vlerën 20,681,950 lekë,

.....detyrime për mallra e shërbime në 8 raste, në vlerën 837,772 lekë,

.....detyrime për vendimet e gjykatave të cilat kanë marrë formën e prerë për 20 raste, në vlerën 28,737,232 lekë dhe

.....detyrime të tjera në 2 raste, në vlerën 1,665,722 lekë.

Veprimet apo mos veprimet janë në kundërshtim me: -Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), Neni 40⁽¹³⁾-E drejta për të kryer shpenzime, -Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014. -Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, -Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Në auditimin e kryer për pasqyrat financiare të vitit 2018, për nivelin e faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, si detyrime të papaguara ndaj të tretëve gjëndje më 31.12.2018 dhe më 30.06.2019 **konstatohet se:**

-Sipas të dhënave të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2018, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 142,899,482 lekë, ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën 59,234,048 lekë, për 47 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 37,206,747 lekë, për 118 raste; detyrime për vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 30,098,764 lekë, në 23 raste dhe detyrime të tjera në vlerën 16,359,923 lekë, për 22 raste.

Ndërsa vlera faturave të palikujduara gjëndje në 30.06.2019, të pasqyruara në llog 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 51,972,676 lekë, ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën 20,681,950 lekë, në 15 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 837,772 lekë, në 8 raste; detyrime për vendimet e gjykatave të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 28,737,232 lekë, për 20 raste dhe detyrime të tjera në vlerën 1,665,722 lekë, për 2 raste.

Veprimet apo mos veprimet janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), Neni 40⁽¹⁴⁾-E drejta për të kryer shpenzime,

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014.

¹³⁾ Ndryshuar me ligjin nr. 57/2016.

¹⁴⁾ Ndryshuar me ligjin nr. 57/2016.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

-Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”,

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”,

Gjetje nga auditimi:

Titulli Gjetjes	-Faturat e pa likuiduara
Situata:	-Totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 142,899,482 lekë, ndaj subjekteve private, Ndërsa vlera faturave të palikujduara në 30.06.2019, të pasqyruara në llog 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 51,972,676 lekë, ndaj subjekteve private.
Kriteri	-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, i ndryshuar me ligjin nr.114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), Neni 40 ⁽¹⁵⁾ -E drejta për të kryer shpenzime, -VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap. I, pika 1. -Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014. -Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, -Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.
Ndikimi/Efekti	-Mos realizim i treguesve të zbatimit të buxhetit, në total treguesit e shpenzimeve të buxhetit buxhetit për vitin 2017 dhe 2018 janë realizuar respektivisht në masën 76% dhe 77%.
Shkaku	- Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	-I mesëm.
Rekomandimi	-Të merren masa nga Bashkia Shkodër, që të zbatohen procedurat ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Znj.B. M. me detyrë Drejtore e Financës.

6.Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Bashkia Shkodër me vendim nr.10, datë 10.3.2016 të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve ka përfituar një investim me objekt “Rikonstruksion i bllokut të pallateve Xhabije” në shumën totale 76,654 mijë dhe është lidhur kontratë në shumën 46,519,6 mijë lekë e cila është likuiduar ë vitin 2016 në shumën 5,408 mijë, në vitin 2017 në shumën 9,796 mijë, në vitin 2018 në vlerën 19,407,4 mijë lekë, në vitin 2019 është akorduar fondi në vlerën 11,907,9 mijë lekë, investimi është në proces. Bashkia Shkodër ka përfituar një investim nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

vendim nr.15, datë 21.3.2017 me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës 9-vjeçare “Ura e shtrenjte” Postribe “ me vlerë 5,000 mijë lekë në vitin 2017. Në vitin 2018 Bashkia Shkodër ka përfituar një investim nga Fondi i Zhvillimi të Rajoneve me vendim nr.7, datë 11.5.2018 me objekt “Projekti "Jeto me sportin" "Rikualifikim i terreneve sportive në shkollat Oso Kuka Bashkia e Shkodrës, Ana Malit Oblike dhe At Gjon Kama Gur i Zi “ me vlerë 12,628,5 mijë lekë dhe që është pakësuar me vlerë 10, 415 mij lekë. Në vitin 2019 me shkresen nr.22760 /269, datë 7.2.2019 është akorduar fondi në shumën 6,238,2 mijë lekë.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Buxheti i Bashkisë Shkodër për vitin 2017 është miratuar me VKB nr.8, datë 30.1.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2017 dhe programit buxhetor afatmesëm 2018-2019 të Bashkisë Shkodër”. Miratimi i buxhetit për vitin 2017, nga njësia vendore është bërë jashtë afateve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e nenit 32 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ndryshimet janë bërë me VKB të konfirmuar me shprehje ligjshmërie nga Prefekti si dhe vendim kryetari. Në vitin 2017 është dërguar raporti i monitorimit të 6 mujorit të parë të vitit 2017 në Këshillin Bashkiak me shkresën 2973/b, datë 24.07.2017. Gjithashtu është dërguar raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën 8 mujorit të vitit 2017 në Këshillin Bashkiak me shkresën 3874/b, datë 22.9.2017 dhe në Ministri të Financave me shkresën nr.14162, datë 22.9.2017. Bashkia Shkodër me shkresën nr. 934/b, datë 27.3.2018 ka paraqitur për miratim buxhetin faktik të vitit 2017 në KB i cili është miratuar me VKB nr. 35, datë 22.05.2018 dhe është dërguar në MF me shkresën nr. 9593, datë 18.06.2018.

Për vitin 2018 buxheti vjetor është miratuar me VKB nr.85, datë 26.12.2017 “Miratim buxheti të vitit 2018 dhe programi buxhetor afatmesëm përfundimtar 2018-2020 të Bashkisë Shkodër”. Miratimi i buxhetit për vitin 2018, nga njësia vendore është bërë brenda afateve ligjore me kërkesat e nenit 32 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ndryshimet janë bërë me VKB të konfirmuar me shprehje ligjshmërie nga Prefekti si dhe vendim kryetari. Në vitin 2018 është dërguar raporti i monitorimit të 4 mujorin e vitit 2018 në Këshillin Bashkiak me shkresën nr.8451, datë 29.05.2018 dhe në Ministri të Financave me shkresën nr.8392, datë 29.5.2018. Gjithashtu është dërguar raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën 8 mujore të vitit 2018 në Këshillin Bashkiak me shkresën nr.15647, datë 25.9.2018 dhe në Ministri të Financave me shkresën nr.15648, datë 25.9.2018. Bashkia Shkodër me shkresën nr. 767/b, datë 27.2.2019 ka paraqitur për miratim buxhetin faktik të vitit 2018 në Këshillin Bashkiak i cili është miratuar me VKB nr. 26, datë 18.04.2019 dhe është dërguar në MF me shkresën nr.3336, datë 28.02.2019.

Për vitin 2019 buxheti vjetor është miratuar me VKB nr.82, datë 26.12.2018 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër”. Miratimi i buxhetit për vitin 2018, nga njësia vendore është bërë brenda afateve ligjore me kërkesat e nenit 32 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ndryshimet janë bërë me VKB të konfirmuar me shprehje ligjshmërie nga Prefekti si dhe vendim kryetari. Në 6 mujorin e parë të vitit 2019 është dërguar raporti i monitorimit të 4 mujorit të I-rë të vitit 2019 në KB me shkresën nr.9456, datë 31.5.2019 dhe në M F me shkresën nr.9455, datë 31.05.2019. Bashkia Shkodër çdo muaj deri më datë 10 të muajit pasardhës dërgon në Këshill Bashkiak treguesit kryesor të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor dhe planit të periudhës për periudhën respektive në bazë të nenit 44 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

-Ndryshimet në buxhet gjatë vitiit 2017, janë miratuara me VKB të konfirmuar me shprehje ligjshme nga Prefekti, janë gjithsej 26 vendime të Këshillit Bashkiak dhe 31 vendime të Kryetarit. Për realizimin e transferimeve janë dërguar në Degën e Thesarit 43 shkresa për ndryshime të planeve. Për vitin 2018 ka ndryshime në buxhet të miratuara me VKB të konfirmuar me shprehje ligjshme nga Prefekti, janë gjithsej 19 vendime të Këshillit Bashkiak dhe 27 vendime të Kryetarit. Për realizimin e transferimeve janë dërguar në Degën e Thesarit për ndryshime të planeve 43 shkresa. Gjatë 6 mujorit të parë 2019 janë bërë shtesa dhe pakësime sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe vendimeve të kryetarit dhe janë gjithsej 10 vendime të Këshillit Bashkiak dhe 4 vendime të Kryetarit. Për realizimin e transferimeve janë dërguar në Degën e Thesarit për ndryshime të planeve 17 shkresa.

-Për shpenzimet e reja kapitale është zbatuar udhëzimi standart i përgatitjes së buxhetit që janë miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak duke hartuar dhe fish projektin përkatës. Bashkia Shkodër për vitet 2017, 2018 dhe me herët nuk ka borxhe të trashëguara për mungese fondi por ka vetëm fatura të palikuiduara si rrjedhojë e mangësive në dokumentacion por edhe në këtë rast është rezervuar fondi në buxhetin e vitit. Janë zbatuar të gjitha hallkat e miratimit për përfshirjen në buxhet, për shpenzimet e reja kapitale.

-Buxheti për vitet 2017 dhe 2018 është i balancuar edhe në fund të vitit, nuk ka mosrealizim të të ardhurave dhe faturat e mbetura të palikuiduara në fund të vitit janë si rrjedhojë e bllokimit nga MFE dhe të mangësisë në dokumentacion. Por shuma e shpenzimeve të palikuiduar në fund të vitit buxhetor janë të planifikuara në plan të buxhetit dhe janë të mbuluara me cash-e. Është ruajtur në buxhetim respektimi i radhës së financimit sipas ligjit ku shpenzimet në vazhdim kanë prioritet, është dhënë prioritet pagesave sipas udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” pika 151.

Për detyrimet e lindura dhe të pashlyera, janë raportuar në MFE përkatësisht: për vitin 2017 sipas shkresës nr. 132 prot datë 04.01.2018, borxhe në total 131,987,048 lekë e ndare sipas kategorive investime, mallra dhe shërbime dhe të tjera. Të gjitha këto detyrime janë shlyer. (bashkëngjitur kopje e shkresës). për vitin 2018 sipas shkresës nr. 1510 prot, datë 30.01.2019 borxhe në total në vlerën 80,516,274 lekë e ndarë sipas kategorive investime, mallra dhe shërbime, dhe të tjera. Të gjitha këto detyrime janë shlyer.

-Bllokimi nga MFE në fund të vitit në krijimin e detyrimeve të prapambetura, paraqiten si në vijim:

Për vitin 2017 janë raportuar në MFE sipas shkresës nr 132 prot datë 04.01.2018 , borxhe në total vlera 131,987,048 lekë e ndarë sipas kategorive investime, mallra dhe shërbime dhe të tjera. Të gjitha këto detyrime janë shlyer.

Për vitin 2018 janë raportuar në MFE sipas shkresës nr. 1510 prot, datë 30.01.2019 borxhe në total vlera 80,516,274 lekë e ndarë sipas kategorive investime, mallra dhe shërbime dhe të tjera. Të gjitha këto detyrime janë shlyer.

Në të gjitha rastet që janë dorëzuar faturat pranë bashkisë Qendër, ka patur fonde kur është marrë shërbimi, pra ka patur disponueshmëri të fondeve. Përbën përjashtim vetëm Muaji Nëntor dhe Dhjetor, viti 2017 dhe viti 2018 kur MFE ka vendosur limit në kryerjen e shpenzimeve gjë që ka renduar shumë në rritjen apo krijimin e detyrimeve të prapambetura.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

-Është buxhetuar shlyerja e detyrimeve të prapambetura, janë të gjitha të përfshira në buxhet afatmesme respektivisht për vitin 2017 dhe për vitin 2018. Për vitin 2017 janë raportuar në MFE sipas shkresës nr. 132 prot datë 04.01.2018, borxhe në total vlera 131,987,048 lekë e ndarë sipas kategorive investime, mallra dhe sherbime dhe të tjera. Të gjitha këto detyrime janë shlyer. (bashkëngjitur kopje e shkresës). Për vitin 2018 janë raportuar në MFE sipas shkresës nr.1510 prot, datë 30.01.2019 borxhe në total vlera 80,516,274 lekë e ndarë sipas kategorive investime, mallra dhe sherbime dhe të tjera. Të gjitha këto detyrime janë shlyer. -Janë zbatuar afatet në miratim, ndryshim dhe raportim të buxhetit.

-Për realizimin e shpenzimeve janë ndjekur të gjitha hapat e domosdoshme për realizimin e pagesën e tyre, në të gjitha shpenzimet janë ndjekur hapat e domosdoshme për realizimin e pagesave. Janë të gjitha dokumentet justifikues dhe autorizues në dosje, të gjitha dokumentet justifikues janë origjinal dhe të bashkëngjitur në urdhër shpenzimet në bankën përkatëse.

-Është regjistruar urdhri i prokurimit në vlerë të plotë në sistemin e thesari (për BI online)dhe është vulosur në thesar (për BI offline) përpara fillimit të procedurës dhe brenda afateve të përcaktuar në ligj. Në momentin e nxjerrjes së urdhrin, ka patur fonde disponibël në buxhet.

-Të gjitha kontrata janë të rregjistruara në thesar brenda afateve ligjore kjo në bazë të pikës 157 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, citon “Nëpunësi zbatues i njësisë respektive regjistron kontratën ose urdhrin e prokurimit për blerjet e vogla, sipas rastit, në kontabilitetin e menaxhimit, përpilon dokumentin e afateve të pagesave, dhe paraqet dokumentacionin si më sipër në gjuhën shqipe (në rastin e kontratave të lidhura në gjuhë të huaj) me njoftimin përfundimtar zyrtar për shpalljen e fituesit, në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë brenda tri ditëve pune nga nënshkrimi i tyre.” Në momentin e lidhjes së kontratave fondet kanë qenë disponibël në thesar. Nuk ka kontrata të rregjistruara me vonësë. Nuk ka raste për kontrata të copëtuara të regjistruara vetëm për vlerën e faturës. Për kontrata shume vjeçare është bërë detajimi sipas viteve në degën e thesarit, është ndarë sipas miratimit në buxhetit afatmesëm. Nuk ka kontrata me datë lidhje nga viti paraardhës të jenë regjistruar në thesar në vitin aktual.

-Urdhër pagesat për fatura dhe shpenzime janë regjistruar brenda afatit ligjore prej 30 ditësh nga data e faturës në sistemin e thesarit, brenda afateve që përcakton ligji.Nuk ka fatura të jenë regjistruar përtej këtij afati për pagesë. Ka patur fonde buxhetore në momentin e lindjes së detyrimit (datë faturës), me përjashtim të një rasti të vetëm i cili është në muajin Nëntor-Dhjetor, kur MFE ka vendosur limit dhe kemi respektuar limitin e vendosur nga MFE, kjo duke i dhënë prioritet pagesave sipas udhëzimit pikës 151 të udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”. Gjatë muajit Nëntor dhe Dhjetor kemi pasur raste të copëtimit të faturave dhe të regjistruara në vlerë pjesore, paguar me disa urdhër pagesa, si në kontratat e pastrimit, gjelbërimit, varrezave dhe mbetjeve shërbimi i Landfield. Kjo për arsye të vendosjes së limit nga MFE. Fondet buxhetore ka patur në momentin e faturave, deri në vendosjen e limitit në datë 9 nëntor 2017dhe për periudhën muajin nëntor,dhjetor respektivisht viti 2017, viti 2018.

-Fatura të paguara nga buxheti i vitit aktual që mbajnë datë fature të vitit paraardhës, janë: Për vitin 2017 janë në total 180 fatura, të cilat janë likuiduar me hapjen e buxhetit në periudhën Janar–Mars 2018. Për vitin 2018 janë në total 110 fatura, të cilat janë likuiduar me hapjen e buxhetit në periudhën Janar –Mars 2019.

-Nuk ka patur gjatë vitit as në në fund të vitit, raste që mund të përbëjnë realizim fiktiv të shpenzimeve dhe faturim të tyre për të mos djegur fondet buxhetore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

-Nuk ka patur raste në kryerjen e pagesave sipas zërave buxhetor thyerje të rradhës FIFO, duke mos i regjistruar në kohë faturat në sistemin e thesarit.

-Faturat janë paguar gjithmonë në respektim të afateve duke zbatuar kontratën (afatet e kontratës), kur kemi vetëm faturë, kjo në respektim të Ftesës për ofertë. Vetëm në rastet e vendosjes së limit në muajin Nëntor dhe Dhjetor kemi prioritet në pagesa si paga, sigurime, energji, ushqime, shërbime pastrimi, gjelbërimi, etj.

-Shpenzime të ndodhura dhe të papaguara, janë raportuar përkatësisht:

Për vitin 2017 janë raportuar në MFE sipas shkresës nr. 132 prot daë 04.01.2018, borxhe në total vlera 131,987,048 lekë e ndarë sipas kategorive investime, mallra dhe shërbime dhe të tjera.(bashkëngjitur kopje e shkresës). Për vitin 2018 janë raportuar në MFE sipas shkresës nr. 1510 prot, datë 30.01.2019 borxhe në total vlera 80,516,274 lekë e ndarë sipas kategorive investime, mallra, shërbime dhe të tjera.(bashkëngjitur kopje e shkresës). Më datë 01.07.2019, me nr.11359 prot, me objekt “Informacion për raportin e detyrimeve të prapambetura të bashkisë Shkodër për tremujorin e dytë të vitit 2019”, është raportuar pranë MFE brenda afateve të Udhëzimit nr.1, datë 17.01.2019 “ Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 109. (bashkëngjitur kopje e shkresës).-Raportimi në thesar i stokut të detyrimeve të prapambetura është ndarë sipas klasifikimit ekonomik kontabël. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura duke marre në konsideratë të dhënat e nxjerra nga analiza e pikave të mësipërme, janë të sakta.

-Sipas situacioneve të shpenzimeve të rakorduara me thesarin për vitin 2017 shpenzimet buxhetore në Bashkinë Shkodër janë planifikuar në vlerën 3,165,026 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 2,395,740 mijë lekë ose në masën 76%, për vitin 2018 shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 3,342,581 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 2,569,341 mijë lekë, ose në masën 77% dhe për 6 mujorin e I-rë të vitit 2019 shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 3,394,462 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,411,866 mijë lekë, ose në masën 42%. Është rakorduar çdo muaj me degën e thesarit Shkodër, si për shpenzimet e kryera, gjithashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Shkodër duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktura nga grantet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore.

(Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.1, datë 31.07.2019)

(Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.2, datë 31.07.2019)

(Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.3, datë 31.07.2019)

(Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.4, datë 31.07.2019)

C. Vlerësimi i Raportimit Financiar, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në, udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisive që varen prej tyre si dhe të njësisive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”; udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006, dhe udhëzimi i MF nr.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, etj, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2017-2018, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.

- 1.1 Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
- 1.2 Vlerësimi i arsyeshem e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);
- 1.3 Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nënjësisë;
- 1.4 Opinioni mbi pasqyrat financiare;

1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit 2017 dhe të vitit 2018 të Bashkisë Shkodër janë dërguar Degës së Thesarit Shkodër me shkresat respective nr.3173, datë 28.02.2018, dhe nr.3158, datë 27.02.2019, të cilat janë nënshkruar pa vërejtje, nga Dega e Thesarit. Është respektuar afatin ligjor i përcaktuar deri në datën 28 shkurt të vitit pasardhës. Është plotësuar bilanci si dhe pasqyrat anekse të tij. Aktivi dhe pasivi i bilancit është i kuadruar. Pasqyrat anekse rakordojnë me aktivin dhe pasivin e bilancit për llogaritë analoge. Pasqyra e shpenzimeve të ushtrimit dhe pasqyra e të ardhurave të ushtrimit kuadrojnë me akt-rakordimet me thesarin për shpenzimet dhe për të ardhurat. Gjithashtu gjendjet e llogarive në pasqyrën e lëvizjeve në “CASH” rakordojnë me akt-rakordimet me thesarin. Gjendja e llogarisë “Teprica në mbyllje të ushtrimit” është e barabartë me gjendjen e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në aktivin e bilancit.

Llogaritë sintetike që përbëjnë Aktivin dhe Pasivin e bilancit për dy vitet të njëpasnjëshme ushtrimore 2017 dhe, 2018, paraqiten bashkangjitur materialit.

Pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Shkodër janë të shoqëruara me situacionin e rakorduar me situacionet përkatëse për shpenzimet dhe të ardhurat, si dhe për të gjitha institucionet e vartësisë.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi në se veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

Shuma e llogarive të paraqitura në postet e P1 Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar me informacionin që jepet në formatet anekse (formatet për “Aktivet e Qëndrueshme”, formati “Shpenzimet e Burimet për Investime”, formati 3 “Pasqyra e Flukseve Monetare (cash flok)” dhe formati 7 “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” korrespondojnë ndërmjet tyre.

Pasqyra e pozicionit financiar, Njësia Publike Bashkia Shkodër. Periudha 2017, 2018 Formatit nr.1, paraqiten bashkangjitur Projektraportit të Auditimit.

Aktivi i Bilancit:

-Gjendja e llogarisë 512 “**Mjete monetare në Bankë** “ në shumën prej 8,780,165 lekë paraqet gjendjen e disponibiliteteve gjendje në llogari jashtë thesarit të hapura në banka të nivelit të dytë dhe konkretisht përbehet nga gjendja në llogaritë e hapura për projektet e mëposhtëme:

	Emertimi I projektit	Shuma lekë
1	Projekti “Adria Muze”	1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

2	Projekti “YADSA”	1,827,017
3	Projekti “MARUBI”	193,639
4	Projekti “Ndriçimi Rrugor i Shirokes”	1,061,773
5	Projekti “Te jetosh Lumin”	308,390
6	Projekti “Zhvillimi i turizmit”	57,689
7	Projekti “Njëqind drita për të gjithë”	5,331,656
	Shuma	8,780,165

Të gjitha projektet janë të përfunduara dhe i përkasin viteve të kaluara përveç projektit YADSA i cili ka përfunduar në fund të viti 2018 dhe projektit “ Njëqind drita për të gjithë” i cili është projekt në proces.

-Gjendja e llogarisë 520 “**Disponibilitete në thesar**” në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 939,695,343 lekë dhe përfaqëson vlerën e fondeve që trashëgohen për vitin 2018, ndërkohë që më 31.12.2018 duke përfshirë edhe llogarinë 466 “ kreditorë për mjete në ruajtje në shumën prej, 59,554,925 lekë .

-Gjendja e llogarisë 532 “**Vlera të tjera**” është e përbërë nga gjendja në fund të vitit e pullave të gjendjes civile dhe letrave të tjera me vlere si më poshtë vijon:

1	Pulla për gjendjen civile	821,000
2	Pulla Gjykate	66,200
3	Bloqe shërbimi veterinar	8,236
4	Bloqe policia ndertimore	3,960
5	Bileta parkingu Velipoje	371,000
6	Bloqe policia bashkiake	14,280
	Shuma	1,284,676

Bashkia Shkodër administron letrat me vlerë sipas legjislacionit në fuqi, vlerat monetare dhe të barasvlerëshme me to ruhen në kasafortën e njësisë dhe janë në përgjegjësi të punonjësit të ngarkuar me veprimet e arkës. Është kryer inventari dhe vlera e tij është e njëjtë me vlerën e pasqyruar në bilanc.

-Gjendja e llogarisë 31 “**Materiale**” të gjendjeve të inventarit qarkullues, në aktivet afat shkurtra, në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 21,366,521 lekë dhe në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 22,466,364 lekë, duke ndryshuar në krahasim me vitin 2017 prej 1,099,843 lekë, të cilat janë blerje gjatë vitit. Gjendja në fund të vitit rakordon me gjendjen e inventarit.

-Gjendja e llogarisë 32 “**Inventari i imët**” të gjendjeve të inventarit qarkullues, në aktivet afat shkurtra, në fund të viteve 2017 paraqitet në vlerën 16,378,183 lekë dhe më 31.12.2018 paraqitet me vlerë 16,503,930 lekë, ndryshimet kanë të bëjnë me shtesat e vitit 2018 në vlerën 125,747 lekë. Gjendja në fund të vitit rakordon me gjendjen e inventarit.

Llogaritë e klasës katër në debit të tyre paraqiten për 788,778,755 lekë për vitin 2017 lekë dhe në vitin 2018 në vlerën 1,005,932,621 lekë.

-Llogaria 468 “**Debitor të ndryshëm**” e cila rezulton me 787,399,420 lekë për vitin 2017 dhe 1,004,546,611 lekë në fund të vitit 2018. Kjo shumë përbehet nga vlera 543,695,905 lekë për debitorë nga bizneset, vlera 459,308,348 lekë debitorë familjarë dhe vlera 1,542,963 lekë të tjerë.

-Llogaria 4342 “**Operacione me shtetin**” (Të drejta) në vitin 2017 ka pasur një gjendje 1,379,335 lekë dhe në 31.12.2018 paraqitet me gjendje në vlerën 1,386,010 lekë, të cilat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

përfaqësojnë të drejtat për pagat e dhjetorit 2018 në shumën 1,187,670 lekë, sigurime shoqërore 198,340 lekë, tatime në vlerën 345,848 lekë për funksionet e deleguara Gjendje civile dhe QKB.

-Gjendja e llogarisë 20 “**Aktive Afatgjata jo materiale**” në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 63,810,318 lekë, kurse në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën 117,967,627 lekë, e cila përfaqëson vlerat e studimeve, kërkimeve dhe projekttimeve për investime, të kryera gjatë periudhës së auditimit dhe investimeve të kryera ndër vite.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:

-Vlera 15,007,412 lekë, janë vlera e projekteve për investime të pa financuara.

-Vlera 77,241,703 lekë, janë vlera e projekteve të financuara për investimet në proces.

-Vlera prej 25,718,512 lekë i përkasin studimeve, kërkimeve dhe projekttimeve për investimet e kryera në periudhën para vitit 2017, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara.

Nga vlera e totale prej 117,967,627 lekë, **duhet sistemuar vlera 25,718,512 lekë e studimeve dhe projekttimeve për investimet e kryera ndër vite, në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit.** Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se shuma shtesë në vitin 2018 i përket projekteve të realizuara në vitin 2018 sipas kontratës me:

1	C. E. C. G.	Studim Projektim Hartimi I Projekteve teknike prioritare per sistemin e ujitje	4,872,000
2	C. E. C. G.	C. E. C. G. Projektim Ndertim Trotuari dhe sistemin kanali Gomsiqe	648,000
3	C. E. C. G.	Studim Projektim Rikonstruksion Rruga Malesoret e Mullirit	288,000
4	C. E. C. G.	Studim Projektim Rikonstruksion rruga e Shirqit	564,000
5	D&C	20% Studim Projektim per objektin Ndrichim Rruge Dytesore	51,092
6	D&C	20% Studim Projektim per objektin Rruga Ali Spahija	41,074
7	D&C	20% Studim Projektim per Objektin Rruga Malo Hoxha Nja Berdice	31,757
8	I.shpk,	Projektim Rikonstruksion degezime rruga e Shirokes	1,200,000
9	T. shpk	Projektim Rikonstruksion Rruga Bashej	362,400
10	T. shpk	Projektim Rikonstruksion Rruga Kacelej	290,400
11	T. shpk	Projektim Rikonstruksion Rruga Karineve	196,800
12	T. shpk	Projektim Rikonstruksion Rruga Vllaznimi	235,200
13	T. shpk	Projektim Rikonstruksion Rruga Ludertune	506,400
14	T. shpk	Projektim Rikonstruksion Rruga Rozar Dodmasej	99,600
			9,386,723

Në këtë llogari janë përfshirë edhe vlera e projekteve jashtë llogarive të thesarit që Bashkia Shkodër ka patur të cilat në vitet e kaluara ishin përfshirë në llogarinë 230 “investim për Aktive Afatgjata jo materiale”, në vlerën 36,502,056 lekë. Gjithashtu për vitin 2018 është përfshirë projekti YADSA i cili përfundoj në fund të vitit 2018, në vlerën 1,827,017 lekë. Ky projekt është marrë në dorëzim dhe kështu e gjithë vlera e këtij projekti duke zbritur vlerën e investimit që ky projekt ka është përfshirë në vitin 2018 në këtë llogari. Janë kryer inventarët dhe vlera e tyre është e njëjtë me vlerën e pasqyruar në bilanc.

-Gjendja në llogarinë sintetike “Aktive Afatgjata materiale” paraqitet, për vitin 2017 në vlerën 6,138,272,233 lekë dhe për vitin 2018 gjendja paraqitet në vlerën 6,346,781,413 leke, me një shtesë nga viti 2017 në vlerën 207,509,180 lekë. Këto ndryshime të detajuara janë të pasqyruara sipas llogarive të mëposhtme:

-Gjendja e llogarisë 210 “**Toka, Troje, Terrene**” në vitin 2017 me vlerë 1,003,868,130 lekë dhe në vitin 2018 paraqitet me vlerë 1,020,858,384 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Në këtë llogari janë përfshirë në vite në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve vlerat e trojeve ku ndodhen ndërtesat pronë e bashkisë. Për vitin 2018 ka shtesa në vlerën prej 16,990,254 lekë që i përkasin pagesat për shpronësimet për sheshe blloqe banimi Xhabiej, blloqe banimi, Zogu I-rë krahu i djathtë, (Zyra e Punës-Drejtoria e Bujqësisë), Rikonstruksion Trotuare segmenti Rruga Bujar Bishanaku, Krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta në Njësitë Administrative.

-Gjendja e llogarisë 211 **“Pyje, kullota, plantacione”** në fund të vitit 2018, paraqitet me një vlerë 6,284,216 lekë e pa ndryshuar, nga viti mëparshëm. **Konstatohet se:**

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

-Në këtë llogari **nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016** “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 48, shtojca me nr.46, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Shkodër, me numur rendor nga 1(një) deri 2160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë)

Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96.

-Gjendja në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” për vitin 2017, paraqitet në vlerën 1,177,726,327 lekë, ndërsa më 31.12.2018, rezulton 1,201,748,830 lekë, shtuar me vlerën prej 24,022,503 . Gjendje e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione është realisht 1,352,946,548 lekë pakësuar me arnotizimin prej -151,197,718 lekë. Ndryshimet në këtë llogari kanë të bëjnë me marrjet në dorëzim në vitin 2018 të investimeve : Blloqe Banimi i rrugicave në qendrën historike në shumën prej 43,857,662 lekë , Rehabilitim dhe risistemim i Merkatos Rus në shumën prej 11,570,870 lekë, Ndërtim xhepa kazanësh për mbeturina në shumën prej 673, 200 lekë dhe termoizolim në zyrën e informacionit turistik Rozafa 94 në shumën prej 151,385 lekë. Gjithashtu në këtë llogari është përfshirë rikonstruksion Qendra Rinore ATELIE realizuar kjo nga projekti jashtë llogarisë së thesarit “Projekti YADSA”, investim ky i shtrirë në vitet 2017,2018.

-Gjendja në llogarinë 213“Rrugë, rrjete vepra ujore” në vitin 2017, paraqitet në vlerën 3,638,459,931 lekë, ndërsa më 31.12.2018, gjendja rezulton 3,807,922,109 lekë. Ndryshimet në këtë llogari në shumën prej 169,462,178 lekë kanë të bëjnë me marrjen në dorëzim të objekteve : Rruga e Varrezave Beltojë 6,748,275 lekë, Rruga Draçin 2,632,716 lekë, Rruga Osja e Falltores 5,824,875 lekë, Rruga Memorandumi i Greçës 673,470 lekë, rruga Oblikë-Obot 12,766,624 lekë, Rruga Mushanit 9,888,045 lekë, Trotuari nga kanali deri te Kisha, Sektori Velipojë 7,180,107 lekë, Rruga Dod Çarri 11,690,068 lekë, Rikonstruksion i rrugës Qendër Mes-Qendër Dragoç 13,164,596 lekë, rruga Sami Repishti 9,015,203 lekë, Rruga Dhimitër Frangu 6,813,253 lekë, Rruga Pjeter Spani, vlera 8,965,155 lekë, rruga Qyteza e Gajtanit, vlera 12,835,946 lekë, ndriçimi rruge dytësore (faza dytë) 3,914,371 lekë, ndriçimi i rrugës Dr. Ali Spahija, valera 2,452,836 lekë, Ndriçim i rrugës Fermentim -Ura e Bardhajve vlera 7,312,752 lekë, Ndërtim i rrjetit të brendshëm të komunikimit elektronik (Intranet) në 3 Njësi Administrative dhe 5 Lagje në vlerën 2,034,480 lekë, Ndriçim rruge dytësore vlera 6,067,471 lekë, Skema ujitëse Berdicë, Shkoder vlera 10,506,565 lekë, Skema Ujitëse Guri I Zi-Juban vlera 5,291,755 lekë, Ndriçim i rrugës Malo Hoxha NjA Bërdicë vlera 1,659,000 lekë, FV kufizues shpejtësie (bumpe gome



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

2,219,490 lekë , Ndertim rrjeti te ujit të pijshem Lagje Mar Lula vlera 7,933,290 lekë, Skema Ujitëse Bërdicë – Shkodër vlera 11,871,835 lekë.

-Gjendja e llogarisë 214 “instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në fund të vitit 2017, paraqitet në vlerën 87,854,354 lekë dhe në fund të vitit 2018 ka rezultuar në vlerën 91,960,341 lekë, lëvizjet në këtë llogari kanë të bëjnë me shtesa për vitin 2018 prej 27,065,458 lekë që përbehen nga 9,128,458 lekë blerje dhe 17,937,000 lekë lëvizje të aktiveve duke zbritur amortizimin vjetor në vlerën pasi llogaria është paraqitur në vlerë neto.

-Gjendja e llogarisë 215 “Mjete transporti” në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 6,281,222 lekë dhe në fund të vitit 2018 paraqitet me vlerën 9,868,178 lekë, lëvizjet në këtë llogari kanë të bëjnë me blerje mjete transporti dhe konkretisht Automjet SKODA FABIA me vlerë 1,323,000 lekë, Automjet Tip VOLSVAGEN JETTA me vlerë 2,583,000 lekë, mjet transporti Mercedes Sprinter 3.5 ton me vlerë 2,148,000 lekë duke zbritur amortizimin vjetor sepse janë paraqitur me vlerë neto.

-Gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik”, Në fund të vitit 2017 gjendja e kësaj llogarie në bilanc, paraqitet në vlerën 51,254,877 lekë dhe më 31.12.2018, ka rezultuar në shumën prej 47,116,129 lekë, ndryshimet në këtë llogari kanë të bëjnë me shtesat gjate vitit në shumën prej 16,827,953 dhe paksimet nga lëvizjet ndërmjet aktiveve dhe kalim ne institucionet e varësisë në shumën prej 1,202,811 lekë dhe paksimet nga amortizimi vjetor sepse janë të paraqitura në bilanc me vlerën neto.

-Gjendja e llogarisë 24 “Aktiveve të dëmtuara” paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 166,543,176 lekë, ndërsa më 31.12.2018 paraqitet me vlerën prej 161,023,223 lekë. Kjo llogari përbëhet nga 38,781,954 lekë mjete transporti të dëmtuara të cilat janë në procedurë ankandi dhe vlera prej 153,216,730 lekë janë aktive të pidentifikuara të trashëguara nga njësitë administrative, të gjitha këto të pakësuara më amortizimin pasi në pasqyrat financiare paraqiten me vlerë neto.

Gjatë vitit 2018 ka patur ndryshime është shtuar vlera 1,490,400 lekë që i përket një mjeti të transportit të dëmtuar dhe është paksuar vlera 7,141,245 lekë që i përket një ndërtese e cila është kaluar në llogarinë 2012 “Ndërtesa e Konstruksione”.

-Gjendja e llogarisë 230 “Për Aktive Afatgjata jo materiale”, në fund të vitit 2017 gjendja e kësaj llogarie në bilanc, paraqitet në vlerën 55,891,056 lekë dhe më 31.12.2018, ka rezultuar në shumën prej 19,389,000 lekë, ndryshimet në këtë llogari në vlerën 36,502,056 kanë të bëjnë me kalimet në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” të projekteve me llogari jashtë thesarit. Gjendja e mbetur në këtë llogari është 19,389,000 lekë, që përbëhet nga shuma 11,121,000 lekë që është e trashëguar nga NJA Velipojë që i përket studimit urbanistik të papërfunduar dhe shuma 8,268,000 lekë që është trashëguar nga NJA Rrethina studim urbanistik i papërfunduar.

-Gjendja e llogarisë 231 “Për Aktive Afatgjata materiale”, në fund të vitit 2018 gjendja e kësaj llogarie në bilanc në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 76,797,004 lekë dhe më 31.12.2018, ka rezultuar në shumën prej 57,382,556 lekë, ndryshimet në këtë llogari në vlerën 19,414,448 lekë, kanë të bëjnë me diferencën e investimeve të reja dhe investimeve të mbetura në proces në fund të vitit 2018 të cilat janë:

Ndërtim Varreza publike shuma 1,213,297 lekë, Pyllëzim kodra Tepes 606,192 lekë, Rikonstruksion blloku i pallateve Xhabije 34,611,620 lekë, ndërtim parcela të reja varresh, varreza NJA Rrethina 1,275,480 lekë, Rikonstruksion rruga Drishtej vlera 2,164,680 lekë, Rikualifikim urban blloqe banimi Bulevardi Zogu i Parë Xhabije vlera 5,139,506 lekë, NJA



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Postribë investime të trashëguara shuma 371,712 lekë, NjA Rrethina investime të trashëguara shuma 5,518,838 lekë, NjA Shalë investime të trashëguara shuma 6,481,231 lekë.

Pasivi i Bilancit:

Gjendja e fondeve të veta më 31.12.2018 sipas bilancit kontabël rezulton në vlerën 7,008,568,086 lekë dhe më 31.12.2018 rezulton në vlerën 7,241.827,619 lekë.

Sipas të dhënave të bilancit në pikën II-të “Detyrimet afatshkurta” paraqiten në fund të vitit 2017 për vlerën 292,037,264 lekë dhe në fund të vitit 2018 për vlerën 325,202,393 lekë, nga të cilat konstatohet se :

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura më to”, më 31.12.2018 paraqitet me një vlerë prej 3,810,210 lekë e cila përbëhet nga fatura të papaguara për blerje materiale me fletë hyrje.

-Gjendja e llogarisë 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, më 31.12.2017 paraqet në kredi të sajë një shumë prej 15,303,091 lekë dhe më 31.12.2018 paraqitet me një vlerë 16,042,059 lekë, pagat e papaguara të muajit dhjetor 2018.

-Gjendja e llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, më 31.12.2017 paraqitet në vlerën 1,328,440 lekë, dhe në 31.12.2018 në vlerën 1,470,966 lekë. detyrime për tatimin mbi pagë të personelit për muajin dhjetor të vitit ushtrimor.

-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” paraqesin detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa derdhura të muajit dhjetor të vitit ushtrimor 2017 në shumën 4.458.531 lekë dhe për vitin 2018 paraqitet në vlerën 4,309,450 sigurimet lekë e papaguara të muajit dhjetor 2018

- Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqesin detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa derdhura të muajit dhjetor të vitit ushtrimor 2017 në shumën 620,322 lekë dhe për vitin 2018 paraqitet në vlerën 606,837 lekë sigurimet e papaguara të muajit dhjetor 2018.

-Llogaria 44 “**Institucione të tjera publike**” paraqitet në fund të vitit 2017 dhe në fund të vitit 2018 me të njëjtën vlerë prej 3,000 lekë, e cila përfaqëson detyrime ndaj shtetit të trashëguar nga Nj A Shalë. **Kjo vlerë prej 3,000 lekë duhet të derdhet në buxhet të shtetit.**

-Në llogarinë nr.466 “**Kreditorë për mjete në ruajtje**” në pasiv të bilancit paraqitet në vlerën 51,271,921 lekë me 31.12.2017 e cila përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme. Për vitin 2018 kjo llogari paraqitet në vlerën 59,554,925 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se vlera 59,554,925 lekë përbëhet si vijon:

-Vlera 8,059,901 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2016. **Kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin bashkangjitur për këtë qëllim në vlerën e sipër cituar prej 8,059,901 lekë.**

-Vlera 14,927,149 lekë, detyrime ndaj subjekteve për garanci punimesh viti 2016.

-Vlera 13,914,050 lekë, detyrime ndaj subjekteve për garanci punimesh viti 2017.

-Vlera 22,653,825 lekë, detyrime ndaj subjekteve për garanci punimesh viti 2018.

- Llogaria 467 “kreditore të ndryshëm ” paraqitet në vlerën 203,641,018 lekë detyrimet për fatura të papaguara në fund të vitit 2018, në këtë shumë përfshihen edhe shumat e papaguara për vendime gjyqësore dhe shumat e papaguara për shpronësime.

Emërtimi	Bilanci 31.12.2018 Bashkia Qender	Bilanci I Konsoliduar Bashkia Shkoder+Inst. Varesive
Shpronësime	46,957,643	46,957,643
Vendime Gjyqate	32,873,305	32,873,305



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Fatura te palikuiduara	123,810,070	132,106,841
Totali	203,641,018	211,937,789

- Llogaria 4341 “ Operacione me shtetin (detyrime) ne fund të vitit 2017 dhe në fund të vitit 2018 paraqitet me vlerë prej 35,763,928, në këtë vlerë përfshihen detyrimet e debitorëve të cilat i përkasin buxhetit të shtetit. Këto detyrime në aktivin e bilancit paraqiten ne llogarinë 468 ‘ Debitore të ndryshëm”.
 - Llogaria 475 “ Llogaria Të ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse “ paraqitet në fund të viti 2017 me vlerë 752,006,492 dhe në fund të vitit 2018 me vlerë prej 969,153,683 lekë.
- Kjo llogari përbehet nga debitoret e ndrsyhem qe në aktiv gjenden ne llogarinë 468 “ Debitorë të ndryshëm” duke zbritur shumen prej 35,763,928 lekë gjendjen ne llogarinë 4341 Operacione me shtetin (detyrime) përmendur më lart .

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Gjetje nga Auditimi:

Titulli i Gjetjes:	Mbi saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare për dhënien e opinionit.
Situata:	<p>Nga auditimi i llogarive të pasqyrave financiare mbi saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, u konstatuan pasaktësi në disa llogari:</p> <p>Në llogarinë 202“Aktive Afatgjata jo materiale”</p> <p>-Nuk është sistemuar vlera prej 25,718,512 lekë që i përkasin studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investimet e kryera në periudhën para vitit 2017, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara.</p> <p>Në llogarinë 211“Pyje, kullota, plantacione”</p> <p>-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.</p> <p>-Nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 48, shtojca me nr.46, për 2160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) prona.</p> <p>Në llogarinë 44 “Institucione të tjera publike”</p> <p>-Nuk është sistemuar vlera prej 3,000 lekë, e cila duhet të derdhet në buxhet të shtetit, pasi përfaqson detyrime të Bashkisë, ndaj shtetit të trashëguar nga Nj A Shalë.</p> <p>Në llogarinë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”</p> <p>-Vlera prej 8,059,901 lekë, duhet të sistemohet, pasi janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2016. Kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin bashkangjitur për këtë qëllim në vlerën e sipër cituar.</p>
Kriteri:	<p>-Lligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2;</p> <p>-VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 48, shtojca me nr.46, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	pronësi të Bashkisë Shkodër, me numur rendor nga 1(një) deri 2160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) -Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96. -UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në besueshmërinë e pasqyrave financiare.
Shkaku:	Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël dhe pasqyrat financiare.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi	Nënpunësi autorizues dhe Nënpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarive të pasqyrave financiare bazuar në dokumentacionin kontabël ligjor.

Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.

Bashkia Shkodër për vitet 2017,2018 ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë. Pasqyrat financiare të konsoliduara japin një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare.

Në pasqyrat financiare të konsoliduara është grupuar informacioni duke bërë eliminimet dhe duke mënjanuar dublimet. Në pasqyrat e konsoliduara përfshihen të gjitha institucionet dhe aksionet e sh.a në pronësi.

Pasqyrat e konsoliduara për vitet 2017 dhe 2018 janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimin nr 42, datë 19.06. 2018 për pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe vendimin nr.35, datë 20.05.2019 për pasqyrat financiare të vitit 2018 dhe janë dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit , Drejtoria Operacionale, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pasqyrat e konsoliduara për vitet 2017 dhe 2018 të Bashkisë Shkodër janë dërguar Degës së Thesarit Shkodër me shkresat respective nr.8014, datë 23.05.2018, dhe nr.7026, datë 26.04.2019, të cilat janë nënshkruar pa vërejtje, nga Dega e Thesarit.

Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2018, përfshijnë informacionin e depozituar nga:

Bashkia Qendër me Njësitë Administrative.
Institucioni Dega Ekonomike e Kulturës.
Institucioni Drejtoria e Kopshte Çerdheve”.
Institucioni Teatri “Migjeni”.
Institucioni Sport Klub “Vllaznia”.
Institucioni Drejtoria Ekonomike e Arsimit.
Institucioni Drejtoria MZSH
Institucioni Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore e Pyjore
Institucioni Shtëpia e Foshnjës
Institucioni Shtëpia e Fëmijës Shkollor
Institucioni Qendra e Zhvillimit

Llogaritë sintetike që përbëjnë Aktivin dhe Pasivin e bilancit për dy vitet të njëpasnjëshme ushtrimore 2017 dhe 2018, paraqiten bashkangjitur Projektraportit të Auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Nga analiza e llogarive të pasqyrave financiare të konsoliduara konstatohet se:

Nga Bashkia Shkodër, Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2017 janë mbyllur me vonesë pasi janë dërguar në Degen e Thesarit Shkodër me shkresën nr.8014, datë 23.05.2018, pra me mbi dy muaj vonesë. Ndërsa për vitin ushtrimor 2018 janë dërguar me shkresën nr.7026, datë 26.04.2019, konfirmuar nga dega e thesarit me nr.783, datë 30.04.2019, pra me një muaj vonesë. Veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtime me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”;

Neni 9 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues pika 4. Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: germa (d) planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimitarisë së njësisë publike;

Neni 12 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues pika 2. Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së: germa (b) raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave.

Si dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjessë Përgjithshme”, pika 118. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit.

Pasqyrat e konsoliduara për vitet 2017 dhe 2018 janë të shoqëruara me situacionin e rakorduar me situacionet përkatëse për shpenzimet dhe të ardhurat, si dhe për të gjitha institucionet e vartësisë.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi në se veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

Aktivi dhe pasivi i bilancit është i kuadruar. Pasqyrat anekse rakordojnë me aktivin dhe pasivin e bilancit për llogaritë analoge. Pasqyra e shpenzimeve të ushtrimit dhe pasqyra e të ardhurave të ushtrimit kuadrojnë me akt-rakordimet me thesarin për shpenzimet dhe për të ardhurat. Gjithashtu gjendjet e llogarive në pasqyrën e lëvizjeve në “CASH” rakordojnë me akt-rakordimet me thesarin. Gjendja e llogarisë “Teprica në mbyllje të ushtrimit” është e barabartë me gjendjen e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në aktivin e bilancit.

-Gjendja e llogarisë 24 “Aktiveve të dëmtuara” paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 166,543,176 lekë, ndërsa më 31.12.2018 paraqitet me vlerën prej 161,023,223 lekë. Kjo llogari përbëhet nga 38,781,954 lekë mjete transporti të dëmtuara të cilat janë në procedurë ankandi dhe vlera prej 153,216,730 lekë janë aktive të pidentifikuara të trashëguara nga njësitë administrative, të gjitha këto të pakësuara më amortizimin pasi në pasqyrat financiare paraqiten me vlerë neto.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Gjatë vitit 2018 ka patur ndryshime është shtuar vlera 1,490,400 lekë që i përket një mjeti të transportit të dëmtuar dhe është paksuar vlera 7,141,245 lekë që i përket një ndërtese e cila është kaluar në llogarinë 2012 “Ndërtesa e Konstruksione”.

-Në pasqyrat e konsoliduara gjendja e llogarisë 20 “**Aktive Afatgjata jo materiale**” në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 69,305,204 lekë, kurse në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën 123,462,513 lekë, e cila përfaqëson vlerat e studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investime, të kryera gjatë periudhës së auditimit dhe investimeve të kryera ndër vite.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:

-Vlera 15,007,412 lekë, janë vlera e projekteve për investime të pa financuara.

-Vlera 77,241,703 lekë, janë vlera e projekteve të financuara për investimet në proces.

-Vlera 5,494,886 lekë janë vlera e projekteve të financuara për investimet në proces, nga njësitë vartëse.

-Vlera 25,718,512 lekë i përkasin studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investimet e kryera në periudhën para vitit 2017, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara.

Nga vlera e totale prej 123,462,513 lekë, duhet sistemuar vlera 25,718,512 lekë e studimeve dhe projekteve për investimet e kryera ndër vite, në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit. Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.

Në llog 202 Studime e kërkime përfshihen			
Bashkia Shkoder Qender	Bashkia Shkoder Qender	108,160,214	
Nj.A.Guri i Zi	Nj.A.Guri i Zi	821,000	
Nj.A.Berdice	Nj.A.Berdice	1,794,000	
Nj.A.Dajç	Nj.A.Dajç	1,200,000	
Nj.A.Postrribe	Nj.A.Postrribe	733,216	
Nj.A.Velipoje	Nj.A.Velipoje	5,259,197	
	Totali Studime e kërkime Bashkia dhe Njësitë Administrative	117,967,627	
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	Drejtoria Ekonomike e Arsimit	1,516,360	
Teatri “Migjeni”	Teatri “Migjeni”	3,978,526	
	Totali Studime e kërkime Bashkia Njësitë vartëse	123,462,513	ok

-Në pasqyrat e konsoliduara gjendja e llogarisë 211 “**Pyje, kullota, plantacione**” në fund të vitit 2018, paraqitet me një vlerë 6,284,216 lekë e pa ndryshuar, nga viti mëparshëm.

Konstatohet se:

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

-Në këtë llogari **nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016** “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 48, shtojca me nr.46, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Shkodër, me numur rendor nga 1(një) deri 2160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96.

-Në pasqyrat e konsoliduara gjendja e llogarisë 44 “Institucione të tjera publike” paraqitet në fund të vitit 2017 dhe në fund të vitit 2018 me të njëjtën vlerë prej 3,000 lekë, e cila përfaqson detyrime të Bashkisë, ndaj shtetit të trashëguar nga Nj A Shalë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se, **vlera prej 3,000 lekë duhet të derdhet në buxhet të shtetit.**

-Në pasqyrat e konsoliduara gjendja e llogarisë 466 “**Kreditorë për mjete në ruajtje**” paraqitet në pasiv të bilancit në vlerën 67,910,088 lekë, e cila përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh, gjendje më 31.12.2018.

E analizuar sipas njësite vartëse paraqitet sipas tabelës në vijim:

Ne llogarine 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" me një saldo kreditorë prej 67,910,090 leke perfshihen :	
BAshkia + NJA vitet e kaluara	36,901,100
BAshkia + NJA viti 2018	22,653,825
Dega Ekonomike e Kultures	652,089
Drejtoria e Kopshte Çerdheve	165,199
Teatri “Migjeni”	62,481
Sport Klub “Vllaznia”	202,461
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	4,153,052
Ujesjellesi	3,119,883
shuma	67,910,090

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se vlera 67,910,088 lekë përbëhet si vijon:

-Vlera 36,901,100 lekë, janë detyrime të bashkisë Shkodër ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2017.

-Vlera 22,653,825 lekë, janë detyrime të bashkisë Shkodër ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera gjatë vitit 2018.

-Vlera 8,355,165 lekë, janë detyrime të bashkisë Shkodër ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera nga njësitë vartëse gjatë vitit 2018.

Nga analiza e mëtejshme e vlerës 36,901,100 lekë, të cilat janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2017, **konstatohet se:**

-Vlera 8,059,901 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2016, kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin bashkangjitur për këtë qëllim në vlerën e sipër cituar prej 8,059,901 lekë.

-Vlera 14,927,149 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera gjatë vitit 2016.

-Vlera 13,914,050 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera gjatë vitit 2017.

Pasqyra e llog. 466 “**Kreditorë për mjete në ruajtje**” para vitit 2016, bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit.

*Pasqyrat financiare janë të firmosura nga Nëpunësi Autorizues znj.V. A. dhe Nëpunësi Zbatues znj.B. M., të cilat kanë nënshkruar në çdo faqe dhe çdo informacion sqarues që i shoqëron pasqyrat financiare si dhe në shkresën përcjellëse,

*Gjendja e llogarive bankare rakordon me gjendjen sipas evidencave të thesarit. Gjendja e llogarive të projekteve në bankat e nivelit të dytë rakordon me gjendjen e ekstrakteve të projekteve në fund të vitit. Gjatë investigimit të llogarive nuk rezulton të ketë diferenca.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

*Akt rakordimi i thesarit është i pasqyruar saktë në pasqyrat financiare.

*Pasqyrat financiare mbajnë datën e 31 Dhjetorit, në pasqyrat financiare të viti 2017 shuma prej 690,594 lekë e kaluar në janar është e pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2017 si detyrim ndaj të tretëve. Pasqyrat financiare mbajnë datën e 31 Dhjetorit, në pasqyrat financiare të vitit 2018 nuk ka detyrime të pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2018 si detyrim ndaj të tretëve.

*Vlera e regjistruar në bilanc dhe PASH e shpenzimeve të përlllogaritura, këto shpenzime janë pasqyruar në llogaritë 421 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, 435 “Sigurime Shoqërore”, 436 “Sigurime Shëndetësore”. Të gjithë këto detyrime janë të llogaritura saktë dhe janë likuiduar të gjitha në muajin Janar të vitit pasardhës.

*Në zërin “Të drejta të arkëtueshme nga të tretët” përfshihen edhe borxhi tatimor/taksa vendore gjendje që subjektet i kanë bashkisë dhe ka kaluar afati pagesës. Gjendja e subjekteve debitore në fund të vitit 2018 është 543,695,300 lekë. Subjekti i kontabilizon këto detyrime në momentin kur ato lindin duke i faturuar dhe ngarkuar si detyrime në sistem e tatim taksave që subjekti disponon dhe është në funksion. Subjekti është në proces të ezaurimit të gjitha mekanizmat ligjore për mbledhjen e vlerave monetare dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të subjektit dhe shtetit. Nuk ka provigjone të llogaritura lidhur me këtë zë.

*Shpenzimet për fatura të mbërritura por të papaguara (detyrime të prapambetura) janë, regjistruar në Bilanc dhe PASH. Të gjitha faturat janë regjistruar në kohë dhe në vlera të plota. Për vitin 2017 janë raportuar në MFE sipas shkresës nr. 132 prot datë 04.01.2018, borxhe në total 131,987,048 lekë e ndarë sipas kategorive investime, mallra dhe shërbime, dhe të tjera. Të gjitha këto detyrime janë shlyer. (bashkëngjitur kopje e shkresës). Për vitin 2018 janë raportuar në MFE sipas shkresës nr.1510 prot, datë 30.01.2019 borxhe në total 80,516,274 lekë e ndarë sipas kategorive investime, mallra dhe shërbime, dhe të tjera. Të gjitha këto detyrime janë shlyer.

*Për vitin 2017, bashkia Shkodër ka raportuar si detyrime të prapambetura nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve objektet si më poshtë, të klasifikuara si shpenzime kapitale. Vlera në total është 19,734,777 lekë e pasqyruar në llogarinë 486 “Shpenzime të periudha të Ardhshme”. Për vitin 2018 nuk ka fonde nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

NR	Emri I Furnitorit	Nipt-I (QKR)	Emri I Kontrates	Data origjinale e fatures	Numri Serial I Fatures	Shuma e Fatures
1	K. G. K.	J66703076Ë	Rikonstrukcion blloku I pallateve Xhabije	27.12.2017	41772471	7,408,909
2	CO 1 Rr. C.	K41517031H	Rik urban, rrugicave Qend Historike (Shtrim irrugicave me gure dhe montimin e dyerve dekorative prej druri) Situacion përfundimtare	22.12.2017	4757473	12,325,868
						19,734,777

*Në fund të vitit 2018, janë krijuar rishtazi detyrime të palikuiduara për Bashkinë Shkodër në zërin shpenzime operative në shumën 36,369 mijë lekë, në zërin transferime 14,694 mijë lekë dhe në zërin Investime dhe projekte në shumën 29,453 mijë lekë. Këto detyrime janë krijuar nga limiti i vendosur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.19932 prot, datë 07.11.2018 me objekt “ mbi limitin e planit të shpenzimeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Bashkia Shkodër me datë 09.11.2018 me nr.3849/b prot ka dërguar email, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për “ Kërkesë për shtesë limitit”. Është kthyer përgjigja me nr.22568 prot, datë 24.12.2018 “Shtese mbi limitin e planit të shpenzimeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, por e pamjaftueshme për të likuiduar të gjitha faturat.

*Granti i pakushtëzuar dhe i papërdorur/bllokuar është mbartur nga vitit në vit dhe është pasqyruar në bilanc.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

*Nuk ka detyrime të lindura për asnjë lloj huaje nga Bashkia.

*Detyrime të pashlyera nga Bashkia për vitin 2017 ndaj enteve publike si energji, ujë janë në shumën prej 6,223,301 lekë, të cilat janë kontabilizuar si detyrime në llogarinë 467 “Kreditor të ndryshëm”, si dhe janë likuiduar në muajin Janar 2018. Detyrime të pashlyera për vitin 2018 ndaj enteve publike si energji, ujë janë në shumën prej 6,980,765 lekë, të cilat janë kontabilizuar në llogarinë 467 “Kreditor të ndryshëm”, si dhe janë likuiduar në muajin Shkurt 2019.

*Bashkia ka shpenzime kapitale me financim të huaj nga projekti “IADSA”, të cilat janë kontabilizuar dhe raportuar të plota këto gjatë vitit 2017 dhe 2018. Këto shpenzime janë të realizuar në llogari jashtë Thesarit (Banka të nivelit të dytë) dhe janë të bazuara në fatura dhe situacione si të gjithë shpenzimet e tjera që operohen nëpërmjet sistemit të Thesarit . Këto shpenzime janë klasifikuar dhe kontabilizuar sipas llojit të shpenzimit. Këto shpenzime kapitale në fund të viti 2017 janë kontabilizuar në llogarinë 230 si investime në proces, ndërsa në fund të viti 2018 kur ky investim është marrë në dorëzim është kontabilizuar në llogarinë 212 Ndërtesa dhe konstruksione.

*Të gjitha vendimet gjyqësore që janë të formës së prerë janë likuiduar sipas rradhës FIFO dhe me urdhër të titullarit. Subjekti ka vendime në proces gjyqësor 25 raste, të gjitha vendimet e formës së prerë të marrë nga Drejtoria Juridike janë likuiduar.

Për vitin 2017 ka likuiduar 5 vendime gjyqësore, në vlerë totale 3,107,551 lekë.

Për vitin 2018 ka likuiduar 5 vendime gjyqësore në vlerë totale 2,216,750 lekë.

Për vitin 2019 (6 Mujori janë likuiduar 7 vendime gjyqësore në shumën 20,485,668 lekë.

Subjekti ka kontabilizuar pagesat për vendime gjyqësore, në llogarinë 467 “Kreditor të ndryshëm”. Janë kontabilizuar detyrimet e lindura por të papaguara për vendime gjyqësore. Vendimet gjyqësore janë paguar sipas rradhës FIFO dhe me urdhër të Titullarit. Gjendje në fund të vitit 2017 e detyrimeve të lindura dhe të pashlyera për vendime gjyqësore është 6,171,239 lekë. Gjendja në fund të vitit 2018 e detyrimeve të lindura dhe të pashlyera për vendime gjyqësore është 32,873,305 lekë.

*Për Aktivet Afatgjata të Trupëzuara është bërë inventarizimi i tyre: Për vitin 2017 inventarizimi është kryer me komision të ngritura me urdhrat përkatës, nr 984 date 11.12.2017, nr .52,53 datë 11.01.2018 dhe për vitin 2018 me nr 79 date 24.09.2018, nr 111 dt 27.11.2018 dhe nr 5 , 7 date 04.01.2019. Gjithashtu është bërë saktë klasifikimi i tyre i aktiveve afatgjata të trupëzuara dhe janë mbajtur kartelat e tyre. Gjatë vitit janë raportuar të gjitha shtesat apo përmirësimet të cilët e kanë shtuar vlerën e aktiveve. Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2018 janë përdorur normat e reja të amortizimit në bazë të Udhëzimit i MF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” Amortizimi është i regjistruar i saktë.

Për vitin 2017 janë bërë nxjerrje jashtë përdorimi dhe asgjësimi i inventarit ekonomik dhe inventarit të imët në shumën prej 15,910,269 lekë dhe me vlerë të akumuluar të amortizimit 10,519,444 lekë. Procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi është bërë në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Nxjerrja jashtë përdorimi është bërë duke zbatuar të gjitha fazat si inventarizimi, vlerësimi, dhe nxjerrja jashtë përdorimi. Duke patur parasysh kriteret si plotësimi i kohës së shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, pamundësinë e riparimit si pasojë e konsumit, dëmtimi në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit, kur vlera e riparimit ose e përshtatjes



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm, kur kanë humbur cilësinë e tyre të caktuara në standartet shtetërore ose në kushtet teknike.

Me shkresën nr.2050/b, datë 29.05.2017 grupi i vlerësimit të aktiveve të vlerësuara si jashtë funksioni i ka paraqitur Kryetares së Bashkisë procesverbalin dhe relacionin përkatës të aktiveve të indentifikuara për vlerësim të cilat rezultuan jashtë funksionit dhe janë dërguar në magazinë si mall në ruajte deri në vlerësimin përfundimtar nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi ose i tjetërsimit të tyre.

Pas marrjes së materialit Kryetarja e Bashkisë ngriti grupin e nxjerrjes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve i cili pasi verifikoi në sasi dhe në vlerë aktivet që ishin pasqyruar në procesverbalin dhe relacionin e vlerësimit duke kontrolluar gjendjen e tyre fizike dhe bërë analizën kosto përfitim vendosi që disa aktive që kanë vlerë historike të mbahen në magazine ndërsa pjesa tjetër në shumën prej 15,910,269 lekë dhe me vlerë të akumuluar të amortizimit 10,519,444 lekë u vlerësua që nuk mund të përdoren për qëllime të tjera u dha mendimi që të asgjësohen (groposen ose digjen).

Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi ka paraqitur relacionin dhe procesverbalin përkatës tek Kryetarja e Bashkisë me nr.417/b prot. datë 13.10.2017. Nga Kryetarja e Bashkisë është bërë miratimi për asgjësimin e materialeve me Vendimin nr.448, datë 16.11.2017 “Për miratimin e asgjësimit të materialeve si mallra të ndryshëm si pajisje druri ose plastike të konsumuara si dhe paisjet kompjuterike të cilat nuk mund të shfrytëzohen për qëllime të tjera”. Komisioni pas marrjes së miratimit të Kryetares së Bashkisë për asgjësimin e materialeve të inventarit mundësoi më parë shkatërrimin e tyre me mjete të përshtatshme për ti bërë ato krejtësisht të gatshme për t'u asgjësuar plotësisht pra duke e ndryshuar formën e tyre fillestare. Kjo metodë e përdorur u konsiderua e përshtatshme për të reduktuar dhe lehtësuar shpenzimet e asgjësimit dhe objektivi i kësaj metode ishte pakësimi i vëllimit të pajisjeve. Të gjitha hapat e procesit janë dokumentuar në materialet që janë dërguar tek Kryetarja e Bashkisë me nr.5417/b, datë 26.12.2017.

Për vitin 2018 janë kryer procedura të nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimi të inventarit ekonomik në institucionet arsimore të njëjësive administrative me vlerë 13,889,671 lekë dhe me vlerë të akumuluar të amortizimit 7,226,330 lekë dhe inventarit të imët me vlerë 6,024,401 lekë. Për vitin 2018 nxjerrje jashtë përdorimi dhe asgjësimi i inventarit ekonomik në konviktet dhe shkollat qytet me vlerë 3,643,868 lekë dhe me vlerë të akumuluar të amortizimit 1,824,066 lekë dhe inventarit të imët me vlerë 6,077,589 lekë. Procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimi është bërë duke zbatuar të gjitha hapat që përcaktohen në Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Për njësitë administrative është ngritur komisionin i inventarizimit dhe vlerësimit me urdhër nr. 79, datë 24.09.2018, pas paraqitjes së relacionit dhe proces verbalit nga komisioni është ngritur komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi me urdhër nr. 82, datë 05.10.2018 pas marrjes së relacionit dhe proces verbalit nga komisioni, titullari ka marrë vendimin nr. 442, datë 23.10.2018 “Për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve” dhe ka nxjerrë urdhrin nr.102, datë 05.11.2018 “Për asgjësimin e aktiveve dhe me datë 09.11.2018 është bërë proces verbali i asgjësimit të tyre.

Për qytetin është ngritur komisionin i inventarizimit dhe vlerësimit me urdhër nr.111, datë 27.11.2018. Me paraqitjen e relacionit dhe proces verbalit nga komisioni është ngritur komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi me urdhër nr.135, datë 26.12.2018. Pas marrjes së relacionit dhe procesverbalit nga komisioni, titullari ka marrë vendimin nr.10, datë 14.01.2019 për nxjerrjen



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

jashtë përdorimi të aktiveve dhe ka nxjerrë urdhrin nr. 3/1, datë 15.01.2019, "Për asgjësimin e aktiveve" dhe me datë 16.01.2019 është bërë procesverbali i asgjësimit të tyre.

Nxjerrjet jashtë përdorimi të ndodhura gjatë vitit, janë kontabilizuar saktë dhe janë pasqyruar efektet e tyre në pasqyrat financiare .

Aktivet afatgjata të trupëzuara të cilat janë përfituar përmes dhurimit janë bërë hyrje në magazinë duke u shoqëruar me Akt marrëveshjen ose aktin e dhurimit, faturën me çmimet përkatëse. Në rastet kur janë dhuruar aktive të cilat kanë hyrë nëpërmjet doganës dokumentet janë shoqëruar edhe me dokumentet e zhdoganimit.

Të gjitha aktivet e dhuruara janë marrë në dorëzim nga grupi i ngritur për marrjen në dorëzim të materialeve të dhuruara në institucion.

Përsa i përket trajtimit kontabël i vlerës dhe amortizimit këtyre aktive janë bërë duke përdorur llogaritë ndërmjetëse Grante kapitale të huaja ose të brendshme në natyrë, llogaritë të cilat janë mbyllur me llogaritë e fondeve konkretisht shtesa të fondeve bazë në fund të vitit.

***Për Aktivet Afatgjata të Patrupëzuara është bërë inventarizimi i tyre. Gjithashtu është bërë saktë klasifikimi i tyre i aktiveve afatgjata të patrupëzuara dhe janë mbajtur kartelat e tyre. Nga analizat e këtyre llogarive u konstatua një pjesë e tyre me vlerë prej 25,718,512 lekë i takon investimeve të cilat janë përfunduar të cilat duhet të ishin shpërndarë në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit. Gjatë vitit janë raportuar të gjitha shtesat apo përmirësimet të cilët e kanë shtuar vlerën e aktiveve.**

*Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në:

-Ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar.

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

-Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme".

-Udhëzimit nr. 39, datë 24.12.2018 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2018".

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

1.2 Vlerësimi i arsyeshëm e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);

Për vlerësimin dhe dhënen e opinionit të pasqyrave financiare të periudhës së viteve 2017-2018, u analizuan të gjithë treguesit e aktivitetit të veprimtarisë ekonomiko financiare dhe në mënyrë përmbledhëse do të paraqitet së bashku me opinionin në projekt raportin dhe raportin përfundimtar të auditimit.

1.3 Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nënjësisë;

Për mënyrën e plotësimit të pasqyrave financiare, për saktësinë dhe analizën e llogarive të pasqyruara dhe të paraqitura në aktiv dhe në pasiv të bilancit janë trajtuar hollësisht në pikën një të programit, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Pasqyrat financiare të Bashkisë përbëhen nga pasqyrat financiare (bilanci) të institucionit më 31 Dhjetor 2018, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare (cash'floë), pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, pasqyra e investimeve dhe burimet e financimit, pasqyra e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (kosto historike), pasqyra e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto), pasqyra e numrit të punonjësve dhe e fondit të pagave, pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

-Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:

Me arkë janë kryer transaksione financiare të kufizuara, si tarifa për dhëni dokumente dublikatë nga arkivi Bashkisë, arkëtim gjoba të policisë Bashkiake, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuara me të gjitha ekstremitetet. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkë, po kështu është mbajtur ditari arkës në formën klasike kontabël.

Përfshirja e shumës të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, si dhe të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 63,64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit për të ardhurat. Gjithashtu të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në Bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje 0 në fund të muajit.

Saktësia e plotësimit të Urdhër shpenzimeve.

Në auditimin e kryer për saktësinë e plotësimit të urdhër shpenzimeve dhe dokumenteve shoqëruese e justifikuse të veprimeve të likuidimeve, u përzgjedhën për tu audituar dokumentet e bankës e konkretisht:

Për vitin 2017, periudha e 3/mujorit të parë e konkretisht urdhër shpenzimet nga nr.1, datë 09.01.2017 deri tek urdhër shpenzimi me nr.383, datë 29.03.2017 dhe 3/mujorit të katërt, urdhër shpenzimet nga nr.1402, datë 02.10.2017 deri tek urdhër shpenzimi me nr.1948, datë 29.12.2017.

Për vitin 2018, periudha e 3/mujorit të dytë, urdhër shpenzimet nga nr.517, datë 03.04.2018 deri tek urdhër shpenzimi me nr.922, datë 28.06.2018 dhe 3/mujorit i tretë, urdhër shpenzimet nga nr.923, datë 02.07.2018 deri tek urdhër shpenzimi me nr.1391, datë 28.09.2018.

Për vitin 2019, periudha e 3/mujorit të parë e konkretisht urdhër shpenzimet nga nr.1, datë 11.01.2019 deri tek urdhër shpenzimi me nr.396, datë 28.03.2019.

Transaksionet e kryera nëpërmjet veprimeve të bankës rezultuan të jenë konform akteve ligjore.

Hartimi i urdhër shpenzimeve është bërë mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës e justifikues, formati i tyre është sipas UMF dhe në të është aplikuar rregullisht sistemi i firmës së dyfishtë duke u nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues.

Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktoheshin qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues. Urdhër shpenzimet ishin konfirmuar dhe nga Specialistët e Degës së Thesarit dhe ishin likuiduar brenda limiteve të përcaktuara nga çelja e fondeve.

*Për rastet e likuidimit të punimeve të ndërtimit, urdhër shpenzimet kanë të bashkangjitur përkatësisht këto dokumente: Urdhër Prokurimi, urdhri për ngritjen e KVO-së, formulari njoftim fituesi, buletini i APP për njoftim fituesi dhe njoftim kontrate, kontrata e lidhur midis palëve, situacioni i punimeve të kryera, fatura e tvsh së subjektit përfitues, certifikata e përkohëshme ose përfundimtare e e marrjes në dorëzim të punimeve, akt kolaudimi përfundimtar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Konkretisht:

Urdhër shpenzimi nr.349, datë 23.3.2017, vlera 4,522,180 lekë, subjekti N., likuiduar nëpërmjet B., Rikualifikim urban i blloqe banimi Bardeleve Pogej, ka të bashkangjitur këto dokumente: Urdhër Prokurimi nr.647, datë 18.10.2016, Formulari njoftim kontrate nr.13305/7 prot, datë 18.10.2016, Urdhër për ngritjen e kvo, nr.648, datë 18.10.2016, buletin njoftim kontrate në app, nr.42, datë 24.10.2016, Buletin Njoftim fituesi në app, nr.46, datë 21.11.2016, Formular njoftim fituesi nr.13305/15, datë 16.11.2016, kontratë datë 14.12.2016, afati 30 ditë, miratim shtyrje afati të punimeve nr.17695 prot datë 30.12.2016, Amendament për zgjatjen e afatit të kontratës datë 24.01.2017-06.02.2017, Fatura nr.seria 44587302, datë 06.02.2017, certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim datë 15.03.2017, Akt kolaudim datë 15.03.2017.

Urdhër shpenzimi nr.366, datë 28.03.2017, vlera 8,684,326 lekë, Subjekti L. V., likuiduar në R. B. sha, Zbatim Urban blloqe banimi Qemal Draçini, Pallati me hark, Shkodër, ka të bashkangjitur këto dokumente: Urdhër Prokurimi Nr.594, datë 03.10.2016, Formulari njoftim kontrate nr.12579/7 Prot datë 03.10.2016, Urdhër për ngritjen e kvo nr.595, datë 03.10.2016, Buletin Shpallje Kontrate në app nr.40, datë 10.10.2016, Buletin njoftim fituesi në app nr.47, datë 30.11.2016, Formular njoftim fituesi nr.12579, prot, datë 21.11.2016, Kontratë nr.12579/15, datë 12.12.2016, afati 30 ditë, Miratim Shtyrje afati të punimeve nr.32/b prot, datë 06.01.2017, Amendament për zgjatjen e afatit të kontratës nr.12586/16, datë 30.01.2017-03.02.2017, Fatura nr.seria 43510765, datë 03.02.2017, Situacion përfundimtar punimesh datë 03.02.2017, Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim datë 09.03.2017, Akt-Kolaudim nr.3277 prot, datë 09.03.2017.

Urdhër shpenzimi nr.157, datë 08.02.2018, vlera 2,501,080 lekë, subjekti S. M. O. V. Objekti Rikonstruksion Rruga Draçin (faza II), (ndertim muri mbajtes), , likuiduar në C. B., ka të bashkangjitur këto dokumente: Urdhër Prokurimi Nr.811, datë 20.10.2017, Formulari Njoftim Kontrate Nr.15789/6, datë 20.10.2017, urdhër për ngritjen e kvo nr.812, datë 20.10.2017, formular njoftim fituesi nr.15789/16, datë 12.12.2017, buletin njoftim fituesi nr.43, datë 30.10.2017, buletin njoftim kontrate nr.50, datë 18.12.2017, kontrata nr.15789/17 prot, datë 21.12.2017 (15 ditë kalendarike), Fatuar nr.seria.53177754, datë 04.01.2018, Situacioni Nr.1 Përfundimtar datë 04.01.2018, certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim datë 22.01.2018 (garancia 24 muaj), Akt kolaudimi datë 22.01.2018.

*Për rastet e blerjeve të materialeve të ndryshme, urdhër shpenzimet kanë të bashkangjitur përkatësisht këto dokumente: Urdhër Prokurimi, urdhër për ngritjen e KVO-së, fotokopje e buletinit të APP për njoftim fituesi dhe njoftim për lidhje kontrate, fotokopje e kontratës së lidhur midis palëve, fatura e subjektit përfitues, proces verbali i marrjes në dorëzim dhe fletë hyrje e magazinës.

Konkretisht:

-Urdhër shpenzimi nr.1157, datë 16.08.2018, vlera 2,501,080 lekë, subjekti A. K.sh.p.k, B., Blerje materiale për shërbime riparimi të rrugëve, urdhër prokurimni nr.396, dt.22.05.2018, FNJK nr.7903/4, dt.22.05.2018, urdhër për ngritjen e kvo nr.397, dt.22.05.2018, buletin njoftim kontrate nr.21, dt.28.05.2018, buletin anullimi nr.23, dt.11.06.2018, urdhër prokurimi nr.439, dt.07.06.2018, FNJK Nr.7703/16, Dt.07.06.2018, urdhër për ngritjen e kvo nr.440, dt.07.06.2018, formular njoftim fituesi nr.7903/23, dt.05.07.2018, buletin njoftim kontrate nr.23, dt.11.06.2018, buletin njoftim fituesi nr.27, datë 09.07.2018, buletin shpallje kontrate nr.29, datë 23.07.2018, kontratë nr.7903/24 prot, datë 16.07.2018 deri më 31.12.2018, fatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

nr.seria.54606997-54607005, datë 26.07.2018, fletë hyrje nr.185-193, datë 26.07.2018, process verbali marrjes në dorëzim nr.12254, prot, datë 26.07.2018, fatura nr.serie 54607006-54607013, datë 27.07.2018, fletë hyrje nr.194-201, datë 27.07.2018, process verbal marrje në dorëzim nr.12324/2, prot, datë 27.07.2018.

*Për rastet e likuidimeve të shërbimeve e konkretisht të shërbimit të pastrimit të qytetit, të shërbimit të gjelbërimit, të shërbimit të varrezave të qytetit, të shërbimit të trotuareve, urdhër shpenzimet kanë të bashkangjitur dokumentet si Situacioni i punimeve të kryera në fakt, fatura e tvsh së subjektit përfitues, kontrata e lidhur midis Bashkisë dhe Subjektit, proces verbali i marrjes në dorëzim të punimeve e shërbimeve.

Konkretisht:

-U shpenzimi nr.786, datë 25.05.2018, vlera 1,864,920 lekë, subjekti K.M. K. sh.p.k, objekti, Mirembajtje rruge e trotuare qytet, situacioni Nr.1, Kontratë 5 vjeçare në vazhdim dt.11.06.2014, Aneks Kontrate datë 30.08.2016, (Afati 01.01.2018-31.12.2018), Fat nra nr. Serie 54601791, datë 17.05.2018, Situacion Nr.1, datë 17.05.2018, Proces verbal marrje në dorëzim të shërbimit, datë 17.05.2018,

-U shpenzimi nr.787, datë 25.05.2018, vlera 576,255 lekë, subjekti M. sh.p.k, objekti, Mirembajtje e sipërfaqeve të gjelbërta qytet, kontrata themelore në vazhdim, datë 24.01.2013 (5-vjeçare), shtesë kontrate datë 29.01.2018, (efektet financiare 24.01.2018-07.04.2018), Fatura nr.serie 49347532, datë 07.04.2018, Situacion 01.04.2018-07.04.2018, Proces Verbal marrje në dorëzim datë 07.04.2018.

-U shpenzimi nr.789, datë 29.05.2018, vlera 8,855,111 lekë, subjekti B.sh.p.k, Situacion Pastrimi Zona A UB nr.11163, Situacion Pastrimi Zona A UB nr.18414, Situacion Pastrimi Zona B UB nr.11164, fiferencë transporti i mbetjeve urbane Landfill Zona A, ub nr.16609, diferencë transporti i mbetjeve urbane Landfill Zona B, UB nr.16608, muaji Prill 2018, kontrate 5 vjeçare në vazhdim datë 01.10.2013, Aneks Kontrate Zona A datë 01.01.2018-10.04.2018, Situacion nr.4 për zona A, Prill 2018, Fatura seria 62642303, Prill 2018, process verbal marrje në dorëzim shërbimi Prill 2018, Aneks Kontrate Zona A, datë 11.04.2018-30.09.2018, Situacion nr.4, për zona A, Prill 2018, Fatura nr. Serie 54635245, datë 30.04.2018, process verbal marrje në dorëzim shërbimi, datë 30.04.2018, Aneks Kontrate Zona B, datë 01.01.2018-30.09.2018, Situacion nr.4 për zona B, Prill 2018, Fatura nr. Serie 54635247, datë 30.04.2018, Proces verbal marrje në dorëzim shërbimi datë 30.04.2018, Kontratë Shërbimi Transporti Zona A, datë 01.01.2018-31.10.2018, Situacion nr.4 për shërbim transport Zona A, Prill 2018, Fatura nr. Serie 54635246, datë 30.04.2018, PV Marrje në dorëzim shërbimi, datë 30.04.2018, Kontratë Shërbimi Transporti Zona B, datë 01.01.2018-31.10.2018, Situacion nr.4 për shërbim transport Zona B, Prill 2018, Fatura nr. Seria 54635248, datë 30.04.2018, PV Marrje në dorëzim shërbimi, datë 30.04.2018,

-U shpenzimi nr.790, datë 29.05.2018, vlera 3,788,034 lekë, subjekti N. B.sh.p.k, Depozitim mbetje urbane Prill 2018, Kontratë Depozitim mbetje Urbane për Bashkinë datë 01.01.2018-30.09.2018, Fatura nr.seria 59152741, datë 30.04.2018, Situacion nr.4, datë 30.04.2018, PV Marrje në dorëzim të shërbimit datë 30.04.2018.

-U shpenzimi nr.791, datë 29.05.2018, vlera 1,466,844 lekë, subjekti A. K. sh.p.k, Shërbim i Pastrimit NjA Rrethina, Postribë, Shalë, Prill 2018, Kontratë në vazhdim nr.3716/16 Prot, datë 02.06.2017, afati deri më 30.09.2018, Fatura nr.54606992, datë 30.04.2018, Situacion nr.4, Prill 2018, proces verbal marrje në dorëzim datë 30.04.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

-U shpenzimi nr.1317, datë 18.09.2018, vlera 724,517 lekë, subjekti B. V., B., Mirembajtje Varreza Publike Gusht 2018, Kontrate Sipërmarrje nr.5037/13 prot, datë 15.05.2018, afati 36 muaj, në vazhdim, Fatuar nr. Seria 56699333, datë 31.08.2018, Situacion nr.04, datë 31.08.2018, PV Marrje në dorëzim sherbimi dt.31.08.2018.

1.4 Opinioni mbi pasqyrat financiare;

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik financiar 01.01.2017 deri më datën 31.12.2018.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Gjetje nga Auditimi:

Titulli i Gjetjes	-Hartimi, plotësimi dhe dorëzimi i pasqyrave financiare të vitit 2018 është jashtë afatit ligjor, në Degën e Thesarit
Situata:	-Nga Drejtoria e Financës, Sektori i Kontabilitetit, Bashkia Shkodër, janë mbyllur me vonesë Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2017, pasi janë dërguar në Degën e Thesarit Shkodër me shkresën nr.8014, datë 23.05.2018, pra me mbi dy muaj vonesë. Ndërsa për vitin ushtrimor 2018 janë dërguar me shkresën nr.7026, datë 26.04.2019, konfirmuar nga dega e thesarit me nr.783, datë 30.04.2019, pra me një muaj vonesë.
Kriteri:	-Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”; Neni 9, pika 4. germa “d” dhe Neni 12 pika 2, germa “b” -UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjessë Përgjithshme”, pika 118.
Ndikimi/Efekti:	-Paraqitja jo në afat e të dhënave nga pasqyrat financiare për drejtuesit ebashkisë dhe organeve të zgjedhura si Këshilli Bashkisë dhe organeve eprore, krijon risk në realizimin dhe analizën e treguesve financiar.
Shkaku:	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël dhe pasqyrat financiare. Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet e mbylljes së pasqyrat financiare.
Rëndësia:	-I lartë.
Rekomandime:	-Nënpunësit autorizues dhe Nënpunësit zbatues të marrin masa për hartimin në afat të pasqyrave financiare.

Gjetje nga Auditimi:

Titulli i Gjetjes:	Mbi saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare për dhënien e opinionit.
Situata:	Nga auditimi i llogarive të pasqyrave financiare mbi saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, u konstatuan pasaktësi në disa llogari: Në llogarinë 202“ Aktive Afatgjata jo materiale ” -Nuk është sistemuar vlera prej 25,718,512 lekë që i përkasin studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investimet e kryera në periudhën para vitit 2017, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara. Në llogarinë 211“ Pyje, kullota, plantacione ” -Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit. -Nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	<p>aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 48, shtojca me nr.46, për 2160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) prona.</p> <p>Në llogarinë 44 “Institucione të tjera publike”</p> <p>-Nuk është sistemuar vlera prej 3,000 lekë, e cila duhet të derdhet në buxhet të shtetit, pasi përfaqson detyrime të Bashkisë, ndaj shtetit të trashëguar nga Nj A Shalë.</p> <p>Në llogarinë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”</p> <p>-Vlera prej 8,059,901 lekë, duhet të sistemohet, pasi janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2016. Kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin bashkangjitur për këtë qëllim në vlerën e sipër cituar.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2;</p> <p>-VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 48, shtojca me nr.46, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Shkodër, me numur rendor nga 1(një) deri 2160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë)</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96.</p> <p>-UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”,</p>
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në besueshmërinë e pasqyrave financiare.
Shkaku:	Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël dhe pasqyrat financiare.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi	Nënpunësi autorizues dhe Nënpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarive të pasqyrave financiare bazuar në dokumentacionin kontabël ligjor.

Komente nga subjekti i audituar: Në kundërshtimet me nr.9599/37/1 datë 26.08.2019, protokolluar në KLSH me nr.405/5, datë 29.08.2019 të znj.B. M. dhe znj.M. D. për Projektraportin e Auditimit ku citohet se:

Mbyllja me vonesë e Pasqyrave Financiare të konsoliduara viti 2017 “ vlen të theksohet afati i vetëm që i përket pasqyrave financiare të konsoliduara të viti 2017 është paraqitur në ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes vendore, neni 51, Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor “ ku theksohet “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet pranë Këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore , jo më vonë se data 31 maj e vitit pasardhës buxhetor raportin për veprimtarinë financiare që përfshin dhe pasqyrat financiare të konsoliduara “. Ky afat është zbatuar duke paraqitur Pasqyrat Financiare të Konsoliduara në Këshillin Bashkiak brenda afatit të caktuar.

Përsa i përket Pasqyrave Financiare të konsoliduara të vitit 2018, vlen të theksohet se në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” afati për paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore nga institucionet dhe afati i paraqitjes së pasqyrave financiare të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

konsoliduara është e njëjtë me 31 mars dhe rrjedhimisht teknikisht i pamundur që të paraqiten në njëjtën datë kur dihet që pasqyrat financiare të konsoliduara janë përmbledhëse e pasqyrave financiare të gjithë institucioneve vartëse. Për këtë arsye dorëzimi në thesar i pasqyrave financiare të konsoliduara është bërë brenda muajit prill, ndërsa raportimi i pasqyrave financiare të konsoliduara në Këshillin Bashkiak është bërë brenda afatit të caktuar, brenda muajit maj 2019. MFE duhet të rishikojë afatet mqs ka patur përplasje në udhëzimet e mëparshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit nuk merren në konsideratë pasi edhe vete subjekti e pranon që pasqyrat Financiare janë mbyllur me vonese, për arsye kohe të pamjaftueshme për tu plotësuar nga ana e tyre. Nga Bashkia Shkodër, Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2017 janë mbyllur me vonesë pasi janë dërguar në Degën e Thesarit Shkodër me shkresën nr.8014, datë 23.05.2018, pra me mbi dy muaj vonesë. Ndërsa për vitin ushtrimor 2018 janë dërguar me shkresën nr.7026, datë 26.04.2019, konfirmuar nga dega e thesarit me nr.783, datë 30.04.2019, pra me një muaj vonesë. Ky afat bie ndesh me kërkesat e UMFnr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 118. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit.

Gjetja 4,5,6,7 pasqyrat Financiare

Komente nga subjekti i audituar: Në kundërshtimet me nr.9599/37/1 datë 26.08.2019, protokolluar në KLSH me nr.405/5, datë 29.08.2019 të znj.B. M. dhe znj.M. D. për Projektraportin e Auditimit ku citohet se:

-Llogaria 20 “Aktive Afatgjata jo materiale “ për të cilën theksohet se vlera prej 25,782,512 lekë i përket studimeve ,kërkimeve dhe projekteve për investimet të kryera para viti 2017 vlen të theksohet se janë investime të përfunduara në vitin 2018 dhe **kjo vlerë është sistemuar dhe kaluar në llogaritë përkatëse gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2019.**

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” sqarojme se në këtë llogari janë të pasqyruara informacionet e marra nga NjA për pyjet dhe kullotat duke shtuar investime që mund të jenë bërë pas vitit 2015 në pyje dhe kullota. Përsa i përket listës së inventarit të pyjeve nuk na rezulton që në Drejtorinë e Financës të ketë **ardhur një informacion tillë për kontabilizim.** Nga informacionet e marra nga Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave sqarojme se: Megjithëse ka një vendim për kalim në pronësi të fondit pyjor/kullosot (433/2016), përsëri problematikat janë të mëdha, problematika që lidhen me gjendjen faktike të sasisë së pyjeve (llojet e drurëve, pyjet prodhues, pyjet mbrojtës etj).Regjistrimi i pronave pyje/kullota megjithëse vendimi është detyruar për Bashkitë, nuk ka gjetur zbatim **sepse ZVRPP nuk veprojnë.**Referuar pronave (pyje/kullota) të kaluara në pronësi të Bashkisë Shkodër, theksojmë se nuk ka një inventar fizik të pyjeve/kullotave, por ky inventar i referohet vitit 1985 dhe në disa raste edhe më herët 1982 apo 1962. Nisur nga kjo problematika janë shumë komplekse.Regjistrimi i pronave Pyje/Kullota, do të kryhet në kuadër të Projektit të financuar nga Banka Botërore , SIDA dhe GEF " Për shërbimet mjedisore" i cili do të realizojë Inventarin Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave si edhe Regjistrimin e tyre. Kjo referuar edhe shkresës nr 5548/1 datë 06.07.2018 të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

K/Regjistruerit Tiranë. Në raportin e performancës së KLSH “Mbi efektivitetin e menaxhimit dhe administrimit të fondit pyjor/kullor”, dërguar bashkisë Shkodër me shkresën nr.1426/20 prot, datë 31.07.2019 i është lënë afat Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe për të gjitha bashkitë të marrin masa për përfundimin e procesit të inventarizimit të fondit pyjor brenda Qershorit 2020.

- Për llogarinë 44 “Institucione të tjera publike”, vlera 3,000 lekë i përket NJA Shale vlerë e cila është trashëguar në momentin e bashkimit, kjo në zbatim të reformës territoriale VKM nr 510, datë 10.06.2015 “ Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territorial”, ku për të cilën nuk ka asnjë dokumentacion të qartë. Kjo shumë rezulton në aktivin e bilancit si detyrim i këshillit të qarkut për ish komunën Shalë dhe në pasivin e bilancit si detyrim i kësaj ish komune ndaj shtetit.

-Për llogarinë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” Drejtoria e Financës nuk disponon asnjë procedure likuidimi për 5% garanci, ndaj Subjekteve. Kërkesat për likudim 5% vijnë kryesisht nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes se Investimeve. Drejtoria e Financës bën ekzekutimin pas verifikimit dhe kontrollit të dokumentacionit dorëzuar nga drejtoria që ndjek Investimet, si: (Urdhri për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzim të punimeve pas përfundimit të garancisë teknike,, pasi komisioni verifikon dhe inspekon gjendjen e objekt bën informacion mbi gjendjen teknike të objektit duke ia dërguar Titullarit, dhe në fund hartohet Çertifikata e marrjes në dorëzim përfundimtare apo Proces-verbali përfundimtar i marrjes në dorëzim, kjo në varësi të fushës së objektit, nëse është rikonstruksion apo blerje paisje.

Kryetari i Bashkisë ka nxjerre urdhrin e brëndshem nr.982 prot, dt 12.12.2017, mbi zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar. Të gjitha detyrimet me efekte financiare, janë kontabilizuar nga Drejtoria Financës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit nuk merren në konsideratë pasi:

Për llogarinë 202 “Aktive Afatgjata jo materiale” nuk është sistemuar gjatë vitit 2018, vlera 25,718,512 lekë që i përkasin studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investimet e kryera në periudhën para vitit 2017, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara, Ju e keni sistemuar gjatë vitit 2019 që i përket pasqyrave Financiare të vitit 2019. Ju e keni zbatuara para afatit sistemimin e vlerës së kësaj llogarie.

Për llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave gjatë vitit 2018, në vijim kur të kryhet sipas komenteve Tuaja veprimet do të regjistrohen në vitet në vijim dhe do të pasqyrohen në pasqyrat financiare të viteve në vijim.

Për llogarinë 44 “Institucione të tjera publike”, nuk është sistemuar vlera prej 3,000 lekë, e cila duhet të derdhet në buxhet të shtetit, pasi përfaqson detyrime të Bashkisë, ndaj shtetit të trashëguar nga Nj A Shalë, kur ta derdhni në buxhet atëhere quhet e sistemuar llogari e pozicionit financiar.

Për llogarinë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, vlera 8,059,901 lekë, duhet të sistemohet, pasi janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2016. Kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin bashkangjitur për këtë qëllim. Bashkëpunimi midis zyrave të Bashkisë dhe konkretisht me zyrën e Shërbimeve e mundëson sistemimin e kësaj llogarie.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Znj.B. M., me detyrë Drejtore e Financës.

Znj.M. D., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kontabilitetit.

D. MBI PLANIFIKIMIN DHE ZBATIMIN E KËRKESAVE TË LIGJIT NR. 9643, DATË 20.1.2006 "PËR PROKURIMIN PUBLIK" I NDRYSHUAR, VKM NR. 914, DATË 29.12.2014 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK" DHE UDHËZIMIN E APP NR. 2, DATË 24.04.2017 "PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT ME VLERË TË VOGËL".

D.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve;

D.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara;

D.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, fondit limit, vlerësimi i ofertave, shpallja e fituesit);

D.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave për mallra dhe shërbime deri marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe kontratave për punë publike deri në kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të tyre.

D.5. Opinion mbi prokurimin e fondeve në nivel institucional shoqëruar me një tabelë në lidhje me procedurat e prokurimit publik, objekti i prokuruar, lloji i procedurës, fondi limit, data dhe vlera e kontratës së lidhur, shtesat e kontratës, diferenca nga fondi limit, operatori ekonomik fitues dhe cila procedura e prokurimit është audituar nga grupi/audituesi i KLSH-së në vlerë dhe përqindje.

- MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2017.

Për auditimin e kësaj nënçështjeje u verifikuan:

- Përlllogaritja e nevojave, informacion nga Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor dhe Drejtoria e Financës;
- Programi buxhetor 2017-2019;
- Buxheti i vitit 2017, fishat mbi projektet;
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik dhe ndryshimet;

Nga auditimi rezultoi se:

- Programimi i këtyre nevojave është materializuar në paketën për Buxhetin e vitit 2018, e cila është trajtuar për çdo program dhe produkt sipas fishave bashkëngjitur VKB nr.8, datë 30.01.2017 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2017 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2019 të Bashkisë Shkodër". (evidenca bashkëngjitur Letrave të punës nr.2);
- Nga Bashkia Shkodër është hartuar Regjistri i parashikimeve për vitin 2017, i cili është depozituar në APP më datë 24.02.2017, pas miratimit të Buxhetit të vitit 2017 me VKB nr. 8, datë 30.01.2017.
- Gjithashtu, është bërë depozitimi i tyre në Degën e Thesarit Shkodër me shkresën nr. 2495, datë 22.02.2017;
- Regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve, janë hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik";
- Ndryshimet në regjistrin e parashikimit të prokurimeve rezultuan të mbështetura me fonde buxhetore përkatëse përpara se të bëhej ndryshimi përkatës. Në të gjitha rastet është vepruar sipas ligjit dhe akteve nënligjore për njoftimet në APP.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

D.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara:

Për auditimin e kësaj nënçështjeje u verifikuan:

- Buxheti i vitit 2017, miratuar me VKB nr. 8, datë 30.01.2017 “Për miratimin e buxhetit dhe Programit Buxhtor Afatmesëm përfundimtar 2018-2019 të Bashkisë Shkodër”;
- Plani përfundimtar (fillestar me ndryshime);
- Realizimi i Buxhetit të vitit 2017;
- Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike;
- Regjistri i realizimeve të prokurimeve publike.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2017, kanë ardhur nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera, donacione dhe te ardhura qe trashегоohen.

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksionet e reja, që i jane transferuar Bashkisë dhe transferta e kushtëzuar.

Tabela nr “Mbi realizimin e prokurimeve dhe financimin e tyre”

Prokurime	Parashikuar (Regjistri)		Realizuar		Diferenca	
	Numër	Vlerë 000/lekë	Numër	Vlerë 000/lekë	Numër	Vlerë 000/lekë
I. Mbi 800,000 lekë	102	481,190	62	213,653	40	267,537
Të hapur	23	197,363	5	52,685	18	144,678
Kërkesë për propozim	77	280,187	53	160,968	24	119,219
Konsulencë	2	8,438	-	-	-	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Sa më sipër, ka rezultuar se nga Bashkia Shkodër, për vitin 2017 parashikimi dhe realizimi i prokurimeve publike është kryer vetëm pasi janë vënë në dispozicion fondet buxhetore. Gjatë vitit 2017 nuk kanë rezultuar tejkalime të planit të buxhetit të miratuar.

Veprimet e mësipërme janë në përputhje me LPP, VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore”, me UMF nr. 2 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kapitulli III. “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike” “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pika nr. 140, ku cilësohet:

Kërkesa për shpenzim paraqitet nga drejtuesi funksional i aktivitetit të çdo niveli të njësisë /nënprogramit/ programit buxhtor, përgjegjës për realizimin e objektivave të planifikuara në kuadrin e programit respektiv buxhtor. Kërkuesi i shpenzimit nuk mund të kërkojë kryerje të shpenzimeve jashtë fondeve të kërkuara prej tij dhe të miratuara¹⁶ në procesin e planifikimit të buxhetit të njësisë sipas programeve buxhetore ku bën pjesë.

ligjin nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 40 “Shpenzimet”, pika 3, ku cilësohet:

Kryetari i bashkisë ose personat e autorizuar prej tij nuk lejohet të kryejnë shpenzime përtej shumës maksimale të shpenzimeve, të përcaktuar në zërin përkatës në buxhetin vjetor. Nuk

¹⁶ “Fond i miratuar” është kufiri maksimal i miratuar me ligjin të buxhetit vjetor ose me vendim të organeve vendimmarrëse të njësisë të qeverisjes vendore, brenda të cilit njësitë e qeverisjes së përgjithshme kanë të drejtë të bëjnë shpenzime.



lejohen shpenzime të fondeve nëse nuk ka fonde të mjaftueshme në gjendje në bashki për të mbështetur shpenzime të tilla.

D.3.1. Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të vlerësimit.

Përcaktimi i specifikimeve teknike:

Për 8 procedurat e audituara, përcaktimi i specifikimeve teknike është kryer nga shoqëri të licencuara dhe të kontraktuara nga AK.

Nga auditimi rezultoi se pjesë e dosjeve të prokurimit janë, Projekti teknik, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Grafiku i Punimeve, si dhe Preventivi sipas zërave dhe sasisë, në bazë të të cilave është bërë përlllogaritja e vlerësimit të kontratës.

Sa më sipër, është vepruar në përputhje me kërkesat e DT, bazuar në VKM, neni 11, pika 3, germa a, ku cilësohet:

Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe kostot;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.¹⁷

Përcaktimi i kritereve për kualifikim:

Nga NJP, kriteret e kualifikimit në përgjithësi janë përcaktuar në përputhje me LPP neni 46 dhe VKM nenin 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5, 6, 7 dhe 8.

- Kriteret e përgjithshme për kualifikim janë përcaktuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST.
- Kriteret e veçanta të kualifikimit në përgjithësi janë përcaktuar në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën limit të kontratës, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

Titulli i gjetjes nr.1: Mbi përcaktimin e kritereve për kualifikim.

Situata:

Nga auditimi i kryer në procedurën e prokurimit “**Rikonstruktion rruga Qyteza e Gajtanit**” lidhje me kriteret e kërkuara në DST, kapaciteti teknik, pika 5 rezultoi se OE ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) inxhinier ndërtimi/ inxhinier hidroteknik 1(nje)inxhinier topograf1 (nje)inxhinier elektrik 1 (nje)inxhinier mekanik 1(nje) inxhinier gjeolog

Sa më sipër nga krahasimi i kryer i preventivit të objektit rikonstruktion i rrugës Pjetër Spani me objektin rikonstruktion i rrugës së Gajtanit, rezulton se punimet të cilat do të kryen janë thuajse të njëjta, prej Njesisë së Prokurimit në DST e objektit rikonstruktion i rrugës Pjetër Spani është kërkuar që OE ofertues të ketë të punësuar të paktën 1 (nje) inxhinier

¹⁷ Kryer nga NJP



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

ndërtimi/ inxhinier hidroteknik, 1(nje)inxhinier topograf, 1(nje)inxhinier elektrik. Pra prej Njesisë së Prokurimit nuk specifikohet dhe arsyetohet se përse në objektin Rikonstruksion i Rugës Qyteza e Gajtanit janë kërkuar inxhinier mekanik dhe inxhinier gjeolog, veprime në papajtueshmëri me kërkesat e Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit

- Kriteri:** LPP, neni 1 "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa d, ku cilësohet:
"Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues, për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik".
- Shkaku:** Mosveprim në përputhje me rregullat e prokurimit publik.
- Ndikimi:** Ky veprim i NJP, mund të sjellë diferencim dhe vendosjen e OE në kushte jo të barabarta.
- Rëndësia:** Mesme
- Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme në të ardhmen, duke vendosur në Dokumentet e Tenderit, kërkesa të njëjta për përmbushjen e kriterëve të njëjta për kualifikim, nga ana e Operatorëve Ekonomikë.

Titulli i gjetjes nr.2: Mbi përcaktimin e kriterëve për kualifikim.

Situata:

Nga auditimi i kryer në sistemin elektronik në lidhje me procedurën e tenderit *“Mirëmbajtje e segmenteve Postribë, Bërdicë, Rrethina, Dajc (Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore ”* lidhur me plotësimin e dokumentacionit ligjor të paraqitur prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës, rezultoi se në pikën 2.3/5 kapaciteti teknik krahas inxhinierit të ndërtimit, inxhinierit topograf dhe atij të mjedisit, është kërkuar inxhinier mekanik, kriter i cili nuk ka lidhje me objektin pastrim dhe mirëmbajtje kanalesh, veprim i cili bie në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit

- Kriteri:** LPP, neni 1 "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa d, ku cilësohet:
"Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues, për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik".
Ky veprim është në kundërshtim me LPP nenin Neni 61 "Hartimi dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2 ku cilësohet:

"-Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

-Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre..."

Shkaku:

Mosveprim në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

Ndikimi:

Skualifikimi i OE, nga gara për një kriter i cili është i përmbushur nga ana e tyre, pavarësisht se nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar në DT, i cili rezulton të jetë i panevojshëm.

Rëndësia: (U/M/L)

Mesme

Rekomandimi:

Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme në të ardhmen, duke përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm dhe të duhur, për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, nga ana e Operatorëve Ekonomikë.

Titulli i gjetjes nr.3: Mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit

Situata:

Nga auditimi i kryer në sistemin elektronik në lidhje me procedurën e tenderit

"Skema ujitëse Bërdicë – Shkodër ". Nga auditimi i kryer në sistemin elektronik në lidhje me plotësimin e kriterëve të vendosura prej AK, rezultoi se BOE Sh. A. shpk & Rr. G. shpk kanë lidhur marrëdhënie kontraktuale sipas prokurës me nr.3158 Rep, Nr.1316 Kol, datë 20.05.2017 për tenderin me objekt "Skema Ujitëse Bërdicë-Shkodër", nga ku përcaktohen kompetencat dhe detyrimet e secilit Operatorë, referuar kësaj akt-marrvëshje punimet do të realizohen në masën 51% prej OE Rr. G. shpk dhe 49% do të realizohen nga OE Sh. A. shpk. Sa më sipër OE Rr. G. shpk ka paraqitur kontratë të ngjashme me nr.3/17 prot, datë 15.10.2015 për tenderin me objekt "Rikonstruksioni i Skarpateve të digës së Zajevës" në vlerën 14,447,170 lekë pa tvsh, kontratë në të cilën OE Rr. G. shpk e ka kryer në bashkëpunim me OE N. 2014 shpk. Nga auditimi i kryer në dokumentat e upload por edhe në kontratën e lidhur midis BOE OE Rr. G. shpk OE N. 2014 shpk nuk rezulton ndarja në % e punëve që do kryej secili operator. Gjithashtu rezulton se Rr. G. shpk ka paraqitur kontratë të ngjashme në bashkëpunim me N. shpk, për objektin Riparim i kanalit të Shtoderit Komuna Postrib me vlerë 4,917,648 lekë pa tvsh, nga ku puna që ka kryer Rr. G. është 76% e totalit të punimeve pra në shumën 3,737,412. Referuar dokumentacionit të upload në sistem rezulton se BOE Sh. A. shpk & Rr. G. kanë paraqitur kontrata të ngjashme, si ndërtim shkollash, rrugësh, objekte të cilat nuk kanë lidhje me Objektin e tenderit "Skema ujitëse Bërdicë – Shkodër ". Procedura e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

tenderimit duhej të anullohej.

- Kriteri:** - VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3, ku cilësohet: *Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*
- Shkaku:** Mosvlerësim i KVO-së në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT.
- Ndikimi:** Kualifikim i padrejtë i OE, të cilët nuk kanë plotësuar të gjithë kriteret e përcaktuara në DT. **Procedura duhej të anullohej**
- Rëndësia: (U/M/L)** Mesme
- Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme në të ardhmen, duke përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm dhe të duhur, për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, nga ana e Operatorëve Ekonomikë.

Titulli i gjetjes nr.: **Mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit**
Situata:

Nga auditimi i kryer në sistemin elektronik në lidhje me procedurën e tenderit “*Rikonstrukcion rruga Dhimitër Frangu*”.

Operatori ekonomik fitues “*K. G. K.”sh.p.k*, ka paraqitur kontratë qeraje me nr.rep 383; nr.kol 281, datë 20.05.2015, mbajtur prej përfaqësuesit të kësaj shoqërie H. S., në cilësinë e qeramarrësit, dhe përfaqësuesit të shoqërisë A. A. shpk, në cilësinë e qeradhënësit, nga ku palët bien dakort për marrjen me qera të mjeteve tip Kamiona me targa SH...E, SH...D, SH...E, për një periudhë 5 vjecare, referuar kësaj aktmarrëveshje në sistemin elektronik janë upload dokumentacionet justifikuese lidhur me besueshmërinë ligjore dhe teknike të mjeteve, nga ku u konstatua se për mjetin tip Kamion me targa SH...E figurojnë Certifikatë nga QKR, fotot përkatëse të mjetit, siguracion nga A. Sh.a me nr.22, datë 04.10.2017 i vlefshëm deri më datë 03.10.2018, taksat vjetore të vitit 2017, certifikatë mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, e vlefshme deri më datë 09.10.2018, leje qarkullimi me nr.0331874. Nga auditimi i ushtruar rezultoi se për mjetin tip Kamion me targa SH...E mungon pulla e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, gjithashtu mungon certifikata e kryerjes së operacionit teknik (Tahograf Analog).

Për sa i përket dokumentacionit të dorëzuar në sistem për mjetin tip Kamion me targa SH...E u konstatua figurojnë Certifikatë nga QKR, fotot përkatëse të mjetit, siguracion nga A. Sh.a me nr.15, datë 06.07.2017 i vlefshëm deri më datë 05.07.2018, taksat vjetore të vitit 2017, certifikatë mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, e vlefshme deri më datë 09.10.2018, leje qarkullimi me nr.0520671.

Nga auditimi i ushtruar rezultoi se për mjetin tip Kamion me targa SH...E mungon pulla e kontrollit teknik të mjeteve rrugore si dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

certifikata e lëshuar nga SGS është jo e dukshme, gjithashtu mungon certifikata e kryerjes së operacionit teknik (Tahograf Analog).

Kriteri:	- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3, ku cilësohet: <i>Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.</i>
Shkaku:	Mosvlerësim i KVO-së në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT.
Ndikimi:	Kualifikim i padrejtë i OE, të cilët nuk kanë plotësuar të gjithë kriteret e përcaktuara në DT. Procedura duhej të anulohet
Rëndësia: (U/M/L)	Mesme
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme në të ardhmen, duke përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm dhe të duhur, për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, nga ana e Operatorëve Ekonomikë.

Nga auditimi I ushtruar në dosjet përkatëse si dhe në sistemin elektronik për 4 procedura tenderimi, nuk u paraqitën mangësi apo shkelje ligjore si në llogaritjen e fondit limit ashtu edhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht :

1. Në tenderin me objekt *“Shërbimi I Pastrimit në Guri I Zi, Bërdicë dhe ana e Malit ”* me fond limit 9,256,136 lekë, tender I cili është fituar prej OE B. 2000 shpk me ofertë 7,206,600 lekë pa tvsh nga ku është lidhur kontrata me nr. 3715/29 prot, datë 28.02.2017.

2. Në tenderin me objekt *“Blerje kazane shërbimi i pastrimit ”*, me fond limit 7,433,300 lekë pa tvsh, tender I cili është fituar prej OE “N.N.Z.K Shkodra” Shpk me ofertë 7,070,700lekë pa tvsh, nga ku është lidhur kontrata me nr.14731/45 prot,datë 27.02.2018.

3. Në tenderin me objekt *“Blerje Dru zjarri ”* me fond limit 11,159,802 lekë pa tvsh, tender I cili është fituar prej OE “D. I.” shpk me ofertë 11,140,491 lekë pa tvsh, nga ku është lidhur kontrata me nr.10372/16 prot,datë 20.10.2017.

4. Në tenderin me objekt *“Rikonstruksion rruga Sami Repishti ”*, me fond limit 8,236,632 lekë pa tvsh, tender I cili është fituar nga OE “Rr. G.” shpk, nga ku është lidhur kontrata me nr.15051/16 prot,datë 18.12.2017.

Lidhur me sa më sipër janë mbajtur aktkonstatimet nr.19, 20, 21 dhe 22, datë 09.08.2019

- MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2018.

D.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve, për vitin 2018:

Për auditimin e kësaj nënçështjeje u verifikuan:

- Përlllogaritja e nevojave, informacion nga Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor dhe Drejtoria e Financës;
- Programi buxhetor 2018-2020;
- Buxheti i vitit 2018, fishat mbi projektet;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik dhe ndryshimet;

Nga auditimi rezultoi se:

- Programimi i këtyre nevojave është materializuar në paketën për Buxhetin e vitit 2018, e cila është trajtuar për çdo program dhe produkt sipas fishave bashkëngjitur VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2018 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 të Bashkisë Shkodër”. (evidenca bashkëngjitur Letrave të punës nr.2);
- Nga Bashkia Shkodër është hartuar Regjistri i parashikimeve për vitin 2018, i cili është depozituar në APP më datë 10.01.2018, pas miratimit të Buxhetit të vitit 2018 me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, si dhe brenda afatit të përcaktuar në LPP neni 4 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, pika 3 ku cilësohet:

Organet e pushtetit vendor, ndërmarrjet shtetërore apo çdo autoritet kontraktor tjetër jobuxhetor përgatitin regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit apo planit të blerjeve nga këshillat vendorë ose nga organet drejtuese përkatëse.

- Gjithashtu, është bërë depozitimi i tyre në Degën e Thesarit Shkodër me shkresën nr. 1251, datë 26.01.2018;
- Regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve, janë hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”;
- Ndryshimet në regjistrin e parashikimit të prokurimeve rezultuan të mbështetura me fonde buxhetore përkatëse përpara se të bëhej ndryshimi përkatës. Në të gjitha rastet është vepruar sipas ligjit dhe akteve nënligjore për njoftimet në APP.

Tabela nr.1 “Mbi regjistrat e prokurimeve”

Regjistri i prokurimeve								
Parashikimit		Realizimit		Nr	Ndyshimet në regjistër		Angazhimi i fondeve ¹⁸	
Nr.	Datë	Nr.	Datë		Nr.	Datë	Nr.	Datë
1251	26.01.2018		20.02.2019	1	11493	13.07.2018	208	26.09.2018
				2	11154	10.07.2018	218	12.10.2018
				3	10080	22.06.2018	206	18.09.2018
				4	4410	27.03.2018	207	18.09.2018
				5	11907	12.10.2018	202	31.08.2019
				6	15180	19.09.2018	201	28.08.2018
				7	16179	03.10.2018	197	16.08.2018
1	Rikonstruksion i rruges "Rragam – Sheldi" Loti 1			8	15366	24.09.2018	187	03.08.2018
2	Rikonstruksion i Rrugës së Malësorëve të Mullirit			9	14590	10.09.2018	186	02.08.2018
3	Rikonstruksion rruga "Vllaznimi"			10	14167	31.08.2018	184	23.07.2018
4	Rikonstruksion Rruga Gjergj Jakin Berdice e Siperme, rruga e			11	14168	31.08.2018	154	26.06.2018

¹⁸ Vendimet perkatëse



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	Palokajve Berdise e Madhe							
5	Shërbime riparimi të akseve të rrugëve			12	12696	08.08.2018	150	22.06.2018
				13	13375	15.08.2018		
				14	8405	29.05.2018		
				15	11772	18.07.2018		
				16	11773	18.07.2018	13526	13.07.2018

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

D.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara:

Për auditimin e kësaj nënçështjeje u verifikuan:

- Buxheti i vitit 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për miratimin e buxhetit dhe Programit Buxhtor Afatmesëm përfundimtar 2018-2020 të Bashkisë Shkodër”;
- Plani përfundimtar (fillestar me ndryshime);
- Realizimi i Buxhetit të vitit 2018;
- Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike;
- Regjistri i realizimeve të prokurimeve publike.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2018, kanë ardhur nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera, donacione dhe te ardhura qe trashегоhen. Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Buxheti i vitit 2018, ne total nga të gjitha burimet e financimit te realizuara, paraqitet:

Tabela nr. 2 “Burimet e financimit”

Nr	Emertimi	Vlera në 000/lekë
	Të ardhurat e veta	702,144
	Grante ndërkombëtare	47,904
	Transfertat	1,931,874
	Të trashëguara	708,562
	Totali të ardhura	3,390,484
	Total shpenzime	3,128,729
	Realizimi në%	92

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Tabela nr. 3 “Buxhetimi i prokurimeve për vitin 2018” 000/lekë

Prokurime	Viti	Programuar në buxhetin e vitit 2018	Sipas Regjistrit të Parashikimeve	Diferenca
Mbi 800 mijë lekë	2018	1,897,585	1,743,142	154,443
Nën 800 mijë lekë	2018	36,982	30,818	6,164
Totali		1,934,567	1,773,960	160,049

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Tabela nr. 4 “Mbi realizimin e prokurimeve dhe financimin e tyre”

Prokurime	Parashikuar (Regjistri)		Buxhetuar në 2018	Diferenca	Realizuar		Diferenca	
	Numër	Vlerë 000/lekë	Vlerë 000/lekë	Vlerë 000/lekë	Numër	Vlerë 000/lekë	Numër	Vlerë 000/lekë
I. Mbi 800,000 lekë	133	1,743,142	1,897,585	154,443	98	616,757	35	1,121,204
Të hapur	25	1,362,154	1,440,399	78,245	19	366,262	6	955,511
Kërkesë për propozim	94	340,848	409,018	68,170	71	215,585	25	120,463
Negocim pa shpallje	1	27,015	32,418	5,403	1	26,985	-	30
Konsulencë	13	13,125	15,750	2,625	7	7,925	6	5,200

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Sa më sipër, ka rezultuar se nga Bashkia Shkodër, për vitin 2018 parashikimi dhe realizimi i prokurimeve publike është kryer vetëm pasi janë vënë në dispozicion fondet buxhetore. Gjatë vitit 2018 nuk kanë rezultuar tejkalime të planit të buxhetit të miratuar.

Veprimet e mësipërme janë në përputhje me LPP, VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore”, me UMF nr. 2 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kapitulli III. “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike” “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pika nr. 140, ku cilësohet:

Kërkesa për shpenzim paraqitet nga drejtuesi funksional i aktivitetit të çdo niveli të njësisë /nënprogramit/ programit buxhetor, përgjegjës për realizimin e objektivave të planifikuara në kuadrin e programit respektiv buxhetor. Kërkuesi i shpenzimit nuk mund të kërkojë kryerje të shpenzimeve jashtë fondeve të kërkuara prej tij dhe të miratuara¹⁹ në procesin e planifikimit të buxhetit të njësisë sipas programeve buxhetore ku bën pjesë.

ligjin nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 40 “Shpenzimet”, pika 3, ku cilësohet:

Kryetari i bashkisë ose personat e autorizuar prej tij nuk lejohet të kryejnë shpenzime përtej shumës maksimale të shpenzimeve, të përcaktuar në zërin përkatës në buxhetin vjetor. Nuk lejohen shpenzime të fondeve nëse nuk ka fonde të mjaftueshme në gjendje në bashki për të mbështetur shpenzime të tilla.

Për sa është trajtuar në pikën D1 dhe D2, sipas Programit të auditimit është mbajtur Aktkonstatimin nr. 6 dhe 7, datë 31.07.2019.

D.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, përlllogaritja e fondit limit, vlerësimi i ofertave, shpallja e fituesit);

D.3.1. Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit.

Përcaktimi i specifikimeve teknike:

Për 20 procedurat e audituara, përcaktimi i specifikimeve teknike është kryer nga shoqëri të licencuara dhe të kontraktuara nga AK.

¹⁹ “Fond i miratuar” është kufiri maksimal i miratuar me ligjin të buxhetit vjetor ose me vendim të organeve vendimmarrëse të njësisë të qeverisjes vendore, brenda të cilit njësitë e qeverisjes së përgjithshme kanë të drejtë të bëjnë shpenzime.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Nga auditimi rezultoi se pjesë e dosjeve të prokurimit janë, Projekti teknik, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Grafiku i Punimeve, si dhe Preventivi sipas zërave dhe sasisë, në bazë të të cilave është bërë përllogaritja e vlerës limit të kontratës.

Sa më sipër, është vepruar në përputhje me kërkesat e DT, bazuar në VKM, neni 11, pika 3, germa a, ku cilësohet:

Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- *projektin dhe specifikimet;*
- *preventivin e hollësishëm dhe kostot;*
- *grafikun e zbatimit;*
- *kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.²⁰*

Përcaktimi i kriterëve për kualifikim:

Nga NJP, kriteret e kualifikimit në përgjithësi janë përcaktuar në përputhje me LPP neni 46 dhe VKM nenin 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5, 6, 7 dhe 8.

- Kriteret e përgjithshme për kualifikim janë përcaktuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST.
- Kriteret e veçanta të kualifikimit në përgjithësi janë përcaktuar në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën limit të kontratës, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

Titulli i gjetjes nr.1: Mbi përcaktimin e kriterëve për kualifikim.

Situata:

Përsa i përket “Kapacitetit teknik”, u evidentua fakti se NJP, nuk ka përdorur të njëjtin standard mbi dokumentacionin që duhet të paraqitet nga OE, për automjetin “Autobitumatriçe”. Në DT pika 2.3. “Kapaciteti teknik” në disa raste (procedura) është kërkuar që OE të paraqesë “Certifikatë transporti për mallrat të rrezikshëm” dhe në disa procedura nuk është vendosur ky kriter. Konkretisht, në procedurën me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Hidrovor Dobraq”, “Asfaltim i Rrugës Oblikë-Obot”, “Rikonstruksion Rruga Tepe-Vasijet”, “Rikonstruksion Rruga Tepe-Vasijet” etj, nuk është kërkuar dhe në “Rikonstruksion i Rrugës Lugoçesme” “Rruga Rragam-Sheldi”, “Rruga Vllaznimi” etj., është kërkuar.

Kriteri:

LPP, neni 1 "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa d, ku cilësohet:

"Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues, për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik".

LPP, neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1 ku cilësohet:

"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese".

²⁰ Kryer nga NJP



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Shkaku:	Mosveprim në përputhje me rregullat e prokurimit publik.
Ndikimi:	Ky veprim i NJP, mund të sjellë diferencim dhe vendosjen e OE në kushte jo të barabarta.
Rëndësia:	Mesme
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme në të ardhmen, duke vendosur në Dokumentet e Tenderit, kërkesa të njëjta për përmbushjen e kriterëve të njëjta për kualifikim, nga ana e Operatorëve Ekonomikë.

Titulli i gjetjes nr.2: Mbi përcaktimin e kriterëve për kualifikim.

Situata:	<p>Përsa i përket “Kapacitetit teknik”, nga NJP, në DT për të përmbushur kriteret mbi automjetet, është kërkuar një sërë dokumentacioni ku bën pjesë edhe pagesave e taksave.</p> <p>Kjo kërkesë e NJP, është e panevojshme, pasi paraqitja ose jo e mandatit mbi pagesën e taksave nuk sjell asnjë dobi, veçse bëhet shkak për skualifikim të padrejtë të OE. Fakti që duhet të paraqitet certifikata mbi kontrollin teknik të mjetit, është shterues edhe për dokumentet e mëposhtme:</p> <p>Për kryerjen e kontrollit teknik të mjeteve (dokument i kërkuar në çdo DT), duhet të përmbushet paraprakisht²¹:</p> <p><i>Leje qarkullimi të vlefshme dhe plotësuar saktë në të gjitha rubrikat e saj Dokument i lëshuar nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor që vërteton shlyerjen e detyrimeve pranë këtij institucioni</i></p> <p><i>Kontratë të vlefshme të sigurimit TPL lëshuar nga kompanitë e sigurimit, sillet dhe lihet kopje ose fotokopje në recepsionin e pranimit</i></p> <p><i>Çelësat e automjetit</i></p> <p><i>Për mjetet me tahograf, lihet kopje e çertifikatës së kalibrimit të tahografit</i></p> <p>Sa më sipër, NJP, ka vendosur kërkesa të panevojshme mbi përmbushjen e kriterëve për kapacitetin teknik.</p>
Kriteri:	<p>Ky veprim është në kundërshtim me LPP nenin Neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2 ku cilësohet:</p> <p><i>"-Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.</i></p> <p><i>-Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre..."</i></p>
Shkaku:	Mosveprim në përputhje me rregullat e prokurimit publik.
Ndikimi:	Skualifikimi i OE, nga gara për një kriter i cili është i përmbushur nga ana e tyre, pavarësisht se nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar në DT, i cili rezulton të jetë i panevojshëm.

²¹ SGS "Kontrolli Teknik i Automjeteve"



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Rëndësia: (U/M/L) Mesme
Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme në të ardhmen, duke përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm dhe të duhur, për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, nga ana e Operatorëve Ekonomikë.

Titulli i gjetjes nr.3: Mbi përcaktimin e kriterëve për kualifikim.

Situata: Përsa i përket përmbushjes së kriterit “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, NJP ka kërkuar që OE të paraqesin xhiro mesatare të tre viteve (2014, 2015 dhe 2016), ndërkohë që procedura do të zhvillohet më vitin 2018. Përsa i përket xhiros vjetore, NJP duhet të kërkonte të dhëna mbi xhiron vjetore të viteve 2015, 2016 dhe 2017 dhe pasqyrat financiare të viteve 2014, 2015 dhe 2016, në rast se procedurat zhvillohen përpara mbylljes dhe dorëzimit të pasqyrave financiare në administratën tatimore deri në 31.03.2018.

Kriteri: KVO duhet të përcaktojë kriterë të cilat vërtetojnë kapacitetin ekonomik sa më koherent të OE, po ti referohemi LPP, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, germa c, ku cilësohet:

gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;

Shkaku: Arsyetim i NJP, me qëllim që Xhiro Vjetore dhe Pasqyrat Financiare ti përkisnin të njëjtës periudhë.

Ndikimi: AK, nuk merr informacion të saktë (koherent), në lidhje me gjendjen financiare të OE.

Rëndësia: (U/M/L) U

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit, për të vërtetuar gjendjen dhe kapacitetin ekonomik-financiar të OE pjesëmarrës në garë, duhet të kërkojnë vërtetim mbi Xhiron Vjetore, apo paraqitjen e Pasqyrave Financiare nga ana e OE, sa më afër kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

D.3.1/c. Mbi miratimin e DT dhe administrimin e dosjeve nga NJP:

- NJP, ka hartuar DT për çdo procedurë, në përputhje me DST, si dhe i ka miratuar ato nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim, veprim në përputhje me VKM, neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 1, ku cilësohet:

"Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit".

- DT, me përjashtim të një rasti, janë të firmosura në çdo faqe nga anëtarët e NJP, veprim në përputhje me VKM, neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, ku cilësohet:

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

- Nga NJP, është ndjekur dhe administruar dokumentacioni sipas kërkesave të LPP dhe VKM, neni "Neni 57 "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit", pika 3, ku cilësohet:

NJP është përgjegjëse:

"...Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;

Hartimin e urdhrit të prokurimit;

Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;

Hartimin dhe dërgimin e ftesave për pjesëmarrje kandidatëve të ftuar në një procedurë prokurimi, duke argumentuar përzgjedhjen e tyre;

Administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;..." etj.

Konkretisht pjesë e dosjeve të prokurimit ishte dokumentacioni i mëposhtëm:

- Shkresa për miratim të anagazhimit të fondeve;
- Procesverbali për "Përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës";
- Urdhëri i prokurimit publik;
- Procesverbali për "Hartimin dhe miratimin e DT", i mbajtur nga NJP;
- DT, të cilat janë hartuar sipas VKM, neni 11 "Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit".
- Miratim për botim i Njoftimit të Kontratës, nënshkruar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (TAK);
- Formulari i Njoftimit të Kontratës dërguar APP-së;
- Urdhër për ngritjen e KVO-së, nga TAK;
- Procesverbali për "Hapjen e ofertave", i mbajtur nga KVO;
- Procesverbali për "Vlerësimin e ofertave", i mbajtur nga KVO;
- "Kërkesë për analizë çmimesh (ofertë anomalisht e ulët)";
- Procesverbal i KVO-së, mbi shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga OE me ofertë anomalisht të ulët;
- Procesverbal "Mbi vlerësimin përfundimtar të ofertave";
- Vendim i KVO-së për kualifikimin;
- Raporti përmbledhës, mbajtur nga KVO;
- Miratimi i Raportit përmbledhës dhe shpallja e fituesit nga TAK;
- Formulari i Njoftimit të OE të sukseshëm në Marrëveshjen Kuadër;
- Kontratat;
- Shkresa Dërgim formular kontrate;
- Njoftimi kontrate në APP, Buletini
- Sigurimi i Kontratës;
- Projekti teknik;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

- Raporti teknik;
- Raporti i ndikimit në mjedis;
- Specifikimet teknike;
- Preventivi;
- Grafiku i punimeve;

Gjetje nga auditimi: Nuk është kryer inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të prokurimit për vitin 2018, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: z. E. D., Përgjegjësi i Njesisë së Prokurimit.

D.3.2. Mbi zhvillimin e procedurave, vlerësimin e ofertave dhe shpalljen e fituesit.

Procedurat e prokurimit “Tender i hapur” të audituara (viti 2018)

Nr.	Objekti i prokuruar	Fondi limit pa tvsh	Vlera e Kontratës pa tvsh	Diferenca në vlerë Fond/Kontratë	Operatori Ekonomik fitues
1	Asfaltim vazhdimi i rrugës Oblike - Obot	16,710,798.00	10,414,171.00	6,296,627.00	S. M. O. V.
2	Mirëmbajtje varreza publike dhe të dëshmorëve në Qytet dhe në NjA	25,199,967.00	24,942,096.00	257,871.00	B. V.
3	Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës	96,269,797.00	96,259,270.00	10,527.00	M.
4	Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit per komunitete te pafavorizuara, Bashkia Shkoder, Përmirësimi i shërbimeve bazë (Ndërtim rrjeti të ujit të pijshëm)	17,785,676.00	12,683,902.00	5,101,774.00	A. K.
5	Rikonstruksion i rruges "Rragam – Sheldi" Loti 1	16,638,245.00	11,696,127.00	4,942,118.00	S. M. O. V.
6	Rikonstruksion Rruga "Lugoçesme"	42,076,966.00	36,466,548.00	5,610,418.00	A. T.
7	Rikonstruksion rruga "Vllaznimi"	17,234,990.00	15,422,809.00	1,812,181.00	N.
8	Rikualifikim i terreneve sportive ne shkollat Oso Kuka Bashkia Shkoder Ana Malit, Oblik, At Gjon Korma, Guri Zi	37,585,085.00	26,226,219.00	11,358,866.00	G.
9	Rikualifikim Urban Blloqe Banimi “Qemal Draçini” (tek Sahati)	23,800,080.00	18,897,168.72	4,902,911.28	Rr. G.
10	“Rikualifikimi urban Blloqe banimi, “Bulevardi Zogu I” (Xhabije)”	15,766,715.00	11,045,648	4,721,067.00	BOE “L.” & “A. K.”
10	Totali	309,068,319.00	264,053,958.70	45,014,360.30	

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Dokumentacioni i shqyrtuar:

- Urdhrat e Titullarit të AK;
- Procesverbalet e mbajtura nga NJP dhe KVO, etj;
- Raporti përfundimtar;
- Korrespondenca me OE;
- Dokumentacioni i hedhur në SPE.

Konstatime të përgjithshme:

- Nga ana e Titullarit të AK, për çdo procedurë ka dalë vendim “Për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh”, duke u shprehur edhe për vendodhjen e tyre, numrin e pasurisë dhe posedimin e saj nga Bashkia Shkodër.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

- Me shkresat përkatëse për çdo procedurë është miratuar kërkesa për anagazhim fondesh e cila është nënshkruar nga NA znj. V. A., NZ znj. B. M. dhe struktura kërkuese, në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 140 dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 40 “Shpenzimet”, pika 3.
- Nga anëtarët e NJP janë plotësuar Deklaratat e konfliktit të interesit për çdo procedurë, gjithashtu edhe nga KVO, me përjashtim të tre rasteve.
- Për çdo procedurë të audituar ka rezultuar se nga AK, janë mbajtur procesverbalet përkatëse dhe Raporti përmbledhës, si dhe është lënë gjurmë për të gjithë procedurën e ndjekur, në përputhje me LPP, neni 12 “Përgjegjësitë e AK”, si dhe ligjin nr.10269, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime, neni 4, pika 10 “Gjurma e auditimit”;
- Në të gjitha rastet nga OE i shpallur fitues është bërë sigurimi i kontratës;
- Kryetarët e KVO-së, janë përzgjedhur nga niveli i lartë drejtues (N/Kryetar Bashkie dhe Përgjegjës të Njësisve Administrative, Bashkia Shkodër, veprim në përputhje me nenin 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, ku cilësohet: “...Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet **ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit...**”.

1. Mbi procedurën me objekt “Mirëmbajtje varreza publike dhe të Dëshmorëve në Qytet dhe Njësitë administrative viti 2018-2020”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje varreza publike dhe të Dëshmorëve”		
Urdhër Prokurimi nr. 300, datë 05.04.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 300, datë 05.04.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 301, datë 05.04.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur e llojit Marrëveshje kuadër.	E. D., Jurist D. K., Specialiste L. B., Specialiste	F. Sh., Kryetar J. G., Anëtar P. I., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 25,199,967 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 24,942,096 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 257,871 lekë
Data e hapjes së procedurës: 30.04.2018 ora 12.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 8.340.833 lekë.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 1 (një) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S'kualifikuar: -
Ankimime: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër

Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Hapur” i llojit “Marrëveshje kuadër” me një OE ku të gjitha kushtet e tjera janë të përcaktuara, për një periudhë tre vjeçare (2018-2020).

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit:

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, janë përcaktuar specifikimet teknike, si dhe është hartuar Raporti teknik. Specifikimet teknike janë përcaktuar bazuar në eksperiencat e mëparshme, duke qenë një shërbim periodik.

Mbi përlogaritjen e vlerësimit të kontratës.

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 25,199,967 lekë pa TVSH dhe 30,239,960 lekë me TVSH. Në përcaktimin e shërbimeve dhe çmimeve për njësi, grupi i punës është mbështetur në eksperiencën e mëparshme, si dhe në analizë kostoje, referuar VKM nr. 629,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2, ku cilësohet:

“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’ireferohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

çmimet e tregut;ose/dhe

çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”²².

Preventivi dhe oferta e paraqitur

Emërtimi	Njësi	Sasi	Çmimi		Vlera	
			P	O	P	O
A-Varrezat publike						
Mirembajtje e parcelave dhe ruageve brenda parcelave	m2	62,668	65	64	4,073,420	4,010,752
Mirembajtje e parcelave te reja	m2	15,000	65	64	975,000	960,000
Mbjellje bordure të gjelbër në parcelat e reja	ml	250	1,396	1,400	349,000	350,000
Mbjellje drure dekorative (selvi0 në parcelat e reja	copë	42	3,902	4,000	163,884	168,000
Roje varreza publike	persona	6	286,000	284,000	1,716,000	1,704,000
Mirembajtje rruge dhe sheshe, asfaltim	m2	100	1,740	1,750	174,025	175,000
Transport mbeturina 17 km	ton	120	1,278	1,339	153,360	160,680
Shuma A					7,604,689	7,528,432
B-Varrezat e Deshmorëve						
Rojet e varrezave		2	286,000	284,000	572,000	568,000
Lyerje me gëlqere dy herë nën vit	m2	1,900	48	45	91,200	85,500
Pastrim, heqje barnash, riparime suvatimi	m2	2,800	25	25	70,000	70,000
Mirembajtje varresh nga amortizimi, rifreskim germash	copë	69	900	900	62,100	62,100
Shuma B	lekë				795,300	785,600
Shuma A+B	lekë				8,399,989	8,314,032
TVSH 20%					1,679,998	1,662,806
Shuma me TVSH	lekë				10,079,987	9,976,838
Shuma pa TVSH per 36 muaj	lekë				25,199,967	24,942,096
TVSH 20%					5,039,993	4,988,419
Shuma me TVSH për 36 muaj	lekë				30,239,960	29,930,515

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga sa kemi konstatuar më lart, bën përjashtim përllogaritja e fondit për zërin “Roje varreza”, të trajtuar më poshtë:

Titulli i gjetjes nr.4: Mbi përllogaritjen e vlerës limit të kontratës (pagat e rojeve).

²² Ndryshuar me vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Situata	Nga shqyrtimi i zërave të preventivuar ka rezultuar se është përfshirë edhe pagesa për shërbim roje të varrezave publike dhe të dëshmorëve për 8 roje gjithsej në vlerën 2,288,000 lekë, ose 286,000 lekë në vit/roje, ose 23,833 lekë në muaj/roje. Sa më sipër rezulton se paga mujore për 8 roje është nën vlerën e pagës minimale të miratuar.
Kriteri	Vendimin nr. 399, datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi për viti 2018”, pika 1, 2, 3 dhe 4 ku cilësohet: “1. Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë. 2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. 3. Paga bazë minimale, orare, të jetë 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) lekë. 4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë”.
Shkaku	Mosveprim i personave përgjegjës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontartës në përputhje edhe me aktet e tjera ligjore.
Ndikimi	Në pagesën e rojeve nga OE, nën pagën minimale ligjore, duke cënuar të drejtën e punonjësve, por që mund të ndikojë edhe në cilësinë e këtij shërbimi.
Rëndësia (U/M/L)	U
Rekomandimi	-

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Personat përgjegjës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, znj. L. B. dhe z. B. F..

Mbi vlerësimin e ofertave

Në këtë procedurë prokurimi është paraqitur vetëm OE “B. V.” SHPK, me ofertë ekonomike në shumën 24,942,096 lekë.

Grupi i auditimit, nëpërmjet SPE, shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga OE dhe rezultoi se ishte në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DT, si dhe oferta ekonomike nuk rezulton anomalisht e ulët dhe me gabime materiale.

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP, VKM dhe DT.

2. Mbi procedurën me objekt “Rikonstruksion Rruga “Lugoçesme L=800 ml”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion Rruga “Lugoçesme L=800 ml”		
Urdhër Prokurimi nr. 777, datë 24.09.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 300, datë 05.04.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 778, datë 24.09.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur	E. D., Jurist D. K., Specialiste ing. E. D., Specialist ing.	V. P., Kryetar P. M., Anëtar J. V., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 42,076,966 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 36,466,548 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 5,610,418 lekë
Data e hapjes së procedurës: 26.10.2018 ora 12.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 15,814,166 lekë dhe 26,262,800 lekë me buxhetin e vitit 2019.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 12 (dymbëdhjetë) OE b. Kualifikuar: 4 (katër) OE c. S’kualifikuar: 8 (tetë) OE



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Ankimime: 1 (një)
Nga OE "N." SHPK

Përgjigje ankesës nga AK.: Me shkresën
nr. 19494/1, datë 23.11.2018

Përgjigje ankesës nga: Nuk është ankimuar në
KPP.

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i "Hapur" me vlerë 42,076,966 lekë, i cili do të financohet në dy vite buxhetore (2018-2019).

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit:

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria "C. R.Gj" SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Projekti teknik, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi sipas zërave, me vlerë totale 42,076,966 lekë pa TVSH dhe 50,492,359 lekë me TVSH. Në përcaktimin e shërbimeve dhe çmimeve për njësi, personi përgjegjës z. E. D. është mbështetur në analizën e çmimeve dhe çmimet e përcaktuara në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Kriteri: LPP neni 28 "Metodat e përlogaritjes së vlerës në kontratat publike" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2, ku cilësohet:

*"Në përlogaritjen e vlerësimit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'ireferohet një ose më shumë alternativavetë renditura si mëposhtë:
çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe
çmimet e tregut;ose/dhe
çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe
ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.
"Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlogaritjen e vlerësimit të kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".*

Grupi i auditimit, me zgjedhje për disa nga zërat me peshë më të madhe në vlerën limit të kontratës, krahasoi çmimet sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" me ato të preventivuara, nga ku nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.87/a	312	312	0
3.89/b	332	332	0
3.124/1a	2,945	2,945	0
3.158/5a	266	266	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

3.210	823	823	0
3.212/b	449	449	0
3.243	11,105	11,105	0
3.228/1	1,085	1,085	0
3.231/1	993	993	0
3.An/1t	1,960	1,960	0
3.An/2t	2,827	2,827	0
3.242	10,537	10,537	0
3.63-3.626 ²³	1,182	1,182	0
3.617 ²⁴	959	1,180	0
3.621	669	669	0
2.491/t ²⁵	566	447	0
3.An/53	19,044	19,044	0
An.151	1,442	1,442	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 12 OE, nga të cilët janë kualifikuar 4 dhe janë skualifikuar 8 OE.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“N.” SHPK & “K.” SHPK	25,203,455
2	“R. 2008” SHPK	28,235,096
3	“N.” SHPK	28,345,044
4	“D. I.” SHPK & “Z.” SHPK	33,294,555
5	“K. G. K.” SHPK & “A.” SHPK	33,208,020
6	“S. M. O. U.” SHPK & “S.M.O. V.” SHPK	33,388,641
7	“P.V.K.” SHPK	35,344,652
8	“B.” SHPK & “A.” SHPK	36,107,726
9	“A.” SHPK	36,466,548
10	“Sh. A.” SHPK	36,555,760
11	“A. K.” SHPK	37,716,210
12	“L.” SHPK	37,701,950

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në DT dhe janë skualifikuar:

Nr.	OE të skualifikuar	Vlera e Ofertës
1	“N.” SHPK & “K.” SHPK	25,203,455
2	“D. I.” SHPK & “Z.” SHPK	33,294,555
3	“K. G. K.” SHPK & “A.” SHPK	33,208,020
4	“S. M. O. U.” SHPK & “S.M.O. V.” SHPK	33,388,641
5	“P.V.K.” SHPK	35,344,652
6	“B.” SHPK & “A.” SHPK	36,107,726

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofertave në SPE për OE të skualifikuar me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, nga ku rezultoi se për OE të mësipërm KVO ka vepruar

²³ Përshkrimi sipas Manualit “H / Izolim me emulsion, 2 K. Katr. .importi cilesia 1”

Përshkrimi sipas preventivit “Hidroizolim i sforcuar i tubave metalik ekzistues të ujësjellësit”

²⁴ Përshkrimi sipas Manualit “Bordura betoni 15x35...”

Përshkrimi sipas Preventivit “Bordura betoni 15x25...”

²⁵ Përshkrimi sipas Manualit “FV Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=63mm, Pn 16”

Përshkrimi sipas Preventivit “FV Tub e rakorderi ujësjellësi PE100, d=63, t=4.7mm, PN10”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

në përputhje me VKM neni 66, pasi OE nuk kanë plotësuar disa prej kriterëve të përcaktuara në DT.

Kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në DT dhe janë kualifikuar:

Nr.	OE të kualifikuar	Vlera e Ofertës
1	“R. 2008” SHPK	28,235,096
2	“N.” SHPK	28,345,044
3	“A.” SHPK	36,466,548
4	“Sh. A.” SHPK	36,555,760
5	“A. K.” SHPK	37,716,210
6	“L.” SHPK	37,701,950

Nga KVO, ofertat ekonomike të OE R. SHPK dhe “N.” SHPK, të kualifikuara përsa i përket plotësisimit të kriterëve, janë cilësuar anomalisht të ulëta, veprim në përputhje me VKM, neni 66. (Vlera e tyre 28,235,096 dhe 28,345,044 është më e vogël se 85 % e mesatares së ofertave të vlefshme në garë, e cila është 29,044,586 lekë).

Nga AK, ju është kërkuar sqarim OE, mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, por nga ana e tyre nuk është paraqitur asnjë material sqarues.

Titulli i gjetjes nr. 5: Mbi vlerësimin e plotësisimit të kriterëve nga KVO.

Situata

Nga këqyrja e dokumentacionit në SPE, të **OE të shpallur fitues “A.” SHPK**, ka rezultuar se në dokumentacionin e paraqitur për automjetin Autobitumatriçe mungon Certifikata për transport mallrash të rrezikshëm, duke mos plotësuar kriterin 2.3.11/iv, ku cilësohet:

“Mjetet e transportit për mallrat e klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi si të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme)”.

Në shqyrtimin që KVO i ka bërë dokumentacionit të OE “N.” SHPK & “K.” SHPK, sipas Raportit përmbledhës nr. 15556/3, datë 03.12.2018, faqe 4, ku ka renditur kriteret të cilat nuk ka plotësuar ky OE, ku ndër të tjera është është shprehur se:

“Për mjetin autobitumatriçe me targa KO3347B nuk keni paraqitur certifikatë transporti për mallra të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse”.

OE “A.” SHPK, është kualifikuar nga KVO, pa përmbushur kriteret për kualifikim.

Kriteri

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3, ku cilësohet: *Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Shkaku Ndikimi

Mosvlerësim i ofertave nga KVO në përputhje me rregullat e PP.

KVO, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm për të njëjtën çështje, duke favorizuar kualifikimin e OE “A.” dhe kualifikuar pa përmbushur kriteret e DT.

Rëndësia (U/M/L)

M

Rekomandimi

-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Anëtarët e KVO-së, të cilët kanë vepruar me dy standarde në vlerësimin e përmbushjes së kriterit për kapacitetin teknik dhe kanë kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A." pa përmbushur kriteret për kualifikim.

3. Mbi procedurën me objekt “Rikualifikim i terreneve sportive”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikualifikim i terreneve sportive”		
Urdhër Prokurimi nr. 747, datë 12.09.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 747, datë 12.09.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 748, datë 12.09.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur	E. D., Jurist D. K., Specialiste ing. Xh. R. Specialist ing.	E. K., Kryetar Gj. Gj., Anëtar specialist fushe J. D., Anëtar ekonomiste
Fondi limit pa tvsh: 37,585,085 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 26,226,219 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 11,358,866 lekë
Data e hapjes së procedurës: 15.10.2018 ora 10.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 11,275,525 lekë dhe FZHR me Vendimin nr. 7, datë 11.05.2018 për vlerën 21,423,498 lekë.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 11 (njëmbëdhjetë) OE b. Kualifikuar: 10 (dhjetë) OE c. S’kualifikuar: 1 (një) OE
Ankimime: 1 (një) Nga OE “N.” SHPK	Përgjigje ankesës nga AK: Me shkresën nr. 19494/1, datë 23.11.2018	Përgjigje ankesës nga KPP: Nuk është pranuar për shqyrtim ankimimi nga KPP.

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Hapur” me vlerë 37,585,085 lekë, i cili do të financohet në periudhën buxhetore (2018-2020).

Financimi sipas burimit:

Bashkia Shkodër	11,275,525 lekë;
Fondi i Zhvillimit të Rajoneve	26,309,560 lekë;
Totali:	37,585,085 lekë

Financimi sipas periudhave:

Në vitin 2018	16,161,587 lekë;
Në vitin 2019	21,423,498 lekë;
Totali:	37,585,085 lekë

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit:

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria “C. R.Gj” SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi sipas zërave nga OE me vlerë totale 37,585,085 lekë pa TVSH dhe 45,102,102 lekë me TVSH. Në përcaktimin e shërbimeve dhe çmimeve për njësi, personat përgjegjës znj. Xh. R. dhe E.S. janë mbështetur në analizën e çmimeve dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

çmimet e përcaktuara në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Shkolla e Mesme e Përgjithshme Oblikë:	5,470,610 lekë
Shkolla e Mesme e Përgjithshme “Oso Kuka”	12,776,537 lekë
Shkolla e Mesme e Bashkuar “At Gjon karma”	19,337,588 lekë
Totali:	37,585,085 lekë

Personat përgjegjës për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, kanë vepruar në përputhje me LPP neni 28 “Metodat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2, ku cilësohet:

“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’ireferohet një ose më shumë alternativavetë renditura si mëposhtë:

çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

çmimet e tregut;ose/dhe

çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Grupi i auditimit, me zgjedhje për disa nga zërat me peshë më të madhe në vlerën limit të kontratës, krahasoi çmimet sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara, duke verifikuar paraprakisht përmbajtjen e zërave të punimeve, nga ku nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.210	823	823	0
3.212/b	449	449	0
3.226/1	1,397	1,397	0
2.182	135,111	135,111	0
3.228/1	1,085	1,085	0
3.231/1	993	993	0
2.110/2	7,913	7,913	0
3.241	10,697	10,697	0
3.617/1	1,043	1,043	0
3.An/et	1,087	1,087	0
2.114/1	8,398	8,398	0
2.291	623	623	0
3.An/53	19,044	19,044	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 11 OE, nga të cilët janë kualifikuar 9 dhe janë skualifikuar 2 OE.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“D. I.” SHPK	2,893,836
2	“N.” SHPK	24,522,498
3	“G.” SHPK	26,226,219
4	“Rr. G.” SHPK	27,211,688
5	“S.M.O. V.” SHPK	28,602,211
6	“B.” SHPK	29,581,608
7	“K. G. K.” SHPK & “A.” SHPK	29,587,197
8	“P.V.K.” SHPK	31,195,622
9	“A.” SHPK	33,445,392
10	“A. K.” SHPK	33,762,913
11	“B.” SHPK	35,019,475

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofertës në SPE për OE të skualifikuar me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, nga ku rezultoi:

- OE “D. I.” SHPK, është skualifikuar në përputhje me LPP dhe VKM, pasi ka paraqitur OE që nuk i përket kësaj procedure.

- OE “N.” SHPK, ka paraqitur OE anomalisht të ulët. Nga AK janë kërkuar sqarime, të cilat OE i ka paraqitur brenda afatit tre ditor, por që nuk kanë justifikuar çmimet anomalisht të ulëta. Analiza e çmimeve nuk është shoqëruar me faturat përkatëse, për një sërë zërash të kërkuar nga AK.

Sa më sipër, AK me të drejtë ka skualifikuar OE, “N.” SHPK, i cili më pas ka paraqitur ankimim në AK dhe KPP, i cili nuk e ka marrë në shqyrtim ankesën e tij.

AK, ka vendosur skualifikimin e tij, duke shpallur fitues OE “G.” SHPK, i cili ka përmbushur kriteret kualifikuese dhe ka paraqitur OE me çmim më të ulët”

Sa më sipër KVO, referuar kriterit të kualifikimit “çmimi më i ulët”, ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “G.” SHPK.

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP, VKM dhe DT.

4. Mbi procedurën me objekt “Shërbimi i gjelbërimit në Bashkinë Shkodër”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbimi i gjelbërimit në Bashkinë Shkodër”		
Urdhër Prokurimi nr. 353, datë 02.05.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 353, datë 02.05.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 354, datë 02.05.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur “Marrëveshje kuadër”	E. D., Jurist D. K., Specialiste ing. L. B., Specialiste e fushës	D. M., Kryetar J. G., Anëtar P. I., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 96,269,797 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 96,259,270 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 10,527 lekë
Data e hapjes së procedurës: 15.10.2018 ora 10.00 Ndryshuar në 04.06.2018	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 116,823,000 lekë me TVSH.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 1 OE b. Kualifikuar: 1 OE c. S’kualifikuar: -
Ankimime: -	Përgjigje ankesës nga AK: -	Përgjigje ankesës nga KPP: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Kjo procedurë është tender i “Hapur” i llojit “Marrëveshje kuadër” me një OE ku të gjitha kushtet e tjera janë të përcaktuara, për një periudhë tre vjeçare (2018-2021), bazuar në nenin 47 “Llojet e marrëveshjes kuadër” pika 1 Marrëveshja kuadër mund të lidhet me: germa a, ku përcaktohet: “një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”;

Financimi sipas periudhave:

Në vitin 2018 23,908,388 lekë;

Në vitin 2019 31,108,333 lekë

Në vitin 2020 31,716,667 lekë;

Në vitin 2021 9,536,409 lekë

Totali: 96,269,797 lekë

Kjo procedurë është prokuruar për vlerë të plotë në përputhje me nenin 28 “Metodat e përlogaritjes së vlerës në kontratat publike”.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit:

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga personat përgjegjës L. B., B. F. dhe I. H.. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi dhe Grafiku i shërbimeve.

Personat përgjegjës, për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit kanë vepruar në përputhje me LPP, neni 23 “Specifikimet teknike” dhe 28 “Kontratat e shërbimeve”.

Mbi përlogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi ka përcaktuar specifikimet teknike, ka hartuar preventivin sipas zërave. Në përcaktimin e shërbimeve dhe çmimeve për njësi, Grupi i punës është mbështetur në analizën e çmimeve (An-1/An-6), analizat nga eksperiencat e mëparshme, duke qenë se ky është një shërbim periodik dhe (3-164/3-165/3-7/3-2) nga Manuali i miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015.

Grupi i punës, ka vepruar në përputhje me LPP neni 28 “Metodat e përlogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2.

Nga grupi i auditimit, u auditua me zgjedhje mënyra e përlogaritjes së çmimit për njësi të disa shërbimeve, të cilët zënë peshën specifike më të lartë, ndaj totalit të shërbimit, nga u konstatua se:

Emërtimi	Preventivi	Manuali Eksperiencat	Diferenca
3-164	2,340	2,340	0
3-165	504	504	0
3-7	34	34	0
3-2	14	14	0
An.1	190	190	0
An.2	227	227	0
An.3	248	248	0
An.4	282	282	0
An.5	313	313	0
An.6	380	380	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”, ka paraqitur interes dhe ka marrë në pjesë në procedurë 1 OE.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“M.” SHPK	96,259,270

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofertës në SPE për OE të kualifikuar (i vetëm) me vlerë 96,259,270 lekë, nga ku rezultoi se OE ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në DT. Sa më sipar KVO, ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “M.” SHPK.

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP, VKM dhe DT.

5. Mbi procedurën me objekt “Rikonstruksion Rruga “Oblikë-Obot”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion Rruga Oblikë-Obot”		
Urdhër Prokurimi nr. 169, datë 22.02.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr.169, datë 22.02.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 170, datë 22.02.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur	E. D., Jurist D. K., Specialiste ing. I. T., Specialist ing.	D. M., Kryetar R. G., Anëtar K. P., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 16,710,798 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 10,414,171 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 6,296,627 lekë
Data e hapjes së procedurës: 30.03.2018 ora 12.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018-2020, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 7 (shtatë) OE b. Kualifikuar: 7 (shtatë) OE c. S'kualifikuar: -
Ankimime: -	Përgjigje ankesës nga AK: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Hapur” me vlerë 16,710,798 lekë, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit:

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria “C.” SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi sipas zërave nga OE me vlerë totale 16,710,798 lekë pa TVSH dhe 20,052,957 lekë me TVSH. Në përcaktimin e shërbimeve dhe çmimeve për njësi, personi përgjegjës Znj. I. T. është mbështetur në analizën e çmimeve dhe çmimet e përcaktuara në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i punës, me zgjedhje për disa nga zërat me peshë më të madhe në vlerën limit të kontratës, krahasoi çmimet sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

“Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara, nga ku nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
An-49	2,366	2,366	0
3.158/2a	266	266	0
3.137	689	689	0
3.An164/1b	1,441	1,441	0
3.240	10,318	10,318	0
3.212/b	449	449	0
3.224/1	1,071	1,071	0
3.355	1,363	1,363	0
An146	4,216	4,216	0
An99	6,326	6,326	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 7 OE, nga të cilët janë kualifikuar 7.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“S. M. O. U.” SHPK & “S.M.O. V.” SHPK	10,414,171
2	“N.” SHPK & “K.” SHPK	11,237,720
3	“Rr. G.” SHPK	12,586,866
4	“N.” SHPK	12,912,018
5	“B.” SHPK	12,956,088
6	“K.” SHPK	13,337,737
7	“A.” SHPK	14,583,660

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga Grupi i auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i ofertës në SPE për BOE të shpallur fitues, me vlerë më të ulët, nga ku rezultoi si dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit ishte në përputhje me kërkesat e DT.

BOE ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët 10,414,171 lekë, pasi rezulton më e vogël se 85 % e mesatares së ofertave të vlefshme, që është në shumën 10,689,145 lekë.

Nr.	Vlera e Ofertës
1	10,414,171
2	11,237,720
3	12,586,866
4	12,912,018
5	12,956,088
6	13,337,737
7	14,583,660
Totali	88,028,260
Mesatarja	12,575,465
85%	10,689,145
Diferenca	-274,975

Për sa më sipër, nga AK është kërkuar sqarim mbi ofertën anomalisht të ulët për disa zëra, për të cilët nga BOE me shkersën nr. 5618, datë 16.04.2018, janë paraqitur sqarimet përkatëse dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

dokumentacioni bashkëngjitur si analiza çmimesh, fatura të blerjes së materialeve, dokument pronësie të fabrikës së Asfaltbetonit etj.

Bazuar në dokumentacionin e mësipërm KVO, vepruar në përputhje me, LPP neni 56 “Oferta anomalisht e ulët”, pika 1.

Sa më sipër KVO, referuar kriterit të kualifikimit “çmimi më i ulët”, ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “S. M. O. U.” SHPK & “S. M. O. V.” SHPK me vlerë 10,414,171 lekë.

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP, VKM dhe DT.

6. Mbi procedurën me objekt “Rikonstruktion Rruga “Rragam-Sheldi”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruktion Rruga Rragam-Sheldi”		
Urdhër Prokurimi nr. 845, datë 19.10.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr.845, datë 19.10.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 846, datë 19.10.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur	E. D., Jurist D. K., Specialiste ing. R. T., Specialist ing.	P. M., Kryetar V. Sh., Anëtar J. G., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 16,638,245 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 11,696,127 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 4,942,118 lekë
Data e hapjes së procedurës: 30.03.2018 ora 12.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018-2020, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 19,966,000 lekë.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 7 (shtatë) OE b. Kualifikuar: 3 (tre) OE c. S'kualifikuar: 4 (katër) OE
Ankimime: -1	Përgjigje ankesës nga AK: Shkresa nr. 21195/1, datë 21.12.2018.	Përgjigje ankesës nga KPP: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Hapur” me vlerë 16,638,245 lekë, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit:

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria “C.” SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi sipas zërave nga OE me vlerë totale 16,710,798 lekë pa TVSH dhe 20,052,957 lekë me TVSH. Në përcaktimin e shërbimeve dhe çmimeve për njësi, personi përgjegjës Znj. I. T. është mbështetur në analizën e çmimeve dhe çmimet e përcaktuara në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, 123ate 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit 123ate123l” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i auditimit, verifikoi me zgjedhje pjesën më të madhe të zërave të preventivit, krahasoi çmimet sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara, nga ku nuk rezultuan diferenca.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.25/b	620	692	0
An-49	2,366	2,366	0
3.158/2a	266	266	0
3.240	10,318	10,318	0
3.137	689	689	0
3.618	1,515	1,515	0
3.An164/1b	1,441	1,441	0
3.243/1	11,237	11,237	0
3.620	1,305	1,305	0
3.379	1,840	1,840	0
An151	1,442	1,442	0
2.575	80,883	80,883	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 7 OE, nga të cilët janë kualifikuar 7.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“D. I.” SHPK & “Rr. U. E.” SHPK	11,178,527
2	“N.” SHPK	11,579,756
3	“S. M. O. U.” SHPK & “S.M.O. V.” SHPK	11,696,127
4	“K. G. K.” SHPK	11,931,491
5	“P.V.K.” SHPK	13,642,065
6	Rr. G.” SHPK	14,129,397
7	“L.” SHPK	15,678,144

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga Grupi i auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i ofertës në SPE për OE të skualifikuar me vlerë më të ulët dhe BOE i shpallur fitues, si më poshtë:

- BOE “D. I.” SHPK & “Rr. U. E.” SHPK.

Nga BOE është paraqitur ankimim në AK, i cili përse i përket procedurës së ndjekur për shqyrtimin e ankesës së BOE, ka vepruar në përputhje me VKM nenin 78 “Ankesat në autoritetin kontraktor”. Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankimimit, ka rrëzuar pretendimet e OE, i cili është njoftuar me shkresën nr. 21195/1, datë 21.12.2018. Ndaj vendimit të AK-së nuk ka ankimim drejtuar KPP-së.

- “N.” SHPK, nga Këqyrja e dokumentacionit në SPE, rezulton se nuk i ka plotësuar kriteret e kualifikimit.

Titulli i gjetjes nr 6. Mbi zbatimin e kriterëve për kualifikim.

Situata 1:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të:

- BOE “D. I.” SHPK & “Rr. U. E.” SHPK në SPE, dhe DT, mbi skualifikimin e BOE ka rezultuar se:

- Për mjetin Autobitumatrice me targa AA...AZ, *mungon pagesa e taksave të automjetit.*

- *Kamioni me targa LB...9A, i marrë me qira në Certifikatën e transportit të mallrave është për përdorim të vet dhe jo për të tretë. Theksojmë se ky kriter (për të tretë) nuk është kërkuar në DT. Në DT pika 2.3.11 është*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

kërkuar Certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

- Sipas KVO-së ka paraqitur vetëm një kamion me 5-9 ton ngarkesa, nga dy të kërkuar. Nga këqyrja e dokumentacionit në SPE ka rezultur se:

Mjeti me targa LB2719A, është me kapacitet nga 7.5-18 ton.

Mjeti me targa AA615CO, është me kapacitet 7.5-14 ton

Mjeti me targa AA084DG, është me kapacitet 3.5-7.5 ton.

Sa më sipër, konstatimi i KVO-së dhe i NJP e cila ka shqyrtuar ankesën e OE, nuk qëndron, pasi OE ka paraqitur 2 kamiona me kapacitet mbi 5-9 ton dhe nje kamion me kapacitet 5 ton.

Sa më sipër BOE, referuar kërkesave të DT, nuk ka përmbushur vetëm kriterin mbi taksat e automjetit.

- BOE "S. M. O. U." SHPK & "S.M.O. V." SHPK i shpallur fitues ka rezultuar me mangësi, të cilat KVO i ka përdorur si kriter për të skualifikuar OE "D. I.", por që nuk janë përdorur si kriter në rastin e këtij operatori. Konkretisht nga BOE "S. M. O. U." SHPK & "S.M.O. V." SHPK " është paraqitur:

Mjeti Autobot uji i marrë me qira nga "G. 2" SHPK, të cilit i mungon:

Certifikata nr. 138, datë 24.08.2018, është lëshuar "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet", pra jo për të tretë;

Mungon pagesa e taksave të automjetit.

Këto dy kritere janë cilësuar si skualifikuese për BOE "D. I." SHPK & "Rr. U. E." SHPK dhe nuk janë cilësuar si të tilla, për BOE "S. M. O. U." SHPK & "S.M.O. V." SHPK.

KVO, ka specifikuar si kriter të paplotësuar nga BOE "D. I." SHPK & "Rr. U. E." SHPK, faktin që Automjetet e marra me qira, certifikatat për transport mallrash brenda vendit nuk janë për të tretë, por për përdorim vetjak, kriter i cili nuk është kërkuar në DT, pika 2.3.11 ku është kërkuar Certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

Situata 2:

Kriteri 1:

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 3, ku cilësohet: *Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Kriteri 2:

DT, Dokumentet e tenderit, pika 2.3.11.

LPP me ndryshime, neni 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", pika 2 ku cilësohet: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Shkaku Ndikimi

Mosvlerësim i KVO-së në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT.

Shkelje e barazisë, për shkak të vlerësimit me dy standarde të ofertave nga ana e KVO-së, duke shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 16,638,245 lekë.**

Rëndësia (U/M/L)

L



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Rekomandimi -

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Anëtarët e KVO-së, pasi kanë vepruar në kundërshtim me LPP dhe VKM.

-Së pari kanë përdorur kritere skualifikuese, të cilat nuk janë të parashikuara në DT;

-Së dyti, kanë vepruar me dy standarde, ku për të njëjtat kritere të plotësuar nga dy OE, njëri është kualifikuar dhe tjetri (me vlerë oferte më të vogël) është s'kualifikuar.

7. Mbi procedurën me objekt “Rikonstruksion Rruga “Vllaznimi”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion Rruga Vllaznimi”		
Urdhër Prokurimi nr. 840, datë 18.10.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr.840, datë 18.10.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 841, datë 18.10.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur	E. D., Jurist D. K., Specialiste ing. J. V., Specialist arkitekt	P. M., Kryetar E. V., Anëtar J. V., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 17,234,990 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 15,422,809 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 1,812,181 lekë
Data e hapjes së procedurës: 19.11.2018, ora 12	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018-2020, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 20,682,000 lekë.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 4 (katër) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S'kualifikuar: 3 (tre) OE
Ankimime: -1	Përgjigje ankesës nga AK: -	Përgjigje ankesës nga KPP: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër

Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Hapur” me vlerë 16,638,245 lekë, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të vlerësimit:

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria “C.” SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi sipas zërave nga OE me vlerë totale 17,234,990 lekë pa TVSH dhe 20,681,988 lekë me TVSH. Në përcaktimin e shërbimeve dhe çmimeve për njësi, personi përgjegjës R. T. është mbështetur në analizën e çmimeve dhe çmimet e përcaktuara në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publikl” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i auditimit, verifikoi me zgjedhje pjesën më të madhe të zërave të preventivit, krahasoi çmimet sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara, nga ku nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.89/b	332	332	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

3.158/5a	266	266	0
3.210	823	823	0
3.212/b	449	449	0
3.An/1t	1,960	1,960	0
3.An/2t	2,827	2,827	0
3.An/3t	6,075	6,075	0
3.617	959	959	0
3.183.a	233	233	0
3.228/1	1,085	1,085	0
3.242	10,537	10,537	0
3.231/1	993	993	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 4 OE, nga të cilët janë skualifikuar 3 dhe është kualifikuar 1 OE.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“S. M. O. U.” SHPK	14,045,295
2	“D. I.” SHPK & “Rr. U. E.” SHPK	14,929,194
3	“P.V.K.” SHPK	14,649,000
4	“N.” SHPK	14,422,809

Nga Grupi i auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i ofertës në SPE për OE të skualifikuar me vlerë më të ulët dhe OE i shpallur fitues “N.” SHPK, si më poshtë:

OE “S. M. O. U.” SHPK, është skualifikuar, pasi nuk ka plotësuar shtojcën kontratat në proces dhe angazhimin e fuqisë punëtore, të cilat janë përcaktuar si kriteret për kualifikim në DT.

-OE “P.V.K.” SHPK, është skualifikuar me të drejtë pasi nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara në DT, pasi kontrata e punës me inxhinierin elektrik kishte përfunduar më datë 24.05.2018 dhe mjetit Fadromë i mungonte i gjithë dokumentacioni i kërkuar.

Titulli i gjetjes nr 7. Mbi zbatimin e kriterëve për kualifikim.

Situata 1:

-BOE “D. I.” SHPK & “Rr. U. E.” SHPK është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur:

Certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm;

Certifikatë për transport mallrash brenda vendit për të tretë, e cila nuk është kërkesë e DT.

-OE “N.” SHPK, që është OE i kualifikuar dhe i shpallur fitues, është kualifikuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DT. Nga këqyrja e dokumentacionit në SPE rezulton se për mjetin “Autobitumatriçe” me targa KO....B nuk ka paraqitur:

Certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm;

Certifikatë për transport mallrash brenda vendit për të tretë;

Këto dy kriteret janë cilësuar si skualifikuese për BOE “D. I.” SHPK & “Rr. U. E.” SHPK dhe nuk janë cilësuar si të tilla, për OE “N.” SHPK.

KVO, ka specifikuar si kriter të paplotësuar nga BOE “D. I.” SHPK &



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Situata 2:	“Rr. U. E.” SHPK SHPK, faktin që Automjetet e marra me qira, certifikatat për transport mallrash brenda vendit nuk janë për të tretë, por për përdorim vetjak, kriter i cili nuk është kërkuar në DT.
Kriteri 1:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3, ku cilësohet: <i>Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.</i>
Kriteri 2:	Dokumentet e tenderit, pika 2.3.11/v; LPP me ndryshime, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 2 ku cilësohet: <i>Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.</i>
Shkaku Ndikimi	Mosvlerësim i KVO-së në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT. Shkelje e barazisë, për shkak të vlerësimit me dy standarde të ofertave nga ana e KVO-së, duke shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 17,234,990 lekë. Gjithashtu, për faktin se asnjë prej OE në garë nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit procedura duhej anuluar.
Rëndësia (U/M/L)	L
Rekomandimi	-

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Anëtarët e KVO-së, pasi kanë vepruar në kundërshtim me LPP dhe VKM.

- Së pari ka përdorur kriteret skualifikuese, të cilat nuk janë të parashikuara në DT, pika 2.3.11/v;
- Së dyti, ka vepruar me dy standarde, ku për të njëjtat kriteret të plotësuar nga dy OE, njëri është kualifikuar dhe tjetri (me vlerë oferte më të vogël) është s’kualifikuar.

8. Mbi procedurën me objekt “Rikualifikim blloqe banimi “Qemal Draçini” (tek Sahati)”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikualifikim blloqe banimi Qemal Draçini		
Urdhër Prokurimi nr. 689, datë 23.08.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr.689, datë 23.08.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrat nr. 690, datë 23.08.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur	E. D., Jurist D. K., Specialiste ing. J. V., Specialist arkitekt	D. M., Kryetar R. G., Anëtar J. G., Anëtare
Fondi limit pa tvsh: 23,800,080 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 18,897,168 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh 4.902.912 lekë
Data e hapjes së procedurës: 24.09.2018, ora 10	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018-2020, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 29,941,000 lekë. 7,894,166 lekë në 2018 15,905,914 lekë në 2019	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 6 (gjashtë) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S’kualifikuar: 5 (pesë) OE
Ankimime: - Me shkresë nr. 17482, datë 22.10.2018	Përgjigje ankesës nga AK: - Me shkresën nr. 17482, datë 26.10.2018	Përgjigje ankesës nga KPP: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Hapur” me vlerë 23,800,080 lekë, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018 dhe 2019, bazuar në PBA 2018-2020.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të vlerësimit:

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria “P. C.” SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi sipas zërave nga OE me vlerë totale 23,800,080 lekë pa TVSH dhe 28,560,096 lekë me TVSH. Në përcaktimin e shërbimeve dhe çmimeve për njësi, personi përgjegjës J. V. është mbështetur në analizën e çmimeve dhe çmimet e përcaktuara në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i auditimit, verifikoi me zgjedhje pjesën më të madhe të zërave të preventivit, krahasoi çmimet sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara, nga ku nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.209	742	742	0
3.228/1	1,085	1,085	0
3.231/1	993	993	0
3.617	959	959	0
3.89/a	361	361	0
2.575	80,883	80,883	0
An-23	18,871	18,871	0
3.An/2t	2,827	2,827	0
3.An/2t	1,960	1,960	0
3.207	391	391	0
3.621	669	669	0
2.37/5a	319	319	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 6 OE, nga të cilët janë skualifikuar 4 dhe është kualifikuar 2 OE.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“K. G. K.” shpk & “A.” SHPK	16,123,191
2	“S. M. O. U.” SHPK & “S. M. O. U.” SHPK	17,100,636
3	“V. E” SHPK	17,707,251
4	“B.” SHPK	18,209,989
5	“Rr. G.” SHPK & “Sh. A.” SHPK	18,897,168
6	“Sh. 07” SHPK	20,000,000

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Operatorët ekonomikë të skualifikuar:

- BOE, “K. G. K.” & “A.” SHPK, ka përmbushur kriteret për kualifikim.

Nga KVO, është përlogaritur oferta e saj e cila ka rezultuar anomalisht e ulët (32 % më pak se vlera limit e kontratës) dhe për këtë arsye në përputhje me VKM nenin 56, i ka kërkuar argumente, analizë çmimesh mbi justifikimin e saj me shkresën nr. 9808/20, datë 11.10.2018.

Nga BOE, nuk është paraqitur asnjë dokumentacion brenda afatit të përcaktuar e për rrjedhojë KVO ka marrë vendim për skualifikimin e BOE, veprim në përputhje me VKM neni 66.

- BOE, “S. M. O. V.” SHPK & “S. M. O. U.” SHPK, është skualifikuar pasi nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit. OE “S. M. O. V.” SHPK, rezulton me detyrime (sig shoqërore) të papaguara në shumën 321,550 lekë, kërkesë e DT dhe e LPP, neni 45 “Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë”, pika 2, germa d, ku cilësohet:

nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

Nuk plotëson kriterin për kapacitetin teknik, pasi ka të punësuar një inxhinier mjedisi, i cili nuk është i certifikuar nga Ministria me Certifikatë për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kundërshtim me DT, pika 2.3.5/e.

Dëshmitë për teknikë ndërtimi të paraqitura nga “S. M. O. V.” SHPK, nuk kanë të cilësuar se çfarë teknikësh janë, në kundërshtim me DT, pika 2.3.10.

- OE, “V. E” SHPK, Specialisti për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë është me profesion ekeonomist dhe nuk figuron në listëpagesat për periudhën janar-gusht 2018, në kundërshtim me DT, pika 2.3.9.

- OE, “B.” SHPK, është skualifikuar pasi nuk ka përmbushur kriterin mbi pajisjet teknike. Sipas KVO-së, mjeti “Autobitumatriçe” me targa AA...LT, i marrë me qira nga “E.” SHPK, nuk ka të përcaktuar afatin e qirasë, në kundërshtim me sa është kërkuar në DT.

KVO, ka shpallur fitues BOE “Rr. G.” SHPK & “Sh. A.” SHPK, është shpallur fituese, si oferta më e ulët, por edhe e vetme e kualifikuar.

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP, VKM dhe DT.

9. Mbi procedurën me objekt “Ndërtim rrjeti ujit të pijshëm”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim rrjeti ujit të pijshëm”		
Urdhër Prokurimi nr. 593, datë 30.07.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr.593, datë 30.07.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 594, datë 30.07.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur	E. D., Jurist D. K., Specialiste ing. R. T., Specialist arkitekt	A. Gj., Kryetar K. K., Anëtar E. D., Anëtare
Fondi limit pa tvsh: 17,785,676 lekë	Oferta fituese pa tvsh: lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh lekë
Data e hapjes së procedurës: 31.08.2018, ora 10	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018-2020, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 23,395,499lekë. 7,993,290 lekë në 2018 14,462,209 lekë në 2019	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 6 (gjashtë) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S’kualifikuar: 5 (pesë) OE
Ankimime: - Me shkresë nr. 15048, datë 17.09.2018	Përgjigje ankesës nga AK: - Me shkresën nr. 15048/1 datë 18.09.2018	Përgjigje ankesës nga KPP: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Hapur” me vlerë 23,800,080 lekë, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018 dhe 2019, bazuar në PBA 2018-2020.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit:

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria “C. R.GJ.” SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi sipas zërave nga OE me vlerë totale 23,800,080 lekë pa TVSH dhe 28,560,096 lekë me TVSH. Në përcaktimin e shërbimeve dhe çmimeve për njësi, personi përgjegjës R. T. është mbështetur në analizën e çmimeve dhe çmimet e përcaktuara në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i auditimit, verifikoi me zgjedhje pjesën më të madhe të zërave të preventivit, krahasoi çmimet sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara, nga ku nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
2.261	1,459	1,459	0
2.491/e	376	376	0
An-2.491.f/g	776	776	0
2.491/g	995	995	0
3.44/1	723	723	0
3.212/d	617	617	0
2.494/3	1,305	1,305	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 6 OE, nga të cilët janë skualifikuar 4 dhe është kualifikuar 2 OE.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“A. K.” SHPK & “K. G. K.” SHPK	12,683,902
2	“B.” SHPK & “S.” SHPK	13,836,816
3	“S. M. O. U.” SHPK & “S. M. O. U.” SHPK	14,814,338

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Operatorët ekonomikë të kualifikuar:

Pas vlerësimit të ofertave në SPE, KVO ka kualifikuar tre OE, pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur fitues BOE, i cili referuar kriterit të vlerësimit “çmimi më i ulët”, ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë më të vogël në shumën 12,683,902 lekë.

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP dhe VKM.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Të tjera:

Titulli i gjetjes: "Mbi dokumentimin e procedurës së prokurimit nga KVO"

Situata 1: - Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Procesverbalin e hapjes së ofertave nr. 1, datë 31.08.2018 me nr. Protokolli 12451/7;

Situata 2: - Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Procesverbalin e shqyrtimit të ofertave nr. 2, datë 13.09.2018 me nr. Protokolli 12451/8;

Situata 3: - Vendimi për shpalljen e fituesit nuk është firmosur nga KVO;

Situata 4: - Raporti përmbledhës nuk është firmosur nga KVO.

Situata 5: - Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Formularin mbi konfliktin e interesit.

Kriteri 1/2/3: VKM, neni 64 "Hapja e ofertave", pika 5, ku cilësohet: "*Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 12 të LPP.*"

Kriteri 4: VKM, neni 68 "Raporti Përmbledhës", ku cilësohet: "*Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afatave të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor*".

Kriteri 5: VKM, neni 64 "Hapja e ofertave", ku cilësohet: "*Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës*".

Shkaku Mosveprim i anëtarëve të KVO-së dhe neglizhencë e NJP.

Ndikimi Moslënie gjurmë për veprimet dhe vendimmarrjen e tyre.

Rëndësia (U/M/L) M

Rekomandimi -

Procedurat e prokurimit "Kërkesë për propozim"

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Diferenca nga fondi limit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues
1	Ndërtim trotuari dhe Sistemim kanali Gomsiqe	10,291,788.00	8,542,254.00	1,749,534.00	M.F I. G.
2	Ndërtim trotuari nga kanali deri tek kisha, Sektor Velipojë	8,308,333.00	5,469,502.50	2,838,830.50	Rr. G.
3	Ndriçimi i rrugës Fermentim – Ura e Bardhajve	6,666,666.00	5,928,804.00	737,862.00	P.
4	Rikonstruksion i Rrugës Hidrovor - Dobraq Loti 1	9,887,500.00	6,167,723.00	3,719,777.00	S. M. O. V.
5	Rikonstruksion i Rrugës së Mushanit, Segmenti I	9,227,500.00	8,055,073.00	1,172,427.00	A. T.
6	Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Beltojë	8,283,333.00	5,484,549.00	2,798,784.00	Rr. G.
7	Rikonstruksion Rruga "Bashej"	6,879,166.00	5,496,456.00	1,382,710.00	B.M-K.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

8	Rikonstruksion Rruga "Lodërtune"	10,476,666.00	8,244,096.00	2,232,570.00	A. K.
9	Rikonstruksion rruges Oblike-Velinaj-Alimetaj(vazhdim)	7,610,563.00	6,312,357.00	1,298,206.00	S. M. O. V.
10	Rikualifikim Urban blloqe banimi "Tepe" (tek Vasiejt)	6,276,854.00	4,540,767.00	1,736,087.00	Rr. G.
11	Sistemim asfaltim Rruga "Dod Çarri", Shtoj i Ri	10,919,166.00	9,531,743.00	1,387,423.00	A. T.
	Totali	108,240,364	87,721,638	23,518,725	

Konstatime të përgjithshme:

- Nga ana e Titullarit të AK, për çdo procedurë ka dalë vendim “Për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh”, duke u shprehur edhe për vendodhjen e tyre, numrin e pasurisë dhe posedimin e saj nga Bashkia Shkodër.
- Me shkresat përkatëse për çdo procedurë është miratuar kërkesa për anagazhim fondesh e cila është nënshkruar nga NA znj. V. A., NZ znj. B. M. dhe struktura kërkuese, në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 140 dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 40 “Shpenzimet”, pika 3.
- Nga anëtarët e NJP dhe KVO, janë plotësuar Deklaratat e konfliktit të interesit për çdo procedurë.
- Për çdo procedurë të audituar ka rezultuar se nga AK, janë mbajtur procesverbalet përkatëse dhe Raporti përmbledhës, si dhe është lënë gjurmë për të gjithë procedurën e ndjekur, në përputhje me LPP, neni 12 “Përgjegjësitë e AK”;
- Për çdo procedurë të audituar, janë bërë publikimet në Buletinin e APP-së, sipas fazave përkatëse;
- Në të gjitha rastet nga OE i shpallur fitues është bërë sigurimi i kontratës;
- Kryetarët e KVO-së, janë përzgjedhur nga niveli i lartë drejtues (N/Kryetar Bashkie dhe Përgjegjës të Njësi Administrative, Bashkia Shkodër, veprim në përputhje me nenin 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, ku cilësohet: “...Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit...”

1. Mbi procedurën me objekt “Rikonstruksion Rruga “Mushanit segmenti I”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion Rruga “Mushanit Segmenti I”		
Urdhër Prokurimi nr. 173, datë 22.02.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 173, datë 22.02.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 174, datë 22.02.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozime	E. D., Jurist D. K., Specialiste I. T., Specialist	Gj. D., Kryetar R. K., Anëtar E. B., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 8,283,311 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 6,547,805 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 1,735,506 lekë
Data e hapjes së procedurës: 05.03.2018 ora 12.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 11 (dymbëdhjetë) OE b. Kualifikuar: 2 (dy) OE c. S'kualifikuar: 9 (nëntë) OE
Ankimime: -	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër

Punoj: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Kjo procedurë është tender i “Kërkesë për propozim”²⁶ me vlerë 8,283,311 lekë, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018, në përputhje me LPP neni 34 dhe VKM neni 39 “Kërkesa përpropozime”, duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE²⁷,

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria “C.” SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 10,918,569 lekë pa TVSH dhe 13,102,282 lekë me TVSH. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, personi përgjegjës znj. I. T., është mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i punës i krahasoi çmimeve sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara dhe nga krahasimi i të cilave nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.25/b	620	620	0
An-49	2,366	2,366	0
3.158/2a	170	170	0
3.137	689	689	0
3.An.164/1b	1,441	1,441	0
3.240	10,138	10,138	0
3.212/b	449	449	0
3.221/1	1,143	1,143	0
3.224/1	1,071	1,071	0
3.287	107,215	107,215	0
3.365	4,208	4,208	0
An146	4,216	4,216	0
An99	6,326	6,326	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

²⁶ VKM Neni 39 “Kërkesa përpropozime” dhe LPP neni 34 ku cilësohet: “Kërkesa për propozim, sipas nenit 34 të LPP, është një procedurë prokurimi, e cila përdoret për kontratat me vlerë nën kufirin e ulët monetar, por mbi 800.000 (tetëqindmijë) lekë”.

²⁷ VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “Kërkesë për propozim”, duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE²⁸, nga të cilët janë paraqitur 2 prej tyre dhe 9 OE të tjerë, të paraqitur më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“S. M. O. U.” SHPK	6,016,014
2	“N.” SHPK	6,297,155
3	“Rr. G.” & “K.” SHPK	6,547,805
4	“S.M.O. V.” SHPK	6,780,777
5	“G.” SHPK	6,814,254
6	“K. K.” SHPK	7,355,124
7	“Sh.” SHPK	7,827,719
8	“A.” SHPK	8,055,073
9	“K. G. K.” SHPK	8,397,165
10	“Z.” SHPK	8,479,065
11	“D. I.” SHPK	-

Nga Grupi i auditimit, u verifikua i gjithë dokumentacioni i mbajtur mbi këtë procedurë, për vlerësimin e OE, si dhe u këqyrën ofertat ekonomike të dy OE me vlerën më të vogël të skualifikuar dhe OE të shpallur fitues nga ku rezultoi:

- Mbi vlerësimin e OE “S. M. O. U.” SHPK.

Mungonte listëpagesa e muajit Dhjetor 2016;

OE kishte marrë pjesë në më shumë se një ofertë, brenda të njëjtës procedurë, konkretisht edhe si “S. M. O. V.” SHPK. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se KVO ka vepruar në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 65 “Ndërhyrja në ofertë”, pasi OE “S. M. O. U.” SHPK, dhe OE “S. M. O. V.” SHPK, të dy pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë të njëjtin aksioner dhe administrator, z. Xh. V., i cili zotëron 100 % të aksioneve tek “S. M. O. V.” SHPK dhe 33 % tek “S. M. O. U.” SHPK.

Sa më sipër, KVO ka vepruar në përputhje me LPP, VKM dhe DT.

Mjeti autobot uji me targa SH....E, sipas KVO-së nuk ka plotësuar kërkesat, pasi në certifikatën e transportit, lëshuar nga Bashkitë Shkodër është cilësuar: “Certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”, pra jo mjet për të tretë, gjë e cila nuk është specifikuar në DT. KVO ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe DT.

Titulli i gjetjes nr 8. Mbi zbatimin e kriterëve për kualifikim.

Situata 1:

- Mbi vlerësimin e OE “N.” SHPK.

Nga ana e KVO, OE “N.” SHPK është skualifikuar për këto arsye:

Mjeti autobot uji me targa SH....E, dhe mjeti autobitumatriçe me targa KO....B, nuk kanë plotësuar kërkesat, pasi në certifikatat e transportit, lëshuar nga Bashkitë Shkodër dhe Korçë, është cilësuar: “Certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”, pra jo mjet për të tretë, ndërkohë që kjo nuk ka qenë e specifikuar dhe cilësuar si kërkesë në DT. Përsa nuk është kërkuar në DT, KVO nuk mund të kërkojë plotësimin e këtij kriteri nga OE pjesëmarrës në procedurë.

²⁸ VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Situata 2:

Për mjetin me targa SH...E, nga KVO është cilësuar se “Ekzistojnë dy kontrata qiraje për këtë mjet.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE, ka rezultuar se Shoqëria “B.” SHPK ka lidhur Kontratë Qiraje me OE “S. M. O. U.” SHPK, me nr. 659 Rep, datë 03.03.2018 dhe me OE “N.” SHPK me nr. 7197 Rep, datë 28.10.2017 me afat vlefshmërie 2 vjet, pra deri më 28.10.2019 automjeti është në posedim të “N.” SHPK. Ekzistenca e dy kontratave të dhënies me qira të të njëjtit mjet nga ana Shoqërisë “B.” SHPK, nuk është arsye skualifikimi për OE, pasi lidhja e kontratës ndodh jashtë dijenisë së OE. Për këtë veprim përgjegjësia juridike i bie qiradhënësit, i cili ka dhënë me qira një mjet të cilin deri më datë 28.10.2019 nuk e posedon.

Për vlerësimin e ofertave të OE “N.” SHPK dhe oferta e OE “S. M. O. U.” SHPK, KVO ka bërë interpretim dhe vlerësimin sipas gjykimit të saj, duke skualifikuar dy OE, ndërkohë që ata në lidhje me këtë kriter kanë plotësuar kërkesat sipas DT. KVO i është referuar për këtë interpretim duke përdoruar si precedent vendimin e KPP nr. 43/2016.

Sa më sipër, AK duhej t’i drejtohej APP-së për interpretim të rastit në fjalë, pasi është institucioni i vetëm i njohur me ligj i cili ka detyrë të japë sqarim dhe të interpretojë dhe këshillojë AK në fushën e prokurimit publik.

Kriteri 1:

Sa më sipër KVO ka vepruar në kundërshtim me LPP me ndryshime, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 2 ku cilësohet: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

DT, pika 2.3.11 “Për Kapacitetin teknik” është kërkuar: *Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:*

Nr	Mjetet	Sasia
7	Autobitumatrice	1 cope
8	Asfaltoshtruese	1 cope

Si deshmi për plotësimin e kesaj pike Operatori duhet të paraqesë: Shtojcen nr. 10 të plotësuar.

Për mjetet e marra me qira/furnizim, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit ku të specifikohet afati i kontratës, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat ,si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme)

Kriteri 2:

LPP, neni 13 Agjencia e Prokurimit Publik, pika 2, germa d, ku cilësohet: *"APP në përputhje me kërkesën, jep këshilla dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin një procedurë prokurimi".*

Shkaku Ndikimi

Mosvlerësim i KVO-së në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT. Veprim me dy standarde nga ana e KVO-së për vlerësimin e ofertave, veprim i cili ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

kërkesat ligjore në vlerën 9,227,500 lekë.

Rëndësia (U/M/L) L
Rekomandimi -

Mbi shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Nga KVO, referuar Procesverbalit nr. 4 datë 16.03.2018, protokolluar me nr. 1918/10, si dhe Vendimit të KVO-së nr. 2918/11, datë 16.03.2018, është shpallur fitues BOE me ofertë ekonomike në vlerën 6,297,155 lekë.

Me shkresën “Kërkesë për dorëheqje” nr. 4258 prot, datë 21.03.2018, BOE tërhiqet nga gara. Referuar tabelës së OE pjesëmarrës, OE i cili plotëson kriteret sipas vlerësimit të bërë nga KVO është OE “A.” SHPK me ofertë në shumën 8,055,073 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Anëtarët e KVO-së, të cilët nuk kanë kryer një vlerësim të drejtë të OE, pjesëmarrës në garë, duke shkaktuar efekt negativ financiar në shumën 1,757,918 lekë.

2. Mbi procedurën me objekt “Rikonstruksion Rruga “Varrezave Beltojë”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion Rruga “Mushanit Segmenti I”		
Urdhër Prokurimi nr. 175, datë 22.02.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 175, datë 22.02.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 176, 22.02.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozime	E. D., Jurist D. K., Specialiste I. T., Specialist	A. P., Kryetar V. B., Anëtar E. M., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 8,283,311 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 5,484,549 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 2,798,762 lekë
Data e hapjes së procedurës: 22.02.2018 ora 12.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 9 (nëntë) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S'kualifikuar: 8 tetë) OE
Ankimime: -	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Kërkesë për propozim” me vlerë 8,283,311 lekë pa TVSH, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018. Lloji i procedurës është përcaktuar në përputhje me LPP neni 34 dhe VKM neni 39 “Kërkesa përpropozime”, duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE²⁹,

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria “C.” SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

²⁹ VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 10,918,569 lekë pa TVSH dhe 13,102,282 lekë me TVSH. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, personi përgjegjës znj. I. T., është mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i punës i krahasoi çmimeve sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara dhe nga krahasimi i të cilave nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.25/b	620	620	0
An-49	2,366	2,366	0
3.158/2a	170	170	0
3.137	689	689	0
3.An.164/1b	1,441	1,441	0
3.240	10,318	10,318	0
3.243	11,105	11,105	0
3.244	11,494	11,494	0
3.An-9	1,037	1,037	0
3.212/b	449	449	0
3.221/1	1,143	1,143	0
3.224/1	1,071	1,071	0
3.287	107,215	107,215	0
3.365	4,208	4,208	0
An146	4,216	4,216	0
An99	6,326	6,326	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

Nr	Operatorët ekonomikë	Oferta ekonomike
1	Rr. G. & K.	5,484,549
2	N.	5,859,179
3	G.	6,033,337
4	S.M.O.U.	6,129,579
5	K. K.	6,587,274
6	S. M. O. V.	6,666,116
7	Sh.	6,712,409
8	K. G. K. &R. 94	6,967,611
9	Z.	7,380,156
10	D. I.	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga KVO, është kualifikuar një BOE “Rr. G.” SHPK & “K.” SHPK dhe janë skualifikuar 9 OE. Nga KLSH u auditua oferta e BOE të shpallur fitues, referuar kriterit të kualifikimit “çmimi më i ulët” dhe rezultoi se, janë plotësuar kriteret e kualifikimit.

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP, VKM dhe DT.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

3. Mbi procedurën me objekt “Sistemim asfaltim Rruga “Dod Çarri”, Shtoj i Ri”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim Rruga “Dod Çarri”, Shtoj i Ri”		
Urdhër Prokurimi nr. 177, datë 22.02.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 177 datë 22.02.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 214, datë 05.03.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozime	E. D., Jurist D. K., Specialiste I. T., Specialiste	V. P., Kryetar Gj. Gj., Anëtar M. F., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 10,918,569 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 9,531,743 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 1,386,826 lekë
Data e hapjes së procedurës: 05.03.2018 ora 10.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 13,103,000 lekë me tvsh.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 10 (dhjetë) OE b. Kualifikuar: 2 (dy) OE c. S'kualifikuar: 8 (tetë)
Ankimime: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Kërkesë për propozim” me vlerë 10,918,569 lekë, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018. Lloji i procedurës së prokurimit është përcaktuar në përputhje me LPP neni 34 dhe VKM neni 39 “Kërkesa përpropozime”, duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE³⁰.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria “C.” SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 10,918,569 lekë pa TVSH dhe 13,102,282 lekë me TVSH. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, personi përgjegjës znj. I. T., është mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i punës i krahasoi çmimeve sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara dhe nga krahasimi i të cilave nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.89/a	361	361	0
An-49	2,366	2,366	0
3.158/2a	170	170	0
3.137	689	689	0

³⁰ VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

3.An.164/1b	1,441	1,441	0
3.240	10,318	10,138	0
3.212/b	449	449	0
3.221/1	1,143	1,143	0
3.224/1	1,071	1,071	0
3.287	107,215	107,215	0
3.355	1,363	1,363	0
An146	4,216	4,216	0
An99	6,326	6,326	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave:

Nr	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Oferta ekonomike
1	Rr. G. & K.	6,988,926
2	S.M.O U.	7,696,697
3	G.	8,074,508
4	S. M. O. V.	8,565,609
5	Sh.	8,818,478
6	K. K.	9,135,052
7	A. T.	9,531,743
8	Z.	10,015,814
9	N.	10,049,435
10	D.	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga KVO, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik, referuar kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, ka kualifikuar dy OE dhe ka skualifikuar 8 prej tyre. Nga Grupi i auditimit u verifikuan ofertat e hedhuara në SPE, për:

Rr. G. & K.³¹	6,988,926
S.M.O U.	7,696,697
G.	8,074,508
S. M. O. V.	8,565,609
Sh.	8,818,478
K. K.	9,135,052
A. T.	9,531,743

Vlerësimi i OE të skualifikuar:

- OE-et “S.M.O. U.” SHPK dhe “S. M. O. V.”, janë skualifikuar nga KVO, në përputhje me VKM, neni 65 “Ndërhyrja në ofertë”, pika 1, ku cilësohet:

“Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën procedurë prokurimi”. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

- OE “G.” SHPK, është skualifikuar nga KVO, pasi nuk ka përmbushur kriterin mbi kontratat e ngjashme, sipas kërkesave të përcaktuara në DT;

³¹ Kualifikuar, por i dorëhequr nga gara.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

- OE “Sh.” SHPK, është skualifikuar se nuk ka sjellë vërtetim mbi pagesat e energjisë nga OSHEE, sipas kërkesave të DT, si dhe nuk ka paraqitur listëpagesën e muajit janar 2018, veprim në përputhje me VKM, neni 66 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Certifikata e transportit për mjetin autobot me targa AA...PA dhe autobitumatrice me targa SR...B janë për transport mallrash për llogari të vet dhe jo për të tretë, veprim i KVO-së në kundërshtim me LPP me ndryshime, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 2 ku cilësohet: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

- OE “K. K.” SHPK, është skualifikuar për faktin se Drejtuesi teknik mungon në listëpagesat e muajve (nëntor-dhjetor) 2017, dhe janar 2018 dhe dy specialistë manovratorë, mungojnë në listëpagesat e muajit janar 2018, veprime në përputhje me VKM, neni 66 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- Nga KVO, është skualifikuar edhe për faktin se Certifikata e transportit për mjetin autobot me targa AA...LO është për transport mallrash për llogari të vet dhe jo për të tretë, veprim i KVO-së, në kundërshtim me LPP neni 53.

OE të kualifikuar:

BOE “Rr. G.” SHPK & “K.” SHPK, kanë paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 6,988,926 lekë pa tvsh, ose 36 % më pak se vlera limit e kontratës.

Për sa më sipër, rezulton që kjo ofertë të jetë anomalisht e ulët, referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 5, ku cilësohet:

Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.

Nga ana e KVO, janë kërkuar analizat e çmimeve të argumentuara dhe të dokumentuara, për të justifikuar çmimet e paraqitura, veprim në përputhje me, LPP neni 56 “Oferta anomalisht e ulët”, pika 1 ku cilësohet:

Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: etj.

Me shkresën nr. 2920/8, datë 09.03.2018 AK i është drejtuar BOE për të paraqitur sqarime rreth ofertës ekonomike. BOE me shkresën nr. 3085, datë 13.03.2018, i ka paraqitur AK Bashkia Shkodër, sqarimet rreth ofertës së paraqitur (analizë çmimesh dhe fatura blerje), brenda afatit 3 ditor të përcaktuar në LPP, neni 56. Bazuar në dokumentacionin e mësipërm KVO është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

mbledhur dhe ka mbajtur Procesverbalin nr. 3, datë 13.03.2018 protokolluar me nr. 2920/9, ku ka rikonfirmuar si fitues BOE, pas argumentimit të ofertës anomalisht të ulët.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se, BOE ka paraqitur argumente të mbështetura (analizë çmimesh dhe dokumentacionin e duhur, fatura të blerjes së materialeve), për justifikimin e vlerës anomalisht të ulët për të gjithë zërat e kërkuar nga AK.

Mbi shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Më datë 16.03.2018 KVO ka mbajtur Procesverbalin nr. 4, protokolluar me nr. 2920/10, ku pas vlerësimit përfundimtar ka miratuar shpalljen e fituesit BOE “Rr. G.” SHPK & “K.” SHPK si dhe Vendimi i KVO-së me nr. 2920/11, datë 16.03.2018, me ofertë ekonomike në vlerën 6,988,926 lekë.

Me shkresën “Kërkesë për dorëheqje” protokolluar me nr. 4257, datë 21.03.2018, BOE tërhiqet nga gara, para njoftimit në SPE se është ofertë fituese. KVO në përputhje me VKM neni 21 “Njoftimi i fituesit”, ku cilësohet: *“Pas miratimit të raportit përmbledhës nga titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar, siç parashikohet në këto rregulla, ofertuesi i suksesshëm njoftohet me shkrim për pranimin e ofertës dhe për lidhjen e kontratës. Ky njoftim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në sistemin elektronik të prokurimit, në përputhje me nenin 58 të LPP”*, ka vazhduar përzgjedhjen e OE i cili ka plotësuar kriteret për kualifikim. Referuar tabelës së OE pjesëmarrës, OE i cili plotëson kriteret është OE “A.” SHPK me ofertë në shumën 9,531,743 lekë.

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP, VKM dhe DT.

4. Mbi procedurën me objekt “Ndërtim trotuari nga kanali deri tek Kisha, Sektor Velipojë”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim trotuari nga kanali deri tek Kisha, Sektor Velipojë”		
Urdhër Prokurimi nr. 171, datë 22.02.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 171 datë 22.02.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 172, datë 22.02.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozime	E. D., Jurist D. K., Specialiste J. V., Specialist	A. C., Kryetar I. M., Anëtar B. T., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 8,307,840 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 5,469,502 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 2,838,338 lekë
Data e hapjes së procedurës: 05.03.2018 ora 15.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 13,103,000 lekë me tvsh.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 11 (dhjetë) OE b. Kualifikuar: 3 (tre) OE c. S'kualifikuar: 8 (tetë)
Ankimime: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Kërkesë për propozim” me vlerë 8,307,840 lekë, pa TVSH dhe 9,969,408 me TVSH, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018, në përputhje me LPP neni 34 dhe VKM neni 39 “Kërkesa përpropozime”, duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE³².

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria “C.” SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave

³² VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 8,307,840 lekë pa TVSH dhe 9,969,408 lekë me TVSH. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, personi përgjegjës znj. I. T., është mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i punës i krahasoi çmimeve sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara dhe nga krahasimi i të cilave nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.25/b	620	620	0
An-49	2,366	2,366	0
3.158/2a	170	170	0
3.137	689	689	0
3.241	10,697	10,697	0
3.246	14,031	14,031	0
3.287	107,215	107,215	0
3.617 ³³	959	1,180	-221
3.An.164/1b	1,441	1,441	0
3.379	1,840	1,840	0
3An/1t	1,960	1,960	0
An146	4,216	4,216	0
An99	6,326	6,326	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

Nr	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Oferta ekonomike
1	“Rr. G.” SHPK & “K.” SHPK	5,469,502
2	“S. M. O. V.” SHPK & “L.” SHPK	5,741,541
3	“N.” SHPK	5,787,495
4	“G.” SHPK	5,813,390
5	“Sh.” SHPK	6,251,081
6	“A.” SHPK	6,585,275
7	“S. M. O. U.” SHPK	6,622,827
8	“K. K.” SHPK	6,664,791
9	“Z.” SHPK	6,836,738
10	“A. T.” SHPK	7,269,049
11	“D. I.” SHPK	-

³³ Përshkrimi në Manual “Bordura betoni 15x35 cm”
Përshkrimi në Preventiv “Bordura betoni 15x25 cm”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga KVO, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik, referuar kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, ka kualifikuar 3 OE dhe ka skualifikuar 8 prej tyre. Nga Grupi i auditimit u verifikua oferta e hedhurar në SPE nga OE i shpallur fitues “Rr. G.” SHPK & “K.” SHPK, e cila është dhe oferta me çmimin më të ulët.

Nr	Operatorët ekonomikë të kualifikuar	Oferta ekonomike
1	“Rr. G.” SHPK & “K.” SHPK	5,469,502
2	“A.” SHPK	6,585,275
3	“A. T.” SHPK	7,269,049

BOE “Rr. G.” SHPK & “K.” SHPK, kanë paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 5,469,502 lekë pa tvsh, ose 85 % më pak se mesatarja e ofertave të vlefshme = 5,475,084 lekë pa TVSH ($5,469,502 + 6,585,275 + 7,269,049 / 3 \times 85 / 100 = 5,475,084$).

Për sa më sipër, rezulton që kjo ofertë të jetë anomalisht e ulët, referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 5, ku cilësohet:

*Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e më poshtme:
-Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*

Nga ana e KVO, janë kërkuar analizat e çmimeve të argumentuara dhe të dokumentuara, për të justifikuar çmimet e paraqitura, veprim në përputhje me, LPP neni 56 “Oferta anomalisht e ulët”, pika 1 ku cilësohet:

Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:³⁴ etj.

AK i është drejtuar BOE për të paraqitur sqarime rreth ofertës ekonomike.

BOE me shkresën nr. 3884, datë 13.03.2018, i ka paraqitur AK Bashkia Shkodër, sqarimet rreth ofertës së paraqitur (analizë çmimesh dhe fatura blerje), brenda afatit 3 ditor të përcaktuar në LPP, neni 56.

Bazuar në dokumentacionin e mësipërm KVO është mbledhur dhe ka mbajtur Procesverbalin nr. 3, datë 13.03.2018 protokolluar me nr. 2917/8, ku ka rikonfirmuar si fitues BOE, pas argumentimit të ofertës anomalisht të ulët.

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP dhe VKM.

5. Mbi procedurën me objekt “Rikualifikim urban blloqe banimi Tepe/Vasijet”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikualifikim blloqe banimi Tepe”		
Urdhër Prokurimi nr.510, datë 02.07.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 510, datë 02.07.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 511, datë 02.07.2018

³⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozime	E. D., Jurist D. K., Specialiste I. T., Specialist	A. Sh., Kryetar J. D., Anëtar V. B., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 6,276,854 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 5,469,502 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 2,838,338 lekë
Data e hapjes së procedurës: 13.07.2018, ora 10.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 7,532,226 lekë me tvsh.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 5 (dhjetë) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S'kualifikuar: 4 (katër)
Ankimime: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Kërkesë për propozim” me vlerë 6,276,854 lekë pa TVSH, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018, në përputhje me LPP neni 34 dhe VKM neni 39 “Kërkesa përpropozime”, duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE³⁵.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria “C.” SHPK, e cila ka fituar kryerjen e shërbimit të konsulencës për përgatitjen e projektit në bazë të termave të referencës të përgatitur nga AK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 6,276,854 lekë pa TVSH dhe 7,532,225 lekë me TVSH. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, personi përgjegjës znj. I. T., është mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i punës i krahasoi çmimeve sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara dhe nga krahasimi i të cilave nuk rezultuan diferenca të pajustificuara.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.25/b	620	620	0
An-49	2,366	2,366	0
3.158/2a	170	170	0
3.137	689	689	0
3.An.164/1b	1,441	1,441	0
3.241	10,697	10,697	0
3.212/b	449	449	0
3.221/1	1,143	1,143	0
3.224/1	1,071	1,071	0
3.246	14,031	14,031	0
3.287	107,215	107,215	0

³⁵ VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

3.617 ³⁶	959	1,180	-221
3.654/1	373	373	0
3.379	1,840	1,840	0
2.523/1	1,960	1,960	0
2.576	98,525	89,081 ³⁷	+9,444

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

Nr	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Oferta ekonomike
1	“N.” SHPK	4,172,598
2	“Rr. G.” SHPK	4,540,767
3	“K.M K.” SHPK	4,563,689
4	“K.” SHPK	4,600,323
5	“A. K.” SHPK	5,133,534

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga KVO, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik, referuar kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, ka kualifikuar 1 OE dhe ka skualifikuar 4 prej tyre. Nga Grupi i auditimit u verifikuan ofertat në SPE nga OE dhe rezultoi:

- OE, “N.” SHPK, ka rezultuar me dokumentacion jo në përputhje me kriteret kualifikuese, konkretisht:

Nuk kishte faturë për presë asfalti;

Nuk kishte faturë për kutinë e ndihmës së shpejtë;

Kamionit me targa AA...V, i mungonte certifikata e transportit;

Katër muratorëve ju mungonte faja e dytë e certifikatave, ku është shënuar afati i vlefshmërisë.

Përsa i përket skualifikimit në lidhje me Certifikatën e mjeteve të marra me qira të cilat nuk kanë të përcaktuar “Për të tretë”, nuk është i saktë **pasi KVO, ka vepruar në kundërshtim me LPP, VKM dhe DT.**

- OE “Rr. G.” SHPK, kanë paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 4,540,767 lekë pa tvsh, ose 25 % më pak se vlera limit e kontratës ($6,276,854 * 25\% = 1,569,213 - 6,276,854 = 4,707,640$).

Për sa më sipër, rezulton që kjo ofertë të jetë anomalisht e ulët, referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 5.

AK në përputhje me, LPP neni 56 “Oferta anomalisht e ulët”, pika 1, me shkresën nr. 8514/20, datë 26.07.2018, i është drejtuar OE për të paraqitur sqarime rreth ofertës ekonomike, për zërat e mëposhtëm:

Zërat	Manuali	Oferta	Diferenca
3.241	10,697	7,915	2,782
3.212/b	449	330	119
3.221/1	1,143	845	298
3.224/1	1,071	790	281

³⁶ Përshkrimi në Manual “Bordura betoni 15x35 cm”

Përshkrimi në Preventiv “Bordura betoni 15x25 cm”

³⁷ Përshkrimi në Manual “Puse kontrolli 1.25x1.25x1.5 m”

Përshkrimi në Preventiv “Puse kontrolli 1.5x1.5x1.5 m”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

3.An/1t	1,960	1,450	510
3.An/2t	2,827	2,050	777
2.576	98,525	65,910	32,615

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

OE me shkresën nr. 12530, datë 31.07.2018, i ka paraqitur AK Bashkia Shkodër, sqarimet rreth ofertës së paraqitur (analizë çmimesh dhe fatura blerje), të cilat kanë rezultuar të rregullta dhe brenda afatit 3 ditor të përcaktuar në LPP, neni 56.

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP dhe VKM.

6. Mbi procedurën me objekt “Rruga Hidrovor Dobraq”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rruga Hidrovor Dobraq”		
Urdhër Prokurimi nr.638, datë 13.08.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 638, datë 13.08.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 639, datë 13.08.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozime	E. D., Jurist D. K., Specialiste E. D., Specialist	V. P., Kryetar V. R., Anëtar V. B., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 9,887,084 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 5,469,502 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 2,838,338 lekë
Data e hapjes së procedurës: 24.08.2018, ora 10.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën .. lekë me tvsh.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 5 (dhjetë) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S'kualifikuar: 4 (katër)
Ankimime: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Kërkesë për propozim” me vlerë 9,887,084 lekë pa TVSH, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018, në përputhje me LPP neni 34 dhe VKM neni 39 “Kërkesa përpropozime”, duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE³⁸.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga personi përgjegjës z. E. D.. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 9,887,084 lekë pa TVSH dhe 11864501 lekë me TVSH. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, personi përgjegjës z.E. D., është mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i punës i krahasoi çmimeve sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të

³⁸ VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara dhe nga krahasimi i të cilave nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.98/b	259	259	0
An-49	2,366	2,366	0
3.158/5a	266	266	0
3.An.164/1b	1,441	1,441	0
3.212/b	449	449	0
3.229/1	1,331	1,331	0
3.231/1	993	993	0
3.243	11,105	11,105	0
3.366	9,799	9,799	0
An.158	4,942	4,942	0
3.242	10,537	10,537	0
An.142	1,358	1,358	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

Nr	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Oferta ekonomike
1	“S. M. O. V.” SHPK & “S. M. O. U.” SHPK	6,167,723
2	“N.” SHPK	6,856,113
3	“K.” SHPK	6,867,144
4	“A. K.” SHPK	6,867,988
5	“K.” SHPK	6,897,611
6	“B.” SHPK	7,548,248
7	“K. G. K.” SHPK	7,777,582
8	“S.” SHPK	8,189,828
9	“B.” SHPK	8,424,576
10	“Rr. G.” SHPK	8,490,619

Nga KVO, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik, referuar kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, ka kualifikuar 3 OE dhe ka skualifikuar 7 prej tyre.

Nr	Operatorët ekonomikë të kualifikuar	Oferta ekonomike
1	“S. M. O. V.” SHPK & “S. M. O. U.” SHPK	6,167,723
2	“N.” SHPK	6,856,113
3	“Rr. G.” SHPK	8,490,619

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga Grupi i auditimit u verifikuan ofertat në SPE dhe rezultoi se BOE i shpallur fitues, ka plotësuar kriteret e kualifikimit.:

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP, VKM dhe DT.

7. Mbi procedurën me objekt “Rruga Lodërtune”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rruga Lodërtune”

Urdhër Prokurimi nr.800, datë 04.10.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 800, datë 04.10.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrorit nr. 803, datë 04.10.2018
--	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozime	E. D., Jurist D. K., Specialiste E. D., Specialist	A. L., Kryetar N. D., Anëtar P. M., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 10,475,890 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 8,244,096 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 2,231,794 lekë
Data e hapjes së procedurës: 15.10.2018, ora 10.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017, për vlerën 12,572,000 lekë me tvsh.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 5 (pesë) OE b. Kualifikuar: 3 (tre) OE c. S'kualifikuar: 2 (dy)
Ankimime: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Kërkesë për propozim” me vlerë 9,887,084 lekë pa TVSH, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018, në përputhje me LPP neni 34 dhe VKM neni 39 “Kërkesa përpropozime”, duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE³⁹.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga “T.” SHPK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 10,475,890 lekë pa TVSH dhe 12,571,068 lekë me TVSH. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, personi përgjegjës z.E. D., është mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2, Grupi i auditimit i krahasoi çmimet sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara dhe nga krahasimi i të cilave nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.98/b	259	259	0
An-49	2,366	2,366	0
3.158/5a	266	266	0
3.An.164/1b	1,441	1,441	0
3.212/b	449	449	0
3.229/1	1,331	1,331	0
3.231/1	993	993	0
3.243	11,105	11,105	0
3.366	9,799	9,799	0
An.158	4,942	4,942	0
3.242	10,537	10,537	0
An.142	1,358	1,358	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale

³⁹ VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

Nr	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Oferta ekonomike
1	“N.” SHPK	6,891,255
2	“S.” SHPK	7,626,381
3	“A. K.” SHPK	8,244,096
4	“B.” SHPK	8,378,053
5	“L. V.” SHA	9,537,392

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga KVO, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik, referuar kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, ka kualifikuar 3 OE dhe ka skualifikuar 2 prej tyre. Nga Grupi i auditimit u verifikuan në SPE ofertat më të ulta se oferta e shpallur fituese, dhe rezultoi:

Nr	Operatorët ekonomikë të skualifikuar	Oferta ekonomike
1	“N.” SHPK	6,891,255
2	“S.” SHPK	7,626,381

- OE “N.” SHPK është skualifikuar se:

Për mjetin “Autobitumatriçe nuk ka paraqitur certifikatë transporti”, kërkesë e DT, pika 2.3.11; Nuk ka paraqitur dokumentacion se disponon mjetin vetshkarkues 3.5-5 ton, kërkesë e DT pika 2.3.11/ii;

Të njëjtin staf dhe makineri i ka paraqitur në dy procedura të zhvilluara në Bashkinë Shkodër në të njëjtën ditë, kërkesë e DT, pika 2.3.11 (VO);

Për mospërmbushjen e kriterit për mjetin “Autobot uji” me targa SH...E, për arsyen se është për përdorim vetjak dhe jo për të tretë, nuk është korrekt, pasi ky kriter nuk është kërkesë e DT, pika 2.3.11 “Për Kapacitetin teknik” verim në kundërshtim me LPP me ndryshime, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 2 ku cilësohet: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

- OE “S.” SHPK, është skualifikuar pasi nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit për sa më poshtë: Nuk është paraqitur dokumentacion për mjetin “Fadromë me goma” (leje qarkullimi, policë, akt kolaudimi), kërkesë e DT, pika 2.3.11/ii;

Nuk është paraqitur dokumentacion mbi mjetin vetshkarkues 3.5-5 ton, kërkesë e DT pika 2.3.11.

KVO, ka vepruar në përputhje me LPP dhe VKM, ka shpallur fitues OE të kualifikuar “A. K.” SHPK, referuar kriterit të vlerësimit “çmimi më i ulët”.

Të tjera:

Titulli i gjetjes: "Mbi dokumentimin e procedurës së prokurimit nga KVO"

Situata 1: - Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Procesverbalin e hapjes së ofertave nr. 1, datë 15.10.2018 me nr. Protokollin 16364/6;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

- Situata 2:** - Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Procesverbalin e shqyrtimit të ofertave nr. 2, datë 25.10.2018 me nr. Protokolli 16364/7;
- Situata 3:** - Anëtarët e KVO-së nuk kanë Formularin mbi konfliktin e interesit.
- Kriteri 1/2:** Veprim në kundërshtim me VKM , neni 64 "Hapja e ofertave", pika 5, ku cilësohet: *"Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 12 të LPP.*
- Kriteri 3:** Veprim në kundërshtim me VKM, neni 64 "Hapja e ofertave", ku cilësohet: *"Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës".*
- Shkaku** Mosveprim i anëtarëve të KVO-së dhe neglizhencë e NJP.
- Ndikimi** Moslënie gjurmë për veprimet dhe vendimmarrjen e tyre.
- Rëndësia (U/M/L)** M
- Rekomandimi⁴⁰**

8. Mbi procedurën me objekt "Rruga Bashej"

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rruga Bashej"		
Urdhër Prokurimi nr.745, datë 12.09.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 745, datë 12.09.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 746, datë 12.09.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozime	E. D., Jurist D. K., Specialiste E. D., Specialist	F. Sh., Kryetar E. V., Anëtare P. M., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 6,878,484 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 5,496,456 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 1,382,028 lekë
Data e hapjes së procedurës: 24.09.2018, ora 14.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 4 (katër) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S'kualifikuar: 3 (dy)
Ankimime: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i "Kërkesë për propozim" me vlerë 9,887,084 lekë pa TVSH, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018, në përputhje me LPP neni 34 dhe VKM neni 39 "Kërkesa përpropozime", duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE⁴¹.

⁴⁰ Janë 5 raste të njëjta dhe është cilësuar vetëm një herë rekomandimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga “T.” SHPK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, projekti teknik, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 6,878,484 lekë pa TVSH dhe 8,254,180 lekë me TVSH. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, personi përgjegjës z.E. D., është mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Grupi i auditimit, krahasoi çmimet sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara dhe nga krahasimi i të cilave nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
2.426/3	3,509	3,509	0
3.210	823	823	0
3.212/b	449	449	0
3.231/1	993	993	0
3.An/2t	2,827	2,827	0
3.242	10,537	10,537	0
3.617	959	959	0
2.491/f	566	566	0
2.491/a	166	166	0
3.An/53	19,044	19,044	0
An.151	1,442	1,442	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

Nr	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Oferta ekonomike
1	“D. I.” SHPK	4,548,163
2	“A. K.” SHPK	5,013,183
3	“S.” SHPK	5,161,720
4	“B.M.K.” SHPK & “Rr. G.” SHPK	5,496,456

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga KVO, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik, referuar kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, ka kualifikuar 1 OE dhe ka skualifikuar 3 prej tyre. Nga Grupi i auditimit u verifikuan në SPE ofertat më të ulta se oferta e shpallur fituese, dhe rezultoi:

⁴¹ VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Nr	Operatorët ekonomikë të skualifikuar	Oferta ekonomike
1	“D. I.” SHPK	4,548,163
2	“A. K.” SHPK	5,013,183
3	“S.” SHPK	5,161,720

- OE “D. I.” SHPK është skualifikuar se:

Për mjetin “Autobot uji” me targa TR...U mungon taksa e qarkullimit, e cila nuk është kërkesë e DT, pika 2.3.11/ii. Për këtë automjet OE ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DT. KVO ka vepruar në kundërshtim me VKM neni 66.

Mjetit “Autovinç” i ka mbaruar afati i vlefshmërisë së certifikatës së transportit, policës së sigurimit, aktit të kolaudimit dhe taksës së qarkullimit, kërkesë e DT pika 2.3.11/ii;

Dëshmisë së kualifikimit për elektricistin Gj. Z., i ka mbaruar afati i vlefshmërisë (datë 05.05.2017), kërkesë e DT, pika 2.3.9.

- OE “A. K.” SHPK, është skualifikuar pasi nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit për sa më poshtë:

Të njëjtin staf dhe makineri i ka paraqitur në tre procedura të zhvilluara në Bashkinë Shkodër në të njëjtën ditë, kërkesë e DT, pika 2.3.11 (VO);

Afati i Vlefshmërisë së Certifikatave ISO 9001:2008 dhe 14001:2004, ju kishte mabruar fati i vlefshmërisë më datë 15.09.2018, kërkesë e DT, pika 2.3.10.

- OE “S.” SHPK, është skualifikuar pasi nuk ka përmbushur kriteret e kualifikimit për sa më poshtë:

Të njëjtin staf dhe makineri i ka paraqitur në dy procedura të zhvilluara në Bashkinë Shkodër në të njëjtën ditë, kërkesë e DT, pika 2.3.11 (VO);

Kontrata e qirasë për automjetin me targa AA...BF nuk është e nënshkruar përpara noterit, kërkesë e DT pika 2.3.11/v;

Nuk është paraqitur dokumentacion për mjetin Autobot uji, por për depozitë uji;

Nuk janë paraqitur fotot e automjeteve, kërkesë e DT pika 2.3.11/vi, etj.

- Për BOE “B.M K.” SHPK & “Rr. G.” SHPK, nga kontrolli i dokumentacionit në SPE, ka rezultuar se:

Titulli i gjetjes nr.9 Mbi zbatimin e kriterëve për kualifikim.

Situata:

-BOE “B.M K.” SHPK & “Rr. G.” SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në DT, pika 2.3.11. iv, për të përmbushur kriterin për mjetet që duhet të ketë në dispozicion, pasi mjete autobitumatriçe me targa AA...HV, nuk ka Certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm.

-Certifikatat ISO të OE “B.M K.” SHPK, nuk janë të përkthyer dhe noterizuara, në kundërshtim me DT, ku është cilësuar se gjuha e ofertës është gjuha shqipe.

-OE “Rr. G.” SHPK, për përmbushjen e kriterit “Kapaciteti ekonomiko-financiar”, ka paraqitur vërtetim mbi shlyerjen e taksave vendore të Bashkisë Shkodër për vitin 2017-2018 dhe të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2017, në kundërshtim me kërkesat e DT, pika 2.2.5, ku kërkohen për vitin 2017-2018.

Sa më sipër, KVO ka shpallur fitues BOE “B.M K.” SHPK & “Rr. G.”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Kriteri:	SHPK, edhe pse nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim të përcaktuara në DT. Sa më sipër KVO ka vepruar në kundërshtim me: - VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 3, ku cilësohet: <i>Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.</i>
Shkaku Ndikimi	Mosvlerësim i KVO-së në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT. Kualifikim i padrejtë i BOE, pa plotësuar të gjithë kriteret e përcaktuara në DT, ka shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 6,878,484 lekë pa tvsh, pasi procedura duhej të anulohet.
Rëndësia (U/M/L)	L
Rekomandimi	-

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Anëtarët e KVO-së.

Të tjera.

Titulli i gjetjes: "Mbi dokumentimin e procedurës së prokurimit nga KVO"

Situata 1: -Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Procesverbalin e hapjes së ofertave nr. 1, datë 24.09.2018 me nr. Protokolli 14825/6;

Situata 2: - Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Procesverbalin e shqyrtimit të ofertave nr. 2, datë 01.10.2018 me nr. Protokolli 14825/7;

Situata 3: - Anëtarët e KVO-së nuk kanë Formularin mbi konfliktin e interesit.

Kriteri 1/2: Veprim në kundërshtim me VKM , neni 64 "Hapja e ofertave", pika 5, ku cilësohet: *"Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 12 të LPP.*

Kriteri 3: Veprim në kundërshtim me VKM, neni 64 "Hapja e ofertave", ku cilësohet: *"Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës".*

Shkaku Ndikimi Mosveprim i anëtarëve të KVO-së dhe neglizhencë e NJP.

Rekomandimi Moslënie gjurmë për veprimet dhe vendimmarrjen e tyre.

Rëndësia (U/M/L) M



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Rekomandimi -

9. Mbi procedurën me objekt “Ndërtim trotuari dhe sistemim kanali Gomsiqe”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim trotuari dhe sistemim kanali Gomsiqe”		
Urdhër Prokurimi nr.862, datë 25.10.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 862, datë 25.10.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 863, datë 25.10.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozime	E. D., Jurist D. K., Specialiste Xh. R., Specialiste	A. K., Kryetar N. D., Anëtar A. S., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 10,291,788 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 8,542,254 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 1,749,534 lekë
Data e hapjes së procedurës: 05.11.2018, ora 14.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017 me vlerë 12,351,000 lekë.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 4 (katër) OE b. Kualifikuar: 3 (tre) OE c. S’kualifikuar: 1 (një)
Ankimime: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga AK.: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga: Nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Kërkesë për propozim” me vlerë 10 lekë pa TVSH, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018, në përputhje me LPP neni 34 dhe VKM neni 39 “Kërkesa përpropozime”, duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE⁴².

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga “C..” SHPK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, Projekti teknik, Raporti Teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 10,350,145 lekë pa TVSH dhe 12,350,145 lekë me TVSH. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, personi përgjegjës znj. Xh. R., është mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2, ku cilësohet:

*“Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’ireferohet një ose më shumë alternativavetë renditura si mëposhtë:
çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe
çmimet e tregut;ose/dhe
çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe*

⁴² VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Grupi i punës i krahasoi çmimeve sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara dhe nga krahasimi i të cilave nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.158/2a	170	170	0
3.137	689	689	0
3.240	10,318	10,318	0
3.243/1	11,237	11,237	0
2.575	80,883	80,883	0
An151	1,442	1,442	0
An99	6,326	6,326	0
3.620	1,305	1,305	0
3.379	1,840	1,840	0
3.An.164/1b	1,441	1,441	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

Nr	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Oferta ekonomike
1	“S.” SHPK	7,892,464
2	“M.F I. G.” SHPK & “M./S” SHPK	8,542,254
3	“P.V.K.” SHPK	9,242,822
4	“L.” SHPK	9,796,639

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga KVO, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik, referuar kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, ka kualifikuar 3 OE dhe ka skualifikuar 1 prej tyre. Nga Grupi i auditimit u verifikua në SPE oferta më e ultët se oferta e shpallur fituese, dhe rezultoi:

Nr	Operatorët ekonomikë të skualifikuar	Oferta ekonomike
1	“S.” SHPK	7,892,464

- OE “S.” SHPK, është skualifikuar pasi nuk ka përmbushur kriteret e kualifikimit për sa më poshtë:

Nuk ka plotësuar kriterin për punë të ngjashme. Kontratat e paraqitura janë.

Nr	Kontratat	Vlera
1	Per objektin Porta hekuri dhe prize betoni per kanalet ujites (Nuk është punë e ngjashme)	-
2	Rikonstruksion i rruges Kuc-Malas,Bashkia Ura Vajgurore	3 955 983
3	Ndertim trotuari rruga Pashtriku dhe reabilitime pjesore ne rrugica dhe trotuare te brendshme ne Qytetin Krume	1 265 691
4	Ndertim i kanaleve te ujrave te bardha Drenove	1 683 369
5	Reabilitim urban i territorit prapa teatrit A.Z.Cajupi	5 567 861



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Për objektin “Ndërtim i kanaleve të ujrave të bardha Drenovë”, mungon Formulari i vlerësimit për realizimin me sukses të investimit.

Totali i puëve të ngjashme të paraqitur për tre objekte është në vlerën 10,789,535 lekë, më pak se dyfishi i vlerësimit të kontratës që po prokurohet në shumën 20,583,576 lekë, kërkesë e DT pika 2.3.1/b .

Kamioni me targa FR.... nuk është vetshkarkues siç kërkohet në DT, kriteri 2.3.12.

Mjeti “Autobetoniere” me targa GJ....B, nuk përmbush kriteret, pasi policës së sigurimit i ka mbaruar afati më datë 02.11.2018 dhe nuk ka foto;

Mjeti “Autobetoniere” me targa GJ....B, nuk përmbush kriteret, pasi policës së sigurimit i ka mbaruar afati më datë 02.11.2018 dhe nuk ka foto dhe taksat e paguara etj, sipas kriterit 2.3.12/ii dhe v;

Kontrata datë 21.05.2018 midis shoqërisë “S.” SHPK dhe A. V. për mjetet e marra me qira nuk është e noterizuar, kërkesë e DT pika 2.3.12/iv.

Sa më sipër, KVO ka shpallur fitues OE me ofertën më të ulët, që ka plotësuar kriteret e kualifikimit BOE “M.F I. G.” SHPK & “M./S” SHPK, referuar kriterit të vlerësimit “çmimi më i ulët”.

Të tjera:

Titulli i gjetjes: "Mbi dokumentimin e procedurës së prokurimit nga KVO"

Situata 1:	Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Procesverbalin e hapjes së ofertave nr. 1, datë 24.09.218 me nr. Protokolli 14825/6;
Situata 2:	Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Procesverbalin e shqyrtimit të ofertave nr. 2, datë 01.10.218 me nr. Protokolli 14825/7;
Situata 3:	Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Raportin përmbledhës.
Situata 4:	Anëtarët e KVO-së nuk kanë Formularin mbi konfliktin e interesit.
Kriteri 1/2/3:	Veprim në kundërshtim me VKM , neni 64 "Hapja e ofertave", pika 5, ku cilësohet: <i>"Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 12 të LPP.</i>
Kriteri 4:	Veprim në kundërshtim me VKM, nenin 64 "Hapja e ofertave", pika 1, ku cilësohet: <i>"Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës".</i>
Shkaku	Mosveprim i anëtarëve të KVO-së dhe neglizhencë e NJP.
Ndikimi	Moslënie gjurmë për veprimet dhe vendimmarrjen e tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Rëndësia (U/M/L)	M
Rekomandimi	-

10. Mbi procedurën me objekt “Ndriçim i Rrugës Fermentim-Ura e Bardhajve”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndriçim i Rrugës Fermentim-Ura e Bardhajve”		
Urdhër Prokurimi nr.255, datë 20.03.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 255, datë 20.03.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 256, datë 20.03.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozime	E. D., Jurist D. K., Specialiste E.S., Specialist	A. L., Kryetar J. G., Anëtare V. Sh., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 6,666,666 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 5,496,456 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 1,382,028 lekë
Data e hapjes së procedurës: 03.04.2018, ora 14.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017 në shumën 8,000,000 lekë.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 2 (dy) OE b. Kualifikuar: 1 (nje) OE c. S'kualifikuar: 3 (dy)
Ankimime: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Kërkesë për propozim” me vlerë 6,666,666 lekë pa TVSH, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018, në përputhje me LPP neni 34 dhe VKM neni 39 “Kërkesa përpropozime”, duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE⁴³.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, z. M. Z.. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, projekti teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 6,666,666 lekë pa TVSH dhe 7,999,999 lekë me TVSH. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, personi përgjegjës z.E.S., është mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2, ku cilësohet:

“Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’ireferohet një ose më shumë alternativavetë renditura si mëposhtë:
çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe
çmimet e tregut;ose/dhe
çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

⁴³ VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Grupi i punës i krahasoi çmimeve sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara dhe nga krahasimi i të cilave nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.An/1sh	23,635	23,635	0
2.426/3	3,509	3,509	0
3.212/b	449	449	0
3.231/1	993	993	0
3.228/1	1,085	1,085	0
3.An/et	1,087	1,087	0
3.242	10,537	10,537	0
3.621	959	959	0
An-1	47,498	47,498	0
An-4	1,170	1,170	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

Nr	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Oferta ekonomike
1	“B.” SHPK	4,504,046
2	“P.” SHPK & “J.” SHPK	5,928,804

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga KVO, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik, referuar kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, ka kualifikuar 1 OE dhe ka skualifikuar 1.

Nga Grupi i auditimit u verifikuan në SPE 2 ofertat e mësipërme dhe rezultoi:

OE “B.” SHPK, nuk ka përmbushur kriteret për kualifikim në përputhje me DT:

Nuk ka përmbushur kriterin mbi paraqitjen e punëve të ngjashme pasi:

-Kontrata mes shoqërisë B. SH.P.K dhe F. Sh. te Zh. me objekt “Sistemimi dhe asfaltimi i rruges “Mertish-Tre Urat” është e paplote pasi i mungon shtojca 18, kushtet e veçanta të kontratës;

-Për kontratën me objekt: Sistemimi dhe asfaltimi i rruges “Mertish-Tre Urat” nuk është paraqitur Certifikata e marrjes në dorëzim të punimeve, përcaktuar në DT pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik”;

-Specifikimet teknike për ndricuesin Led të paraqitura nga ana juaj nuk përputhen me specifikimet teknike të publikuara nga AK konkretisht:

-Ndricimi është kërkuar të jetë me i madh se 10.000 lm ndërsa në katalogun e paraqitur është 9300 lm;

-Fuqia është kërkuar të jetë 90ë, ndërsa nga OE është paraqitur 84 ë;

-Eficenca është kërkuar 114 lm/ë, është paraqitur 111 lm/ë;

-Dimensionimi hyrës i ndricuesit të propozuar është max ø60 mm, sipas projektit duhet të ishte paraqitur ø76mm; etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

<u>Titulli i gjetjes nr.10</u>	Mbi zbatimin e kriterëve për kualifikim.
Situata:	Nga KVO, është cilësuar se OE "B." SHPK, për kamionin me targë AA ...LM nuk ka paraqitur pagesën e taksës së qarkullimit, gjë e cila nuk është kërkesë e DT.
Kriteri:	Sa më sipër KVO ka vepruar në kundërshtim me: - LPP me ndryshime, neni 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", pika 2 ku cilësohet: <i>Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.</i>
Shkaku	Mosvlerësim i KVO-së në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT.
Ndikimi	Nuk ka patur ndikim konkret, pasi OE nuk ka plotësuar disa kriterë.
Rëndësia (U/M/L)	M
Rekomandimi	-

Sa më sipër, KVO ka kualifikuar OE, "P." SHPK & "J." SHPK, i cili ka plotësuar kriteret për kualifikim.

Të tjera:

Titulli i gjetjes: "Mbi dokumentimin e procedurës së prokurimit nga KVO"

Situata 1: - Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Procesverbalin e hapjes së ofertave nr. 1, datë 03.04.2018 me nr. Protokolli 4166/6;

Situata 2: - Anëtarët e KVO-së nuk kanë firmosur Procesverbalin e shqyrtimit të ofertave nr. 2, datë 10.04.2018 me nr. Protokolli 4166/7;

Situata 3: - Procesverbali nr. 4166, datë 20.03.2018, mbi përllogaritjen e vlerësimit të kontratës nuk është firmosur nga personi përgjegjës, E.S..

- Procesverbali nr. 4166/2, datë 20.03.2018, mbi miratimin e DT, nuk është firmosur nga personi përgjegjës, E.S., anëtar i NJP.

- Anëtarët e KVO-së nuk kanë Formularin mbi konfliktin e interesit.

Situata 4: - DT, nuk janë firmosur nga z. E.S..

Situata 5:

Situata 6:

Kriteri 1/2/3/4: Veprim në kundërshtim me VKM , neni 64 "Hapja e ofertave", pika 5, ku cilësohet: "Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 12 të LPP.

Kriteri 5: Veprim në kundërshtim me VKM, nenin 64 "Hapja e ofertave", ku



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

cilësohet: "Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës".

Kriteri 6:

Veprim në kundërshtim me VKM, neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, ku cilësohet: "...Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit...".

Shkaku

Mosveprim i anëtarëve të KVO-së dhe neglizhencë e NJP.

Ndikimi

Moslënie gjurmë për veprimet dhe vendimmarrjen e tyre.

Rëndësia (U/M/L)

M

Rekomandimi

NJP të marrë masa për eliminimin e rasteve të tilla, duke kërkuar jo vetëm plotësimin e dokumentacionit mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit nga ana e KVO-ve, por edhe nënshkrimin e tyre, me qëllim lënien e gjurmës së auditimit, mbi veprimet e kryera.

11. Mbi procedurën me objekt "Rikonstruksion i Rrugës Oblikë-Velinaj"

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i Rrugës Oblikë-Velinaj"		
Urdhër Prokurimi nr.967, datë 07.12.2018.	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 967, datë 07.12.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 970, datë 07.12.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozime	E. D., Jurist D. K., Specialiste E. D., Specialist	A. C., Kryetar I. M., Anëtar N. D., Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 7,610,563 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 6,312,357 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 1,298,206 lekë
Data e hapjes së procedurës: 21.12.2018, ora 14.00	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 85, datë 26.12.2017 në shumën 7,980,000 lekë.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 5 (pesë) OE b. Kualifikuar: 1 (nje) OE c. S'kualifikuar: 4 (katër)
Ankimime: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër

Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i "Kërkesë për propozim" me vlerë 7,610,563 lekë pa TVSH, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018, në përputhje me LPP neni 34 dhe VKM neni 39 "Kërkesa përpropozime", duke i dërguar kërkesë për pjesëmarrje 5 OE⁴⁴.

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria "K. RGJ" SHPK. Pjesë e dosjes së prokurimit janë, projekti teknik, Specifikimet Teknike, Preventivi sipas zërave dhe sasisë dhe Grafiku i Punimeve.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e TAK nr. 80, datë 29.01.2018, pasi janë përcaktuar specifikimet teknike, është hartuar preventivi me vlerë totale 7,610,563 lekë pa TVSH dhe 9,132,675 lekë me TVSH. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, personi përgjegjës z.E. D.,

⁴⁴ VKM 914, datë 29.12.2014, neni 39, pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

është mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteri: LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2, ku cilësohet:

“Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’ireferohet një ose më shumë alternativavetë renditura si mëposhtë:

çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

çmimet e tregut;ose/dhe

çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Grupi i punës i krahasoi çmimeve sipas Manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me ato të preventivuara dhe nga krahasimi i të cilave nuk rezultuan diferenca.

Emërtimi	Preventivi	Manuali	Diferenca
3.98/b	259	259	0
3.89/a	361	361	0
2.426/3	3,509	3,509	0
3.158/2a	170	170	0
3.207	391	391	0
3.212/b	449	449	0
3.243	11,105	11,105	0
3.228/1	1,085	1,085	0
3.231/1	993	993	0
3.287	107,213	107,2015	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër & Manuale
Punoi: KLSH

Mbi vlerësimin e ofertave

Nr	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Oferta ekonomike
1	“A.A.” SHPK & “K. G. K.” SHPK	4,573,040
2	“K.” SHPK	4,680,219
3	“Rr. G.” SHPK	5,626,371
4	“S. M. O. V.” SHPK & “S. M. O. U.” SHPK	6,312,357
5	“L. V.” SHPK	6,751,890

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga KVO, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik, referuar kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, ka kualifikuar 1 OE dhe ka skualifikuar 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Nga Grupi i auditimit u verifikuan në SPE, 3 ofertat me vlerë më të vogël se oferta fituese, ku rezultoi:

OE “A.A.” SHPK & “K. G. K.” SHPK, nuk ka përmbushur kriteret për kualifikim, pasi nuk ka paraqitur:

- Punë të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkimin mes dy shoqërive pasi nuk ka paraqitur miratimin e Autoritetit Kontraktor për nënkontraktimin;
- Certifikatat ISO sipas përqindjes së pjesëmarrjes në bashkimin mes dy shoqërive;
- Asnjë deshmi kualifikimi për punonjësit e kërkuar në DT sipas përqindjes së pjesëmarrjes në bashkimin mes dy shoqërive;

OE “K.” SHA, nuk ka përmbushur kriteret për kualifikim, pasi nuk ka paraqitur:

-Në deklaratën për punët në proces apo që është shpallur fitues nuk ka deklaruar kontratën me objekt: Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë Rruga "Lezhë-Nënkalimi Milot; Lidhja e 2 urave-K/Pllanë-U.Zogut; Lezhë-H.Gjuetisë; U.Drojes-Milot; Laç-Patok dhe Balldre-B Juge 77.85 km”.

-Nuk ka paraqitur shtojcën nr.4, për teknikun e ndërtimit nuk ka paraqitur diplomën e shkollës.

-Nuk ka paraqitur dokumentacion se disponon mjetet “Autobitumatriçe” dhe “Autobot uji”.

OE “Rr. G.” SHPK, nuk ka përmbushur kriteret për kualifikim, pasi nuk ka paraqitur:

-Certifikatës së transportit për mallrat e rrezikshme për mjetin autobitumatriçe i ka mbaruar afati i vlefshmerisë;

-Taksa e kamionit me targe AA...BF ishte jashtë afatit të vlefshmerisë.

OE “L. V.” SHPK, nuk ka përmbushur kriteret për kualifikim, pasi nuk ka paraqitur:

-Inxhinieri topograf nuk figuronte në listëpagesën e muajit tetor 2018, ndërsa në muajin nëntor nuk figuron me kohë të plotë;

-Tekniku i ndërtimit R.S nuk figuronte në listëpagesën e muajit nëntor 2018.

Titulli i gjetjes nr.11 Mbi zbatimin e kriterëve për kualifikim.

Situata:

-BOE “S. M. O. V.” SHPK & “S. M. O. U.” SHPK, është shpallur fitues, për ofertën me vlerë 6,312,357 lekë.

Nga këqyrja e ofertës në SPE, rezulton se BOE, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për përmbushjen e kriterit për kapacitetin teknik të përcaktuar në DT, pika 2.3.11/ii dhe iv.

Për rrjedhojë në kushtet që asnjë prej OE nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim, procedura duhej të anulohet.

Kriteri:

Sa më sipër KVO ka vepruar në kundërshtim me:

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3, ku cilësohet: *Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Shkaku

Ndikimi

Mosvlerësim i KVO-së në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT.

Kualifikim i padrejtë i BOE, pa plotësuar të gjithë kriteret e përcaktuara në DT, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore** në vlerën **7,610,563** lekë pa tvsh, pasi **procedura duhej të anulohet.**

Rëndësia (U/M/L)

L



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Rekomandimi -

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Anëtarët e KVO-së.

Titulli i gjetjes: "Mbi dokumentimin e procedurës së prokurimit nga KVO"

Situata 1:	- Anëtari i KVO-së, N. D. nuk ka firmosur Procesverbalin e hapjes së ofertave nr. 1, datë 21.12.2018 me nr. Protokolli 20384/6;
Situata 2:	- Anëtari i KVO-së, N. D. nuk ka firmosur Procesverbalin e shqyrtimit të ofertave nr. 2, datë 03.01.2018 me nr. Protokolli 20384/7;
Situata 3:	- Raporti Përmbledhës nr. 20384/9, datë 11.01.2019, nuk është firmosuar nga anëtari i KVO-së N. D..
Situata 4:	- Anëtari i KVO-së, N. D. nuk ka Formularin mbi konfliktin e interesit. - Procesverbali nr. 20384/2, datë 07.12.2018, mbi miratimin e DT, nuk është firmosur nga D. K., anëtare e NJP.
Situata 5:	Veprim në kundërshtim me VKM , neni 64 "Hapja e ofertave", pika 5, ku cilësohet: <i>"Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 12 të LPP.</i>
Kriteri 1/2/3:	
Kriteri 4:	Veprim në kundërshtim me VKM, nenin 64 "Hapja e ofertave", pika 2, ku cilësohet: <i>"Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës".</i>
Kriteri 5:	Veprim në kundërshtim me VKM, neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, ku cilësohet: <i>"...Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit..."</i> .
Shkaku	Mosveprim i anëtarëve të KVO-së dhe neglizhencë e NJP.
Ndikimi	Moslënie gjurmë për veprimet dhe vendimmarrjen e tyre.
Rëndësia (U/M/L)	M
Rekomandimi	NJP të marrë masa për eliminimin e rasteve të tilla, duke kërkuar jo vetëm plotësimin e dokumentacionit mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit nga ana e KVO-ve, por edhe nënshkrimin e tyre, me qëllim lënien e gjurmës së auditimit, mbi veprimet e kryera.

Për sa është trajtuar më lart (pika D3 e Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 8 dhe 9, datë 01.08.2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

1. Mbi procedurën me objekt “Rikualifikimi urban Blloqe banimi, “Bulevardi Zogu I” (Xhabije)”, Bashkia Shkodër

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban Blloqe banimi, “Bulevardi Zogu I” (Xhabije)”, Bashkia Shkodër.		
1. Urdhër Prokurimi Nr 460, Datë 19.06.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Njësia e Prokurimit 1. E. D., me detyrë Përgjegjës i sektorit juridik 2. D. K., specialiste Inxhinier 3. I. T., specialist Inxhinier	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr 461, Datë 19.06.2018 1. F. Sh., zv. Kryetar i Bashkisë Shkodër, Kryetar 2. J. V., specialist i fushës, anëtar 3. M. F., ekonomiste, anëtar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “I hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 15,766,715 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 11,045,648 lekë (70% e fondit limit)	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,721,067 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 23.07.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 11 OE (3 BOE) b) Skualifikuar 8 OE (2 BOE), c) Kualifikuar 3 OE (1 BOE)
11. Ankimim në AK me nr. 13191/1 prot, datë 13.08.2018 (N.)	12. Përgjigje Ankesës nr. 13191/3 prot datë 17.08.2018	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka.

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender “I hapur” me vlerë 15,766,715 lekë pa TVSH, i cili do të financohet në vitin buxhetor 2018.

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit

I. Nga auditimi i dosjes së tenderit u konstatua se nga ana e Njesisë së Prokurimit janë përcaktuar kriteret e veçanta të kualifikimit (KVK), si më poshtë:

...

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 10 (dhjetë) copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 1 (nje) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 (dy) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 2 (dy) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi 2 (dy) copë

.....

Grupi i auditimit konstaton se kriteret e mësipërme janë të tepërta dhe nuk duhet të ishin vendosur në KVK, pasi këto pajisje janë objekt kontrolli nga Inspektorati i Punës dhe nuk është e nevojshme që të vendosen në KVK.

Përsa sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Mbi vlerësimin e ofertave

Nr	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Oferta ekonomike
----	----------------------------------	------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

1	“Sh. K.” SHPK	9,412,152
2	“A.” SHPK	9,845,642
3	“N.” SHPK	10,309,778
4	“L.” SHPK, & “A. K.” SHPK	11,045,648
5	“D. I.” SHPK	11,460,500
6	“K.” SHPK, & “Rr. G.” SHPK	11,788,497
7	“V. E” SHPK	11,835,468
8	“S.” SHPK	11,937,621
9	“B.” SHPK	12,220,467
10	“A.T.” SHPK	13,369,860
11	“V.” SHPK, & “L.” SHPK	13,881,794

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga KVO, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik, referuar kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, ka kualifikuar 3 OE dhe ka skualifikuar 8.

Nga Grupi i auditimit u verifikuan në SPE, 3 ofertat me vlerë më të vogël se oferta fituese dhe ofertën fituese, ku rezultoi:

1. Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE nga OE “**Sh. K.**” SHPK, u konstatua si më poshtë:

-Në ofertën ekonomike është bërë gabim aritmetik në masen 5.29% dhe në bazë të nenit 66, pika 4, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, OE “Sh. K.” SHPK është skualifikuar me të drejtë.

2. Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE nga OE “**A.**” SHPK, u konstatua si më poshtë:

- Shtojcën 11, deklarata nga administratori i Shoqërisë se OE plotëson pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik, është e plotësuar sipas DT të hedhura në SPE. Nuk ka mosplotësim të kriterit.

-Sipas licencës së punimeve NZ...../.., z.G. H. figuron si drejtues ligjor, sepse kjo licencë është e vitit 2013 dhe me afat skadence deri në 02.12.2019, brenda afatit të realizimit të prokurimit. Sipas Ekstraktit Historik, ky drejtues ligjor është ndryshuar (zëvendësuar) në datën 11.10.2017. Nuk ka mosplotësim të kriterit.

- Në dokumentet e tenderit (DT) është kërkuar “6.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë Ofertuese se inxhinieri i ndertimit, inxhinieri elektrik,inxhinieri i mjedisit dhe inxhinieri topograf janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.” Nga OE është plotësuar një deklaratë sipas të cilës “...Të gjithë inxhinierët dhe punonjësit e kërkuar në pikën 2.3.3 për kualifikim, nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera fituese dhe janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate”. Në DT nuk ka të shpjeguar mënyrën se si duhet plotësuar kjo deklaratë. Përsa sipër nuk ka mosplotësim të kriterit.

- Automjeti i paraqitur është cisternë dhe jo autobot. Ka mosplotësim kriteri.
Përsa sipër, OE “A.” SHPK është skualifikuar me të drejtë.

3- Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE nga OE “**N.**” SHPK, u konstatua si më poshtë:

-Nga verifikimi, rezulton se certifikata e transportit per autobitumatricen me targa KO....B nuk është në SPE; Përsa sipër ka mosplotësim të kriterit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

-Nga verifikimi, dokumentacioni i kërkuar për kompletin e ndihmës së shpejtë është në SPE.
Përsa sipër nuk ka mosplotësim të kriterit

-Nga verifikimi i SPE, rezulton se për objektet e përmendura, OE “N.” është shpallur fitues në datën 11.07.2018, para datës së hapjes së ofertave. Përsa sipër nuk ka mosplotësim të kriterit
Ky OE është skualifikuar me të drejtë nga KVO.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE nga BOE fitues “L.”SHPK & “A. K.” SHPK, u konstatuan mangësitë si më poshtë:

- Bilanci i vitit 2015 të OE “L.” SHPK, është i pacertifikuar nga Dega e Tatim Taksave, ashtu siç kërkohet në pikën 2.2.2 të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit (KVK).
- Shtojca 10 “Mbi disponimin e makinerive dhe pajisjeve” të OE “A. K.” SHPK është për objektin “Ndërtimi i depos qendrore të re të barnave QSUT”.
- Inxhinieri elektrik Xh. S. nuk është në listëpagesat e “A. K.” SHPK në tre muajt e fundit.
- Inxhinierja gjeodete M. K. nuk është në listëpagesat e “A. K.” SHPK në muajin Qershor.
- Mjeti i paraqitur për autobitumatriçe me targa AA...IS, është kamion.
- Sipas licencës së punimeve NZ...../. znj.V. J. dhe z. S. K., figurojnë si drejtues ligjorë ndërsa nuk figurojnë tek drejtuesit ligjorë të shoqërisë sipas Ekstraktit Historik.

Nga sa sipër, KVO në vlerësimin e ofertave ka gjykuar subjektivisht, duke bërë kualifikimin e BOE “L.”SHPK & “A. K.” SHPK. Nëse do të vlerësoheshin drejt ofertat e pjesëmarrësve në këtë tender, edhe ky OE duhej skualifikuar dhe shpallur fitues oferta pasardhëse e OE “B.” SHPK, me ofertë ekonomike 12,220,467 leke pa tvsh, më të lartë se oferta fituese.

Titulli i gjetjes nr. Mbi zbatimin e kriteve për kualifikim.

Situata: -BOE “L.”SHPK & “A. K.” SHPK, është shpallur fitues, për ofertën me vlerë 11,045,648 lekë.

Nga këqyrja e ofertës në SPE, rezulton se BOE, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për përmbushjen e kriterit për kapacitetin teknik të përcaktuar në DT.

Për rrjedhojë në kushtet që ky OE nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim, duhej skualifikuar dhe shpallur fitues OE “B.” SHPK, me ofertë ekonomike 12,220,467 leke pa tvsh.

Kriteri: Sa më sipër KVO ka vepruar në kundërshtim me:

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3, ku cilësohet: *Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Shkaku Mosvlerësim i KVO-së në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT.

Ndikimi Kualifikim i padrejtë i BOE, pa plotësuar të gjithë kriteret e përcaktuara në DT, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore** në vlerën **15,766,715** lekë pa tvsh.

Rëndësia (U/M/L) L

Rekomandimi -



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Anëtarët e KVO-së.

- Mbi procedurat e prokurimit të zhvilluara 01.01.2019 deri në 30.06.2019

D. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797 datë 29.12.2017, për periudhën 01.01.2019-31.05.2019

Nga Bashkia Shkodër është përgatitur regjistri i parashikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit për APP, të cilat në zbatim të udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publike dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, pika 3 dhe Kreu II-Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit, janë dërguar online. Në Degën e Thesarit Shkodër janë dërguar me shkresën nr. 668 prot, datë 15.01.2019 regjistri i parashikimeve për vitin 2019. Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë më parë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi më parë të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, si dhe në përputhje midis parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar dhe në VKB.

Për aktivitetin e 6/mujorit viti 2019, nga Bashkia Shkodër janë kryer gjithsej 30 procedura prokurime me vlera të larta, fondi limit i llogaritur është në vlerën 347,185 mijë lekë për të cilat lidhur kontrata me OE/BOE, në vlerën 250,232 mijë lekë ose për diferencë në vlerën 96,954 mijë lekë ose 28% më pak se fondi limit. Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, mbi bazën e të dhënave nga subjekti (*fondeve të prokuruar për 5/mujorin e vitit 2019, llog. 602/231*), grupi i auditimit nga 30 procedura me vlerë kontrate 250,232 mijë lekë, auditoi 4 procedura me vlerë 108,773 mijë lekë, ose 44 % e totalit të kontratave.

Më poshtë po trajtojmë rastet të cilat janë evidentuar mangësi për procedurat e prokurimit 01.01.2019-31.05.2019.

1-Tenderi me objekt: “Rikonstruksion Rruga Udhakryq” (REF-06863-02-07-2019), me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rikonstruksion Rruga Udhakryq”, viti 2019”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 75 datë 07.02.2019 (prot nr. 1931/1)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit urdhër nr. 75, datë 07.02.2019 1.E. D. 2. D. K. 3. R. T.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 76, datë 07.02.2019 prot, 1931/5) 1. P. M. 2. J. G. 3. J. V.
Lloji i Procedurës “Hapur”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 24,482,500 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) - BOE SMO V. & S. M. O. U. ofertë 20,811,378 lekë pa TVSH me kontratë nr. 1931/12 prot, datë 10.04.2019 , me afat 4 muaj nga dita që kontraktorit I jepet leja për te hyre në kantier.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 3,671,122 ose 14.9 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 11.03.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE. b)Skualifikuar 3 OE/BOE



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

		c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- s'ka; KPP----- APP-s'ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr. ----, dt. ----

Situata:

Me urdhrin nr. 34, datë 21.01.2019, Titullari i AK ka ngarkuar z. R. T. me detyrë arkitekt për hartimin e fondit limit. Nga ana e këtij personi është mbajtur procesverbal nr 1931, datë 07.02.2019 dhe nr. 1931 prot., për hartimin e fondit limit mbi investimin “Rikonstruksion Rruga Udhakryq”, me fonde nga Buxheti i Bashkisë. Mbi bazën e të dhënave nga ana e personit është mundësuar llogaritje e fondit limit në vlerën 24,482,500 lekë pa TVSH. Me procesverbal nr.1931/2, datë 07.02.2019 nga NJP është mundësuar hartimi i dokumenteve të tenderit (DST), në mbështetje të VKM nr. 629, datë 15.07.2015, me ndryshimet. Me procesverbal nr. 1, datë 11.03.2019 (prot, 1931/6), është kryer verifikimi i ofertave dhe me procesverbal nr. 2, datë 27.03.2019 (prot, 1931/7), është bërë vlerësimi i ofertave në mënyrë elektronike (brenda afatit ligjorë), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedure. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 OE/BOE dhe skualifikuar 3 (tre) për mos plotësim kriteresh nga KVO. Nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurën e zhvilluar, u konstatua se kualifikimi i BOE “S. M. O. U.” shpk & “S. M. O. V.” shpk, nuk është në përputhje me kriteret e DST, pasi disa prej tyre nuk plotësohen, e konkretisht:

- kontrata e paraqitur me nr. 1639/660, datë 7.3.2019, ndërmjet qiradhënësit subjektivit “D. B.” dhe qiramarrësit shoqërisë “S.M.O. V.” për mjetin tip kamionçinë me targë AA...UX dhe kapacitet 7.5 deri 18 ton, I mungon leje e bashkisë (sipas pikës 11 të DST).
- të dy shoqëritë paraqesin të njëjtin mjek, konkretisht mjekun “Y. Z.”, kur secili nga shoqëritë duhet të këtë mjekun e vet, të siguruar (pika 8 e DST). Sipas listepagesave shoqëria “S. M. O. V.”, nuk ka paguar sigurim për mjekun e deklaruar.
- Shoqëria “S. M. O. U.”, në licencën e shoqërisë nuk ka të përfshirë drejtuesin teknik, që në rast konkret është “R. A.”, sic kërkohet në (pikën 7 të DST). Gjithashtu nuk mund të jetë i njëjti drejtues teknik i deklaruar për të dy shoqëritë.
- shoqëria “S.M.O U.”, nuk paraqet 1(një) inxhinier Topograf, Gjeodet, Markshaidet, Gjeomatik siç kërkohet në (pikën 5 të DST), por ka paraqitur ing. Hidro (ing. O. M.).
- nuk plotësohet pika 11 e DST, ku thuhet se: Për te gjitha mjetet e marra me qira/furnizim, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit ku të specifikohet objekti që tenderohet si dhe afati i kontratës, konkretisht:
- Kontrata nr. 146/75, datë 16.2.2019, e lidhur midis shoqërisë ”G.” (qiradhënë) dhe shoqërisë ”S. M. O. U.” (qiramarrës), për mbetin tip ”Autobot uje” me targe AA...UO, nuk është përcaktuar objekti i kontratës.
- Kontrata nr. 147/76, datë 16.2.2019 e lidhur midis shoqërisë ”G.”(qiradhënë) dhe shoqërisë ”S. M. O. U.” (qiramarrës), për mjetin tip ”Autobitumatrice” me targe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

AA...UB, **nuk është përcaktuar objekti i kontratës.**

Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi: anëtarët e KVO P. M., kryetar i KVO, me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Guri I Zi, antarët e KVO-së J. G. me detyrë, Specialiste në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor dhe J. V. me detyrë, Specialist në Sektorin e Studimit, Projektimit të Investimeve të Bashkisë.

Kriteri:

Në kundërshtim me: nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, neni 24 “Anullimi i një procedure prokurimi” pikën 5 e neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe neni 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime.

Impakti:

Shpallja fitues BOE “S. M. O. U.” shpk & “S. M. O. V.” shpk, me fond limit 24,482,500 lekë pa TVSH dhe me vlerë të ofertës ekonomike 20,811,378 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, është veprim në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa ekonomicitet në vlerën **24,482,500 lekë**.

Shkaku:

Nga mos vlerësim i drejtë i kriterëve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit të LPP.

Rëndësia

E lartë.

Rekomandimi

Bashkia Shkodër të analizojë arsye të kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomik, të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST dhe kualifikohen, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, pasi këta OE nuk japin garanci për kryerjen me cilësi të kontratës.

2-Tenderi me objekt: “Sistemim asfaltim rruga nacionale pika Ada – By Pass” (REF-10066-02-21-2019), me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Sistemim asfaltim rruga nacionale pika Ada – By Pass”, viti 2019”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 123 datë 21.02.2019 (prot nr. 2830/1)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit urdhër nr.123, datë 21.02.2019	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.124, datë 21.02.2019 prot
2. Lloji i Procedurës “Hapur”	1.E. D. 2. D. K. 3. Xh. R.	1. V. P. 2. J. V. 3.J. G.
5. Fondi Limit (pa TVSH) 16,197,981 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) -BOE ”S. M. O. V.” & “S. M. O. U.” shpk ofertë 13,257,923 lekë me kontratë nr. 2830/12 prot, datë 16.05.2019 , me afat 60 ditë kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 2,940,058 ose 18.15 %
8. Data e hapjes së tenderit datë 25.03.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 5 OE/BOE b) Skualifikuar: 3 OE/BOE c) Kualifikuar: 2 OE/BOE
11. Ankimime AK- s’ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

KPP----- APP-s'ka/ka;		Shkresa nr. ----, dt. ----
--------------------------	--	----------------------------

Situata:

Me urdhrin nr. 34, datë 21.01.2019, Titullari i AK ka ngarkuar z. R. T. me detyrë arkitekt për hartimin e fondit limit. Nga ana e këtij personi është mbajtur procesverbal datë 21.02.2019 dhe nr. 2830 prot., për hartimin e fondit limit mbi investimin “Sistemim asfaltim rruga nacionale pika Ada – By Pass”, me fonde nga Buxheti i Bashkisë. Mbi bazën e të dhënave nga ana e personit është mundësuar llogaritje e fondit limit në vlerën 16,197,981 lekë pa TVSH, në mbështetje të VKM nr. 629, datë 15.07.2015, me ndryshimet. Me procesverbal nr. 2830/2 , datë 21.02.2019 nga NJP është mundësuar hartimi i dokumenteve të tenderit (DST). Me procesverbal nr. 1, datë 25.03.2019 (prot, 2830/6), është kryer verifikimi i ofertave dhe me procesverbal nr. 2, datë 09.04.2019 (prot, 2830/7), është bërë vlerësimi i ofertave në mënyrë elektronike (brenda afatit ligjorë), në këtë procedurë kanë marrë pjesë 5 OE/BOE dhe skualifikuar 3 (tre) për mos plotësim kriteresh dhe kualifikuar 2(dy). Nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurën e zhvilluar, u konstatua se kualifikimi i BOE “S. M. O. U.” shpk &”S. M. O. V.” shpk, nuk është në përputhje me kriteret e DST, pasi disa prej tyre nuk plotësohen, e konkretisht:

- Nuk plotëson pikën 2.3/11 kapacitete teknike, pasi mjetet janë të deklaruara dhe në procedurën me objekt **“Rikonstrukcion Rruga Udhakryq”** (REF-06863-02-07-2019, procedura e cila është zhvilluar datë 11.03.2019, kontrat e lidhur datë 10.04.2019 dhe afat zgjatje 4 muaj/ ose 120 ditë, **pra deri me datë 10.08.2019**, deklarata këto në system.

- Nuk plotëson pikë 2.3.3 të DST, ku thuhet se: Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimi”, pasi shoqëria është kontraktore në objektin **“Rikonstrukcion Rruga Udhakryq”** (REF-06863-02-07-2019, dhe nuk ka plotësuar 100% të vlerës së punimeve.

- Nuk plotëson pikën 2.3.6 të DST, ku thuhet se: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë Ofertuese se **inxhinieri i ndertimit, inxhinieri topograf dhe inxhinieri i mjedisit**, janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate, **pasi këto janë të deklaruara dhe në objektin “Rikonstrukcion Rruga Udhakryq”** (REF-06863-02-07-2019, të pambyllur akoma.

- Nuk plotëson pikën 2.3.7 të DST, ku thuhet se: Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtimesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet, **pasi këto janë të deklaruara dhe në objektin “Rikonstrukcion Rruga Udhakryq”** (REF-06863-02-07-2019, të pambyllur akoma.

- Kontrata e paraqitur me nr. 1639/660, datë 7.3.2019, ndërmjet qiradhënësit “D. B.” dhe qiramarrësit shoqërisë “S.M.O. V.” për mjetin tip kamionçinë me targë AA...UX dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

kapacitet 7.5 deri 18 ton, I mungon leje e baskisë (sipas pikës 11 të DST).

- Të dy shoqëritë paraqesin tënjëjtin mjek, konkretisht mjekun "Y. Z.", kur secili nga shoqëritë duhet të këtë mjekun e vet, të siguruar (pika 8 e DST). Sipas listepagesave shoqëria "S.M.O. V.", nuk paguar sigurim për mjekun e deklaruar.

- Shoqëria "S. M. O. U.", në licencën e shoqërisë nuk ka të përfshirë drejtuesin teknik, që në rast konkret është "R. A.", sic kërkohet në (pikën 7 të DST).

Gjithashtu nuk mund të jetë i njëjti drejtues teknik i deklaruar për të dy shoqëritë.

-shoqëria "S.M.O. U.", nuk paraqet 1(një) inxhinier Topograf, Gjeodet, Markshaidet, Gjeomatik siç kërkohet në (pikën 5 të DST), por ka paraqitur ing. Hidro (ing. O. M.).

-Nuk plotësohet pika 11/iv e DST, ku thuhet se: Për te gjitha mjetet e marra me qira/furnizim, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit ku të specifikohet objekti që tenderohet si dhe afati i kontratës,konkretisht:

Kontrata nr. 146/75, datë 16.2.2019, e lidhur midis shoqërisë "G." (qiradhënës) dhe shoqërisë "S. M. O. U." (qiramarrës), për mbetin tip "**Autobot uje**" me targe AA...UO, nuk është përcaktuar objekti i kontratës.

Kontrata nr. 147/76, datë 16.2.2019 e lidhur midis shoqërisë "G." (qiradhënës) dhe shoqërisë "S. M. O. U." (qiramarrës), për mjetin tip "**Autobitumatrice**" me targe AA...UB, nuk është përcaktuar objekti i kontratës

Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi: anëtarët e KVO V. P. kryetar i KVO me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Rrethina, antarët e KVO-së J. G. me detyrë, Specialiste në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor dhe J. V. me detyrë, Specialist në Sektorin e Studimit, Projektimit të Investimeve të Bashkisë

Kriteri:

Në kundërshtim me: nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", neni 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", neni 24 "Anullimi i një procedure prokurimi" pikën 5 e nenit 53 "Shqyrtimi i ofertave", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" me ndryshime.

Impakti:

Shpallja fitues BOE "S. M. O. U." shpk &"S. M. O. V." shpk, me fond limit 16,197,981 lekë pa TVSH dhe me vlerë të ofertës ekonomike 13,257,923 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, është veprim në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa ekonomikitet në vlerën **16,197,981 lekë.**

Shkaku:

Nga mos vlerësim i drejtë i kriterëve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit te LPP.

Rëndësia

E lartë.

Bashkia Shkodër të analizojë arsyete kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomik, të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST dhe kualifikohen, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, pasi këta OE nuk japin garanci për kryerjen me cilësi të kontratës.

Rekomandimi

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 12, datë 08.08.2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

D. 4. Auditim për zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve

1. “Zbatim Rikualifikim Urban blloqe banimi “Tepe-tek Fusha e Druve”, Bashkia Shkodër

Zbatimi i punimeve

- Është bërë ndryshimi i gjurmës së rrugës së dhënë në projektin e zbatimit për bllokun 1, pa marrë miratimin e AK. Përsa sipër ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve.

- Gjithashtu, është bërë ndryshimi i zërit “Shtresë asfalti i gomuar” me “Shtresë asfalti me granil gur kave”. Sipas Procesverbalit “Për ndryshimin e zërave të punës dhe shtimin e zërave të paparashikuar, brenda vlerës së preventivit”, protokolluar me nr. 11131, datë 18.07.2017, sipërmarrësi i punimeve ka argumentuar ndryshimin e këtyre zërave me distancën e madhe me vendin e prodhimit të këtij lloj asfalti (Maqedoni) dhe për pasojë vështirësi në zbatimin e këtij zëri pune. Kjo kërkesë e miratuar nga titullari i AK, është bërë pa konsultimin me projektuesin dhe pa konsideruar faktin që vështirësitë e sipërcituara duheshin shqyrtuar nga OE fitues në fazën e përgatitjes së ofertës. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve dhe AK.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Zbatim Rikualifikim Urban blloqe banimi “Tepe-tek Fusha e Druve”, Bashkia Shkodër			
14.Lidhja e kontratës Nr. 13306/33 prot datë 15.05.2017	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 29,941,160 lekë OE fitues “P.V.K.” shpk		16.Likuiduar
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 29,941,157 lekë -Vlera pa tvsh 24,950,964 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 45 ditë, Zbatuar 94 ditë. Fillimi punimeve: 15.05.2017 Përfundimi punimeve : 16.08.2017		19. Zgjatja e kontratës Nr. 10949, datë 14.07.2017 dhe nr. 12411 prot, datë 14.08.2017, 49 ditë
20. Mbikëqyrësi i punimeve “D.”shpk	Licenca Nr: MK /4	Kontrata nr. 3698/6, datë 15.05.2017	
21. Kolaudatori i punimeve Emri Mbiemri: G. L.	LicencaNr: MK /2	Kontrata nr. 14728 prot., datë 03.10.2017	
22.Akt Kolaudimi Datë 07.10.2017	23.Akt i marrjes në dorëzim dt 09.10.2017		

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **243,320 lekë pa tvsh.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Titulli i Gjetjes 1&2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Zbatim Rikualifikim Urban blloqe banimi “Tepe-tek Fusha e Druve”, Bashkia Shkodër, nga zbatuesi i punimeve OE “P.V.K.” SHPK, për zërat e punimeve 1.2,2.5 dhe 3.9.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve “Gërmim dheu me ekskavator 0.25 m3 b > 2 m, tokë e zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet”, “Struktura monolite betoni C16/20 (kuneta, shtresa)” dhe “Trotuar betoni 6 cm, me sipërfaqe të përpunuar”, për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 13306/33 prot datë 15.05.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3698/6, datë 15.05.2017. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 14728 prot., datë 03.10.2017.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Shkodër.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandime:	Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 508,760 lekë pa tvsh nga OE “P.V.K.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 13306/33 prot datë 15.05.2017 me objekt “Zbatim Rikualifikim Urban blloqe banimi “Tepe-tek Fusha e Druve”, Bashkia Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 14, datë 09.08.2019.

Vlera prej 243,320 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Shkodër. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. V. T. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. G. L.me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Lidhur me këtë pikë të projektraportit, ka observuar me shkresën datë 16.08.2019 mbikqyrësi I punimeve z. V. T., si më poshtë:

1. Ndryshimi i zërit "Shtresë asfalti i gomuar me "Shtres asfalti me granil gur kave" sipas Procesverbalit "Për ndryshimin e zërave të punës dhe shtimin e zërave të paparashikuar, brenda vlerës së preventivit, protokolluar me nr. 11131 prot, datë 18.07.2017, është argumentuar nga sipërmarrësi i punimeve dhe janë realizuar bazuar ne nenin 41 te Kontrates se sipermarrjes/Pika 41.3. Bashkangjitur po japim Procesverbalin e vulosur.

2. Zeri 1.2. Germim dheu me ekskavator 0.25 m³ b > 2 m, toke e zakonshme, kategoriaIII, me shkarkim ne mjet.

Ne P/Raport pretendohet se në pasqyrimin e volumeve te punimeve te ketij zeri ka një diferencë prej 947 m³ pasi jane vjele me situacion 1440 m³ nga 493 m³ të pretenduara të matura ne terren.

Konkluzioni i arritur për ekzistencën e kësaj difference në volum, rrjedhimisht edhe në vlerën përkatëse, nuk është i saktë dhe nuk qëndron.

Volumet e “Gërmim dheu me ekskavator 0.25 m³ b > 2 m, toke e zakonshme, kategoriaIII, me shkarkim ne mjet” jane pasqyruar saktesisht sipas projektit dhe faktit te realizuar, ato jane shoqeruar me zberthimin analitik per cdo seksion dhe gjatesi perkatese dhe jane te kontrolluara dhe dokumentuara me librezën e masave perkatese, P/Verbalet e punimeve te maskuara dhe fotot perkatese.

Ne librezën e masave totali i germimit per KUZ, KUB, KUSH dhe Ujesjellesin eshte 1660 m³ dhe keto volume jane te argumentuara qartesisht ne kete dokument. Nderkohe volumi i germimit prej 493 m³, qe pretendohet te jete kryer faktikisht sipas P/Raportit eshte vlere shume e vogel dhe e pajustificueshme.

Theksojme se nga grupi i auditimit nuk eshte bere asnje matje ne terren per keto punime te fshehta dhe konkluzioni eshte nxjerre apriori dhe mbi asnjë baze teknike dhe nuk kane treguar asnjë fakt per keto matje te cilat mendojne se i kane kryer.

3. Volumet e ndertimit te “Struktura monolite betoni C16/20” jane pasqyruar saktesisht sipas faktit te realizuar, ato jane shoqeruar me zberthimin analitik në librezat e masave perkatese sipas cdo blloku e pallati, lehtesisht te matshme.

Theksojme se nga ana e grupit te auditimit në objekt nuk u bë matje dhe perfundimi i arritur eshte bere pa matje, por apriori dhe i paargumentuar.

4. Ne P/Raport pretendohet se ne pasqyrimin e volumeve të punimeve te ketij zeri ka nje difference prej 49 m³ pasi jane vjele me situacion 1656 m³ nga 1607 m³ te pretenduara te matura ne terren. Konkluzioni i arritur se gjeresia e tortuarit ne librezat e masave eshte me e madhe se fakti nuk eshte i sakte dhe nuk qendron. Volumet per tortuarin jane paraqitur ne librezën e masave sipas realizimit te tyre ne veper dhe jane qartesisht te argumentuara.

Theksojme se nga ana e grupit te auditimit ne objekt nuk u be matje dhe perfundimi i arritur eshte bere pa matje, por apriori dhe i paargumentuar.

Opinioni i grupit të auditimit:

1. Pretendimet e sjella në observacion nuk merren në konsideratë, pasi vështirësitë e sipërcituara duheshin shqyrtuar nga OE fitues në fazën e përgatitjes së ofertës dhe jo gjatë zbatimit.

2. Argumenti I sjellë në observacion merret pjesërisht në konsideratë, pasi në aktverifikim dhe projektraport nuk është folur për matjet në terren, por është cituar që volumi është situacionuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

dy herë, për trupin e rrugës dhe për kanalet e tubacioneve të KUB dhe KUZ. Nga rillogaritja e volumit të gërmimit për KUZ dhe KUB, si prodhim i gjatësisë së kanaleve me diferencën e lartësisë së gërmimit (lartësisë së marrë në librin e masave me lartësinë mesatare të gërmimit të trupit të rrugës), ky volum del 1125 m³ dhe diferenca e volumit të përfituar më tepër është 315 m³. Ky argument merret pjesërisht në konsideratë dhe do të reflektohet në tabelën e dëmit ekonomik.

3. Pretendimi nuk merret në konsideratë pasi është bërë matja në terren dhe rruga e shtruar me beton ndërmjet pallatit 3 dhe 4 është me gjatësi 23 ml dhe jo 30 ml, siç pasqyrohet në librin e masave.

4. Argumenti nuk merret në konsideratë pasi është bërë matja në terren për çdo trotuar dhe më pas është bërë llogaritja sipas përmasave të matura.

Ju bëjmë me dije se Grupi I auditimit ka bërë matje në terren në prani të punonjësve të Bashkisë, pasi është refuzuar ardhja në objekt nga ana juaj.

2. “Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Qendër Dragoç”, Bashkia Shkodër

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Qendër Dragoç”, Bashkia Shkodër			
14.Lidhja e kontratës Nr. 4697/15 prot datë 31.08.2017	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 12,888,162lekë OE fitues “S. M. O. U.” shpk		16.Likuiduar ----
17- Situacioni Përfundimtar dt - Vlera me tvsh 12,887,794 lekë -Vlera pa tvsh 10,739,828 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 46 ditë. Fillimi punimeve: 03.09.2018 Përfundimi punimeve : 16.10.2018		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve “N. S.” SHPK	Licenca Nr: MK/5	Kontrata nr. 13670/6, datë 31.08.2018	
21. Kolaudatori i punimeve OE “D.” SHPK	Licenca Nr: MK/6	Kontrata nr. 18404 prot., datë 02.11.2018	
22.Akt Kolaudimi Datë 09.11.2018	23.Akt i marrjes në dorëzim dt 09.11.2018		

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **262,860 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes

Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

1&2:	“Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Qendër Dragoç”, Bashkia Shkodër, nga zbatuesi i punimeve OE “S. M. O. U.” SHPK, për zërat e punimeve A.3, B.1, B.6+B.7 dhe B.8.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve “Transport dhe me auto deri në 2 km”, “Gërmim dhe me ekskavator goma 0.15 m ³ në themele, tokë e zakonshme, kat III, me shkarkim në tokë”, “Shtresë stabilizanti + shtresë binderi t=3 cm” dhe “Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave t=3 cm”, për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4697/15 prot datë 31.08.2018. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 13670/6, datë 31.08.2018. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 18404 prot., datë 02.11.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Shkodër.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandime:	Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 360,360 lekë pa tvsh nga OE “S. M. O. U.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4697/15 prot datë 31.08.2018 me objekt “Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Qendër Dragoç”, Bashkia Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 15, datë 09.08.2019.

Vlera prej 262,860 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Shkodër. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E. N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. V. T. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me këtë pikë të projektraportit, ka observuar me shkresën datë 15.08.2019 mbikëqyrësi I punimeve z. E. N., si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

1. Zërat 1. Transport dheu me auto deri ne 2km

2. Germim dheu me ekskavator goma ...tok e zakonshme kat.III me shkarkim ne toke Ne preventivin baze, ky ze ka qene 210 m³. Gjate zbatimit te punimeve lindi domosdoshmeria per permiresim dhe ndryshim të projektit dhe një ndër zërat e ndryshuar ishte zëri I gërmimit dhe rrjedhimisht edhe zëri I transportit.

Konkretisht zeri “Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m³, ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim në toke” u rrit nga 210 m³ ne 1,218 m³. Një nga nën-ndarjet e gërmimit sic e paraqitem edhe me lart eshte “Germim per trupin e rruges”, I cili sipas preventivit te ripunuar , per arsytet qe u shpleguna analitikisht ne terren gjate inspektimit te siperpermenur ,eshte miratuar te behet 313.11 m³. Ky volum rezulton nga germimi I gjithe gjatesise se rruges prej 994ml, me nje gjeresi prej 4.5m dhe nje thellesi germimi mesatare prej 7cm. Pra profilet e projektit tashme nuk mund te merren per baze per llogaritje.

2. Zeri Mbushje me cakull,, e gur gurore ne trupin e rruges , perhapur e ngjeshur me makineri.

Ne kete rruge eshte ndertuar kunete betoni me gjatesi 649ml dhe me gjeresi 0.5m. Grupi i auditimit argumenton se ne kete pjese ku eshte ndertuar kuneta me gjatesi 649m dhe me gjeresi 0.5m, nuk duhet te merret mbushje me cakell.Edhe ky problem eshte sqarur gjate inspektimit te siperpermendur dhe nga ana jone argumentohet si me poshte:

Ne te gjithe gjatesine ku eshte ndertuar kuneta ka qene kanal natyror I hapur qe ka sherbyer per largimin e ujrave nga trupi I rruges ekzistuese. Ky kanal ka pasur thellesi nga 20-40cm. Sipermarresi, per kete pjese, ka bere jo vetem pastrimin e ketij kanali, por edhe mbushjen me cakell me trashesi mbi 20cm ne te gjithe gjatesine e pjeses ku eshte ndertuar kuneta e betonit, pasi ne kushtet egzistuese ne te cilat ndodhej terreni teknikisht do te ishte e pamundur te ndertohej kuneta pa u skarifikuar skarpata e kanalit e me pas pa u mbushur ajo me cakull

Theksojme se nga grupi i auditimit nuk eshte bere asnje matje ne terren per keto punime te fshehta dhe konkluzioni eshte nxjerre apriori dhe mbi asnjë baze teknike dhe nuk kane treguar asnjë fakt per keto matje te cilat mendojne se i kane kryer.

3. Zërat Shtrese stabilizanti dhe shtrese binderi t=3cm.

Ne total jane realizuar faktikisht ne sasine prej 227 m² dhe te pasqyruara ne librezen e masave ne sasine 190 m². Pra ne fakt eshte realizuar nje sasi prej 37m² me shume se sa sasia e situacionuar prej 190 m². Te gjitha keto sipërfaqe jane te matshme te verifikueshme.

Opinion i grupit të auditimit:

1. Ky argument nuk merret në konsideratë, për arsytet e evidentuara në aktkonstatimi dhe Projektraport, pasi edhe në librin e masave të hartuar nga sipërmarrësi dhe të kontrolluar (miratuar) nga mbikëqyrësi, citohet që “sipërfaqe në gërmim sipas profiëve”.

2. Argumenti i sjellë në observacion merret në konsideratë dhe do të reflektohet në tabelën e dëmit ekonomik.

3. Argumenti nuk merret në konsideratë, pasi nga verifikimi në objekt në prezencën e mbikëqyrësit, u sqaruan sipërfaqet e situacionuara tepër.

3. “Rikonstrukcion rruga e “Mandave”, Bashkia Shkodër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Librezë e masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion rruga e “Mandave”, Bashkia Shkodër”, Bashkia Shkodër			
14. Lidhja e kontratës Nr. 4032/15 prot datë 22.06.2017	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 9,085,164 lekë OE fitues “D. I.” shpk		16. Likuiduar -----
17- Situacioni Përfundimtar dt 04.09.2017 -Vlera me tvsh 9,085,164 lekë -Vlera pa tvsh 7,570,970 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 45 ditë, Zbatuar 75 ditë. Fillimi punimeve: 22.06.2017 Përfundimi punimeve : 04.09.2017		19. Zgjatja e kontratës nr. 12922, datë 28.08.2017, 30ditë
20. Mbikëqyrësi i punimeve ““P. C.” SHPK	Licenca Nr: MK /16	Kontrata nr. 8423/5, datë 22.06.2017	
21. Kolaudatori i punimeve OE “M. S.” SHPK	Licenca Nr: MK /6	Kontrata nr. 13998/3 prot., datë 04.10.2017	
22. Akt Kolaudimi Datë 09.11.2018	23. Akt i marrjes në dorëzim dt 09.11.2018		

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **107,690 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 1&2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion rruga e “Mandave”, Bashkia Shkodër, nga zbatuesi i punimeve OE “D. I.” SHPK, për zërat e punimeve 1.1, 1.2, 1.4, 3.1, 3.4 dhe 3.8.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ në themele”, “Gërmim dheu me ekskavator 0.25 m ³ b > 2 m, tokë e zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet”, “Transport dheu me auto deri në 2 km”, dhe “FV Bordura betoni 15x25” “FV tub i brinjëzuar HDPE SN 8 me D=200 mm” dhe “FV tuba e rakorderi ujësjellësi d=25 mm, t=2mm, PN 10”, për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4032/15 prot datë 22.06.2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 8423/5, datë 22.06.2017. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 13998/3 prot., datë 04.10.2017.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Shkodër.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandime:	Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 498,422 lekë pa tvsh nga OE “D. I.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4032/15 prot datë 22.06.2017 me objekt “Rikonstruksion rruga e “Mandave”, Bashkia Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhje e situacionimit të punimeve të pakryera.

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 16, datë 09.08.2019.

Vlera prej 107,690 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Shkodër. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. V. G. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. T. S. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me këtë pikë të projektraportit, ka observuar me shpresën datë 20.08.2019 mbikëqyrësi I punimeve znj. V. G., si më poshtë:

Lidhur me konstatimet tuaja përsa i përket zërit “FV tub I brinjëzuar HPDE SN* me D=200mm “ theksojmë që është realizuar plotësisht pavarësisht që në librezën e masave është dhënë sasia 285 dhe nuk është detajuar .

Për këtë po ju praqesim matjet faktike sipas piketave të paraqitura në planimetrine bashkëlidhur si:

- Piketa 1 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0ml
- Piketa 2 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
- Piketa 3 ka gjatësi tubi të barabartë me 3 .0ml
- Piketa 4 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
- Piketa 5 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
- Piketa 6 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0ml
- Piketa 7 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0ml
- Piketa 8 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
- Piketa 9 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
- Piketa 10 ka gjatësi tubi të barabartë me 7.0 ml
- Piketa 11 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
- Piketa 12 ka gjatësi tubi të barabartë me 7.0 ml



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Piketa 13 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 14 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 15 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 16 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.5 ml
Piketa 17 ka gjatësi tubi të barabartë me 3.5 ml
Piketa 18 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 19 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 20 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
Piketa 21 ka gjatësi tubi të barabartë me 3.0 ml
Piketa 22 ka gjatësi tubi të barabartë me 10.0 ml
Piketa 23 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
Piketa 24 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 25 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 26 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 27 ka gjatësi tubi të barabartë me 8.5 ml
Piketa 28 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 29 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 30 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
Piketa 31 ka gjatësi tubi të barabartë me 3.0 ml
Piketa 32 ka gjatësi tubi të barabartë me 3.0 ml
Piketa 33 ka gjatësi tubi të barabartë me 7.0 ml
Piketa 34 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0ml
Piketa 35 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
Piketa 36 ka gjatësi tubi të barabartë me 8.0 ml
Piketa 37 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 38 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 39 ka gjatësi tubi të barabartë me 8.0ml
Piketa 40 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 41 ka gjatësi tubi të barabartë me 7.0 ml
Piketa 42 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 43 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
Piketa 44 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
Piketa 45 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 46 ka gjatësi tubi të barabartë me 7.5 ml
Piketa 47 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.5 ml
Piketa 48 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 49 ka gjatësi tubi të barabartë me 15.0 ml
Piketa 50 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
Piketa 51 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 52 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 53 ka gjatësi tubi të barabartë me 7.0 ml
Piketa 54 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 55 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 56 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml

Gjatësia totale = 313.5 ml



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Lidhur me konstatimet tuaja për sa I përket zërit “**Furnizim vendosje tub ujësjesli d=25mm t=2mm , PN10**“ theksojmë që është i realizuar, pavarësisht që në librezën e masave është dhënë sasia 714 dhe nuk është detajuar.

Per kete po ju praqesim matjet faktike sipas piketave te paraqitura ne planimetrine bashkelidhur si:

Piketa 1 ka gjatësi tubi të barabartë me 3.0 ml
Piketa 2 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 3 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 4 ka gjatësi tubi të barabartë me 7.0 ml
Piketa 5 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 6 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 7 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
Piketa 8 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 9 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 10 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 11 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 12 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 13 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 14 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 15 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.0 ml
Piketa 16 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 17 ka gjatësi tubi të barabartë me 3.5 ml
Piketa 18 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 19 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
Piketa 20 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 21 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 22 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 23 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 24 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 25 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 26 ka gjatësi tubi të barabartë me 8.0 ml
Piketa 27 ka gjatësi tubi të barabartë me 8.5 ml
Piketa 28 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.5 ml
Piketa 29 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 30 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 31 ka gjatësi tubi të barabartë me 3.5 ml
Piketa 32 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 33 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 34 ka gjatësi tubi të barabartë me 7.0ml
Piketa 35 ka gjatësi tubi të barabartë me 7.0 ml
Piketa 36 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 37 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 38 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 39 ka gjatësi tubi të barabartë me 3.5 ml



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Piketa 40 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.0 ml
Piketa 41 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 42 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 43 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 44 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 45 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 46 ka gjatësi tubi të barabartë me 7.5 ml
Piketa 47 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.5 ml
Piketa 48 ka gjatësi tubi të barabartë me 6.5 ml
Piketa 49 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml
Piketa 50 ka gjatësi tubi të barabartë me 5.0 ml
Piketa 51 ka gjatësi tubi të barabartë me 4.5 ml

Gjatesia totale =700.0 ml

Per te realizuar furnizim vendosje te tubave Ø 200mm dhe Ø 25 mm jane kryer dhe germimet perkatese sipas zerave:

Gërmim dheu me eskavator goma 0.25m³ ne themele ne sasine 124 m³

Gërmim dheu me eskavator goma 0.25m³ b.2m toke e zakonshme kat II,me shkarkim ne mjet ne sasine 74 m³

Transport dheu me auto 2 km ne sasinë 198 m³

Përsa i përket Fv bordurë betoni 15x25 jemi dakort pasi është gabim në matje.

Bashkengjitur janë planimetritë dhe tabelat e volumeve sipas piketave.

Ju lutemi që të rivleresoni edhe një herë konstatimet Tuaja.

Opinionit i grupit të auditimit:

Argumentet e sjella në observacion përsa i përket zërave “FV tub i brinjëzuar HDPE SN 8 me D=200 mm” dhe “FV tuba e rakorderi ujësjellësi d=25 mm, t=2mm, PN 10”, të shoqëruara me tabelat përkatëse të munguara në librin e masave, merren në konsideratë dhe do të reflektohet tek vlera e dëmit ekonomik. Pretendimet në lidhje me zërat “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³ në themele”, “Gërmim dheu me ekskavator 0.25 m³ b > 2 m, tokë e zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet” dhe “Transport dheu me auto deri në 2 km”, nuk merren në konsideratë, pasi janë llogaritur dy herë shtresat në gërmim, si dhe është llogaritur gabim volume I gërmimit me b>2 m.

4. “Rikonstruksion rruga e Shirqit”, Bashkia Shkodër

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion rruga e Shirqit”, Bashkia Shkodër		
14.Lidhja e kontratës Nr. 16563/12 prot datë 17.12.2018	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 12,825,002 lekë BOE fitues “S.M.O. V.” shpk & “S. M. O. U.”	16.Likuiduar -----



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	shpk		
17- Situacioni Përfundimtar dt 16.02.2019 -Vlera me tvsh 12,825,002 lekë -Vlera pa tvsh 10,687,502 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 60 ditë, Zbatuar 59 ditë. Fillimi punimeve: 19.12.2018 Përfundimi punimeve : 16.02.2019		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve "N. S." SHPK	Licenca Nr: MK/5	Kontrata nr. 20185/5, datë 17.12.2018	
21. Kolaudatori i punimeve OE "A." SHPK	Licenca Nr: MK/2	Kontrata nr. 4351/5 prot., datë 25.03.2019	
22.Akt Kolaudimi Datë 27.03.2019	23.Akt i marrjes në dorëzim dt 27.03.2019		

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **731,549 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 1&2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion rruga e Shirqit", Bashkia Shkodër, nga zbatuesi i punimeve BOE "S.M.O. V." shpk & "S. M. O. U." SHPK, për zërat e punimeve A.2, B.1 dhe B.2.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve "Transport dheu me auto deri në 2 km", "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.15 m3 në themele, tokë e zakonshme, kat III, me shkarkim në tokë" dhe "Mbushje me çakull e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri", për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 16563/12 prot datë 17.12.2018. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 20185/5, datë 17.12.2018. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 4351/5 prot., datë 25.03.2019.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Shkodër.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandime:	Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 731,549 lekë pa tvsh nga BOE "S.M.O. V." shpk & "S. M. O. U." SHPK, në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 16563/12 prot datë 17.12.2018 me objekt “Rikonstruksion rruga e Shirqit”, Bashkia Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 17, datë 09.08.2019.

Vlera prej 731,549 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Shkodër. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E. N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. G. T. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me këtë pikë të projektraportit, ka observuar me shkresën datë 15.08.2019 mbikqyrësi I punimeve z. E. N., si më poshtë:

1. Zëri Mbushje me cakull në trupin e rrugës 426 m³

KOUTA E PROJEKTIT të niveletës në këtë rrugë është detyruese pasi shërben si rrugë evakuimi në raste përmbytjesh (që në këtë zonë janë pothuajse të përvitshme)

Ndërtimi i këtij segmenti është bërë në argjinaturën midis një kanali vaditës djathtas dhe kullues majtas. Gjerësia e kurorës së argjinaturës para fillimit të punimeve ka qenë 2.7 deri 3 m , pra nuk plotesonte asnjë parametër gjeometrik për zbatimin e projektit, ndërkohe që vet argjinatura ka shërbyer si rrugë për mjetet e bonifikimit dikur, për pastrim të kanaleve kullues e vaditës në dy anët e saj.

Për kapjen e nje gjerësie minimale sipas standartit të ndërtimit të rrugëve prej 3.5 m , është dashur të zgjerohet argjinatura, kjo sidomos nga krahun perendimor, pasi në krahun lindor ka shtëpi banimi dhe zgjerimi në atë krah do të sillte për pasojë prishjen e shtëpive. Për “perfitimin” e gjerësisë prej 3.5 m të pjesës kaluese, sipërmarrësi ka qenë i detyruar t bëjë një gjermim të skarpatës prej 50 cm per heqjen e vegjetacionit dhe shtresës argjilore dhe me pas për te kapur gjerësinë e bazës së rrugës B=3.5m (pjesa kaluese) + 2 x 0,5m (bankina), si dhe ka qenë i detyruar të bëjë mbushje me cakull në skarpat me cakull me gure te thyer/ngjeshur per të kapur gjerësinë ne kuotën qe dikton kurora e argjinatures.

Kjo ishte detyruese, sepse duke qenë që zona në fjalë është zonë me ekspansion ujrash në përmbytje, në rast shkarkimesh rruga duhej mundësisht të permbytej e fundit (pasi shërben si rrugë evakuimi në rast përmbytjesh).

Në këto kushte thellësia e gjermimit dhe e mbushjes me cakull per efekt kapjes të kuotës projektit dhe gjerësisë së shtresave po sipas projektit, ishin detyrim megjithse skarpatata e mbushjes nga 1:1.5;1:1 e argjinatures ekzistuese eshte zvogeluar deri ne 1:0.5 e me shume si detyrim per kapjen e gjerësisë se trasese se re ne kuotën sipas projektit.

Proporcionalisht me keto volume shkon edhe volumi i I transportit te materialeve.

Opinion i grupit të auditimit:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

1. Ky argument nuk merret në konsideratë, për arsyet e evidentuara në aktkonstatim dhe Projektraport. Gjerësia e kurorës së argjaturës para fillimit të punimeve nuk ka qenë 2.7 deri 3 m, siç pretendohet në observacion, pasi edhe gërmimi i trupit të rrugës është marrë me gjerësi 4 m. Për të kundërshtuar këtë pretendim, janë marrë në konsideratë edhe fotot e administruara në dosjen teknike, që tregojnë se trupi I rrugës ekzistuese nuk ka qenë në gjendjen e paraqitur në observacion.

D.5. Opinion mbi prokurimin e fondeve në nivel institucional shoqëruar me një tabelë në lidhje me procedurat e prokurimit publik, objekti i prokuruar, lloji i procedurës, fondi limit, data dhe vlera e kontratës së lidhur, shtesat e kontratës, diferenca nga fondi limit, operatori ekonomik fitues dhe cila procedurë prokurimi është audituar nga grupi/audituesi i KLSH-së në vlerë dhe përqindje.

Mbi procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2018.

Për vitin 2018, sipas regjistrimit të prokurimeve ishin planifikuar të zhvilloheshin 133 procedura prokurimi me fond limit në shumën 1,743,142 mijë lekë, dhe u realizuan 100 prej tyre, me vlerë kontrate në shumën 621,938 mijë lekë.

Procedurat e zhvilluara rezultojnë:

- Tender i hapur 19 procedura, me fond limit 366,262 mijë lekë;
- Kërkesë për propozim 71 procedura me fond limit 215,585 mijë lekë;
- Negocim pa shpallje 1 procedurë, me fond limit 26,985 mijë lekë;
- Projektim 7 procedura, me fond limit 7,925 mijë lekë.

Procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës 01.01.2017- 30.06.2019

Nr	Lloji i procedurës	Numri procedurave	Fondi limit	Vlera e kontratave Pa tvsh	Diferenca
Viti 2017					
1	Procedurë e hapur	6	57,339	52,685	-4,654
2	Kërkesë për propozim	55	200,303	160,968	-39,335
Viti 2018					
1	Procedurë e hapur	19	430,062	366,262	-63,800
2	Kërkesë për propozim	71	255,130	215,585	-39,545
3	Projektim	7	8,683	7,925	-758
4	Negocim pa shpallje	1	27,015	26,985	-30
6 Muji 2019					
1	Procedurë e hapur	6	178,773	119,982	-58,792
2	Kërkesë për propozim	23	101,427	63,363	-38,064
4	Negocim pa shpallje	1	66,985	66,886	-98
Totali/popullata					
		189	1,455,637	1,210,621	-245,016



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Procedurat e prokurimit të audituara

Nr	Lloji i prokurimeve Nën/popullata	Procedura të zhvilluara		Procedura të audituara		Raporti	
		Numër	Vlerë 000/lekë	Numër	Vlerë 000/lekë	Numër %	Vlerë %
Viti 2017							
1	Procedurë e hapur	6	82,685	4	54,316	66	67
2	Kërkesë për propozim	55	160,968	4	33,605	4	21
Viti 2018							
1	Procedurë e hapur	19	430,062	9	293,301	47	68
2	Kërkesë për propozim	71	255,130	11	94,828	15	37
3	Projektim	7	8,683	0	0	0	0
1	Negocim pa shpallje	1	27,015	0	0	0	0
6 Mujori Viti 2019							
1	Procedurë e hapur	6	178,773	4	108,773	66	61
2	Kërkesë për propozim	23	101,427	0	0	0	0
3	Negocim pa shpallje	1	66,985	0	0	0	0
Totali		189	1,455,637	32	584,823	17	40

Sa më sipër, nga Grupi i auditimit, u përzgjedhën bazuar në përlogaritjen e materialitetit dhe riskut (sasior dhe cilësor) të auditohen gjithsej 32 procedura prokurimi me vlerë limit të kontratës, në shumën 584,823 mijë ose 54 % e vlerës së prokuruar, nga të cilat 456,390 mijë lekë, ose 65 % e vlerës së fondit të prokuruar "Tender i hapur" dhe 128,433 mijë lekë, ose 25 % e vlerës së prokuruar "Kërkesë për propozim".

Për vitin 2017 janë zhvilluar:

- 6 procedura prokurimi "Tender i hapur" me fond limit në shumën 82,685 mijë lekë, nga të cilat u audituan 4 procedura me fond limit (total) në shumën 54,316 mijë lekë, ose në masën 66 % të fondit limit.

Në 8 procedurat e audituara kemi një ulje nga fondi limit në shumën 15,313 mijë lekë, ose në masën 20 % kundrejt fondit limit.

Në këto procedura ka patur një pjesëmarrje të OE në garë që ka variaur nga 2 në shërbime të veçanta (pastrami) në 12 OE në kontrata punësh civile (rrugë).

Për vitin 2018 janë zhvilluar:

- 19 procedura prokurimi "Tender i hapur" me fond limit në shumën 430,062 mijë lekë, nga të cilat u audituan 9 procedura me fond limit (total) në shumën 293,301 mijë lekë, ose në masën 67 % të fondit limit. Nga këto procedura dy prej tyre kanë qenë tender i hapur i llojit "Marrëveshje kuadër", me kushte të përcaktuara me një OE.

Duke përjashtuar këto dy procedura, për 7 procedurat e tjera kemi një ulje nga fondi limit në shumën 40,024 mijë lekë, ose në masën 23 % kundrejt fondit limit.

- 71 procedura prokurimit të llojit "Kërkesë për propozim", me fond limit në shumën 255,130 mijë lekë, nga të cilat u audituan 11 procedura me fond limit në shumën 94,828, ose në masën 37 %, si dhe është realizuar një ulje nga vlera limit e kontratës në shumën 21,054 mijë lekë, ose në masën 22 % me pak se fondi limit.

Në këto procedura ka patur një pjesëmarrje të OE në garë që ka variaur nga 4-12 OE.

Për vitin 2019 janë zhvilluar:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

- 6 procedura prokurimi "Tender i hapur" me fond limit në shumën 178,773 mijë lekë, nga të cilat u audituan 4 procedura me fond limit (total) në shumën 108,773 mijë lekë, ose në masën 61 % të fondit limit.

Në 4 procedurat e audituara kemi një ulje nga fondi limit në shumën 31,347 mijë lekë, ose në masën 22.4 % kundrejt fondit limit.

Në këto procedura ka patur një pjesëmarrje të OE në garë që ka variaur nga 4-7 OE.

Në mënyrë të detajuar për procedurat e audituara, bashkëngjitur anekseve të PRA janë:

- Tabela anekse "Të dhënat mbi Procedurat e audituara /Tender i hapur"
- Tabela anekse "Të dhënat mbi Procedurat e audituara /Kërkesë për propozim"

E. AUDITIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME.

Mbi zbatimin të rekomandimeve të dërguara në Bashkinë Shkodër nga KLSH me shkresën nr. nr. 1005/57, datë 20.12.2018

IV/F. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm.

1-Realizimi i Rekomandimeve masa organizative, masa shpërblim dëmi dhe masave disiplinore, sipas cilësimeve në plan veprimin të hartuar nga subjekti audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për Rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga Rekomandimet nuk janë pranuar.

KLSH konstatoi se nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme janë rekomanduar 34 masa organizative, prej të cilave janë pranuar 34 masa, janë zbatuar 12 masa, janë në proces zbatimi 21 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative për të cilën rikërkojmë zbatimin e saj. Nga 13 masa për për shpërblim dëmi në vlerën 12,638,793 lekë, janë pranuar 13 masa, nga ku 8 masa janë zbatuar dhe 5 prej tyre janë në proces zbatimi dhe deri më datë 31.12.2018 është arkëtuar shuma 4,554,275 lekë, ndërsa shuma 8,084,318lekë nuk është arkëtuar, pasi janë ende në proces gjyqësor.

Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-" është rekomanduar që të analizohet në një masë në vlerën 9,758,551 lekë.

Janë rekomanduar **12** masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet;

-Sipas "Ligjit për Nëpunësin Civil" janë **rekomanduar 12 masa disiplinore "Vërejtje"** e parashikuar në nenin 58, germa "a" deri në masën "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit" e parashikuar në nenin 58, germa "c". Nga verifikimi rezulton se për 9 punonjësit është ngritur komisioni i posatshtëm i cili ka filluar procedurat përkatëse lidhur me marrjen e masave disiplinore **"Vërejtje"**, masa të cilat janë në proces zbatimi

Sipas "Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë" janë rekomanduar **3 masa disiplinore** nga "Vërejtje" deri në "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", për të cilën Kryetari i Bashkisë Shkodër ka nxjerrë urdhrat sipas masës së rekomanduar vetëm për 2 punonjës. Nga verifikimi i kryer rezulton se me shkresën nr.18568 prot,datë 13.12.2017 është filluar procedura për ecurinë e masave disiplinore prej titullarit të Bashkisë Shkodër,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

masa të cilat janë në proces zbatimi.

I është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Shkodër t'i kërkoj Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, për 7 **persona**. Nga verifikimi rezulton se për 7 persona është vendosur masa dënim me gjobe secili nga 50,000 lekë në shumën gjithsejtë **prej 350,000 lekë, të cilat janë arkëtuar.**

Situata

Referuar komenteve dhe sqarimeve të paraqitura prej Bashkisë Shkodër me shkresën nr.9599/37/1 prot.datë 26.08.2019. Realizimi i rekomandimeve dhe detyrave të lëna nga KLSH, paraqitet si më poshtë **Masa organizative** janë rekomanduar 34 masa organizative, prej të cilave janë pranuar 34 masa, janë zbatuar 12 masa dhe janë në proces zbatimi 22 masa.

Për rekomandimin 1.7.1. Në Bashkinë Shkodër dhe në ish Komunat nuk është mbajtur në rregull protokollin i mbledhjeve të Këshillit duke mos evidentuar saktësisht prezencën e këshilltarëve ndërkohë që listë prezencë për pagesat e ish këshilltarëve është nënshkruar rregullisht në çdo muaj nga sekretari dhe Kryetari i Këshillit pa mungesa duke u paguar në mënyrë jo mirë të dokumentuar vlera prej **9,255,291** lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 37 pika 2 germa “a” dhe nenin 29 e 31 të ligjit nr.8652, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 24-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashki, në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të verifikojë të gjithë dokumentacionin mbi të cilin është bërë pagesa e këtyre këshilltarëve. Pas verifikimit dhe saktësimin të këtyre pagesave, i **lihet në kompetencë Kryetarit të Bashkisë**, të përcaktojë masat përkatëse në lidhje me vlerën e dëmit që duhet të kthejnë në buxhet këshilltarët. Detyrimi për mos llogaritjen e tatimit mbi pagë duhet të paguhet, pasi rrjedh nga kërkesat e kreut II-të, neni 8 “E ardhur e tatueshme” shkronja “g”, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar me ligjin nr. 83/2014 datë 17.07.2014 dhe 156/2014 datë 27.11.2014

Masa për shpërblim dëmi, nga 13 masa për shpërblim dëmi në vlerën 12,638,793 lekë, janë pranuar 13 masa, nga ku 8 masa janë zbatuar dhe 5 prej tyre janë në proces zbatimi, dhe deri më datë 31.12.2018 është arkëtuar shuma 4,554,275 lekë, ndërsa shuma **8,084,318lekë nuk është arkëtuar**, pasi janë ende në proces gjyqësor.

Për rekomandim 1.1.1: Në zbatim të vendimit nr.26,datë 24.01.2018 të Kryetares së Bashkisë “Mbi zbatimin e rekomandimit të raportit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

përfundimtar të KLSH-së, nr.491/15 datë 30.11.2017 ndaj z.M. L., znj.A. M., znj.V. M.. Me shkresën nr.2095, datë 09.02.2018 është njoftuar vendimi z.M. L.. Me shkresën nr.11117/b, datë 13.04.2018 është kërkuar konfirmimi nga drejtoria e të ardhurave lidhur me shlyerjen e detyrimit nga z.M. L.. Drejtoria e të ardhurave ka kthyer përgjigje me shkresën nr.1280/b, datë 26.04.2018 nga ku rezulton se z.M. L. nuk e ka shlyer detyrimin. Bashkia Shkodër me shkresën nr.7504 dt.17.05.2018 ka depozituar kërkesë padinë shpërbllim dëmi me vlerë 26,687 lekë, pranë gjykatës administrative shkalla e parë Shkodër, **çështja është në proces gjyqësor.**

Me shkresën nr.1766 dt.5.2.2018, është njoftuar vendimi zj.A. M. e cila ka marrë njoftim dt.06.02.2018. Me shkresën nr.11117/b dt.13.04.2018 është kërkuar konfirmimi nga drejtoria e të ardhurave nëse znj.A. M. ka shlyer detyrimin. Drejtoria e të ardhurave me shkresën nr.1280/b, datë 26.04.2018 ka konfirmuar shlyerjen e detyrimit prej znj.A. M., në shumën 26,687 lekë pranë U. B. sipas mandate arkëtimit me nr.KIB 21451102, datë 06.02.2018.

Me shkresën nr.1931 dt.07.02.2018, I është njoftuar vendimi z.V. M.. Me shkresën nr.11117/b dt.13.04.2018 është kërkuar konfirmimi nga drejtoria e të ardhurave nëse znj.A. M. ka shlyer detyrimin. Drejtoria e të ardhurave me shkresën nr.1280/b, datë 26.04.2018 ka konfirmuar shlyerjen e detyrimit prej 26,687 lekë pranë R. B., dega 14 Shkodër, nr referenc 20180223, datë 23.02.2018.

Për rekomandimin 2.2.1: Në zbatim të vendimit nr.25, datë 24.01.2018 të Kryetares së Bashkisë, "Mbi zbatimin e rekomandimit të raportit përfundimtar të KLSH-së, nr.491/15 datë 30.11.2017, ndaj BOE B.M K. & K.A.N Shpk. Me shkresën nr.1659, datë 02.02.2018 I është njoftuar vendimi për shlyerje detyrimi, vendim i cili është marrë dorazi më datë 14.02.2018, prej B.M K. shpk, ndërsa OE K.A.N shpk e ka marr njoftimin dorazi më datë 16.02.2018. Me shkresën nr.11117/b dt.13.04.2018 është kërkuar konfirmimi nga drejtoria e të ardhurave nëse BOE B.M K. & K.A.N Shpk kanë shlyer detyrimin prej 4,442,862 lekë pa tvsh. Drejtoria e të ardhurave nga ana e saj me shkresën nr. 1280/b, datë 26.04.2018 ka konfirmuar *mos likuidimin* e detyrimit prej BOE të sipërcituar. Në të tilla kushte Bashkia Shkodër me shkresën nr.7106, datë 10.05.2018 ka depozituar kërkesë padinë pranë gjykatës administrative shkalla e parë Shkodër, **çështja është në proces gjyqësor.**

Rekomandimi 3.3.1: Në zbatim të vendimit nr.24, dt.24.01.2018 "Mbi zbatimin e rekomandimit të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së, nr.491/15 dt.30.11.2017 ndaj OE CO1 Rr.K. shpk, me shkresën nr.1656, datë 02.02.2018 i është njoftuar vendimi OE të sipërcituar, me shkresën nr.11117/b dt.13.04.2018 është kërkuar konfirmimi nga drejtoria e të ardhurave nëse është paguar detyrimi prej 1,829,238 lekë. Drejtoria e të ardhurave ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1280/b, datë 26.04.2018 ka konfirmuar *mos likuidimin* e detyrimit prej BOE të sipërcituar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Bashkia Shkodër me shkresën nr.7105 prot,datë 10.05.2018 ka depozituar kërkesë padinë për shpërblimin e dëmit me vlerë 1,829,238 lekë, pranë gjykatës administrative shkalla e parë Shkodër, **çështja është në proces gjyqësor.**

Rekomandim 4.4.1: Në zbatim të vendimit nr.24 dt.24.01.2018 "Mbi zbatimin e rekomandimit të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së, nr.491/15 dt.30.11.2017 ndaj OE CO1 Rr. K. shpk. OE CO1 Rr. K. shpk është njoftuar me shkresën nr.1656, datë 02.02.2018 lidhur me detyrimin të cilin duhet të paguaj pranë Bashkisë Shkodër. Me shkresën nr.11117/b dt.13.04.2018 është kërkuar konfirmimi nga drejtoria e të ardhurave nëse është paguar detyrimi prej 1,355,002 lekë nga OE I sipërcituar. Drejtoria e të ardhurave ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1280/b, datë 26.04.2018 ka konfirmuar *mos likuidimin* e detyrimit. Në të tilla kushte Bashkia Shkodër me shkresën nr.7105 prot,datë 10.0.2018 ka depozituar kërkesë padinë për shpërblimin e dëmit prej 1,355,002 lekë pranë gjykatës administrative shkalla e parë Shkodër, **çështja është në proces gjyqësor.**

Rekomandimi 5.5.1: Në zbatim të vendimit nr.23 dt.24.01.2018 "Mbi zbatimin e rekomandimit të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së, nr.491/15 dt.30.11.2017 ndaj OE K.M K. shpk. Me shkresën nr.1656 dt.2.2.2018 I është njoftuar vendimi OE K.M K. Shpk për shlyerjen e detyrimit prej 275,220 lekë. I është kërkuar drejtorisë së të ardhurave me shkresën nr.11117/b dt.13.04.2018 kemi kërkuar konfirmim drejtorise së ardhurave nëse OE K.M K. shpk. e ka shlyer detyrimin. Me shkresën nr.1280/b dt.26.04.2018 drejtoria të ardhurave konfirmon se OE K.M K. shpk, ka realizuar marrëveshje nr.3301 dt.1.3.2018 për likuidimin e detyrimit me këste, për vlerën totale 615,601 lekë, referuar sistemit të taksave rezulton se OE K.M K. ka paguar shumën prej 275,220 lekë për "*Objektin Mirmbajtje e Rrugve dhe Trotuarve të qytetit, viti 2013*".

Rekomandimi 6.6.1: Në zbatim të vendimit nr.23 dt.24.01.2018 "Mbi zbatimin e rekomandimit të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së, nr.491/15 dt.30.11.2017 ndaj OE K. M. K.shpk. Me shkresën nr.1656 dt.2.2.2018 është njoftuar vendimi OE K.M K. shpk. Me shkresën nr.11117/b dt.13.04.2018 i është kërkuar konfirmim drejtorise së ardhurave nese OE K.M K. shpk. ka shlyer detyrimin prej 106,400 lekë. Me shkresën nr.1280/b dt.26.04.2018 drejtoria të ardhurave konfirmon se OE K.M K. shpk, ka realizuar marrëveshje nr.3301 dt.1.3.2018 për likuidimin e detyrimit me këste, për vleften totale 615,601 lekë , referuar sistemit të taksave rezulton se OE K.M K. ka paguar shumën prej 106,400 lekë për "*Objektin Mirmbajtje e Rrugve dhe Trotuarve të qytetit, viti 2013*"

Rekomandimi 7.7.1: Në zbatim të vendimit nr.23 dt.24.01.2018 "Mbi zbatimin e rekomandimit të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së, nr.491/15 dt.30.11.2017 ndaj OE K. M. K.shpk. Me shkresën nr.1656 dt.2.2.2018 është njoftuar vendimi OE K. M. K.shpk. Me shkresën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

nr.11117/b dt.13.04.2018 I është kërkuar konfirmim drejtorise së ardhurave nëse OE K. M. K.shpk. ka shlyer detyrimin prej 67,760 lekë.Me shkresen nr.1280/b dt.26.04.2018 drejtoria të ardhurave konfirmon se OE K. M. K.shpk, ka realizuar marrëveshje nr.3301 dt.1.3.2018 për likujdimin e detyrimit me këste, për vleften totale 615,601 lekë, referuar sistemit të taksave rezulton se OE K. M. K.ka paguar shumën prej 67,760 lekë për " *Objektin Mirmbajtje e Rrugve dhe Trotuarve të qytetit, viti 2013*"

Rekomandim 8.8.1: Në zbatim të vendimit nr.23 dt.24.01.2018 "Mbi zbatimin e rekomandimit te raportit përfundimtar të auditimit te KLSH-se, nr.491/15 dt.30.11.2017 ndaj OE K. M. K.shpk. Me shkresën nr.1656 dt.2.2.2018 është njoftuar vendimi OE K. M. K.shpk. Me shkresën nr.11117/b dt.13.04.2018 I është kërkuar konfirmim drejtorise së ardhurave nëse OE K. M. K.shpk. ka shlyer detyrimin. Me shkresën nr.1280/b dt.26.04.2018 drejtoria të ardhurave konfirmon se OE K. M. K.shpk, ka realizuar marreveshje nr.3301 dt.1.3.2018 per likujdimin e detyrimit me këste, per vleftën totale 615,601 lekë, referuar sistemit të taksave rezulton se OE K. M. K.ka paguar shumën prej 166,221 lekë për " *Objektin Mirmbajtje e Rrugve dhe Trotuarve të qytetit, viti 2013*"

Rekomandimi 9.9.1: Në zbatim të vendimit nr.29dt.24.01.2018 "Mbi zbatimin e rekomandimit të raportit perfundimtar të auditimit të KLSH-së, nr.491/15 dt.30.11.2017 ndaj OE L. V. shpk. Me shkresen nr.1666 dt.2.2.2018 I është njoftuar vendimi OE L. V. shpk. Me shkresën nr.11117/b dt.13.04.2018 I është kërkuar konfirmim drejtorise së ardhurave nëse OE L. V. shpk. ka shlyer detyrimin. Me shkresën nr.1280/b dt.26.04.2018 drejtoria të ardhurave konfirmon se OE L. V. shpk. nuk ka likujduar detyrimin. Në të tilla kushte Bashkia Shkodër me shkresën nr.7107 dt.10.05.2018 ka depozituar kërkesë padinë shpërblim dëmi me vlerë 457, 216 lekë, pranë gjykatës administrative shkalla e parë Shkodër, *cështja është në proces gjyqësor.*

Rekomandimi 10.10.1: Në zbatim të vendimit nr.27 dt.24.01.2018 "Mbi zbatimin e rekomandimit të raportit perfundimtar të auditimit të KLSH-se, nr.491/15 dt.30.11.2017 ndaj subjektit L. P.. Me shkresën nr.1765 dt.5.2.2018 është njoftuar vendimi subjektit L. P. i cili ka marrë njoftim dt.08.02.2018. Me shkresën nr.11117/b dt.13.04.2018 I është kërkuar konfirmim drejtorisë së ardhurave nëse subjektit L. P., ka shlyer detyrimin prej 127,883 lekë. Me shkresën nr.1280/b dt.26.04.2018 drejtoria të ardhurave konfirmon se subjekti L. P. ka realizuar marrëveshje nr.6394 dt.27.4.2018 per likujdimin e detyrimit me këste. Sipas urdhër pagesave konfirmohet nga drejtoria e të ardhurave se subjekti L. P. ka shlyer detyrimi ne vleften 127,883 lekë, sipas konfirmeve të degës së thesarit të datës 01.10.2018 në shumën 32,000 lekë, datë 02.07.2018 në shumën 32,000 lekë, datë 30.04.2018 në shumën 32,000 lekë, mandat pagesës me nr reference, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

27.12.2018, U. B. në shumën 31,883 lekë.

Masa Displimore: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se me shkresën nr.18568 prot,datë 13.12.2017 është filluar procedura për ecurinë e masave disiplinore prej titullarit të Bashkisë Shkodër, drejtuar Komisionit Disiplinor. Me shkresën nr.18630 prot,datë 14.12.2017 komisioni disiplinor ka njoftuar DAP-in dhe ka kërkuar përcaktimin e përfaqësuesit të tyre. Me shkresën nr.18630/1 prot,datë 14.12.2017 janë njoftuar anëtarët e tjerë të KD. Me shkresën nr.18630/2 prot,datë 14.12.2017 komisioni ka njoftuar fillimin e procedurave për marrjen e masave disiplinore për punojësit z.A. L., z.B. Gj., znj.A. Sh., z.A. K., z.K. K., z.S. Z., z.Z. U., z.V. B. dhe z.N. D.. Për sa u përket punojësve të cilët janë me kod pune janë hartuar vendimet me masa disiplinore dhe konkretisht shkresën me nr.490 prot,datë 13.12.2017, për punoësin Gj. G. me detyrë teknik pyjesh, sektori i shërbimit Pyjor pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor pranë Drejtorisë së Shërbimit Bujqësor dhe Pyjor, institucion i cili është në varësi të Bashkisë Shkodër, me shkresën nr.491 prot,datë 13.12.2017 për punonjësen E. Z. me detyrë Punonjës sekretarie, sektori i lejeve të ndërtimit dhe kontrollit mbi territorin në Drejtorinë e Kontrollit Zhvillimit të Territorit, **masa të cilat janë në proces zbatimi.**

Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E:

1-Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion me shkresën nr.9599/37/1 prot,datë 26.08.2019 rezulton se Njësia e Auditit të Brendshëm, në përputhje me rekomandimet e lëna në raportin final të KLSH-së me nr.491/1 prot,datë 30.11.2017, si dhe në përputhje me urdhrin e brendshëm të titullares së Bashkisë Shkodër, ka kryer auditimin përkatës lidhur me tre rekomandimet e lëna për zbatim dhe në përfundim është hartuar raporti final i auditimit i cili i është dërguar titullares me shkresën nr.21618, datë 28.12.2018 nga ku rezultoi se investimi i kryer nga subjekti "L. 2007" shpk me objekt "Shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane, Njësia Administrative Velipojë", neni 4 i kontratës, është likuqduar në shumën 9,758,551 lekë për afatin 4.33 muaj, në formën e pagesës paradhënie, pa procedura prokurimi. Nga auditimi i kryer i Njesisë së Auditit të Brendshëm është kryer verifikimi i procedurës ku rezultoi se kontrata e sipërcituar i përket ish Komunës, ku krahas kësaj kontrate janë lidhur edhe kontrata të tjera në periudha të ndryshme, të cilat duhet të ishin prokuruar si një e vetme, çka ka sjell edhe vështirësi në përcaktimin e përgjegjësive. Lidhur me sa më sipër ky rekomandim është **i pa zbatuar** dhe do të rikërkohet zbatimi i saj, pasi është kompetencë e Bashkisë Shkodër që të gjej shkaqet dhe përgjegjësitë, pasi me reformën e re territoriale ish Komuna Velipojë është nën juridiksionin e Bashkisë Shkodër.

2-Bashkia Shkodër, ka kryer shpenzime me blerje të vogla ne shkelje të disiplinës financiare jo në përputhje me parimet e Ekonomicitetit, Eficiencës dhe Efektivitetit, të cilat për 3 raste në vlerën prej 60,938 lekë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

kanë sjellë efekte negative financiare në shpenzimet për mirëmbajtje dhe pajisje ambiente zyresh. Nga verifikimi i kryer në dokumentacionin e paraqitur prej Bashkisë Shkodër rezulton se ky rekomandim është **i pa zbatuar** dhe do të rikërkohet zbatimi i saj.

Ligji nr.154/2014,d atë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 15 shkronja (j) “Të drejtat e KLSH” dhe shkresa e dërguar nga KLSH në Bashkinë Shkodër, mbi rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 1005/57, datë 20.12.2018, protokolluar në subjekt me shkresën nr.21353,datë 24.12.2018

Impakti

Mosrealizimi i plotë i rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e mëparshëm

Shkaku

Janë në proces realizimi.

Rëndësia

E lartë.

Rekomandimi:

Bashkia Shkodër të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke ndjekur procedurat administrative dhe ligjore.

Afati për

Menjëherë

zbatim

CI. PËRDORIM JO ME EFIKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET I SHPENZIMEVE NË FUSHËN E PROKURIMEVE PUBLIKE

1.Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër, me kontratën nr. 6325/9, datë 14.06.2016, lidhur me subjektin “L.2007” shpk, ka kontraktuar investimin “*Shërbimi pastrimit të mbetjeve urbane, Njësia administrative Velipojë*”, për vlerën 11,389,518 lekë me tvsh me afat përfundimi deri në datë 10.09.2016 për (89 ditë kalendarike) dhe e likuiduar në masën 100%. Kontrata është lidhur 20 % mbi kontratën bazë, por pa zbatuar afatet kohore past kontrata bazë rezulton e lidhur për 36 muaj, ndërsa shtesë kontrata për 3 muaj, kur afati i shërbimit shtesë duhet të ishte 7.2 muaj (36 muaj x 20%») ose deri më datë 20.12.2016.

Referuar parashikimit të nenit 4 të Kushteve të kontratës bazë dhe duke vlerësuar faktin se, subjekti “L. 2007” shpk është likuiduar me shumën 9,758,551 lekë për afatin 4.33 muaj, rezulton se vlerë e përfituar nga subjekti duhet të ishte likuiduar deri në datën 20.12.2016.

Nga mos zbatimi i kushteve të kontratës dhe mos prokurimi i shërbimit, si dhe referuar në shpjegimet paraqitura nga NJP, personi i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës, por dhe materialeve mbështetëse të dërguara me Projektraportin e Auditimit, subjekti “L. 2007”, ka vazhduar të kryej shërbimin e pastrimit të mbetjeve urbane deri në fund të vitit 2016.

Likuidimi në formën e pagesës paradhënie, pa procedura prokurimi për këtë shërbim, i ka shkaktuar buxhetit të bashkisë mospërdorim me *efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet* të fondeve publike në vlerën 9,758,551 lekë (Trajtuar më llojlësisht në faqet 54-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Bashkia Shkodër, të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë për shpenzimet lidhur me kontratën e shërbimit të pastrimit nr. 6325/9, datë 14.06.2016, lidhur me subjektin “L. 2007” shpk, lidhur deri më 10.09.2016 dhe vazhduar edhe në vitin 2017, duke marrë masa që të mos përsëritet një situatë e tillë në të ardhmen.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër, ka kryer shpenzime me blerje të vogla ne shkelje të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

disiplinës financiare jo në përputhje me parimet e Ekonomicitetit, Eficiencës dhe Efektivitetit, të cilat për 3 raste në vlerën prej **60,938 lekë**, kanë sjellë efekte negative financiare në shpenzimet për mirëmbajtje dhe pajisje ambiente zyrash (*urdhëf shpenzimeve nr. 133 datë 19.03.2014, nr. 136 datë 19.03.2014 dhe nr. 620 datë 28.10.2014*), ku komisioni i blerjeve me vlera të vogla ka s'kualifikuar dhe nuk ka zgjedhur drejt ofertat, në kundërshtim me pikën 1/c kreu II të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin APP nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet nr. 43-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, të analizojë e nxjerr përgjegjësinë për shpenzimet me blerje të vogla jo në përputhje me parimet e Ekonomicitetit, Eficiencës dhe Efektivitetit, të cilat kanë sjellë efekte negative financiare në shpenzimet për mirëmbajtje ambientesh dhe pajisje zyrash në vlerën prej **60,938 lekë**, si dhe të evidentojë përgjegjësinë e anëtarëve të Komisionit me blerje të vogla.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Dajç, janë konstatuar **21 raste pagesash** të kryera me bankën, për blerjet me vlera të vogla, për mallra dhe shërbime, të cilat janë kryer me shkelje procedurash, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me ligjin 131/112 dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, si dhe Udhëzimit nr. 7, datë 20.12.2012, “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin elektronik” (*Trajtuar hollësisht në faqet nr. 147-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër, Sektori i Auditimit të Brendshëm të kryejnë një mision auditimi në ish komunën (NJA) Dajç për periudhën 01.01.2013 deri më datën 30.06.2015, lidhur me ligjshmërinë e kryerjes të pagesave nëpërmjet veprimeve të bankës, përfshirë edhe 21 raste pagesash të konstatuara nga KLSH, duke nxjerrë edhe përgjegjësitë ndaj personave përkatës.

Menjëherë

IV/4- C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në ligjin “Për statusin e Nëpunësit Civil”, nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, i rikërkohet Kryetarit të Bashkisë, fi llimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore st më poshtë:

C.1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së* të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013 datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmar en në komisionin disiplinor në shërbimin civil” **KLSH i ka rekomanduar** Kryetarit të Bashkisë Shkodër, që ti kërkojë Komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, “**Vërejtje**” e parashikuar në nenin 58, germa “a” deri në masën “**Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

pagës për një periudhë deri në 1 vit” e parashikuar në nenin 58, germa “c”, për 12 punonjës.

Nga verifikimi rezulton se për 9 punonjësit është ngritur komisioni i posaçëm, i cili ka filluar procedurat përkatëse lidhur me marrjen e masave disiplinore “Vërejtje”, si më poshtë:

- 1-z.Z. U. me detyrë Përgjegjës, Sektori i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve, Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave
- 2-z.V. B. me detyrë Specialist, Sektori i Ndjekjes së Investimeve, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastruktues.
- 3-z.S. Z. me detyrë Përgjegjës, Sektori i Lejeve të Ndërtimit dhe Kontrollit mbi Territorin, Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
- 4-z.N. D. me detyrë Specialist, Sektori i Koordinimit të Investimeve Bashkiake, Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve
- 5-z.K. K., me detyrë Drejtor, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit
- 6-z.B. Gj., me detyrë Drejtor, Drejtoria e të Ardhurave
- 7-z.A. K., me detyrë Drejtor, Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve
- 8-z.A. L., me detyrë Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës
- 9-znj.A. Sh., me detyrë Drejtor, Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave.

Sipas “Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë” janë rekomanduar 3 **masa disiplinore** nga “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për të cilën Kryetari i Bashkisë Shkodër ka nxjerrë urdhrat sipas rekomandimeve për vetëm 2 punonjës. Nga verifikimi i kryer rezulton se me shkresën nr.18568 prot, datë 13.12.2017 është filluar procedura për ecurinë e masave disiplinore prej titullarit të Bashkisë Shkodër për punonjësit të cilët janë me kod pune, janë hartuar vendimet me masa disiplinore dhe konkretisht shkresën me nr.490 prot, datë 13.12.2017, për punonjësin Gj. G. me detyrë teknik pyjesh, sektori i shërbimit Pyjor pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor pranë Drejtorisë së Shërbimit Bujqësor dhe Pyjor, institucion i cili është në varësi të Bashkisë Shkodër, me shkresën nr.491 prot, datë 13.12.2017 për punonjësen E. Z. me detyrë Punonjës sekretarie, sektori i lejeve të ndërtimit dhe kontrollit mbi territorin në Drejtorinë e Kontrollit Zhvillimit të Territorit. Mungon masa për punonjësin e tretë.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër rezulton me një performancë pozitive përsa i përket realizimit të planit të të ardhurave, të cilat në vitin 2017 janë realizuar në masën 99% dhe në vitin 2018 është realizuar në masën 104%, ndërsa në realizimin e shpenzimeve faktike ka patur një performancë jo të kënaqshme. Për vitin 2017, buxheti faktik është realizuar në masën 76% dhe për vitin 2018 është realizuar në masën 77%. Një ndikim në mosrealizimin e shpenzimeve faktike ka patur zëri “Investime”, i cili në vitin 2017 është realizuar në masën 42.4% dhe në vitin 2018 është realizuar në masën 44%.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 42-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Shkodër, krahas arritjeve në realizimin e të ardhurave të palnifikuara, duhet të marrë masa për analizimin e faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve, kryesisht të investimeve, me qëllim përmirësimin e këtij treguesi i cili ka impakt të drejtëpërdrejtë në përfitimin e shërbimeve nga qytetarët.

Në vazhdimësi

2.Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2018, konstatohet se totali i faturave të palikuiduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën **142,899,482 lekë**, ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën 59,234,048 lekë, për 47 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 37,206,747 lekë, për 118 raste; detyrime për vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 30,098,764 lekë, në 23 raste dhe detyrime të tjera në vlerën 16,359,923 lekë, për 22 raste.

Ndërsa vlera faturave të palikuiduara gjendje në 30.06.2019, të pasqyruara në llog 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën **51,972,676 lekë**, ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën 20,681,950 lekë, në 15 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 837,772 lekë, në 8 raste; detyrime për vendimet e gjykatave të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 28,737,232 lekë, për 20 raste dhe detyrime të tjera në vlerën 1,665,722 lekë, për 2 raste.

Veprimet apo mos veprimet janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 02.06.2016, neni 40⁴⁵ “E drejta për të kryer shpenzime”;

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014;

-Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 73-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës, bazuar në Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pikat 116-117 “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **51,972,676 lekë**, sipas Aneksit bashkangjitur mbi gjendjen e faturave të palikuiduara me datën 30.06.2019, e rakorduar kjo me pasqyrën e dërguar në Ministrinë e Financave.

⁴⁵) Ndryshuar me ligjin nr. 57/2016.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak

3.Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2017, janë mbyllur me vonesë nga Bashkia Shkodër, pasi me shkresën nr.8014, datë 23.05.2018, janë dërguar në Degën e Thesarit Shkodër, pra me mbi dy muaj vonesë. Ndërsa për vitin ushtrimor 2018 janë dërguar me shkresën nr.7026, datë 26.04.2019, konfirmuar nga dega e thesarit me nr.783, datë 30.04.2019, pra me një muaj vonesë.

Veprime në kundërshtime me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, nenin 9, pika 4, germa (d) dhe nenin 12, pika 2, germa (b), si dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 118.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 73-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Nënpunësit autorizues dhe Nënpunësit zbatues të marrin masa për hartimin në afat të pasqyrave financiare, në vitet në vijim.

Në vazhdimësi

4.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e konsoliduara, gjendja e llogarisë 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” në fund të vitit 2017, paraqitet në vlerën 69,305,204 lekë, kurse në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën 123,462,513 lekë, e cila përfaqëson vlerat e studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investime, të kryera gjatë periudhës së auditimit dhe investimeve të kryera ndër vite.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:

-Vlera 15,007,412 lekë, është vlera e projekteve për investime të pa financuara;

-Vlera 77,241,703 lekë, është vlera e projekteve të financuara për investimet në proces;

-Vlera 5,494,886 lekë, është vlera e projekteve të financuara për investimet në proces, nga njësitë vartëse;

-Vlera 25,718,512 lekë i përkasin studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investimet e kryera në periudhën para vitit 2017, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara.

Nga vlera e totale prej 123,462,513 lekë, **duhet sistemuar vlera 25,718,512 lekë** e studimeve dhe projekteve për investimet e kryera ndër vite, në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit. Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, germa “b”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 68-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për vlerën **25,718,512 lekë**, llogaria 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” duhet të pakësohet dhe kjo vlerë të shtohet në investimet e përfunduara sipas objekteve që u përkasin projektet.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

5.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e konsoliduara gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në fund të vitit 2018, paraqitet me një vlerë 6,284,216 lekë e pa ndryshuar, nga viti mëparshëm. Konstatohet se:

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

-Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 48, shtojca me nr.46, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Shkodër, me numur rendor nga 1(një) deri 2160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë). Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 7, pika 1 dhe 2; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV, pika 74 dhe 96.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 73-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit dhe Pyjeve, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për inventarizimin, evidentimin dhe regjistrimin në Pasqyrat Financiare, të pronave , Pyje, kullota, plantacione.

Në vazhdimësi

6.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e konsoliduara gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në pasiv të bilancit në vlerën 67,910,088 lekë, vlerë e cila përfaqëson detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh, deri më 31.12.2018. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:

-Vlera prej 8,059,901 lekë, përfaqëson detyrime të bashkisë ndaj subjekteve, për garanci punimesh të kryera para vitit 2016, paraqitur analitikisht në aneksin nr. 3, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në pasqyrat e konsoliduara gjendja e llogarisë 44 “Institucione të tjera publike” paraqitet në fund të vitit 2017 dhe në fund të vitit 2018 me të njëjtën vlerë prej 3,000 lekë, e cila përfaqëson detyrime të Bashkisë, ndaj shtetit të trashëguar nga Njësia Administrative Shalë, nga viti 2015. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se, vlera prej 3,000 lekë duhet të derdhet në buxhet të shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 73-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 8,059,901 lekë, duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumenteve, me qëllim sistemimin e vlerave përkatëse, sipas objekteve dhe subjekteve, si dhe të marrë masa për të derdhur sistemuar llogarinë 44 “Institucione të tjera publike” duke derdhur në buxhet të shtetit, vlerën prej 3,000 lekë.

Në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

7. Gjetje nga auditimi : Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Shkodër për periudhën objekt auditimi, nuk ka vlerësuar si duhet riskun, dhe për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016, “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën A.3, faqe 30-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Për këtë rekomandimë: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Shkodër të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Përsa i përket “Kapacitetit teknik”, u evidentua fakti se NJP, nuk ka përdorur të njëjtin standard mbi dokumentacionin që duhet të paraqitet nga OE, për automjetin “Autobitumatriçe”. Në DT pika 2.3. “Kapaciteti teknik” në disa raste (procedura) është kërkuar që OE të paraqesë “Certifikatë transporti për mallrat të rrezikshëm” dhe në disa procedura nuk është vendosur ky kriter. Konkretisht, në procedurën me objekt “Rikonstruksion i Rugës Hidrovor Dobraq”, “Asfaltim i Rugës Oblikë-Obot”, “Rikonstruksion Rruga Tepe-Vasijet”, “Rikonstruksion Rruga Tepe-Vasijet” etj, nuk është kërkuar dhe në “Rikonstruksion i Rugës Lugoçesme” “Rruga Rragam-Sheldi”, “Rruga Vllaznimi” etj., veprime në kundërshtim me LPP, nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa d, dhe nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën D2, faqe nr. 95-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme në të ardhmen, duke vendosur në Dokumentet e Tenderit, kërkesa të njëjta për përmbushjen e kriterëve të njëjta për kualifikim, nga ana e Operatorëve Ekonomikë.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Përsa i përket “Kapacitetit teknik”, nga NJP, në DT për të përmbushur kriteret mbi automjetet, janë kërkuar gjithashtu një sërë dokumentesh, ku bën pjesë edhe pagesave e taksave. Kjo kërkesë e NJP, është e panevojshme, pasi paraqitja ose jo e mandatit mbi pagesën e taksave nuk sjell asnjë dobi, veçse bëhet shkak për skualifikim të padrejtë të OE. Fakti që duhet të paraqitet certifikata mbi kontrollin teknik të mjetit, është shterues edhe për dokumentin mbi pagesën e taksave. Në këtë rast NJP, ka vendosur kërkesa të panevojshme mbi përmbushjen e kriterëve për kapacitetin teknik. Ky veprim është në kundërshtim me LPP nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, LPP, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa d dhe neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

(Më hollësisht trajtuar në pikën D2, faqe nr. 95-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme në të ardhmen, duke përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm dhe të duhur, për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, nga ana e Operatorëve Ekonomikë.

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Përsa i përket përmbushjes së kriterit “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, NJP ka kërkuar që OE të paraqesin xhiro mesatare të tre viteve (2014, 2015 dhe 2016), ndërkohë që procedura do të zhvillohet më vitin 2018. Përsa i përket xhiros vjetore, NJP duhet të kërkonte të dhëna mbi xhiron vjetore të viteve 2015, 2016 dhe 2017 dhe pasqyrat financiare të viteve 2014, 2015 dhe 2016, në rast se procedurat zhvillohen përpara mbylljes dhe dorëzimit të pasqyrave financiare në administratën tatimore deri në 31.03.2018, referuar LPP, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, germa c.

(Më hollësisht trajtuar në pikën D2, faqe nr. 95-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit, për të vërtetuar gjendjen dhe kapacitetin ekonomiko-financiar të OE pjesëmarrës në garë, duhet të kërkojnë vërtetim mbi Xhiron Vjetore, apo paraqitjen e Pasqyrave Financiare nga ana e OE, sa më afër kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit, me qëllim marrjen e informacionit sa më real dhe garantimin e zbatimit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në 5 raste nga ana e anëtarëve të KVO-së nuk është nënshkruar: Procesverbali i hapjes së ofertave; Procesverbali i shqyrtimit të ofertave; Raporti Përmbledhës; Formulari mbi konfliktin e interesit. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 64 "Hapja e ofertave", pika 1 dhe neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën D2, faqe nr. 95-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandim: NJP të marrë masa për eliminimin e rasteve të tilla, duke kërkuar jo vetëm plotësimin e dokumentacionit mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit nga ana e KVO-ve, por edhe nënshkrimin e tyre, me qëllim lënien e gjurmës së auditimit mbi veprimet e kryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Shkodër rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 491/15, dalë 30.11.2017, protokolluar në Bashkinë Shkodër me nr. 7802/109, datë 04.12.2017, ndërsa nga Bashkia Shkodër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr. 7802/110, datë 21.12.2017, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 491/16, datë 26.12.2017. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Shkodër është hartuar Plan veprimi, bashkëlidhur shkresës nr. 7802/110 datë 21.12.2017 për zbatimin e rekomandimeve dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete. Bashkia Shkodër me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

shkresën nr. 10633, datë 03.07.2018 “Raportim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga raporti përfundimtar për auditimin e rregullshmërisë dhe përputhshmërisë”, ose me 1 muaj vonesë nga afati ligjor i raportimit, ka raportuar pranë KLSH-së për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve konstatohet se:

- Janë rekomanduar 34 masa organizative, prej të cilave janë pranuar 34 masa, janë zbatuar 12 masa, janë në proces zbatimi 21 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative për të cilën rikërkojmë zbatimin e saj.

- Janë rekomanduar 13 masa për për shpërbllim dëmi në vlerën 12,638,793 lekë, janë pranuar 13 masa, nga ku 8 masa janë zbatuar dhe 5 prej tyre janë në proces zbatimi, dhe deri më datë 31.12.2018 është arkëtuar shuma 4,554,275 lekë, ndërsa shuma 8,084,318 lekë nuk është arkëtuar, pasi janë ende në proces gjyqësor.

- Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-" është rekomanduar që të analizohet një masë në vlerën 9,758,551 lekë, si vlerë e përfituar për tre muaj, kur në fakt duhet të ishte përfituar për 7.33 muaj punë në objektin “Shërbimi pastrimit të mbetjeve urbane, Njësia administrative Velipojë”.

- Bashkia Shkodër, ka kryer shpenzime me blerje të vogla ne shkelje të disiplinës financiare jo në përputhje me parimet e Ekonomicitetit, Eficiencës dhe Efektivitetit, të cilat për 3 raste në vlerën prej 60,938 lekë, kanë sjellë efekte negative financiare në shpenzimet për mirëmbajtje dhe pajisje ambiente zyrash.

- Janë rekomanduar 12 masa disiplinore, nga verifikimi rezulton se për 9 punonjësit është ngritur komisioni i posaçëm i cili ka filluar procedurat përkatëse lidhur me marrjen e masave disiplinore “Vërejtje”, masa të cilat janë në proces zbatimi. Sipas “Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë” janë rekomanduar 3 masa disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” rezulton se me shkresën nr.18568 prot, datë 13.12.2017 është filluar procedura për ecurinë e masave disiplinore prej titullarit të Bashkisë Shkodër, nga ku janë zbatuar 2 masa dhe 1 masë në proces zbatimi.

-Nga 7 masa administrative të rekomanduara rezulton se për 7 persona është vendosur masa dënim me gjobë secili nga 50,000 lekë në shumën gjithsej 350,000 lekë, të cilat janë arkëtuar.

Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe nr. 187-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Duke vlerësuar punën shumë të mirë të bërë në zbatimin e rekomandimeve, i rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë Shkodër të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 491/15, datë 30.11.2017 respektivisht :

-Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-" është rekomanduar që të analizohet në një masë në vlerën 9,758,551 lekë, si vlerë e përfituar për tre muaj, kur në fakt duhet të ishte përfituar për 7.33 muaj punë në objektin “Shërbimi pastrimit të mbetjeve urbane, Njësia administrative Velipojë”.

- Të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë për shpenzimet me blerje të vogla jo në përputhje me parimet e 3E, të cilat kanë sjellë efekte negative financiare në shpenzimet për mirëmbajtje ambientesh dhe pajisje zyrash në vlerën prej **60,938 lekë**, si dhe të evidentojë përgjegjësinë e anëtarëve të Komisionit me blerje të vogla.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

- Për 17 masat të cilat nga auditimi kanë rezultuar të jenë në proces zbatimi, por përtej afateve të përcaktuara në shkresën përcjellëse 491/15, datë 30.11. 2017 të auditimit të mëparshëm, të merren masa për përfundimin e zbatimit të tyre dhe njoftimin KLSH-së.

Brenda datës 31.10.2019

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, nga Titullari i Njësisë Publike, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit. Nëpunësi Zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit **në vlerën 11,870,224 lekë** si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Sektori i Sinjalistikës, Transportit dhe Mobiliteit, Bashkia Shkodër, nuk është vepruar për të pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet dhe vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, si dhe nuk është arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, të trajtuara në aneksin nr.B/4. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, Kapitulli II, pika 1, germa “b” dhe pika 9 dhe të VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar me VKB nr.84, datë 26.12.2017 dhe VKB nr.79, datë 04.12.2018, Kapitulli II.4.5.1, me pasojë për buxhetin e Bashkisë Shkodër, sipas aneksit nr.1, në 8 raste **në vlerën 8,000,000 lekë.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 42-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **8,000,000 lekë**, sipas aneksit nr.1, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, detyrime të pa arkëtuara nga kontratat e qirave.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për planifikimin, realizimin e të ardhurave nga dhënia me qira e asteve, konstatohet se nga Bashkia Shkodër, Zyra e Aseteve, nuk ka kryer



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

plotësisht monitorimin për të arkëtuar detyrimin sipas kontratave të qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Shkodër dhe shoqërive private, për dhënien me qira të aseteve, veprime në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Kapitulli VI, pikat 1,2,9 e 10 (sipas aneksit nr.2) me pasojë, dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë në vlerën 2,524,805 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 42-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimit e shumës **2,524,805 lekë**, sipas aneksit nr.2, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, detyrime të pa arkëtuara nga kontratat e qirave.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion rruga e Shirqit”, Bashkia Shkodër, me vlerë të kontratës (me tvsh) 12,825,002 lekë, fituar nga BOE “S.M.O. V.” shpk & “S. M. O. U.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 731,549 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4032/15, datë 22.06.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe BOE “S.M.O. V.” shpk & “S. M. O. U.” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën D.4, faqet 95-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimit e vlerës prej **731,549 lekë pa TVSH**, nga BOE “S.M.O. V.” SHPK & “S. M. O. U.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4032/15, datë 22.06.2017, me objekt “Rikonstruksion Rruga e Shirqit”, Bashkia Shkodër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Zbatim Rikualifikim Urban blloqe banimi “Tepe-tek Fusha e Druve”, Bashkia Shkodër, me vlerë të kontratës 29,941,160 lekë me TVSH, fituar nga OE “P.V.K.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 243,320 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 13306/33, datë 15.05.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE “P.V.K.” SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën D.4, faqet 95-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimit e vlerës prej **243,320 lekë pa TVSH** nga OE “P.V.K.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 13306/33, datë 15.05.2017, me objekt “Zbatim Rikualifikim Urban blloqe banimi “Tepe-tek Fusha e Druve”, Bashkia Shkodër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes-Qendër Dragoç”, Bashkia Shkodër, me vlerë të kontratës 12,888,162 lekë me TVSH, fituar nga OE “S. M. O. U.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 262,860 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4697/15, datë 31.08.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE “S. M. O. U.” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën D.4, faqet 95-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **262,860 lekë pa TVSH**, nga OE “S. M. O. U.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4697/15, datë 31.08.2018, me objekt “Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes-Qendër Dragoç”, Bashkia Shkodër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion rruga e “Mandave”, Bashkia Shkodër, me vlerë të kontratës 9,085,164 lekë me TVSH, fituar nga OE “D. I.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 107,690 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4032/15, datë 22.06.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE “D. I.” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën D.4, faqet 95-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **107,690 lekë pa TVSH**, nga OE “D. I.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4032/15, datë 22.06.2017, me objekt “Rikonstruksion rruga e “Mandave”, Bashkia Shkodër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C2. SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUNDËRSHTIM ME KËRKESAT LIGJORE TË PROKURIMIT DHE EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1. Për shkak të mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, duke kualifikuar operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë disa nga kriteret e veçanta për kualifikim, të përcaktuara në DT, janë përdorur fonde publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, **në vlerën 148,390,911 lekë pa tvsh.**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik të zhvilluara, u konstatuan shkelje në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 2; nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 66 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

prokurimit publik”, i ndryshuar. Operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DT, të hartuara nga Njësia e Prokurimit e të miratuara nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, duke mos garantuar përmbushjen me cilësi të kontratës në këto tendera, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të vendosura në DT. Procedurat e prokurimit të konstatuara me shkelje, në mënyrë të detajuar janë si më poshtë vijon:

1.1. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Rikualifikimi urban Blloqe banimi, “Bulevardi Zogu I” (Xhabije)”, Bashkia Shkodër, me fond limit 15,766,715 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2018, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “L.” SHPK, & “A. K.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 11,045,648 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DT. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DT, ka shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, **në vlerën 15,766,715 lekë.**

1.2. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Rikonstruksion Rruga Udhakryq”, me fond limit 24,482,500 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE fitues “S. M. O. U.” SHPK & “S. M. O. V.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 20,811,378 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DT. Shpallja fitues e BOE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, ka shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore **në vlerën 24,482,500 lekë.**

1.3. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim rruga nacionale pika Ada-By Pass”, me fond limit 16,197,981 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE fitues “S. M. O. U.” SHPK & “S. M. O. V.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 13,257,923 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DT. Shpallja fitues e BOE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, ka shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën **16,197,981 lekë.**

1.4. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Rikonstruksion Rruga “Rragam-Sheldi”, me fond limit 16,638,245 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE fitues “S. M. O. U.” SHPK & “S. M. O. V.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 11,696,127 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DT. Shpallja fitues e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, ka shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën **16,638,245 lekë.**

1.5. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Rikonstruksion Rruga “Vllaznimi”, me fond limit 17,234,990 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE fitues “N.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 14,422,809 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DT. Shpallja fitues e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, ka shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën **17,234,990 lekë.**

1.6. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Rikonstruksion Rruga “Mushanit seg. I”, me fond limit 9,227,500 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE fitues “A.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 8,055,073 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DT.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

Shpallja fitues e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, ka shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën **9,227,500 lekë**.

1.7. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Rikonstruksion rruges Oblike-Velinaj-Alimetaj”, me fond limit 7,610,563 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE fitues “S. M. O. V.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 6,312,357 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Shpallja fitues e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, ka shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën **7,610,563 lekë**.

1.8. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Rikonstruksion Rruga "Bashej”, me fond limit 6,879,166 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE fitues “B.M-K.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 5,496,456 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Shpallja fitues e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, ka shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën **6,879,166 lekë**.

1.9. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Skema ujitëse Bërdicë-Shkodër”, me fond limit 26,466,971 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “Rr. G.” SHPK & “Sh. A.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 16,326,443 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DT. Shpallja fitues e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, ka shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën **26,466,971 lekë**.

1.10. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Rruga Dhimitër Frangu”, me fond limit 7,886,280 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE fitues “K. G. K.” shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 5,594,337 lekë, e cila nuk plotëson kriteret e vendosura në DT. Shpallja fitues e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, ka shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën **7,886,280 lekë**.

(Më hollësisht gjetjet nga pika 1.1-1.10 janë trajtuar në pikën D.3, faqet 95-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1-10. Për këtë rekomandojmë: Titullari i Autoritetit Kontraktor, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, të cilat çenojnë realizimin në kohë të kontratave dhe nuk japin garanci për kryerjen me cilësi të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

C.3. PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.Gjetje nga auditimi: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

ndikimit në infrastrukturë **966 persona me vlerë 235,048,927 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Shkodër, sipas listës së administruar me CD.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqet 42-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Për këtë rekomandojmë: Bashkia Shkodër, nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave të marrë masa si dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **235,048,927 lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej **4195 subjekte debitorë, për vlerën 543,695,300 lekë** (sipas listave të administruara me CD)

-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimin të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqet 42-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të paarkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura ndaj **4195 subjekteve për vlerën 543,695,300 lekë** (sipas pasqyrave që disponon, marrë në CD), bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”;
- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime;
- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë së Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2018, janë gjithsej **debitorë 37302 familje për vlerën gjithsej 351,468,284 lekë** (për taksë toke në vlerën 12,917,007 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 129,754,321 lekë, për taksë trualli në vlerën 3,516,124 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 205,280,832 lekë), pasi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

nga Drejtoria e të ardhurave nuk janë bërë rakordime periodike me Ujësjetllës Kanalizime Shkodër për familjet të cilat nuk kanë paguar detyrimet sipas kushteve të kontratës ndërmjet tyre. (Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqet 42-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër në bashkërendim me Ujësjetllës kanalizime Shkodër, të marrë masa dhe të kërkojë arkëtimin debitorëve për **37302 familje për vlerën gjithsej 351,468,284 lekë**, sipas të dhënave të disponon, duke dërguar njoftim vlerësimet abonentëve familjarë me postë, për:

- Taksë toke në vlerën 12,917,007 lekë;
- Taksë ndërtese në vlerën 129,754,321 lekë;
- Taksë trualli në vlerën 3,516,124 lekë;
- Tarifa shërbimi në vlerën 205,280,832 lekë.

Menjëherë

VI. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:

Mbi problemet e trajtuara në këtë Projekt Raport Auditimi, janë mbajtur akt-konstatimet akt-vefikimet nga grupi i auditimit, të cilat janë dorëzuar në zyrën e protokollit të Institucionit Bashkia Shkodër sipas të dhënave në pasqyrën e mëposhtme:

Lista e akt konstatimeve

Nr	Emërtimi	Protokolluar në Subjekt nr.datë		Audituesi
1	Akt Konstatimi nr.1, datë 31.07.2019, Buxheti	5597/7	09.08.2019	H. A.
2	Akt Konstatimi nr.2, datë 31.07.2019, Buxhet Fat pa likujduar	5597/8	09.08.2019	“
3	Akt Konstatimi nr.3, datë 31.07.2019, Të ardhura Qira Asete	5597/9	09.08.2019	“
4	Akt Konstatimi nr.4, datë 31.07.2019,T'A Licenca Karburanti	5597/10	09.08.2019	“
5	Akt Konstatimi nr.5, datë 31.07.2019, Pasqyrat Financiare	5597/11	09.08.2019	“
6	Akt Konstatimi nr.6, datë 31.07.2019, NjProkurimit v 2016	5597/12	09.08.2019	B. Z.
7	Akt Konstatimi nr.7, datë 31.07.2019, Regj Prokurim v 2018	5597/13	09.08.2019	“
8	Akt Konstatimi nr.8, datë 01.08.2019, Prokurime v 2018	5597/14	09.08.2019	“
9	Akt Konstatimi nr.9, datë 01.08.2019, Prokurime v 2018	5597/15	09.08.2019	“
10	Akt Konstatimi nr.10, datë 07.08.2019, Kontrolli i brendshem	5597/16	09.08.2019	P. Gj.
11	Akt konstatimi nr.11, datë,07.08.2019, Të ardhurat	5597/17	09.08.2019	“
12	Akt konstatimi nr.12, datë, 08.08.2019, Prokurime v 2019	5597/18	09.08.2019	“
13	Akt konstatimi nr. 13, datë, 09.08.2019, M F K	5597/19	09.08.2019	R. G., F.Ç.
14	Akt konstatimi nr. 14, datë, 09.08.2019, Zbatim Punime	5597/20	09.08.2019	A. Z.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

15	Akt konstatimi nr.15, datë, 09.08.2019, Zbatim Punime	5597/21	09.08.2019	“
16	Akt konstatimi nr. 16, datë 09.08.2019, Zbatim Punime	5597/22	09.08.2019	“
17	Akt konstatimi nr.17, datë, 09.08.2019, Zbatim Punime	5597/23	09.08.2019	“
18	Akt konstatimi nr.18, datë, 09.08.2019, Procedure Prokurimi	5597/24	09.08.2019	“
19	Akt konstatimi nr.19, datë, 09.08.2019, Procedure Prokurimi	5597/25	09.08.2019	R. G.
20	Akt konstatimi nr.20, datë, 09.08.2019, Procedure Prok Blerje	5597/26	09.08.2019	“
21	Akt konstatimi nr.21, datë, 09.08.2019, Procedure Prok Blerje	5597/27	09.08.2019	“
22	Akt konstatimi nr.22, datë, 09.08.2019, Procedure Prokurimi	5597/28	09.08.2019	“
23	Akt konstatimi nr.23, datë, 09.08.2019, Procedure Prokurimi	5597/29	09.08.2019	“
24	Akt konstatimi nr.24, datë, 09.08.2019, Procedure Prokurimi	5597/30	09.08.2019	“
25	Akt konstatimi nr.25, datë, 09.08.2019, Procedure Prokurimi	5597/31	09.08.2019	“
26	Akt konstatimi nr.26, datë, 09.08.2019, Procedure Prokurimi	5597/32	09.08.2019	“
	Lista e akt verifikimeve			
1	Akt Verifikimi nr. 1 per zbatimin e rekomandimeve	5597/33	09.08.2019	“

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë Projekt Raport Auditimi, duhet t’u bëhen prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse nëse kanë,

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

A. Z. (P. Grupi)

H. A.

P. Gj.

R. G.

B. Z.

F. Ç.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

V. ANEKSET:

ANEKSI NR.1.

Pasqyra e detyrimeve të subjekteve që tregtjnë karburante pa pajisur me autorizime periudha 01.01.2017-30.06.2019.

Nr	Subjekti	Administratori	Adresa	Nipti	Vlera
1	"E.-K"shpk	V. G.	Rr Lev Postribes	K71821011C	1,000,000
2	"A." shpk	R. S.	Bul Zogu I	K 04004205V	1,000,000
3	"L - A" shpk	S. L.	Pazari Vjetër	K66816001C	1,000,000
4	"J. P." shpk	D. Gj. C.	Bahçallëk	L22322007I	1,000,000
5	"L - A" shpk	S. L.	Bahçallëk	K66816001C	1,000,000
6	"L. - S" shpk	S. L.	L.Naim Gjylbegu	K36804001I	1,000,000
7	"D." shpk	I. D.	L.S. Halili	K77227001T	1,000,000
8	"A." shpk	Xh. A.	L.Liria	J66703087O	1,000,000
TOTALI					8,000,000

ANEKSI NR.2. Pasqyra e detyrimeve, për vitet 2017,2018 dhe janar –qershor 2019.

Nr	Emri Shoqërisë	Vend ndodhja	Kontrata		Dif për arkëtim në lekë
			Nr	Datë	
1	B. B.	Shkodër	2,946	23.05.2014	2,331,000
2	"I." shpk	Shkodër	650	24.03.2000	193,805
TOTALI					2,524,805

ANEKSI NR.3

Pasqyra e llog. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” para vitit 2016.

	Emertimi	C	Gjendje fillim (A)	Te hyra (B)	Te dala (C)	Gjendje ne fund (D) (A+B-C)
	Derdhje Gabim, Bashkia Shkoder NJ.A	C0839	152935			152,935.00
1	Derdhje Gabim, Bashkia Shkoder C0839		152,935.00		0.00	152,935.00
	Komuna Ana e Malit, Rik Qendra Shendetesore, kod projekti. 1410028	C0514	46,911.00			46,911.00
	Komuna Ana e Malit, Rik i Pjesshem i Sist, kod projekti. M160902	C0514	49,880.00			49,880.00
	Komuna Shosh Plantacione, kod projekt.1410040	C0514	20,679.00			20,679.00
2	Totali C0514		117,470.00		0.00	117,470.00
	Komuna Postribes, Nderim Lulishte, kod projekti. 1410030	C0305	22,386.00			22,386.00
	Komuna Shale, konstruksionin e rrugeve, urave dhe rrjeteve, kod projekti.1410033	C0305	198,336.00		#####	118,536.00
	Komuna Shale, konst i linjes elektrike Nderlysaj-Breglumit, kod projekti. 1410098	C0305	73,800.00			73,800.00
	Komuna Dajç, Rik i rruges se Kishes Shirq, kod projekti.1410020	C0305	131,982.00		#####	49,392.00
	Komuna Dajç, Rik i rruges fshatit Mushan, kod projekti.1410099	C0305	14,781.00		#####	0.00
	Komuna Rrethina Ndriçim Rrugesh, kod projekti. 1410022	C0305	44,940.00			44,940.00
3	Totali C0305		486,225.00		####	309,054.00
	Komuna Postribes, Konstruksione te urave, kod projekti.1410031	C0624	17,848.00			17,848.00
4	Totali C0624		17,848.00		0.00	17,848.00
	Komuna Shale, kod projekti.1410032	C0267	823.00			823.00
5	Totali C0267		823.00		0.00	823.00
	Kom Shale, Konstruksion Rruga Abat, kod projekti.1410034	C1702	20,000.00			20,000.00
	Kom Shale, Riparim Ambjente komuna, kod projekti.1410035	C1702	20,000.00			20,000.00
	Komuna Shale, Riparim kabine, kod projekti.1410036	C1702	20,000.00			20,000.00



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	Kom Shale, Rip Rruga Gimaj, kod projekti.1410037	C1702	20,000.00		20,000.00
6	Totali C1702		80,000.00	0.00	80,000.00
	Komuna Shale lulishtet, kod projekti.1410038	C2986	47,623.00		47,623.00
	Komuna Guri i Zi, Rik rruga Guri i Zi-Rragam, kod projekti.1410086	C2986	271,291.00		271,291.00
	Komuna Shale, ndertim muri mbajtes dhe rehabilitim i rruges Breglumit, kod proj.M160873	C2986	442,305.00		442,305.00
7	Totali C2986		761,219.00	0.00	761,219.00
	Komuna Shale, Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare, kod projekti. M112519	C0787	762,881.00	#####	0.00
	Komuna Berdice Rikonstruksion Rrugesh, kod proj.1410050	C0787	389,984.00	#####	0.00
	Komuna Berdice Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare Berdice, kod proj.M112474	C0787	499,695.00	#####	0.00
	Komuna Rrethina, Rik Rruga Shtoj i vjeter, kod proj.1410064	C0787	17,495.00		17,495.00
	Komuna Rrethina, Rrethim Qendra Shendetesore Hot i Ri, kod proj.1410065	C0787	14,851.00		14,851.00
	Komuna Rrethina, Rrethim Qender shendetesore Golem, kod proj.1410066	C0787	9,109.00		9,109.00
	Komuna Rrethina Hapje pusi shkolla Shtoj i vjeter, kod projekti.1410067	C0787	12,474.00		12,474.00
	Komuna Shale Rik shkolla 9 vjeçare Gjinnaz, kod proj.M112519	C0787	272,121.00	#####	0.00
	Komuna Berdice Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare Berdice, kod proj.M112474	C0787	496,001.00	#####	0.00
	Komuna Shale Rik shkolla 9 vjeçare Gjinnaz, kod proj.M112519	C0787	486,844.00	#####	1.00
	Komuna Rrethina Rikonstruksion Shkollash, kod projekti.1410068	C0787	322,711.00		322,711.00
8	Totali C0787		#####	####	376,641.00
	Komuna Velipoje Rikonstruksion dhe Shtese, kod proj.1410041	C1309	1,278,746.00	#####	0.00
9	Totali C1309		#####	####	0.00
	Komuna Velipoje Ndertim Sistemin i Sheshit, kod proj.1410042	C2734	9,991.00		9,991.00
10	Totali C2734		9,991.00	0.00	9,991.00
	Komuna Velipoje, Sistemim Sheshi Ças, kod projekti.1410043	C1024	112,476.00		112,476.00
	Komuna Velipoje, Shetitorja Velipoje Loti II, kod proj.1410044	C1024	1,355,020.00	#####	0.00
	Komuna Velipoje, Rritja e hapësirave te gjelbra, kod proj.1410045	C1024	23,633.00		23,633.00
	Komuna Guri i Zi, Gjelberim Aksi rrugor Fshati Juban, kod proj.1410081	C1024	23,886.00		23,886.00
	Komuna Guri i Zi, Ndertim ambulanca fshati Rrence, kod proj.M133822	C1024	73,209.00		73,209.00
	Komuna Velipoje, Shetitorja Velipoje Loti II, kod proj.1410017	C1024	448,273.00	#####	0.00
	Komuna Rrethina gp sarr Bleran qender koder, kod proj.1410100	C1024	277,497.00		277,497.00
11	Totali C1024		#####	####	510,701.00
	Komuna Velipoje, Rikonstruksione te ndryshme, viti 2009, kod proj.1410046	C0263	347,891.00		347,891.00
12	Totali C0263		347,891.00	0.00	347,891.00
	Komuna Velipoje Rikonst Qendra Shendetesore, kod proj.M133820	C0752	5.00		5.00
13	Totali C0752		5.00	0.00	5.00
	Komuna Berdice, Rikonstruksione te ndryshme v.2009, kod projekti.1410048	C0178	14,951.00		14,951.00
14	Totali C0178		14,951.00	0.00	14,951.00
	Komuna Berdice, Rikonstr.te ndryshme v.2009, kod proj.1410049	C0598	24,892.00		24,892.00
15	Totali C0598		24,892.00	0.00	24,892.00
	Komuna Berdice Rikonstruksion Shkollash v.2009, kod projekti.M112614	C0609	9,991.00		9,991.00
16	Totali C0609		9,991.00	0.00	9,991.00
	Komuna Berdice, rikonst qendra shendetesore, kod proj.M133821	C0564	49,892.00		49,892.00
	Komuna Berdice, Rikonstruksion gjendja civile v.2009, kod proj.160906	C0564	40,261.00		40,261.00
17	Totali C0564		90,153.00	0.00	90,153.00
	Komuna Dajç, Blerje Kontenijere mbeturinash, kod proj.1410055	C0024	186,960.00		186,960.00
18	Totali C0024		186,960.00	0.00	186,960.00
	Komuna Dajç, Rrethim i shkollës 9 vjeçare Shirq, kod proj.1410056	C0210	105,258.00	#####	0.00
19	Totali C0210		105,258.00	####	0.00
	Komuna Rrethina Rikonstruksion Rrugesh, kod proj.1410058	C0261	434,827.00	#####	0.00
	Komuna Shale, konstruksione te rugeve, kod proj.1410097	C0261	44,820.00		44,820.00
20	Totali C0261		479,647.00	####	44,820.00
	Komuna Rrethina, Sistemim Asfaltim Rruga Nacionale Koplik, kod proj.1410059	C0338	200,038.00		200,038.00
	Komuna Rrethina Sist Asfaltim Rruga Shtoj i Ri-Grude e Re, kod proj.1410060	C0338	749,546.00	#####	0.00
21	Totali C0338		949,584.00	####	200,038.00
	Komuna Rrethina, Sistemim Asfaltim Rruga Dobraq, kod proj.1410061	C0563	199,494.00		199,494.00
	Komuna Rrethina KUZ, kod proj.M063691	C0563	249,180.00		249,180.00
	Komuna Rrethina, Sistemim Asfaltim Rruga Bleran, kod proj.1410062	C0563	197,500.00		197,500.00
22	Totali C0563		646,174.00	0.00	646,174.00
	Komuna Rrethina Sistemim Asfaltim Rruga Domnoreve, kod proj.1410063	C0659	102,881.00	#####	0.00
	Komuna Rrethina Sistemim Asfaltim Rruga Domnoreve, kod proj.1410023	C0659	155,399.00	#####	0.00
	Komuna Rrethina Rikonstruksion Kopshti Dobraq, kod proj.1410024	C0659	109,586.00	#####	0.00
	Komuna Rrethina Rikonstruksion Kopshti Dobraq, kod proj.1410025	C0659	66,391.00	#####	0.00
23	Totali C0659		434,257.00	####	0.00
	Komuna Rrethina, Sistemim Asfaltim mbikalim Hekurudhe-Rruge Nacionale, kod proj.1410069	C0996	395,310.00		395,310.00
24	Totali C0996		395,310.00	0.00	395,310.00



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

	Komuna Rrethina, Sistemim asfaltim rruga Qender Grude, kod proj.1410070	C1263	1,565,600.00	#####	0.00
24	Totali C1263		#####	####	0.00
	Komuna Rrethina, Sistemim Asfaltim Rruga Unaza Rus-Qender, kod proj.1410071	C1268	417,682.00	#####	0.00
25	Totali C1268		417,682.00	####	0.00
	Komuna Rrethina Dyer Shkolle, kod proj.1410072	C1921	16,920.00		16,920.00
	Komuna Rrethina Dritare Shkolle, kod proj.1410073	C1921	17,250.00		17,250.00
26	Totali C1921		34,170.00	0.00	34,170.00
	Komuna Rrethina Nderetim Kabine Shkolla Bleran, kod proj.1410074	C2012	23,919.00		23,919.00
27	Totali C2012		23,919.00	0.00	23,919.00
	Komuna Rrethina Rikonstruksion Shkolla Hot i Ri, kod proj.1410075	C2256	23,993.00		23,993.00
	Komuna Rrethina. Shpim pusi shkolla Shtoj i Ri, kod proj.1410076	C2256	14,986.00		14,986.00
	Komuna Rrethina. Shpim pusi shkolla Bleran, kod proj.1410077	C2256	7,500.00		7,500.00
28	Totali C2256		46,479.00	0.00	46,479.00
	Komuna Rrethina Master Plan, kod proj.1410078	C2993	3,307,200.00		3,307,200.00
29	Totali C2993		#####	0.00	3,307,200.00
	Komuna Guri i Zi, Hartim Projekti Fshati Juban, kod proj.1410081	C2013	118,400.00		118,400.00
30	Totali C2013		118,400.00	0.00	118,400.00
	Komuna Guri i Zi, Gjelberim aksi rrugor, kod proj.1410082	C2499	23,910.00		23,910.00
	Komuna Guri i Zi, gjelberim sistemim te sheshi Nene Tereza, kod proj.1410083	C2499	23,916.00		23,916.00
31	Totali C2499		47,826.00	0.00	47,826.00
	Komuna Guri i Zi, Gjelberim Lagjja Gjuraj, Fshati Juban, kod proj.1410084	C2718	23,918.00		23,918.00
	Komuna Guri i Zi, Mbjellje pemesh oborri i shkolles, kod proj.1410085	C2718	15,889.00		15,889.00
32	Totali C2718		39,807.00	0.00	39,807.00
	Komuna Guri i Zi, Rikonstruksion ambulanca fshati, kod proj.M132918	C0724	10,000.00		10,000.00
33	Totali C0724		10,000.00	0.00	10,000.00
	Komuna Pult Rik Rruga Bruçaj, kod proj.1410026	C2299	86,300.00		86,300.00
	Komuna Pult Rik Rruga Bruçaj, kod proj.1410101	C2299	7,636.00		7,636.00
34	Totali C2299		93,936.00	0.00	93,936.00
	Komuna Guri i Zi Rik Rruga Rragam, kod proj.1410027	C3524	9,700.00		9,700.00
35	Totali C3524		9,700.00	0.00	9,700.00
	Komuna Berdice Mirmbajtje kanalesh,kod.proj.1410018	C1822	30,597.00		30,597.00
36	Totali C1822		30,597.00	0.00	30,597.00
					0.00
		-	#####	##	8,059,901.00

ANEKSI NR.4

Pasqyra e realizimit të Investimeve për vitin 2017 me burim financimi burimet e veta

Në lekë

Plani	Fakti	Realizimi ne %	Pershkrimi
1,973,120	1,173,120	59.5%	Blerje pajisje te ndryshme
11,481,423	6,622,223	57.7%	Rikonstruksion rrjeti elektrik godina qender e Bashkise Shkoder
1,600,000	1,599,600	100.0%	Blerje automjete ne funksion te administrates
3,887,000		0.0%	Blerje Paisje TIK
2,514,042	264,236	10.5%	Ndert rrjetit brendsh komunikimit elektronik (intranet) ne 3 Nj A, 5 lagje
200,000	161,880	80.9%	Blerje Vegla Pune
6,049,092	5,966,142	98.6%	Zgjerimi i rrjetit kompjuterik (Intranet) për komunikimin elektronik të brendshëm, implementimi i Sistemit të Kontrollit të Aksesit dhe Sistemit të Vëzhgimit (Bashkin Qendër)
3,948,000	3,436,678	87.0%	Ndertim sistemit dixhital konferences regji audio sall kesh bashkiak
2,744,000	2,742,756	100.0%	Rikonstruksion i godines Nj.A Gur i Zi
4,920,000	4,920,000	100.0%	Implementimi sistemit informac mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore
644,000		0.0%	Implementimi i sistemit te Menaxhimit te Dokumentave ne nje baze te dhenash qendrore te qenderzuar dhe te integruar
8,400		0.0%	Kolaudim rikonstruksion godina komune 2014
39,969,077	26,886,635	67.3%	Prog.1110/1+5/231
93,600	93,600	100.0%	Rikonstruksion I rrjetit elektrik godina e Bashkise Shkoder
93,600	93,600	100.0%	Prog.1110/5/230
11,672,485	-	0.0%	Rehabilitim dhe risistemim i Merkatos Rus
2,500,000		0.0%	Ngritja e tregj ditore,zbatimi i projektit npm rregullim i sinjalistikes,vijezime dhe sherb.te tj mbeshtet
14,172,485	-	0.0%	Prog.4130/1/231
10,116,635		0.0%	Rikonstruksion rruga "Sami Repishti"
9,661,129		0.0%	Rikonstruksion rruga "Dhimiter Frangu"
11,297,341		0.0%	Rikonstruksion rruga "Pjeter Spani"
36,236,000	24,450,322	67.5%	Rikonstruksion rruga "Dracin" (faza e dyte)
5,542,000	4,065,283	73.4%	Rikonstruksion rruga "Memorandumi Greces"
14,039,000	9,110,363	64.9%	Rikonstruksion rruga "Mandave"
14,287,700		0.0%	Rikonstruksion rruga "Qyteza e Gajtanit"
8,384,000		0.0%	Rikonstruksion rruga "Osja Falltores" (blloqe pallatesh)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

3,632,000		0.0%	Rikualifikim urban blloqe banimi "Tepe" (tek Vasiejt)
17,584,682	17,463,057	99.3%	Rikualifikim urban I rrugicave historike ne Qendren Historike (Rikonstrukcion I sistemit ujsjelles kanalizime)
666		0.0%	Konstruksione te rrugeve Nj.A.Velipoje
48,240		0.0%	Kontrate mbikqyrje Sup SARR Bardhaj Koder II
15,000		0.0%	Kontrate kol Kol SARR Bardhaj Koder II,
26,622		0.0%	Kontrtae kolKol SARR Shtoj I Ri - Grude e Re
14,710		0.0%	Kontrate Kolaudimi Kol Investim Gjelberim
19,900		0.0%	Kontrate Kolaudimi Kol SARR Dobrac-Rus II
64,800	64,800	100.0%	Supervizim Mbikqyrje Rik Rrugesh kryesore
83,900		0.0%	Kontrate Kol SARR Grude Vinoteke
250,000		0.0%	Kontrate mbikqyrje SARR RR,Na - Golem
34,400		0.0%	Kontrate Kol SARR RR,Na - Golem
16,000		0.0%	Kontrate kolaudimi Kol SARR Bardhaj Koder I
21,056		0.0%	Rikonstrukcion degezim rruga Pal Engjelli (Supervizimi)
2,000		0.0%	Supervizim Trotuare seg qytet Don Bosko
5,540		0.0%	Kolaudim Sistemim asfaltim Industrial I
38,000		0.0%	Supervizim Rr.Beselidhja (20% shtese)
19,500		0.0%	Kolaudim Sistemim sheshi pallati sportit
50,000		0.0%	Kolaudim rr.Artistike
10,680		0.0%	Supervizim Rr.Pjeter Gjoka
5,702		0.0%	Supervizim Rik rruga Danja 20% shtese kontrate
10,093		0.0%	Kolaudim Rik rr.Babej
14,400		0.0%	Kolaudim Rik rr.Anton Mazreku
11,743,000		0.0%	Asfaltim vazhdim i rruges Oblike-Obot
7,265,000		0.0%	Rikonstrukcion i rruges se varrezave Beltoje
8,611,000		0.0%	Rikonstrukcion i rruges se Mushanit-Segmenti I
5,306,000		0.0%	Ndertim trotuari nga kanali deri tek kisha,Sektori Velipoje
12,602,000		0.0%	Sistemim asfaltim rruge "Dod Carri",Shtoj i Ri
6,675,000		0.0%	Sistemim asfaltim rruga Qender Mes-Qender Dragoc
2,478,061	2,478,061	100.0%	Rikonstrukcion rruge Degëzim "Isuf Sokoli"
4,955,136	4,955,090	100.0%	Rikonstrukcion rruge "Qazim Llazani"
13,002,318	9,203,652	70.8%	Rikualifikim urban blloqe banimi Qemal Dracini
7,104,760	4,812,009	67.7%	Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bardeleve" (Pogej)
35,548,000	30,019,042	84.4%	Rikualifikim urban blloqe banimi tepe-te fusha e druve
697,000		0.0%	Mbikqyrje rikonstrukcion blloqe banimi pallatet Xhabiej
1,108,732		0.0%	Kontrate shtese Bardhaj koder II 20%
8,327,000	5,135,119	61.7%	Rik rr Oblike-Velinaj-Ali Metaj (segm F Cunit-Kryq L Garuc)
5,724,504	5,724,504	100.0%	Rikonstrukcion rruga Gjomarkaj
262,679,207	117,481,302	44.7%	Prog. 4530/1+5/231
539,000	534,000	99.1%	Rikonstrukcion rruga "Sami Repishti"
469,000	462,000	98.5%	Rikonstrukcion rruga "Dhimiter Frangu"
586,000	576,000	98.3%	Rikonstrukcion rruga "Pjeter Spani"
641,000	636,000	99.2%	Rikonstrukcion rruga "Qyteza e Gajtanit"
207,000	204,000	98.6%	Rikualifikim urban blloqe banimi "Tepe" (tek Vasiejt)
631,000	612,000	97.0%	Asfaltim vazhdim i rruges Oblike-Obot
429,000	420,000	97.9%	Rikonstrukcion i rruges se varrezave Beltoje
488,000	486,000	99.6%	Rikonstrukcion i rruges seMushanit -Segmenti I
337,000	336,000	99.7%	Ndertim trotuari nga kanali deri tek kisha,Sektori Velipoje
535,000	474,000	88.6%	Sistemim asfaltim rruga "Dod Carri",Shtoj i Ri
384,000	342,000	89.1%	Sistemim asfaltim rruga Qender Mes-Qender Dragoc
2,000,000	2,000,000	100.0%	Studime dhe projektme ne bashkefinancim me FZHR
162,000	162,000	100.0%	Rikonstrukcion rruga Gjomarkaj
3,010,800	2,976,000	98.8%	Rik i rruges se hidrovorit-Dobrac NjA Rrethina Projektim
348,000	278,304	80.0%	Studim Projektim Rikonstrukcion rruga memorandumi i Greces
640,000	345,475	54.0%	Rikualifikim urban blloqe banimi Zogu i I (Xhabiej)
1,256,000	779,100	62.0%	Rikualifikim urban blloqe banimi Qemal Dracini.tek sahati
1,444,891		0.0%	Proj "rik urban rr qendr historik sipas marreveshjes me FSHZH
435,000		0.0%	Projektim rikonstrukcion rruga"Bashej"
348,000		0.0%	Projektim rikonstrukcion rruga"Kaçelej"
236,000		0.0%	Projektim rikonstrukcion rruga " Karinëve "
275,515		0.0%	Projektim rikonstrukcion rruga "Vllaznimi"
534,000		0.0%	Proj rikualifi urb bllok banimi " Qemal Draçini "(Pallat Pyjores)
469,000		0.0%	Proraj rikualif urban blloqe banimi " Europa "(tek ish Podgorica)
16,405,209	11,622,879	70.8%	Prog.4530/1/230
4,688,000		0.0%	Ndert kanal ujrave bardha, zeza,dalja shina tren lum Kir (faza 2)
4,688,000	-	0.0%	Prog.6370/1/231
8,950,000		0.0%	Blerje kazana, Sherbimi I pastrimit
879,000		0.0%	Ndertim xhepa kazanash per mbeturina
250,000		0.0%	Blerje pajisje elektronike per monitorim
10,102,906	5,977,109	59.2%	Investime ndricim rruge dytesore + mbikqyrje
2,093,000	2,074,560	99.1%	Zevendesimi i ndricuesve te demtuar (dekorativ+zinkat)
700,000	667,814	95.4%	Riparim dhe lyerje ndricuesish ne pedonale Velipoje



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

2,514,171		0.0%	Ndricim i rruges Dr.Ali Spahija
1,721,123		0.0%	Ndricim i rruges Malo Hoxha ne Nj.A Berdice
11,600,000		0.0%	Ndertim parcela te reja varresh Varreza Nj.A Rrethina
2,383,000		0.0%	Rrethim parceles se shproneluar Varreza Nj.A.Rrethina
360,000	174,666	48.5%	Tabelat e lajmerimeve
432,000	396,000	91.7%	F.V Kosha mbeturinash per lulishte
2,000,000		0.0%	Krijimi i siperfaqeve te gjelberta ne Nj.A
3,200,000		0.0%	Krijimi siperfaqe e gjelbert ne qytet,Lulishte Pazar
740,000	548,400	74.1%	Pajisje prerese bari per Nj.A
38,206,871	3,449,982	9.0%	Shkrese Nr 9305 dt 27.07.2016 shpronesime
86,132,071	13,288,531	15.4%	Prog.6260/1+5/231
267,000	204,366	76.5%	Studim projektim ndricim rruge dytesore
214,000	164,296	76.8%	Ndricim i rruges Dr.Ali Spahija
166,000	127,026	76.5%	Ndricim i rruges Malo Hoxha ne Nj.A Berdice
647,000	495,688	76.6%	Prog.6260/1/230
397,853	397,853	100.0%	Proj Rik god Teatrit " Migjeni".50% e 3978526 marre FSHZH
397,853	397,853	100.0%	Prog.8250/1/230
2,052,000	2,052,000	100.0%	F.V Kufizues shpejtesie (bumpe gome)
2,631,360		0.0%	F.V kufizues trafiku me tampon bllokues,territori i bashkise
600,000	522,000	87.0%	Blerje pajisje pune
4,797,600	4,797,600	100.0%	Blerje makine vijezi
10,080,960	7,371,600	73.1%	Prog.4570/1+5/231
250,000		0.0%	Blerje Pajisje TIK
250,000	-	0.0%	Prog.10430/1+5/231
3,000,000		0.0%	Projekt-studim trafiku (levizshmeria dhe semaforet)f vendosje
3,000,000	-	0.0%	Prog.4570/1+5/230
339,600	339,600	100.0%	Konc prodh stende leviz pjesëmarrje akt promovim destinacionit
160,000		0.0%	Paj zyres infor turist Theth mat funksionale dhe promocionale
700,000		0.0%	Ngritja strukture te levizshme ballkon jugperendimore i kalase
1,199,600	339,600	28.3%	Prog.4760/5/231
400,000		0.0%	Hartimi i planit te sinjalistikës turistike te Bashkise Shkoder
400,000	-	0.0%	Prog.4760/5/230
4,200,000		0.0%	Projekte teknike te ndryshme per riaftesimin e kanaleve kulluese
4,200,000	-	0.0%	Prog.4240/5/230
2,000,000	1,279,362	64.0%	Zbatim projekteve teknike per mbrojtjen tokes bujq na erozioni
2,000,000	1,279,362	64.0%	Prog.4240/5/231
3,000,000	2,003,562	66.8%	Ndertim prita malore ne Njesite Administrative
1,000,000	750,041	75.0%	Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota ne NJA
4,000,000	2,753,603	68.8%	Prog.4260/5/231
140,000		0.0%	Blerje tabela portative dhe fushe portative basketbolli
140,000	-	0.0%	Prog.8140/5/231
22,000		0.0%	Kolaudim Rik.Shk Skenderbeg
182,000		0.0%	Supervizim shk.Skenderbeg
226,412	215,478	95.2%	Supervizim Shkolla 9 vjecare Shiroke
98,600	98,600	100.0%	Supervizim konvikti shkolle e mesme qytet
529,012	314,078	59.4%	Prog.9240/5/231
1,734,542		0.0%	Rikonstruksion KUB lidhja e kolektorit Perash-Unaze
1,734,542	-	0.0%	Prog.6330/1+5/231
9,099,000		0.0%	Studim projektim
9,099,000	-	0.0%	Prog.6140/5/230
900,000		0.0%	Blerje agregat per prerje ferrash
2,200,000		0.0%	Blerje mjet transporti 8-10 ton
3,100,000	-	0.0%	Prog.4520/1/231
464,917,616	182,324,731	39.2%	TOTALI Bashkia Qender me burimet e veta
2,540,706	-	0.0%	Blerje Pajisje TIK
1,000,000		0.0%	Implement qend b Sh Micro Mail Server bazuar ne Cloud
1,370,300	1,321,180	96.4%	Nd rrj brendsh elektronik (intranet) ne 5 Njesi Administrative
4,911,006	1,321,180	26.9%	Prog.1110/6/231
2,040,000	1,866,318	91.5%	Zb projekteve teknike per mbrojtjen tokes bujqes nga erozioni
2,040,000	1,866,318	91.5%	Prog.4240/6/231
800,000		0.0%	Proj ndryshme teknike per riaftesimin e kanal kull
800,000	-	0.0%	Prog.4240/6/230
7,751,006	3,187,498	41.1%	Totali kap Bashkia Qender nga donatoret
60,000	58,788	98.0%	Pajisje per sistemin e sigurimit Muzeu i Kalase dhe Oso Kuka
60,000		0.0%	Blerje Pajisje TIK
150,000		0.0%	Prodhim dhe vendosje e suporteve metalike ne Muzeun Oso Kuka
1,000,000		0.0%	Rikonstruksioni i salles B- sala e vogel e Galerise se Arteve
3,700,000	3,367,790	91.0%	Nje piano per qytetin e artit
100,000		0.0%	Realizim duralumini me xhama te Qendra Kulturore P.Gaci
1,555,000		0.0%	Blerje impiant audio,sistem ndricimi dhe pod per koncert live
215,000		0.0%	Blerje te instrumentave muzikore



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin në Bashkinë Shkodër.

1,469,424	469,424	31.9%	Zhvillimi pasurim fondit bibliotekes Blerje libra, revista,
575,000	565,200	98.3%	Sistem kondicionimi dhe kondicionere
100,000		0.0%	Blerje ekspozitresh
29,520	29,520	100.0%	Rinovim i ekspozites fotografike me materiale te reja
376,985	376,985	100.0%	Zhvillimi dhe pasurimi i fondit te bibliotekes Blerje libra, revista
9,390,929	4,867,707	51.8%	Prog.8250/1+5/231
300,000	220,210	73.4%	Nje piano per qytetin e artit
300,000	220,210	73.4%	Totali DEK kap 6 Prog.8250/6/231
9,690,929	5,087,917	52.5%	Totali Dek
1,745,200	1,614,000	92.5%	Blerje paisje orendi
